



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

PROVIMI I SHTETIT
FONDI I PYETJEVE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR
TË PSIKOLOGUT

KAPITULLI I
FUSHA E BIOPSIKOLOGJISË

1. Sistemi nervor, endokrin dhe bashkëveprimi i trashëgimisë me mjedisin

Pyetja 1

Njësia bazë e sistemit nervor është:

- A) Truri
- B) Palca kurrizore
- C) Sinapsi
- D) Neuroni

Pyetja 2

Ku i çlirojnë hormonet gjëndrat endokrine?

- A) Në muskul
- B) Në inde
- C) Në gjak
- D) Në sinaps

Pyetja 3

Pjesa e neuronit që kap mesazhet hyrëse quhet:

- A) Askon
- B) Këllëf myeline
- C) Dentrit
- D) Nerv

Pyetja 4

Cilin hormon sekretojnë vezoret?

- A) Melatoninën
- B) Insulinën
- C) Glukagonin
- D) Estrogjenin

Pyetja 5

Në cilën pjesë të neuronit impulsi elektrik nervor çliron neurotransmetuesit?

- A) Dentritet
- B) Aksonet
- C) Bërthamat e neuronit
- D) Nyjet terminale

Pyetja 6

Nxitja e neuronit që krijon ngarkesë elektrike quhet:

- A) Potencial
- B) Potencial i shkallëzuar
- C) Potencial pushimi
- D) Potencial veprues

Pyetja 7

Neuronet që mbartin mesazhet nga një neuron tek një tjetër quhen neurone:

- A) Shqisore
- B) Aferente
- C) Shoqëruese
- D) Motore

Pyetja 8

Cilat valë prodhohen në tru kur personi është duke lexuar?

- A) Alfa
- B) Beta
- C) Theta
- D) Delta

Pyetja 9

Pankreasi rregullon nivelin _____ në gjak.

- A) Glukozës
- B) Kalciumit
- C) Fosfatit
- D) Natriumit

Pyetja 10

Pjesën më të madhe të trurit e zë:

- A) Korja e trurit
- B) Talamusi
- C) Hipotalamusi
- D) Hipofiza

Pyetja 11

Cila pjesë e trurit është përgjegjëse për ekuilibrin dhe koordinimin e lëvizjeve të trupit?

- A) Truri i mesëm
- B) Truri i madh
- C) Truri përparmë
- D) Truri i vogël

Pyetja 12

Nervi dëgjimor i përcjell mesazhet deri në lobin:

- A) Parietal
- B) Temporal
- C) Frontal
- D) Oksipital

Pyetja 13

Cili lloj shurdhimi dobëson dëgjimin për tinguj të të gjitha frekuencave?

- A) I përçueshmërisë
- B) I nervit
- C) I membranës
- D) I daulles

Pyetja 14

Cilët lloj nervash përmbajnë vetëm dendrite dhe mbartin mesazhe nga receptorët për në sistemin nervor qendror?

- A) Motorre
- B) Ndjesore
- C) Mielenike
- D) Mikse

Pyetja 15

Cili sistem nervor përfshin nervat që i shërbejnë sistemit muskulozor-eshtëror?

- A) Somatik
- B) Autonom
- C) Vegjetativ
- D) Simpatik

Pyetja 16

Cili lob i trurit është përgjegjës për perceptimin pamor?

- A) Temporal
- B) Oksipital
- C) Parietal
- D) Frontal

Pyetja 17

Sëmundja e Parkinsonit shkaktohet nga pamjaftueshmëria e:

- A) Dopaminës
- B) Endofrinës
- C) Glicinës
- D) Serotoninës

Pyetja 18

Sëmundja e Alzheimer shkaktohet nga një mangësi e neurotransmetuesve:

- A) Norepinefrinë
- B) Serotoninë
- C) Acetilolinë
- D) Dopaminë

Pyetja 19

Dëmtimet në zonën Broka ndikojnë në:

- A) Aftësinë për të kuptuar gjuhën e shkruar
- B) Aftësinë për të kuptuar gjuhën e folur
- C) Aftësinë për të folur
- D) Aftësinë për të shkruar

Pyetja 20

Palca kurrizore lidhet me trurin me anë të:

- A) Urës
- B) Korpus kallosum
- C) Palcës së zgjatur
- D) Shtyllës së trurit

2. Zhvillimi para lindjes

Pyetja 1

Periodha e embrionit ka një kohëzgjatje nga implantimi deri:

- A) Në javën e tretë të shtatzanisë
- B) Në javën e tetë të shtatzanisë
- C) Në javën e katërt të shtatzanisë
- D) Në javën e pestë të shtatzanisë

Pyetja 2

“Ektoderma” quhet shtresa e jashtme e diskut embrional që formon:

- A) Sistemin muskolor-kockor dhe organet vitale
- B) Sistemin visual-dëgjimor
- C) Sistemin nervor, lëkurën dhe flokët
- D) Sistemin tretës, mëlçinë dhe pankreasin

Pyetja 3

Në muajin e shtatë dhe të tetë të shtatzanisë, ndodh zhvillimi seksual i embrionit në formën e një kreshte gjenitale të quajtur:

- A) Gonadi diferent
- B) Gonadi primitiv
- C) Gonadi indiferent
- D) Gonadi diversiv

Pyetja 4

Me termin “teratogjen” kuptohet:

- A) Çdo element që ndikon në shëndetin e nënës
- B) Çdo agjent dhe element mjedisor që ndikon në zhvillimin e fetusit
- C) Çdo element fizik në mjedisin intrauterin
- D) Çdo sëmundje që mund të prekë nënën gjatë periudhës së shtatzanisë

Pyetja 5

Studimet kanë treguar se nënat mund të kenë konsumuar alkool gjatë shtatzanisë, foshnjat e tyre:

- A) Do të kenë dëmtime neurologjike
- B) Do të kenë dëmtime fizike

- C) Do të kenë dëmtime kardiovaskulare
- D) Do të kenë dëmtime të inteligjencës dhe procesimit të informacionit

Pyetja 6

Studimet kanë treguar se ndër SST-të më serioze të trasmetuara te gratë shtatzanë në shek.XX është:

- A) Sifilizi
- B) Sindromi i imuno deficiencës së akuizuar
- C) Klamidia
- D) Gonorrea

Pyetja 7

Nëse merren gjatë tremujorit të parë të shtatzanisë pa rekomandim mjeku, barnat që përmbajnë litium:

- A) Shkaktojnë depresion post-partum
- B) Rrezikojnë sjelljen në jetë të fëmijës nën-peshë
- C) Shkaktojnë deficite në zhvillimin e zemrës së bebit
- D) Shkaktojnë deficite në zhvillimin e trurit të bebit

Pyetja 8

Fëmijët e nënave që kanë qenë abuzuese me alkoolin gjatë shtatzanisë kanë probabilitet të lartë për:

- A) Sindromi nalkoolik fetal
- B) Sindromin Wernicke-Korsakoff
- C) Deficiencë të vitaminës B
- D) Sindroma Boerhaave

Pyetja 9

Të dhënat e Imazherisë së Resonancës Magnetike kanë treguar se fëmijët deri në 6 vjeç të ekspozuar ndaj alkoolit kanë më shumë gjasa të shfaqin:

- A) Simptoma të Ankthit të Përgjithësuar
- B) Simptoma të Demencës Infantile
- C) Simptoma të Depresionit Madhor
- D) Simptoma të Çrregullimit Bipolar II

Pyetja 10

Në hulumtimet e tyre Schuetze dhe Zeski zbuluan se tymosja e duhanit te gratë shtatzana është e lidhur me:

- A) Lindjen e fëmijës nën peshën normale
- B) Lindjen e parakohshme
- C) Lindjene fëmijës me probleme të frymëmarrjes
- D) Lindjen e fëmijës me reduktim të aktivitetit të sistemit nervor autonom

Pyetja 11

Foshnjat me peshë shumë të ulët gjatë lindjes quhen:

- A) Ato që peshojnë rreth 2500 gr.
- B) Ato që peshojnë rreth 2000 gr.
- C) Ato që peshojnë nën 1500 gr.
- D) Ato që peshojnë nën 1000 gr.

Pyetja 12

Bastra, Hadders-Algra dhe Neeleman në studimet e tyre gjetën që tymosja e duhanit nga gratë shtatzëna lidhet me:

- A) Shfaqjen e Çrregullimit të Hiperaktivitetit dhe Deficitit të Vëmendjes në fëmijëri
- B) Psikozat infantile
- C) Depresionin infantil
- D) Çrregullimin e Personalitetit Skizoid

Pyetja 13

Përdorimi i mariuhanës nga grate shtatzëna lidhet drejtpërdrejtë me:

- A) Shfaqjen e Sindromit Kanaboid Hiperemesis të foshnjat
- B) Delirium nga Intoksikimi i Kanabisit të foshnjat
- C) Çrregullime të Ankthit të shkaktuara me përdorimin e Kanabisit të foshnjat
- D) Simptoma e vështërsisë së frymëmarrjes të foshnjat

Pyetja 14

Studimet kanë treguar se rreziqet për fetusin rriten nëse moshë e nënës është:

- A) Më e vogël se 15 vjeç dhe më e madhe se 35 vjeç
- B) Më e vogël se 15 vjeç dhe më e madhe se 40 vjeç
- C) Më e vogël se 10 vjeç dhe më e madhe se 35 vjeç
- D) Më e vogël se 10 vjeç dhe më e madhe se 40 vjeç

Pyetja 15

Me termin “holofrazë” kuptojmë:

- A) Shprehjen e një ideje a fjalie vetëm përmes një fjale të foshnjat
- B) Shprehjen e një ideje a fjalie vetëm përmes një fjale të fëmijët
- C) Shprehjen e një ideje a fjalie vetëm përmes një fjale të adoleshentët
- D) Shprehjen e një ideje a fjalie vetëm përmes një fjale të prindërit

3. Proceset ndijore

Pyetja 1

Si quhet tingulli që kapet vetëm nga njëri vesh?

- A) Fonik
- B) Monofonik
- C) Bifonik
- D) Trifonik

Pyetja 2

Cili organ shqisor ka si receptorë konet?

- A) Syri
- B) Veshi
- C) Hunda
- D) Gjuha

Pyetja 3

Në cilin lob të trurit interpretohet të shijuarit?

- A) Parietal
- B) Temporal

- C) Frontal
- D) Oksipital

Pyetja 4

Cila shqisë na jep informacion për pozicionin tonë në hapësirë?

- A) Kinestetike
- B) Vesibulare
- C) Haptike
- D) Kimike

Pyetja 5

Në sa pjesë kryesore ndahet veshi i njeriut?

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5

Pyetja 6

Ku gjenden fotoreceptorët?

- A) Në lëkurë
- B) Në veshin e brendshëm
- C) Në retinë
- D) Në gjuhë

Pyetja 7

Njerëzit me shikim normal të ngjyrës quhen:

- A) Kromatë
- B) Monokromatë
- C) Dikromatë
- D) Trikromatë

Pyetja 8

Kur një ngacmues që ka shkaktuar një herë ndijim fillon të bëhet më pak efektiv, atëherë themi se ka ndodhur:

- A) Shndërrimi shqisor
- B) Përshtatja shqisore
- C) Transduksioni shqisor
- D) Ndryshimi shqisor

Pyetja 9

Cilës shqisë i referohet shqisa haptike?

- A) E të prekurit
- B) E të ftohtit
- C) E të ngrohtit
- D) E dhimbjes

Pyetja 10

Sasia minimale e energjisë fizike që duhet për të prodhuar një ndijim quhet:

- A) Prag linear
- B) Prag i ndryshimit
- C) Prag absolut

D) Prag i zakonshëm

Pyetja 11

Si quhet numri i cikleve të presionit zanor për sekondë?

- A) Volum
- B) Timbër
- C) Amplitudë
- D) Frekuencë

Pyetja 12

Cili organ përmban receptorët dëgjues?

- A) I kudhrës
- B) I daulles
- C) I yzengjisë
- D) I kortit

Pyetja 13

Nervi zanor i përcjell sinjalet ndjesore aferente që lindin në _____ për në qendrat nervore.

- A) Aparatin e kortit
- B) Aparatin nervor
- C) Aparatin vestibular
- D) Aparatin zanor

Pyetja 14

Rruga që ndjek drita për të krijuar impulsin neutral është:

- A) Kornea; Bebjë; Lentja; Retina
- B) Kornea; Bebjë; Retina; Lentja
- C) Kornea; Lentja; Bebjë; Retina
- D) Kornea; Lentja; Retina; Bebjë

Pyetja 15

Rruga që ndjek vala zanore për të krijuar impulsin neutral është:

- A) Llapa e veshit; Kanali i veshit; Kërmilli i veshit; Daullja e veshit
- B) Llapa e veshit; Kanali i veshit; Daullja e veshit; Kërmilli i veshit
- C) Llapa e veshit; Daullja e veshit; Kanali i veshit; Kërmilli i veshit
- D) Llapa e veshit; Daullja e veshit; Kërmilli i veshit; Kanali i veshit

4. Drogat psikoaktive dhe efektet e tyre

Pyetja 1

Substanca aktive që ka në pëmbajtje hashashi quhet:

- A) Morfinë
- B) LSD
- C) Benzodiazepinë
- D) Tetrahidrokanaboid

Pyetja 2

Halucinacionet e prekjes shfaqen më së tepërmi në:

- A) Personat që abuzojnë me alkoolin
- B) Personat që abuzojnë me kokainën

- C) Personat që abuzojnë me heroinën
- D) Personat që abuzojnë me meskalinën

Pyetja 3

Në grupin e stimulantëve mund të bëjnë pjesë:

- A) Kafeja
- B) Heroina
- C) GABA Receptorët
- D) Benzodiazepinat

Pyetja 4

Varësia psikologjike krijohet kur:

- A) Trupi dhe muskujt tanë mësohen shumë me drogën dhe nuk mund të jetojë dot pa të
- B) Truri dhe psikika jonë mësohen shumë me drogën dhe nuk mund të funksionojë pa të
- C) Zemra dhe mushkëria jonë mësohet shumë me drogën dhe nuk mund të funksionojë pa të
- D) Shpirti ynë mësohet shumë me drogën dhe nuk mund të funksionojë pa të

Pyetja 5

Simptomat e tërheqjes nga droga përfshijnë:

- A) Marramendjen
- B) Djersitjen dhe krampet
- C) Kollën e fortë
- D) Hipertensionin

Pyetja 6

Sipas studiuësve Robinson dhe Berridge, përdorimi i drogave psikoaktive përfshin përdoimin:

- A) Social-rekreativ
- B) Agresiv
- C) Stinor
- D) Obsesiv

Pyetja 7

Kur efektet e përdorimit të drogave kombinohen dhe shumëfishohen kemi të bëjmë me:

- A) Abuzim teleologjik
- B) Abuzim me polidrogat
- C) Abuzim me monodrogat
- D) Abuzim edelik

Pyetja 8

Halucinogjenet njihen ndryshe:

- A) Qetësues madhorë
- B) Epinefrinë
- C) Droga psikedelike
- D) Strike

Pyetja 9

Në drogat psikoaktive, rrezja e sigurisë dhe tolerancës së substancës nënkupton që:

- A) Droga është më e rrezikshme
- B) Droga është më pak e rrezikshme

- C) Droga është më pak e pastër në përbërje biokimike
- D) Droga është më e shtrenjtë në vlerën e tregut

Pyetja 10

Nga studimet e Vibeke dhe Slinning mbi faktorët e rrishtit me përdorimin e drogës nga nëna shtatzanë, u vu re se më vulnerabël ndaj përdorimit janë:

- A) Vajzat
- B) Djemtë
- C) Binjakët monozigotikë
- D) Binjakët dyzigotikë

Pyetja 11

Droga e tipit krak shkakton efekte të dëmshme të fetusit si:

- A) Vazokonstriksion dhe hipertension që pengojnë kalimin e lëndëve ushqyese në placentë
- B) Sklerozë laterale amiotrofike
- C) Vazodilatacion dhe hipotension që pengojnë procesin e frymëmarrjes në placentë
- D) Distrofi muskulare

Pyetja 12

Procesi i "tërheqjes" nga përdoruesit e kokainës fillon:

- A) Në fazën e tretë deri në 8 ditë pas fazës së përplasjes
- B) Në fazën e katërt deri në 10 ditë pas fazës së përplasjes
- C) Në fazën e dytë deri në 4 ditë pas fazës së përplasjes
- D) Në fazën e parë të përplasjes

Pyetja 13

Rodning, Beckwith dhe Howard zbuluan në studimet e tyre se fëmijët e ekspozuar ndaj përdorimit të kokainës:

- A) Kthehen në përdorues të kokainës kur arrijnë moshën e adoleshencës
- B) Kthehen në dhunues kur arrijnë moshën e rritur të re
- C) Kthehen në individë me sjellje deviante ekstreme kur arrijnë moshën e adoleshencës
- D) Kthehen në fëmijë që nuk arrijnë dot të krijojnë lidhje të sigurtat atashuese me prindërit e tyre në moshën 1 vjeç

Pyetja 14

Qetësuesit nervorë që shkaktojnë vështësi të frymëmarrjes të porsalindurit përfshijnë:

- A) Amytal
- B) Diazepam
- C) Donnatal
- D) Metadon

Pyetja 15

Metilenedioksimetamfetamina, substanca e përngjashme me amfetaminën, shkakton gjatë përdorimit:

- A) Relaksim, përgjurmje dhe reduktim të aktivitetit muskular
- B) Rritje të energjisë, afërsi në marrdhëniet me të tjerët dhe rritje të aktivitetit motorik
- C) Sëmundje kronike të organeve të brendshme

D) Sëmundje kronike neurologjike

5. Stresi, fiziologjia e tij dhe fazat e përjetimit/përballimit

Pyetja 1

Sipas Selye, në fazën e parë të reagimit të trupit ndaj një stresori ndodh:

- A) Ngadalësim i rrahjeve të zemrës
- B) Pakësim i djersitjes në lëkurë
- C) Shtim i sheqerit në gjak
- D) Ulje e aktivitetit të trurit

Pyetja 2

Në cilën fazë të reagimit të trupit ndaj një stresori niveli i sheqerit në gjak bie shumë?

- A) Stadi i njohjes
- B) Stadi i nxitjes
- C) Stadi i rezistencës
- D) Stadi i rraskapitjes

Pyetja 3

Si quhet gjendja në të cilën ne ndihemi të detyruar të arrijmë një standard më të lartë sjelljeje?

- A) Presion
- B) Zhgënjim
- C) Konflikt
- D) Konfrontim

Pyetja 4

Cili hormon rregullon ritmin e metabolizmit të trupit?

- A) Tiroksina
- B) Melatonina
- C) Insulina
- D) Adrenalina

Pyetja 5

Si quhet procesi në të cilin për të përballuar stresin ne kundërshtojmë të njohim një realitet të hidhur, kërcënues apo të dhimbshëm?

- A) Kompromis
- B) Mohim
- C) Zhvendosje
- D) Sublimim

Pyetja 6

Njerëzit e cilit tip të sjelljes janë vazhdimisht nën një stres të tepërt?

- A) Tipi A
- B) Tipi B
- C) Tipi C
- D) Tipi D

Pyetja 7

Si quhet burimi i stresit i cili ndodh kur personi pengohet në arritjen e një qëllimi?

- A) Presioni i jashtëm
- B) Presioni i brendshëm

- C) Konflikti
- D) Frustracioni

Pyetja 8

Në cilin stad të sindromës së përgjithshme të përshtatjes njerëzit besojnë se i kanë kapërcyer pasojat negative të stresit?

- A) Stadi i alarmit
- B) Stadi i rezistencës
- C) Stadi i konsumimit
- D) Stadi i raskapitjes

Pyetja 9

Cili lloj konflikti përjetohet kur ndeshemi me dy kërkesa njëloj të padëshirueshme, prej të cilave na duhet të zgjedhim njëren?

- A) Tërheqje-tërheqje
- B) Shmangie-shmangie
- C) Tërheqje-shmangie
- D) Shmangie-tërheqje

Pyetja 10

Vonesat janë një nga tipat më të zakonshme të:

- A) Frustracionit
- B) Konfliktit
- C) Presionit të jashtëm
- D) Presionit të brendshëm

Pyetja 11

Në situatat e urgjencës (rritet pulsi, presioni i gjakut, frymëmarrja, rrahjet e zemrës), sistem nervor më aktiv është:

- A) Simpatik
- B) Parasimpatik
- C) Somatik
- D) Qendror

Pyetja 12

Teknika e përbalimit të stresit në të cilën merret vendimi për një zgjidhje realiste, kur zgjidhja ideale nuk është e mundur quhet:

- A) Kompromis
- B) Fantazim
- C) Konfrontim
- D) Largim

Pyetja 13

Cili mekanizëm mbrojtës për përbalimin e stresit ka të bëjë me rikthimin e sjelljeve në një formë që ju ngjajnë fëmijëve.

- A) Zhvendosjen
- B) Represionit
- C) Fantazisë
- D) Regresionit

Pyetja 14

Cili mekanizëm mbrojtës për përballimin e stresit ka të bëjë me ridrejtimin e ndjenjave të ndrydhura në kanale më të pranueshme nga ana shoqërore.

- A) Sublimimit
- B) Intelektualizmit
- C) Kompensimit
- D) Projektimit

Pyetja 15

Cili mekanizëm mbrojtës për përballimin e stresit lidhet me veshjen e motiveve dhe dëshirave të tua të ndryshuara të tjerëve?

- A) Mohimit
- B) Sublimimit
- C) Projeksionit
- D) Reaksionit

6. Gjumi, tipat, teoritë, çrregullimet e gjumit dhe ëndrrat

Pyetja 1

Si quhet kalimi i papritur në gjumë gjatë ditës?

- A) Disomni
- B) Insomni
- C) Epilepsi
- D) Narkolepsi

Pyetja 2

Në cilën pjesë të gjumit ndodhin zakonisht ëndrrat?

- A) Gjumi me lëvizjen e shpejtë të syve
- B) Gjumi me lëvizjen e ngadaltë të syve
- C) Gjumi me lëvizjen e moderuar të syve
- D) Gjumi pa lëvizjen e syve

Pyetja 3

Cili lloj gjumi ka katër faza?

- A) Gjumi paradoksal
- B) Gjumi aktiv
- C) Gjumi me lëvizjen e shpejtë të syve
- D) Gjumi me lëvizjen jo të shpejtë të syve

Pyetja 4

Ndalimi frymëmarrjes në gjumë dhe më pas zgjimi duke gulçuar për ajër quhet:

- A) Apnea e gjumit
- B) Ëndërr e keqe
- C) Tmerr i natës
- D) Makthi i gjumit

Pyetja 5

Si quhet ndryshe paaftësia për të të zënë gjumi?

- A) Hipersomni

- B) Insomni
- C) Parasomni
- D) Trisomni

Pyetja 6

Gjatë gjumit paradoksal sytë lëvizin:

- A) Avash majtas djathtas
- B) Shpejtë majtas djathtas
- C) Avash lart e poshtë
- D) Shpejtë lart e poshtë

Pyetja 7

Cila neurotransmetues ndikon tek rregullimi i gjumit?

- A) Acetilkolina
- B) Dopamina
- C) Serotonina
- D) Norepinafrina

Pyetja 8

Cilat valë prodhohen në tru kur njeriu është i qetë dhe me sy mbyllur?

- A) Alfa
- B) Beta
- C) Theta
- D) Delta

Pyetja 9

Në cilin lloj gjumi muskujt e trupit janë thuajse të paralizuar?

- A) Gjumi me lëvizjen e syve
- B) Gjumi me lëvizjen e shpejtë të syve
- C) Gjumi me lëvizjen jo të shpejtë të syve
- D) Gjumi me lëvizjen e ngadaltë të syve

Pyetja 10

Individët e moshuar kanë zgjime më të shpeshta spontane sepse kanë më pak gjumë të:

- A) Fazës së parë
- B) Fazës së dytë
- C) Fazës së tretë
- D) Fazës së katërt

Pyetja 11

Cili gjumë mbetet i pandryshuar gjatë gjithë jetës së njeriut?

- A) Gjumi i fazës së dytë
- B) Gjumi i fazës së tretë
- C) Gjumi i fazës së katërt
- D) Gjumi i fazës së pestë

Pyetja 12

Cila fazë e gjumit karakterizohet nga shpërthime ritmike të aktivitetit të valëve të trurit?

- A) Faza e parë
- B) Faza e dytë
- C) Faza e tretë

D) Faza e katërt

Pyetja 13

Sipas teorisë së sintezës së aktivizimit të ëndërrimit:

- A) Ëndrrat janë rrugë drejt mendjes së pandërgjegjshme
- B) Në ëndrra ripërpunohet informacioni që grumbullohet gjatë ditës
- C) Truri e aktivizon vetveten dhe pastaj e sintetizon në ëndrra informacionin e krijuar
- D) Ëndrrat shprehin në mënyrë indirekte dëshirat e pavetëdijshme

Pyetja 14

Në orët e fundit të gjumit, cili lloj gjumi shkurtohet derisa zhduket plotësisht?

- A) Gjumi i fazës së parë
- B) Gjumi i fazës së dytë
- C) Gjumi i fazës së katërt
- D) Gjumi i fazës së gjashtë

Pyetja 15

Cila gjëndër endokrine rregullon ciklin e gjumit dhe të qëndrimit zgjuar?

- A) Tiroide
- B) Pineale
- C) Adrenale
- D) Paratiroide

7. Gjenetika e sjelljes

Pyetja 1

Binjakët homozigotë kanë një material gjenetik:

- A) Të ndryshëm
- B) Të afërt
- C) Të ngjashëm
- D) Të njëjtë

Pyetja 2

Njësisia bazë e trashëgimisë është:

- A) Gjени
- B) Gjenomi
- C) Gjenotipi
- D) Gjenetika

Pyetja 3

Valët e trurit regjistrohen përmes:

- A) Elektrokardiogramës
- B) Elektroencefalogramës
- C) Elektromiografisë
- D) Elektrokulogramës

Pyetja 4

Cilat qeliza përmbajnë vetëm 23 kromozome?

- A) Nervore
- B) Muskulore
- C) Kockore

D) Seksuale

Pyetja 5

Si quhet substanca që rrethon çdo fibër nervore në një nerv?

- A) Ganglion
- B) Mielinë
- C) Akson
- D) Dentrit

Pyetja 6

Ciki term i referohet karakteristikave fizike të individit?

- A) Poligjen
- B) Gjenom
- C) Gjenotip
- D) Fenotip

Pyetja 7

Cilat studime bazohen në supozimin se nëse gjenet ndikojnë mbi një tipar të caktuar, të afërmit e rrethit të ngushtë duhet të jenë të ngjashëm për këtë tipar?

- A) Studimet e familjes
- B) Studimet e adoptimit
- C) Studimet e binjakëve monozigotë
- D) Studimet e binjakëve bizigotë

Pyetja 8

Cila strukturë mundëson shkëmbimin e informacionit midis dy hemisferave të trurit?

- A) Korpus kallosum
- B) Talamusi
- C) Medulla
- D) Amigdala

Pyetja 9

Cila lloj trashëgime ka të bëjë me bashkëveprimin e disa gjeneve për të dhënë një tipar të caktuar?

- A) Gjenetike
- B) Poligjenike
- C) Monogjenike
- D) Epigjenetike

Pyetja 10

Gjenetika e sjelljes i referohet:

- A) Studimit sesi tiparet kalojnë nga një brez tek tjetri përmes gjeneve
- B) Studimit se sa ndikon trashëgimia mbi sjelljen dhe mendimin e individit
- C) Studimit sesi kanë ndryshuar rrënjët e sjelljes dhe proceseve mendore përgjatë evolucionit
- D) Studimit të origjinës së sjelljes dhe të ADN-së

KAPITULLI II FUSHA E ZHVILLIMIT

1. Teoria e Frojdit mbi zhvillimin

Pyetja 1

Hipnoza, asosacioni i lirë dhe analiza e ëndrrave i dhanë të dhëna Frojdit për:

- A) Motivët e pavetëdijshme të njeriut
- B) Konfliktet e pavetëdijshme të njeriut
- C) Motivët dhe konfliktet e pavetëdijshme të njeriut
- D) Motivët e pavetëdijshme dhe të represuara të njeriut

Pyetja 2

Sipas pikpamjes psikanaliste të Frojdit:

- A) Mënyra sesi prindërit menaxhojnë dëshirat seksuale në pesë vitet e para të jetës luan një rol thelbësor në formimin e personalitetit
- B) Mënyra sesi prindërit menaxhojnë dëshirat seksuale në tre vitet e para të jetës luan një rol thelbësor në formimin e personalitetit
- C) Prindërit nuk kanë ndikim në formimin e personalitetit të fëmijës
- D) Fëmijët zhvillohen sipas parimit ontogjenik

Pyetja 3

Në formimin e personalitetit tonë sipas teorisë së zhvillimit të Frojdit:

- A) Idi dhe Egoja janë element të lindur dhe kërkojnë plotësimin e menjëhershëm të kënaqësisë
- B) Superegoja formohet diku në moshën 5 vjeç dhe është e pavarur nga Egoja dhe Idi
- C) Idi është I vetmi element psikik I lindur që kërkon plotësimin e menjëhershëm të kënaqësisë
- D) Egoja dhe Superegoja formohen si pasojë e zhvillimit të Idit dhe janë të fituara

Pyetja 4

Me maturimin e Egos, fëmijët sipas Frojdit:

- A) Kërkojnë të plotësojnë në vijimësi kërkesat e tyre për ushqim dhe higjienë
- B) Përmirësohen në aftësitë e kontrollimit të idit dhe gjejnë mënyrave të përshtatshme për të kënaqur nevojat e tyre
- C) Janë të vetëdijshëm për devijimet e tyre pasi Egoja është censori i tyre i brendshëm
- D) Është në konflikt të vazhdueshëm me Idin dhe Superegon pasi nuk mund të ruajë dot ekuilibrat psikikë

Pyetja 5

Në teorinë e tij të zhvillimit psikoseksual, Frojdi argumentoi se:

- A) Zhvillimi lidhet vetëm me kënaqësinë seksuale të individit
- B) Zhvillimi evoluon sipas një modeli stadial
- C) Zhvillimi evoluon sipas ngjarjeve jetësore që ne përjetojmë
- D) Zhvillimi është element i konfliktit dhe përvojave të fëmijërisë së hershme

Pyetja 6

Në stadin Falik:

- A) Fëmijët zhvillojnë kompleksin e Edipit dhe të Elektrës në varësi të përkatësisë së tyre gjinore
- B) Fëmijët zhvillojnë trauma përshtypjen e konflikteve të tyre seksuale
- C) Fëmijët zhvillohen sipas mbajtjes dhe marrëdhënies së tyre me tualetin
- D) Fëmijët janë krejtësisht të varur nga rregullat e moralit social

Pyetja 7

Në stadin Oral:

- A) Konflikti i pavetëdijshëm ndodhet në zonën erogjene të gojës
- B) Konflikti i vetëdijshëm ndodhet në zonën erogjene të gojës
- C) Kateksis ndodhet në zonën erogjene të gojës
- D) Fiksimi ndodh në zonën erogjene të gojës

Pyetja 8

Reaksionet orale të mësuara nga foshnjat në stadin oral shpjen në:

- A) Të rritur dashamirës, pranues dhe miqësor kur janë pjesë e prototipit të marrjes
- B) Të rritur analizues kur janë pjesë e prototipit të hedhjes
- C) Të rritur cinikë kur janë pjesë e prototipit të kafshimit
- D) Të rritur pozitive kur janë pjesë e prototipit të mbylljes së gojës

Pyetja 9

Nocioni i atashimit emocional nënë-foshnjë në teorinë e Frojdit:

- A) Është pararendës i studimeve të Spitz për marrëdhëniet e vështira nënë-fëmijë
- B) Është pararendës i studimeve të Klein për marrëdhëniet e fëmijës me tjetrin
- C) Është pararendës i studimeve të Einnicott për marrëdhëniet e fëmijës me nënën e keqe dhe të mirë
- D) Është pararendës i studimeve të Fairnbairn për marrëdhëniet e fëmijës me objektet psikike

Pyetja 10

Qëllimi i stadi anal është:

- A) Të lejojë eksplorimin dhe rrisë vetë-kontrollin e fëmijës duke filluar nga kontrolli sfinkterial
- B) Të lejojë analizën e thelluar psikologjike për proceset e vetë-vlerësimit të fëmijës
- C) Të lejojë eksplorimin e kontrollit të impulseve
- D) Të lejojë eksplorimin e imazhit të vetes

Pyetja 11

Në stadin fallik, vajzat sipas Frojdit:

- A) Përjetojnë më shumë konflikte dhe janë më të maturuara se djemtë
- B) Përballen me konflikte të ngjashme por më pak intensive se djemtë
- C) Përballen me ankthin e kastrimit në kohëzgjatje më të lartë se djemtë
- D) Përjetojnë më shumë impulse dhe janë më pak të maturuara se djemtë

Pyetja 12

Për Frojdin, mendja funksionon në tri nivele, e pavetëdijes, e vetëdijes dhe:

- A) e pavetëdijes individuale
- B) e pavetëdijes kolektive

- C) e paravetëdijes
- D) e ndërgjegjshmes

Pyetja 13

Superegoja është përgjegjëse për:

- A) menaxhimin e konflikteve të pavetëdijshme
- B) mbajtjen në kontroll të idit dhe të egos
- C) rritjen psikologjike të individit
- D) rregullsinë morale dhe të kontrollit

Pyetja 14

Sipas Frojdit, cili element i psikikes është krejtësisht e pandërgjegjshme:

- A) pavetëdija
- B) nën-vetëdija
- C) paravetëdija
- D) superegoja

Pyetja 15

Energjia psikike që drejton të gjitha veprimtaritë e jetës psikike sipas Frojdit është:

- A) thanatos
- B) libido
- C) eros
- D) antilibido

Pyetja 16

Sipas modelit të ajsbergut të Frojdit, impulset tona biologjike dhe konfliktet e pazgjidhura:

- A) ndodhen në sipërfaqjen e dukshme të ajsbergut
- B) ndodhen në brendësi të ajsbergut
- C) ndodhen në thellësinë e padukshme të ajsbergut
- D) nuk ndodhen në ajsberg

Pyetja 17

Parimi sipas të cilit gjetja e mënyrave të pranueshme nga shoqëria për të kënaqur Idin quhet sipas Frojdit:

- A) parim i entropisë
- B) parim i kënaqësisë
- C) parim i redundancës
- D) parim i realitetit

Pyetja 18

Një vajzë e re, fajtohet për dëshirën e saj të fortë seksuale, rastis të harroje emrin e të dashurit, madje edhe kur përpiqet ta prezantojë atë me të afërmit e tjerë. Cilin prej mekanizmave mbrojtës reflekton shembulli mësipërm?

- A) Represioni
- B) Introjeksioni
- C) Reagimi i kundërt
- D) Asgjesimi

Pyetja 19

Një burrë i martuar, i mire dhe nga më besnikët gjendet i joshur nga një zonjë e hijshme dhe lozonjare fqinje. Në vend që t'i pranoje vetes këtë dëshirë të ethshme, si normale ai bëhet gjithnjë e më shumë xheloz për gruan e tij, i shqetësuar gjithmonë e më shumë për besnikërinë e saj. Cilin prej mekanizmave mbrojtës reflekton shembulli mësipërm?

- A) Zhvendosja
- B) Projeksioni
- C) Reagimi i kundërt
- D) Racionnalizimi

Pyetja 20

Për Frojdin, një individ që është pasiv, i varur dhe ka nevojë për vëmendje, është i fiksuar në stadin :

- A) anal
- B) fallik
- C) oral
- D) gjenital

Pyetja 21

Elementët që operojnë për të mbrojtur Egon nga frika dhe ankthi në teorinë psikanalitike quhen:

- A) mekanizma inhibitorë
- B) mekanizma asociativë
- C) mekanizma përballues
- D) mekanizma mbrojtës

Pyetja 22

Në teorinë e zhvillimit psikanalitik, reagimi i formimit është mekanizmi mbrojtës ku:

- A) Superegoja mposht Egon dhe i kthen nevojat e saj në irracionale
- B) Egoja transformon impulset dhe sjelljet e papranuara në të kundërtën e tyre
- C) Idi projekton kërkesat veta të menjëhershme në mjedis
- D) Egoja transformon instiktet e papranuara në të kundërtën e tyre

Pyetja 23

Për Frojdin, procesi i përfimit të identitetit gjinor të një fëmije 4 -vjeçar quhet:

- A) projeksion
- B) introjeksion
- C) identifikim
- D) reagim formimi

Pyetja 24

Kur kërcënimi nuk vjen nga jashtë, por nga bota shoqërore e brendshme e superegos, këtu kemi të bëjmë:

- A) Ankthin neurotik
- B) Ankthin moral
- C) Ankthin real
- D) Ankthi i motivuar

Pyetja 25

I vetmi mekanizëm mbrojtës kompleks që përfshin ngritjen e qëllimit seksual në një nivel më të lartë dhe lejon njerëzit të kontribuojnë për shoqërinë është:

- A) regresioni
- B) represioni
- C) sublimimi
- D) zëvendësimi

Pyetja 26

Sipas teorisë së zhvillimit të Frojdit, kur njerëzit brendësojnë cilësitë pozitive të një personi tjetër në egon e tyre që të mund të reduktojnë ndjesitë e inferioritetit, ata përdorin:

- A) introjeksionin
- B) projeksionin
- C) asosacionin
- D) mohimin

2. Teoria e Piazhës mbi zhvillimin

Pyetja 1

Sipas pikëpamjes konjitive të Piazhës, inteligjenca është:

- A) Një proces dinamik që ndihmon një organizëm të mbijetojë
- B) Një proces themelor që ndihmon një organizëm të përshtatet në mjedisin e tij
- C) Është një proces konjitiv i ekzekutimit të lartë mendor
- D) Është një proces neurobiologjik që avancohet me progresin e zbulimeve shkencore

Pyetja 2

Sipas Piazhës, stadi i zhvillimit konjitiv:

- A) Janë 4 dhe janë të përcaktuara sipas tipologjisë së fëmijës
- B) Janë 4 dhe janë të pavarura nga njëra-tjetra
- C) Janë 4 dhe janë të përcaktuara sipas inteligjencës së fëmijës
- D) Janë 4 dhe janë të ndryshme nga njëra-tjetra

Pyetja 3

Procesi i përshtatjes së ideve ekzistuese ose ideve në vartësi të përvojave të reja quhet:

- A) Akomodim
- B) Inhibicion
- C) Asimilim
- D) Alteracion

Pyetja 4

Nëse një fëmijë mund të hasë një ndryshim në lëvizjen e një aeroplani prej letre, kemi të bëjmë me procesin e:

- A) Çorganizimit
- B) Disfunksionit
- C) Disekuilibrimin
- D) Disorientimit

Pyetja 5

Në teorinë e zhvillimit konjitiv të Piazhës, stadi i operacioneve formale i takon:

- A) Moshës 6-12 vjeç
- B) Moshës 7-12 vjeç
- C) Moshës 7-11 vjeç
- D) Moshës 6-11 vjeç

Pyetja 6

Stadi i parë i zhvillimit kognitiv në teorinë e Piaget quhet edhe:

- A) Stadi sensoro-motorr
- B) Stadi paraoperacional
- C) Stadi post-operacional
- D) Stadi motorr-sensor

Pyetja 7

Thithja e gishtit të foshnjës përfaqëson:

- A) Reaksion cirkular dytësor
- B) Reaksion cirkular tretësor
- C) Reaksion cirkular reflektiv
- D) Reaksion cirkular parësor

Pyetja 8

Një fëmijë e di se kur ju e bashkoni ngjyrën e verdhë me atë blu ju përftoni ngjyrën jeshile. Por kur e pyesni se çfarë ngjyre del kur bashkon ngjyrën blu me të verdhë ai nuk e di se cila është ngjyra që përftohet. Të menduarit e tij ka mungesë në:

- A) Qartësi
- B) Kthyeshmëri
- C) Liri dhe egocentrizëm
- D) Konservim

Pyetja 9

Në fillimet e stadi paraoperacional, fëmijët:

- A) Organizojnë të gjitha skemat e tyre mendore nga fillimi
- B) Organizojnë të menduarit në bazë të induksioneve të kujdestarëve
- C) Organizojnë të menduarit në bazë të përfaqësimeve të tyre mendore
- D) Organizojnë të menduarit në bazë të arsytimit pragmatik

Pyetja 10

Kur fëmijët fillojnë të kuptojnë dhe zgjedhin identitetin e tyre shoqëror, ata ndodhen në:

- A) Stadin e operacioneve konkrete
- B) Stadin e operacioneve formale
- C) Stadin e operacioneve post-formale
- D) Stadin e zhvillimit para-operacional

Pyetja 11

Në cilin nënstad të stadi sensoromotorik bën pjese Gabimi AB:

- A) Reagimet cirkulare tretësore
- B) Koordinimi i skemave sekondare
- C) Reagimet cirkulare parësore
- D) Reagimet cirkulare sekondare

Pyetja 12

Aftësia konjitive thelbësore që shfaqet në stadin para-operacional është:

- A) Aftësia për veprimtari e orientuar me qëllim
- B) Aftësia për të kuptuar perspektivat e të tjerëve

- C) Të menduarit induktiv-deduktiv
- D) Aftësia për të menduar me logjik të lartë

Pyetja 13

Kur jepet një kompleks udhëzimesh që pasqyrojnë fazat për pjekjen e një ëmbëlsire, Dori nuk mund t'i vendos ato sipas radhës së duhur. Cilin prej stadeve të zhvillimit sipas Piaget reflekton shembulli i mësipërm?

- A) Sensoromotor
- B) Paraoeracional
- C) Veprime konkrete
- D) Veprime Formale

Pyetja 14

Nëse një fëmijë vendos dorën e nënës në telekomandë për të treguar se kërkon të shohë televizor, ai:

- A) Koordinon dhe përdor skemat dytësore të objektit për të asimiluar informacionin
- B) Koordinon dhe përdor objektet për të përfaqësuar informacionin
- C) Koordinon dhe përdor skemat parësore për të akomoduar informacionin
- D) Koordinon skemat me objektet si qëllime për të përfaqësuar informacionin

Pyetja 15

Sipas Piaget, për një nocion të një bote të qëndrueshme e të parashikueshme është e nevojshme:

- A) Njohuria mbi stadet e zhvillimit konjitiv
- B) Njohuria mbi permanencën objektuale
- C) Njohuria mbi nën-stadet e stadi sensor-motor
- D) Njohuria mbi objektet cirkulare tretësore

Pyetja 16

Gabimi që foshnjat rreth moshës 8 muaj mund të kuptojnë që objektet që janë të fshehura ekzistojnë dhe nuk janë zhdukur, quhet:

- A) Gabimi A dhe jo B
- B) Gabimi A dhe B
- C) Gabimi B dhe A
- D) Gabimi B dhe jo A

Pyetja 17

Mbështetur në teorinë e Piaget, gjuha :

- A) Vjen para mendimit dhe është më e gjerë se mendimi
- B) Vjen në të njëjtën linjë me mendimin dhe nuk ka ndikim mbi të
- C) Vjen pas mendimit dhe është më pak e gjerë se mendimi
- D) Vjen pas mendimit dhe është e pavarur prej tij

Pyetja 18

Sipas Piaget, fëmijët e stadi paraoperacionalë karakterizohen nga kongicioni i kufizuar social sepse:

- A) Ata nuk mund të krijojnë marrëdhënie me bashkëmoshatarët
- B) Ata bazojnë konceptet sociale në vartësi të ndryshorëve të brendshëm
- C) Ata bazojnë konceptet sociale në vartësi të ndryshorëve të jashtëm
- D) Ata bazojnë konceptet sociale në vartësi të përvojave personale konkrete

Pyetja 19

Egocentrizmi si element karakterizues i mendimit para-operacional përfaqëson:

- A) Arrogancën dhe egoizmin përçmues ndaj të tjerëve në shoqëri
- B) Tendencën për të perceptuar, kuptuar dhe interpretuar botën në kuptimin e vetes
- C) Tendencën për të perceptuar, kuptuar dhe interpretuar veten në marrëdhënie me botën
- D) Tendencën për një vetë-vlerësimin e lartë dhe nivel të lartë të besimit të vetja

Pyetja 20

Kur uji mund të duket i ndryshëm pasi derdhet nga një enë në tjetrën, por është i njëjti ujë, atëherë kemi të bëjmë me ruajtjen e:

- A) Identitetit
- B) Vëllimit
- C) Hapësirës
- D) Objektivit

Pyetja 21

Qeni ka katër këmbë. Macja ka katër këmbë. Atëherë qeni është mace dhe macja është qen sipas sipas një fëmije 4 vjeçar. Ky fëmijë arriti në këtë përfundim duke përdorur:

- A) Arsyetimin deduktiv
- B) Arsyetimin transduktiv
- C) Arsyetimin sinkretik
- D) Arsyetimin induktiv

Pyetja 22

Pyetja “Si do të ishte bota nëse njerëzit nuk do të flinin gjumë?” iu drejtua një adoleshenti dhe ai i dha përgjigjen bazuar në:

- A) Arsyetimin induktiv
- B) Arsyetim epistemologjik
- C) Logjikën me një drejtim
- D) Arsyetimin deduktiv

Pyetja 23

Kur reaksionet dytësore përgjithësohen, ato shndërrohen në:

- A) Procedura që bëjnë tingujt e pamjet e bukura të zgjasin
- B) Procedura që bëjnë pamjet mbresëlënëse të zgjasin
- C) Procedura që bëjnë imagjinatën e fëmijës të zgjasë
- D) Procedura që bëjnë fantazinë e fëmijës të zgjasë

Pyetja 24

Akomodimi sipas Piazhësë ndodh kur:

- A) Informacioni i ri përgatitet në përshtatje me zhvillimin kognitiv të fëmijës
- B) Informacioni i ri përshtatet, duke përdorur strukturat në përgjigje të stimulit të ri
- C) Informacioni i ri është shumë kompleks për t’u integruar në strukturën ekzistuese
- D) Informacioni i ri brendësohet në strukturat mendore në mënyrë të njëjtë

Pyetja 25

Kur një fëmijë në moshën 6 vjeç thotë, se shoku tij ra nga shkalla, sepse ai po e sheh shokun të lënduar, ky fëmijë:

- A) Ka kryer arsyetim logjik
- B) Ka kryer arsyetim semiologjik
- C) Ka kryer arsyetim deduktiv

D) Ka kryer arsyetim epistemiologjik

Pyetja 26

Ju mund të keni patur idenë tuaj për inteligjencë, por tani ju e ndryshoni strukturën tuaj kognitive, si rrjedhojë e dijeve të tjera. Sjellja juaj tani ndryshon për arsye të ndryshimit në në strukturat tuaja kognitive. Cilët nga mekanizmat funksionalë keni vënë në përdorim, sipas Piazhës:

- A) Ekuilibrin dhe organizimin
- B) Asimilimin dhe akomodimin
- C) Akomodimin dhe organizimin
- D) Adaptimin dhe organizimin

3. Teoria e Eriksonit dhe Kohlbergut mbi zhvillimin

Pyetja 1

Teoria e zhvillimit e mbështetur në studimet e Erik Erikson njihet ndryshe:

- A) Teoria psikosociale dhe epigjenetike e zhvillimit
- B) Teoria psiko - edukative e zhvillimit
- C) Teoria psiko - sociale e zhvillimit
- D) Teoria epigjenetike e zhvillimit

Pyetja 2

Një nga dallimet thelbësore ndërmjet teorisë së Eriksonit dhe të Frojdit mbi zhvillimin është se:

- A) Erikson fokusohet më së tepërmi në modelet e të mësuarit social për sjelljen
- B) Erikson fokusohet më së tepërmi në modelet disfunktionale të personalitetit
- C) Erikson fokusohet më së tepërmi në ndikimet sociale dhe kulturore mbi zhvillimin
- D) Erikson fokusohet më së tepërmi në ndikimet e temperamentit mbi zhvillimin

Pyetja 3

Mbështetur në teorinë e zhvillimit të Eriksonit, njerëzit përballen me:

- A) 9 periudha të mëdha krizash
- B) 8 periudha të mëdha krizash
- C) 5 periudha të mëdha krizash
- D) 3 periudha të mëdha krizash

Pyetja 4

Në filozofinë e vet të zhvillimit, stadi "Identitet-Krizë Identiteti" përfaqësohet nga thënia e famshme:

- A) Të kesh apo të jesh
- B) Të jesh apo dish
- C) Të kesh apo të të mos kesh
- D) Të jesh apo të mos jesh

Pyetja 5

Periudha moshore që ndeshet në stadin e "Identitetit kundrejt Konfuzionit të rolit quhet":

- A) Adoleshencë
- B) Moshën e rritur të Re
- C) Moshën e rritur të Mesme
- D) Moshën e rritur të Avancuar

Pyetja 6

Referuar stadi të “Kalimit nga fëmijëria në maturitet” të Erikson, zhvillimi epinegjenetik:

- A) I përket stadi të 5-të nga 16-20 vjeç
- B) I përket stadi të 5-të nga 14-20 vjeç
- C) I përket stadi të 5-të nga 12-18 vjeç
- D) I përket stadi të 5-të nga 12-21 vjeç

Pyetja 7

Në zhvillimin normal të stadi të “Besim kundrejt Mosbesimit”:

- A) Fëmija mëson t’u besojë instikteve të tij si agjenti i parë social
- B) Fëmija mëson t’i besojë kujdestarit të tij si agjenti i parë social
- C) Fëmija mëson të mbrohet nga kujdestarët e tij parësorë
- D) Fëmija mëson të mbrohet nga instiktet vetjake të zhvillimit

Pyetja 8

Nëse në stadin e fundit të zhvillimit jetësor sipas teorisë së Erikson, nuk do të kemi plotësuar normalisht detyrat e vendosura, atëherë do të shfaqet:

- A) Stanjacioni
- B) Izolimi
- C) Inferioriteti
- D) Dëshpërimi

Pyetja 9

Mara është 30 vjeç dhe një nga objektivat e saj jetësore është të krijojë një marrëdhënie intime afatgjatë; mbështetur në teorinë e Erikson ajo ndodhet në:

- A) Stadin e Identitetit kundrejt Konfuzionit të rolit
- B) Stadin e Intimiteti kundrejt Izolimit
- C) Stadin e Industrisë kundrejt Inferioritetit
- D) Stadin e Prodhimtarisë kundrejt Stanjacionit

Pyetja 10

Nëse detyrat e stadi të “Besim kundrejt mosbesimit” plotësohen shëndetshëm, tipologjia e atashimit të fëmijës me nënën do të jetë:

- A) Anksioze-ambivalente
- B) E pasigurtë
- C) E sigurtë
- D) E çorganizuar

Pyetja 11

Në mbështetje të teorisë së Eriksonit, “rolet sociale” përfaqësojnë:

- A) Përpyqjen e fëmijëve për të luajtur një rol të caktuar social për t’u ndjerë të vlerësuar si individë
- B) Përpyqjen e fëmijëve për të luajtur një rol të caktuar social për t’u bërë përshtypje të tjerëve
- C) Përpyqjen e fëmijëve për të luajtur një rol të caktuar social për të shkuar mirë me bashkëmoshatarët
- D) Përpyqjen e fëmijëve për të luajtur një rol të caktuar social për të shpëtuar nga kontrolli prindëror

Pyetja 12

Në analogji me stadin e zhvillimit anal psikoseksual të Frojdit, stadi i zhvillimit sipas Eriksonit përfaqësohet me:

- A) Stadi i autonomisë kundrejt ndjenjave të turpfit
- B) Stadi i autonomisë kundrejt ndjenjave të fajit
- C) Stadi i autonomisë kundrejt kontrollit
- D) Stadi i autonomisë kundrejt kufizimit

Pyetja 13

Nëse një grua 36 vjeç heq dorë nga puna e saj e mirëpaguar për t'ju përkushtuar fëmijëve, ajo ndodhet në stadin e:

- A) Autonomisë kundrejt Ndjenjave të turpfit
- B) Prodhimtarisë kundrejt Stanjacionit
- C) Identitetit kundrejt Konfuzionit të rolit
- D) Integritetit të Egos kundrejt Dëshpërimit

Pyetja 14

Nëse një individ është compliant me rregullat për t'iu shmangur ndëshkimit, mbështetur në teorinë e Kohlberg ai:

- A) Ndodhet në Stadin e V të Moralit post-konvencional
- B) Ndodhet në Stadin e II të Moralit pre-konvencional
- C) Ndodhet në Stadin e IV të Moralit konvencional
- D) Ndodhet në Stadin e I të Moralit pre-konvencional

Pyetja 15

Stadi i VI i Moralit post-konvencional në teorinë e Kohlberg përfshin:

- A) Orientimin ndaj shpërblimit
- B) Orientimin ndaj ligjit dhe rregullit
- C) Orientimin ndaj parimeve etike dhe universale
- D) Orientimin ndaj kontratës sociale

Pyetja 16

Sipas Kohlberg, ne të gjithë:

- A) Zhvillohemi në stadin pre-konvencional si fëmijë
- B) Zhvillohemi në stadin konvencional si fëmijë
- C) Zhvillohemi në stadin post-konvencional si fëmijë
- D) Zhvillohemi në stadin pre-konvencional si adoleshentë

Pyetja 17

Elementët thelbësorë së teorisë së zhvillimit moral të Kohlberg përfshijnë:

- A) Pasojën morale, arsytimin moral dhe sjelljen morale
- B) Afektin moral, arsytimin moral dhe sjelljen morale
- C) Afektin moral, konjicionin moral dhe sjelljen morale
- D) Gjykimin moral, arsytimin moral dhe sjelljen morale

Pyetja 18

Statet e 3 dhe të 4 të Nivelit të Moralit Konvencional të Kohlberg i referohen zhvillimit në:

- A) Fëmijërinë e Hershme dhe të Mesme
- B) Moshën e Pubertetit dhe Adolehencës
- C) Moshën e Rritur të Re dhe të Mesme
- D) Moshën e Adolehencës dhe të Rritur të re

Pyetja 19

Sipas teorisë së Kohlberg:

- A) Dija mbi gjininë paraprihet nga sjellja gjinore
- B) Dija mbi gjininë paraprihet nga zhvillimi konjitiv
- C) Dija mbi gjininë paraprihet nga zhvillimi motor
- D) Dija mbi gjininë paraprihet nga zhvillimi moral

Pyetja 20

Identiteti gjinor sipas Kohlberg:

- A) Ndodh rreth moshës 3-4 vjec dhe përfaqëson fillesat e krijimit të identitetit të vetes
- B) Ndodh rreth moshës 2-3 vjeç dhe përfaqëson një formë të ndërgjegjësimit për veten dhe të tjerët
- C) Ndodh rreth moshës 4-5 vjeç dhe përfaqëson një formë të perceptimit për veten dhe të tjerët
- D) Ndodh rreth moshës 1-2 vjeç dhe përfaqëson fillesat e krijimit të orjentimit seksual

Pyetja 21

Nëse një djalë në moshën 24 muaj preferon të luajë me makina pasi ato janë lodra për djemtë, ai:

- A) Ndodhet në fazën e Identitetit Gjinor
- B) Ndodhet në fazën e Stabilitetit Gjinor
- C) Ndodhet në fazën e Konsistencës Gjinore
- D) Ndodhet në fazën e Rregullimit të rolit Gjinor

Pyetja 22

Zhvillimi i të arsyetuarit etik dhe vlerave të moralit absolut përfshihet në :

- A) Stadin e gjashtë të Nivelit post-konvencional
- B) Stadin e pestë të Nivelit post-konvencional
- C) Stadin e shtatë të Nivelit post-konvencional
- D) Stadin e tretë të Nivelit konvencional

Pyetja 23

Sipas teorisë së zhvillimit moral të Kohlberg, rritja morale përparon:

- A) Në një sekuencë të njëjtrajstme me dy nivele me nga dy nën-stade të ndryshme
- B) Në një sekuencë të njëjtrajstme me tri nivele me nga tre nën-stade të ndryshme
- C) Në një sekuencë të njëjtrajstme me dy nivele me nga tre nën-stade të ndryshme
- D) Në një sekuencë të njëjtrajstme me tri nivele me nga dy nën-stade të ndryshme

Pyetja 24

Nëse një fëmijë në moshën 5 vjeç mendon se nëse një shok e ngacmon edhe ai duhet ta ngacmojë shokun ai ndodhet në:

- A) Stadin e djalit të mirë ose të keq në Nivelin konvencional
- B) Stadin e Hedonizmit Masiv në Nivelin pre-konvencional
- C) Stadin e Moralit si Rend dhe Mbrojtje sociale në Nivelin konvencional
- D) Stadin e Moralit të Parimeve Individuale në Nivelin post-konvencional

Pyetja 25

Në fokusin e Stadit të katërt të Nivelit konvencional parimor qendron:

- A) Kuptimi se ligjet janë instrument i përmbushjes së mirëqenies njerëzore

- B) Dallimi mes asaj që është e ligjshme dhe e moralshme tek shoqëria
- C) Arritja e zhvillimit të një arsytimi moral ideal të individit në shoqëri
- D) Të folurit bukur në publik dhe vetë-përmbajtja, një sjellje pozitive e pranueshme

Pyetja 26

Niveli i parë i arsytimit moral parakonvencional e Kohlberg, i cili shpreh se “Gjykimi bazohet mbi nevojat personale dhe rregullat e të tjerëve” është e njëjtë me cilën prej fazave të Piazhesë për të menduarit moral?

- A) Morali autonom
- B) Gjykimi paramoral
- C) Realizimi Moral
- D) Gjykimi djalë/vajzë i/e mirë

4. Bazat biologjike dhe sociale të zhvillimit njerëzor

Pyetja 1

Bërthama zigotike në materialin tone qelizor përmban:

- A) 46 kromozome
- B) 47 kromozome
- C) 45 kromozome
- D) 46,5 kromozome

Pyetja 2

Molekula komplekse që përmban materialin trashëgimor të njeriut quhet ndryshe:

- A) Acidi deoksiribonukleik
- B) Acidi desoksiribonukleik
- C) Acidi acetilsalicilik
- D) Acidi ribonukleik

Pyetja 3

Mitoza përfaqëson procesin e:

- A) Dyfishimit të zgotës në tubin fallopian
- B) Dyfishimit të zgotës në mitër
- C) Dyfishimit të zgotës në muret e mitrës
- D) Dyfishimit të zgotës si procesi ndarjes natyrore

Pyetja 4

Në mejozë:

- A) Kromozomet e veçanta bashkohen në 46 çifte kromozomike
- B) Shkëmbëhen material gjenetike unike gjatë kalimit gjenetik
- C) Krijohen qelizat seksuale të foshnjës
- D) Krijohen qelizat e sistemit endokrin të foshnjës

Pyetja 5

Shanset për përsëritje të njëjtë të të njëjtit grup gjeni janë në procesin e kalimit trashëgimor janë:

- A) 1 në 64 milionë
- B) 1 në 64 bilionë

- C) 1 në 64 trilionë
- D) 1 në 64 katërlionë

Pyetja 6

Një individ me alelenn është:

- A) Heterozigotë dhe nuk e trasmeton paaftësinë te pasardhësit e tij
- B) Homozigotë dhe e trasmeton paaftësinë te pasardhësit e tij
- C) Bizigotë dhe trasmeton gene dominante
- D) Monozigotë dhe trasmeton gene recesive

Pyetja 7

Gjatë zhvillimit intrauterin në muajin e tretë fetusit:

- A) Mund të dëgjojë qartësisht zërat në mjedisin e jashtëm
- B) Mund të shkelmojë dhe rrotullojë trupin
- C) Mund të këndojë sipas dëgjimit të zërit të nënës
- D) Mund të flejë për periudha të gjata kohore

Pyetja 8

Studimet mbi atashimin e foshnjave kanë treguar se:

- A) Atashimi është një konstrukt jo i vërtetë
- B) Atashimi me nënën është më i rëndësishëm sesa atashimi me babain
- C) Atashimi i tipologjisë së tretë dhe të katërt lidhet me shfaqjen e çrregullimeve në moshën adulte
- D) Atashimi është konstrukt konjitiv disfunksional

Pyetja 9

Mbështetur në studimet e zhvillimit, shqisa më pak e zhvilluar në foshnjëri është:

- A) E shikimit
- B) E nuhatjes
- C) E dëgjimit
- D) E prekjes

Pyetja 10

Funksionet vizuale të të porsalindurit janë:

- A) Të ndara nga përvoja
- B) Të lidhura drejtpërdrejtë me përvojën
- C) Të lidhura drejtpërdrejtë me zhvillimin e muskujve skeletorë
- D) Të palidhura me përforcimin sinaptik visual

Pyetja 11

Fëmijët me Trizomi 21:

- A) Kanë vështësi të përqëndrimit dhe mbajtjes së vëmendjes dhe njihen si fëmijë me ADHD
- B) Kanë një kopje shtesë të çiftit kromozomik 21 dhe njihen edhe si fëmijë me sindromin Down
- C) Kanë mungesë gjenetike të çiftit kromozomik 21 dhe njihen edhe si fëmijë me sindromin Apert
- D) Kanë 2 alele të çiftit kromozomik 21 dhe njihen edhe si fëmijë me sindromin Kongjenital Zika

Pyetja 12

Mary Answorth:

- A) Studion sjelljet e atashimit të foshnjave në Ghana
- B) Përshkroi situatën e çuditshme
- C) Përshkroi kategoritë e atashimit të sigurtë
- D) Përshkroi kategoritë e atashimit anksioz

Pyetja 13

“Imitimi”:

- A) Është një tipar i rëndësishëm i të mësuarit të fëmijës
- B) Shfaqet në moshën 1 vjeç
- C) Fillon që në ditën 12-24 të jetës
- D) Është tipar dallies i zhvillimit gjuhësor të fëmijës

Pyetja 14

Të vegjlit janë më shumë të interesuar ndaj stimujve:

- A) Që janë monotone
- B) Janë stacionarë
- C) Janë të mbushur me detaje
- D) Janë fluidë

Pyetja 15

Sipas teorisë së zhvillimit psikosocial të Vygotskij:

- A) Gjuha është themeli i të gjitha proceseve të larta konjitive të foshnjave
- B) Fjalimi egocentric është themeli I të gjitha proceseve të larta konjitive të foshnjave
- C) Vëmendja dhe kujtesa janë themeli I të gjitha proceseve të larta konjitive të foshnjave
- D) Dialogu social është themeli i të gjitha proceseve të larta konjitive të foshnjave

Pyetja 16

Sipas modelit të përshkruar të “zonës së zhvillimit proksimal”, karakteristikë e zhvillimit të fëmijëve është:

- A) Intersubjektiviteti
- B) Marrëdhënia me prindërit
- C) Marrëdhënia me bashkëmoshatarët
- D) Intrasubjektiviteti

Pyetja 17

“Psikobiologjia” studion bazat fiziologjike të sjelljes mbështetur në teorinë e:

- A) Konrad Lorenz
- B) Karl von Frisch
- C) Ivan Pavlov
- D) Charles Darwin

Pyetja 18

Nivelet e funksionimit neural sipas psikobiologëve “nuk” përfshijnë:

- A) Nivelin biologjik
- B) Nivelin antropometrik
- C) Nivelin ekonomiko-social

D) Nivelin neurofiziologjik

Pyetja 19

Për të studiuar evolucionin e një sjelljeje përgjatë historikut të saj, psikologjia e zhvillimit përdor të dhënat burimore nga:

- A) Ontogjenia
- B) Mekanizmat e kontrollit
- C) Filogjenia
- D) Mekanizmat mbrojtës

Pyetja 20

Për etologun e zhvillimit John Bowlby, foshnjat njerëzore:

- A) Janë rrjedhojë e seleksionimit natyror
- B) Janë të programuara gjenetikisht ndaj sjelljeve që përçojnë te nëna
- C) Janë të programuara që të kryejnë sjellje automatike
- D) Janë proces i zhvillimit tabula rasa

Pyetja 21

Ndryshe nga etologët, gjenetistët e sjelljes:

- A) Janë të interesuar për unikalitetin e sjelljes sonë sipasojë e gjeneve të trashëguara
- B) Janë të interesuar për ndikimet gjenetike në jetën e njeriut
- C) Janë të interesuar për sjelljen normale dhe anormale të njeriut
- D) Janë të interesuar në modifikimin e gjeneve të njeriut

Pyetja 22

Teknikat diagnostike imazherike përdoren:

- A) Për të kuptuar ndërveprimin e receptorëve dhe neuroneve në trup
- B) Për të studiuar morfologjinë dhe aktivitetin e SNQ
- C) Për të parë lezionet cerebrale të mundshme
- D) Për të kuptuar stimulimin elektrik të trurit

Pyetja 23

Binjakët dizogitikë janë:

- A) Gjenetikisht identikë
- B) Vijnë nga një qelizë e vetme veze
- C) Janë gjithnjë të së njëjtës gjini
- D) Janë të gjinive të njëjta ose të ndryshme

Pyetja 24

Periudha në të cilën individi shfaq komeptencat ose sjellje të caktuara dhe ndikohet nga mjedisi sipas etologëve quhet ndryshe edhe:

- A) Periudha e zhvillimit proksimal
- B) Periudha e ndjeshme
- C) Periudha e konceptionit
- D) Periudha e zhvillimit neuro fiziologjik

Pyetja 25

Mosha më optimale e krijimit të marrëdhënieve intrapersonale të zgjatura përgjatë kohës sipas psikologjisë së zhvillimit është:

- A) 3 javë pas lindjes
- B) 3 muaj pas lindjes
- C) 3 vjeç
- D) 2,5 vjeç

Pyetja 26

Uri Bronfenbrenner njihet ndryshe në psikologjinë e zhvillimit edhe si zbuluesi i:

- A) Teorisë së procesimit të informacionit
- B) Teorisë evolucionare moderne
- C) Teorisë ekologjike
- D) Teorisë së konstrukteve konjitive

Pyetja 27

Cilat nga të mëposhtmet “nuk” është pjesë e Teorisë Ekologjike të zhvillimit:

- A) Biofeedback
- B) Mezosistemi
- C) Lidhjet në ekzosistem
- D) Kronosistemi

Pyetja 28

Në teorinë ekologjike-sociale të sistemeve:

- A) Fëmijët nuk ndikojnë në sjelljen e prindërve
- B) Fëmijët nuk janë pjesëmarrës në krijimin e sistemit të familjes
- C) Familjet janë sisteme sociale holistike
- D) Fëmijët janë pjesë e nën-sistemeve brenda familjes

Pyetja 29

“Referimi social” është termi që përshkruan me procesin e:

- A) Aftësinë e foshnjave për të kuptuar dhe interpretuar shprehje të veçanta emocionale ndërmjet muajit të 7 dhe të 10 të lindjes
- B) Aftësinë e foshnjave për të kuptuar dhe interpretuar shprehje të veçanta emocionale ndërmjet muajit të 2 dhe të 5 të lindjes
- C) Aftësinë e foshnjave për të kuptuar dhe interpretuar shprehje të veçanta emocionale ndërmjet muajit të 8 dhe të 9 të lindjes
- D) Aftësinë e foshnjave për të kuptuar dhe interpretuar shprehje të veçanta emocionale ndërmjet muajit të 1 dhe të 3 të lindjes

Pyetja 30

Sipas studimeve të Gunnar dhe Davis, zhvillimi i sistemeve fiziologjike të emocionit dhe përballimit të stresit te fëmijët:

- A) Është i ndërvarur me nivelin e zhvillimit emocional dhe të përballimit të stresit të prindit
- B) Është I pavarur nga niveli i zhvillimit emocional dhe të përballimit të stresit të prindit
- C) Është I njëjtë nga niveli i zhvillimit emocional dhe të përballimit të stresit të prindit
- D) Është I varur nga niveli i zhvillimit emocional dhe të përballimit të stresit të prindit

Pyetja 31

Sipas shkencëtarëve që kanë studiuar dimensionet emocionale të temperamentit, faktori kryesor që ndikon në zhvillimin e shëndetshëm emocional të fëmijës është:

- A) Karakteri
- B) Personaliteti
- C) Konstrukti Temperamentit
- D) Tipologjia e Temperamentit

Pyetja 32

Korrelacioni më i forte mes temperamentit dhe sjelljes së mëvonshme të fëmijëve ndodh:

- A) Në moshën 18 muaj
- B) Në moshën 2 vjeç
- C) Në moshën 3 vjeç
- D) Në muaj 1 vjeç

Pyetja 33

Në vitet e para të jetë, binjakët identitikë:

- A) Janë të njëjtë në atributet e temperamentit të tyre
- B) Janë të ndryshëm në atributet e temperamentit të tyre
- C) Janë të njëjtë në atributet e personalitetit të tyre
- D) Janë të njëjtë në atributet e karakterit të tyre

Pyetja 34

Ndër faktorët që gjenetistët sjellorë socialë shohin si shumë të rëndësishëm në zhvillimin e njeriut është:

- A) Statusi ekonomik familjar
- B) Statusi politik familjar
- C) Konteksti kulturor
- D) Konteksti I zhvillimit teknologjik

Pyetja 35

Cila nga alternativat e mëposhtme është pjesë e tipologjive të temperamentit të njeriut sipas Thomas, Chess dhe Birch:

- A) Flegmantik
- B) Sanguin
- C) Temperamenti I lehtë
- D) Bila e verdhë

Pyetja 36

Studimet për rëndësinë e “miqësisë” dhe “pranimit social” të fëmijëve kanë treguar:

- A) Se miqësia dhe pranimi social janë njësoj të rëndësishme
- B) Se miqësia dhe pranimi social janë të rëndësishme sipas dëshirës së fëmijës
- C) Miqësia është më e rëndësishme se pranimi social
- D) Pranimi social është më i rëndësishëm se miqësia

Pyetja 37

Sipas teorisë stadiale të zhvillimit moral të Kohlberg, “bindja ndaj rregullave pasi ato janë të nevojshme për bashkëjetesën sociale” i përket:

- A) Stadi IV të Moralit Konvencional
- B) Stadi V të Moralitetit Post-konvencional

- C) Stadi II i Moralit Pre-konvencional
- D) Stadi VI i Moralitetit Post-konvencional

Pyetja 38

Në përshkrimin e Situatës së Çuditshme të Ainsworth, “ndarja e dytë” zgjat:

- A) Më pak se 3 min
- B) Më pak se 13 min
- C) Më pak se 30 min
- D) Më pak se 3 orë

Pyetja 39

Në studimet e saj mbi stilet e prindërimit, Diana Baumrid, raportoi se:

- A) Prindërit autoritarë janë më efektivë në edukimin e fëmijëve
- B) Prindërit e çangazhuar janë më efektivë në edukimin e fëmijëve
- C) Prindërit autoritativë janë më efektivë në edukimin e fëmijëve
- D) Prindërit lejues janë më efektivë në edukimin e fëmijëve

5. Karakteristikat e zhvillimit fizik, kognitiv, moral e social në foshnjëri dhe fëmijëri

Pyetja 1

Cili është përkufizimi i konceptit zhvillim njerëzor?

- A) Zhvillimi është baraz me procesin e rritjes jo vetëm tek fëmijët por edhe adoleshentët;
- B) Zhvillimi është tërësia e ndryshimeve që ndodhin tek njeriu gjatë hapsirës së tij jetësore;
- C) Zhvillimi është një proces i vazhdueshëm ndryshimesh që kulmojnë në adoleshencë;
- D) Zhvillimi është proces i ndryshimeve biologjike tek njeriu që vazhdon gjatë gjithë jetës.

Pyetja 2

Foshnjëria përfshin periudhën kohore:

- a) 0-3 muajsh;
- b) 0-6 muajsh;
- c) 0-12 muajsh;
- d) 0-24 muajsh.

Pyetja 3

Fëmijëria e mesme përfshin periudhën kohore:

- A) 5-12 vjeç;
- B) 6-12 vjeç;
- C) 7-12 vjeç;
- D) 8-12 vjeç.

Pyetja 4

Cila nga reagimet e mëposhtme lidhet me fëmijët që shfaqin temperament të lehtë:

- A) I shmanget situatave të panjohura;
- B) Shfaq intensitet të ulët të reagimeve emocionale në situata të reja;
- C) Përshtatet më lehtë në situata të reja;
- D) Ka një orar gjumi të parregullt.

Pyetja 5

Buzëqeshja sociale shfaqet përafërsisht në cilën periudhë zhvillimore tek fëmijët e vegjël?

- A) 1-2 muajsh;

- B) 2-3 muajsh;
- C) 3-4 muajsh;
- D) 4-5 muajsh.

Pyetja 6

Fëmijët e vegjël tipikisht shqiptojnë fjalën e parë në cilën periudhë zhvillimore?

- A) 6-7 muajsh;
- B) 7-8 muajsh;
- C) 8-9 muajsh;
- D) 10-12 muajsh.

Pyetja 7

Pesha e trurit të një fëmije 6 vjeç është rreth:

- A) 60% e peshës së trurit të një të rrituri;
- B) 80% e peshës së trurit të një të rrituri;
- C) 90% e peshës së trurit të një të rrituri;
- D) 95% e peshës së trurit të një të rrituri.

Pyetja 8

Fëmijët e vegjël ecin këmbadorasi për afërsisht në cilën periudhë kohore:

- A) 5-6 muajsh;
- B) 6-7 muajsh;
- C) 8-9 muajsh;
- D) 9-10 muajsh.

Pyetja 9

Në cilën periudhë kohore fëmijët përfaqësojnë objekte në vizatimet e tyre duke shfaqur më shumë kontroll dhe qëllimshmëri?

- A) 5-6 vjeç;
- B) 4-5 vjeç;
- C) 3-2 vjeç;
- D) 2-1 vjeç.

Pyetja 10

Koncepti për veten private shfaqet tek fëmijët në cilën periudhë kohore?

- A) 1 vjeç;
- B) 2 vjeç;
- C) 3 vjeç;
- D) 4 vjeç.

Pyetja 11

Në cilën stad zhvillimor fëmijët fillojnë të kuptojnë se koncepti për veten lidhet me tipare të qëndrueshme të personalitetit?

- A) Në fëmijërinë e hershme;
- B) Në fëmijërinë e mesme;
- C) Në para-adoleshencë;
- D) Në adoleshencë.

Pyetja 12

Në cilën moshë fëmija kupton se gjinia e tij nuk ndryshon, është konstante (e qëndrueshme)?

- A) 2-3 vjeç;
- B) 3-4 vjeç;

- C) 4-5 vjeç;
- D) 6-7 vjeç

Pyetja 13

Fëmijët që shfaqin moral konvencional:

- A) I binden rregullave nga frika e ndëshkimit;
- B) I binden rregullave për të marrë shpërblim;
- C) I binden që përputhen me vlerat e tyre;
- D) I binden rregullave për të marrë aprovimin e të tjerëve

Pyetja 14

Aftësitë e konjicionit social zhvillohen dukshëm në cilin stad zhvillimor?

- A) Në fëmijërinë e mesme;
- B) Në fëmijërinë e hershme;
- C) Në moshën parashkollore;
- D) Në foshnjëri

Pyetja 15

Fëmijët kalojnë nga kombinimi i dy fjalëve në përdorimin e fjalive me tre ose me katër fjalë, në cilën moshë përafërsisht?

- A) 1.5-2 vjeç;
- B) 2.5-3 vjeç;
- C) 3-3.5 vjeç;
- D) 1-1.5 vjeç

Pyetja 16

Një fëmijë 4 muajsh fillon dhe reagon duke lëvizur këmbët, duart, dhe duke qeshur kur babai i tregon një lodër që kishte përafërsisht një javë që nuk e shihte (lodra kishte humbur por babai e gjeti sërish). Kur babai e afron lodrën në dorën e fëmijës, ai përpiqet ta shtyp për të dëgjuar muzikën. Reagimet e fëmijës ndaj lodrës janë tregues të:

- A) Inteligjencës së fëmijës;
- B) Kujtesës së fëmijës;
- C) Reflekseve të fëmijës;
- D) Temperamentit të fëmijës.

Pyetja 17

Një nënë tregon se si vajza e saj e vogël kohët e fundit ka filluar të kap me gishtin dhe gishtin e madh lodra të vogla që janë në tapet. Përafërsisht, në cilin periudhë moshore është vajza e vogël?

- A) 6-8 muajshe;
- B) 9-12 muajshe;
- C) 12-14 muajsh;
- D) 16-18 muajsh.

Pyetja 18

Një baba i emocionuar tregon se si fëmija e tij ka filluar të ecë duke u mbajtur vetëm tek një dorë e babait dhe jo tek të dyja duart. Përafërsisht, në cilin periudhë moshore është fëmija i vogël?

- A) 6-7 muajsh;
- B) 8-9 muajsh;
- C) 11-12 muajsh;

D) 10-14 muajsh.

Pyetja 19

Një edukatore po i tregon prindërve të një fëmije të vogël, se si fëmija e tyre ka ngjitur dhe ka zbritur shkallët vetë, pa ndihmën e saj. Përafërsisht, në cilën periudhë moshore është fëmija?

- A) 14-20 muajshe;
- B) 18-24 muajshe;
- C) 20-26 muajsh;
- D) 24-30 muajsh.

Pyetja 20

Babai tregon për vajzën e tij të vogël që është shumë e vështirë për të dhe bashkëshorten e tij të vënë orare për gjumin dhe për ushqimin për vajzën e tyre pasi kundërshton shpesh këto orare. Duke u bazuar tek rrëfimi i babait, cilin temperament shfaq vajza?

- A) Temperament të vështirë;
- B) Temperament të ngadaltë;
- C) Temperament miks;
- D) Temperament kundërshtues.

Pyetja 21

Nëna rrëfen se djali i saj 10 muajsh që sa ka filluar të shkojë në çerdhe, nuk qan kur nëna largohet, reagon njëllë si me nënën dhe edukatoren e re, dhe nuk shfaq interes ndaj nënës kur ajo rikthehet për ta marrë. Duke u bazuar tek reagimet e djalit, cilin tip atashimi shfaq fëmija?

- A) Atashim shmangës;
- B) Atashim të sigurtë;
- C) Atashim rezistent;
- D) Atashim i pasigurtë.

Pyetja 22

Një edukatore që ka në përgjegjësi grupin e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç po planifikon aktivitetet për javën. Nga konsulta me psikologun zhvillimor, ajo vendosi që çdo aktivitet të zgjasi përafërsisht:

- A) 4-6 minuta;
- B) 8-10 minuta;
- C) 12-18 minuta;
- D) 16-24 minuta.

Pyetja 23

Një nxënës i thotë shoqes së bankës të mos e pyes për diçka gjatë momentit që mësuesja po shpjegon mësimin, por të pyesi kur të jetë pushimi ndërmjet orëve. Nxënësi po shfaq:

- A) Vëmendje selektive;
- B) Disiplinë;
- C) Bindje ndaj rregullave të mësueses;
- D) Përqëndrim të lartë

Pyetja 24

Babai i thotë vajzës së tij 5 vjeçare të vendos lodrat në tapet tek koshi i lodrave, më pas të vendos librin tek rafti, dhe më pas të ulet në tavolinë për të ngrënë drekën. Vajza vendos lodrat në vendin e tyre dhe ulet në tavolinë për të ngrënë drekën, por librin nuk e vë në raft. Vajza nuk e vendosi librin në raft sepse:

- A) Kujtesa afatshkurtër në këtë moshë është e kufizuar;
- B) Kujtesa afatgjatë në këtë moshë është e kufizuar;

- C) Fëmija në këtë moshë nuk ka aftësitë e duhura të ndjekë udhëzimet;
- D) Kujtesa dëgjimore në këtë moshë është e kufizuar.

Pyetja 25

Një fëmijë parashkollor po përpiket të mbaj mend kafshët, objektet, frutat dhe perimet që po sheh në foto. Ai sheh faqen me figurat përkatëse, pastaj mbyll sytë dhe thotë fjalët që mban mend. Ky fëmijë shfaq:

- A) Strategji të qëllimshme për të ruajtur informacionin në kujtesë;
- B) Kujtesë afatshkurtër të avancuar;
- C) Kujtesë afatshkurtër të kufizuar;
- D) Strategji të kufizuara për të ruajtur informacionin në kujtesë.

Pyetja 26

Kur nëna e pyet djalin e saj se cili është kuptimi i shprehjes: “Ujku qimen e ndërron por zakonin se harron”, djali përgjigjet se sa do ujku të shkoj të qethë flokët, ato do i dalin sërish. Duke u bazuar në përgjigjen e tij, përafërsisht cilës periudhë moshore i përket djali?

- A) Moshës parashkollore;
- B) Fëmijërisë së mesme;
- C) Periudhës moshore në vitet e para të shkollës;
- D) Periudhës moshore 9-11 vjeç.

Pyetja 27

Një nënë po sheh se si vajza e saj ka vizatuar një rreth që duket si koka e një njeriu dhe dy vija që duken si këmbë, dhe kur e pyet se çfarë po vizaton, vajza përgjigjet se po vizaton vëllain e saj të vogël, dhe se tani po vizaton sytë. Përafërsisht, cilës periudhë moshore i përket vajza?

- A) 2.5-3 vjeç;
- B) 3-3.5 vjeç;
- C) 3.5-4 vjeç;
- D) 4-4.5 vjeç.

Pyetja 28

Një djalë po i shpreh babait të tij se sa u gëzua në momentin e parë kur babai i dha dhuratën për ditëlindje, por më pas u zemërua shumë me të, pasi dhurata nuk ishte ajo që ajo i kishte kërkuar më parë. Duke u bazuar tek ky rrëfim i djalit, cilës periudhë moshore i përket?

- A) 4-6 vjeç;
- B) 5-7 vjeç;
- C) 7-9 vjeç;
- D) 9-11 vjeç.

Pyetja 29

Një vajzë merr nga tavolina lekët që kanë lënë prindërit dhe i vë në sirtarin e saj, ndërkohë motra më e vogël e sheh këtë gjë, i thotë motrës më të madhe që po bën gabim dhe se do i thotë prindërve. Motra më e madhe e bind motrën më të vogël që të mos i thotë asgjë prindërve pasi me lekët do t'i blej një ëmbëlsirë. Në cilin stad të zhvillimit të moralit janë të dyja motrat?

- A) Në stadin e ndëshkimit;
- B) Në stadin e shpërblimit;
- C) Në stadin parakonvecional;
- D) Në stadin konvecional.

Pyetja 30

Një fëmijë në moshën e shkollës e ka të vështirë të bëjë ushtrimet që mësuesi jep në fiskulturë, dhe nuk është i talentuar në atletikë, por ai punon me shumë këmbëngulje në orën e vizatimit dhe të gjithë shokët e klasës i pëlqejnë vizatimet e tij. Ky rezultat i fëmijës zhvillon:

- A) Vetë-vlerësimin;
- B) Arritjet shkollore;
- C) Personalitetin;
- D) Motivimin

Pyetja 31

Një nënë dëgjon djalin e saj 2 vjeçar që i thotë: “Mama, dea, dada”, nëna kupton që djali po mundohet të thotë që të hapë derën dhe të dalin jashtë për shëtitje, dhe i thotë: “Mami, thuhet hape derën të dalim jashtë, dera mami jo dea, dera”. Si e vlerësoni reagimin e nënës?

- A) Nëna po nxit zhvillim e gjuhës tek fëmija duke i folur korrektësisht;
- B) Nëna po zhvillon një marrëdhënie emocionale të ngrohtë me fëmijën;
- C) Nëna po zhvillon një marrëdhënie imponuese me djalin e saj;
- D) Nëna po pengon zhvillimin spontan gjuhësor të djalit të saj.

Pyetja 32

Një baba po sheh se si vajza e tij 26 muajshe po shgarravit me laps në murin e dhomës. Ai ulet afër saj dhe i thotë se nuk mund të shgarravisim murin, ai nuk i jep një letër ku mund të shgarravis, por i merr lapsin dhe e vendos në një vend të lartë, më pas orienton vajzën drejt lodrave të tjera. Si vlerësoni reagimin e babait ndaj vajzës?

- A) Babai po zhvillon aftësi të vetë-kontrollit tek vajza e tij duke i mësuar rregulla;
- B) Babai nuk po nxit aftësitë paraprake të shkrimit në këtë moshë;
- C) Babai nuk po nxit krijimtarinë e fëmijës në këtë moshë;
- D) Babai ka vepruar në përputhje me nevojat e vajzës duke e orientuar në lodra të tjera.

Pyetja 33

Një nënë është e shqetësuar pasi vajza e saj 5 vjeçare imagjiron sikur dhoma e saj është mbretëria e zanave. Vajza rri në dhomën e saj dhe rrobat, librat i sheh si pjesë e mbretërisë së zanave, për shembull rrobat si pëlhura magjike, lapsat si shkopa magjik. Ju si e vlerësoni këtë sjellje të vajzës?

- A) Vajza angazhohet në lojë imagjinare;
- B) Vajza angazhohet në lojë me shokë imagjinarë;
- C) Vajza ka nevojë të socializohet;
- D) Vajza ndjehet e vetmuar.

Pyetja 34

Babai është i shqetësuar për djalin e tij 6 vjeçar, pasi sa herë lozin, ai e ka të vështirë të ndjek rregullat, madje shpik rregulla të reja, vetëm e vetëm që të fitoj lojën. Si e vlerësoni sjelljen e fëmijës?

- A) Fëmijët në këtë moshë e kanë të vështirë të kuptojnë rregullat e lojërave;
- B) Babai duhet të bëjë një vlerësim më të detajuar të fëmijës tek një psikolog zhvillimor;
- C) Babai mund të ketë përforcuar më parë këto sjellje të fëmijës gjatë lojës;
- D) Fëmija shfaq përqendrim të ulët dhe mund të ketë probleme me vëmendjen.

Pyetja 35

Gjyshërit sa shohin mbesën e tyre 6 vjeçare të vizatoj apo të thotë diçka, menjëherë i thonë se ajo është mbesa më e bukur dhe e mirë në botë. Si do të vlerësoni sjelljen e gjyshërve?

- A) Gjyshërit nxisin vetë-vlerësimin e mbesës së tyre pozitivisht;
- B) Gjyshërit ofrojnë një mjedis të sigurt emocional për mbesën e tyre;
- C) Gjyshërit po pengojnë zhvillimin e kompetencave të mbesës së tyre;
- D) Gjyshërit po nxisin vetë-vlerësimin e mbesës së tyre negativisht.

Pyetja 36

Një nxënëse në moshën 8 vjeçare po dëgjon mësuesen, por nga ana tjetër ndjehet shumë e lodhur dhe do të donte të lëvizte, të dilte jashtë klasës, por ajo nuk e pyet mësuesen do edhe shumë të mbaroj mësimi, por qëndron ulur dhe dëgjon. Si e vlerësoni reagimin e vajzës?

- A) Shfaq aftësi të socializimi;
- B) Shfaq aftësi të inteligjencës interpersonale;
- C) Shfaq aftësi të vëmendjes auditive;
- D) Shfaq aftësi të kuptimit të perspektivës së të tjerëve.

Pyetja 37

Një nxënës 10 vjeçar thotë për shokun e tij të bankës që ai është shumë i lëvizur dhe vazhdimisht përpiqet që të tërheq vëmendjen e të tjerëve me sjelljet e tij. Ndërsa, një fëmijë 6 vjeçar shprehet për shokun e tij që ai vazhdimisht lëviz dhe bërtet shumë. Cili është ndryshimi midis përshkrimit të nxënësit dhe atij të fëmijës?

- A) Nxënësi jep përshkrim më të detajuar të sjelljes së shokut të bankës;
- B) Fëmija jep më shumë detaje në përshkrimin e sjelljes së shokut të tij;
- C) Nxënësi nxjerrë përfundime për sjelljen e shokut të bankës;
- D) Fëmija nxjerrë përfundime për sjelljen e shokut të tij.

Pyetja 38

Një fëmijë shprehet se shoku i tij i ngushtë është shumë i mirë pasi ai e sillet mirë me të dhe e ndihmon sa herë që ka nevojë. Duke u bazuar tek përshkrimi, si e vlerësoni konceptin e shoqërisë që fëmija ka zhvilluar?

- A) Shoqëria bazohet në aktivitete të përbashkëta të dy fëmijëve;
- B) Shoqëria bazohet tek mirësia dhe ndihma ndaj njëri-tjetrit;
- C) Shoqëria bazohet tek reciprociteti;
- D) Shoqëria bazohet tek ndjenjat e besimit.

Pyetja 39

Një nxënës i merr pa leje stilolapsin nxënësit tjetër për të shkruar diçka. Nxënësi tjetër i kërkon stilolapsin, por nxënësi i parë nuk ja jep stilolapsin. Nxënësi që merr stilolapsin pa leje shfaq:

- A) Temperament të vështirë;
- B) Aftësi të ulëta të konjicionit social;
- C) Aftësi të ulta të konservimit;
- D) Temperament të ngadaltë.

6. Karakteristikat e zhvillimit fizik, kognitiv, moral e social në adoleshencë dhe në moshën e rritur

Pyetja 1

Fillimi i adoleshencës, fillon me:

- A) Fillimin e pubertetit
- B) Fillimi i identitetit

- C) Fillimi i personalitetit
- D) Fillimi i karakterit

Pyetja 2

Fillimi i seksualitetit sipas Frojdit fillon në:

- A) Stadin Oral
- B) Stadin Anal
- C) Stadin Fallik
- D) Stadin Gjenital

Pyetja 3

Në elementët parësor të sjelljes seksuale tek adoleshentët, të dhënat tregojnë se, ata përjashtojnë sjellje dhe qëndrime, si:

- A) Vetëstimulimi seksual
- B) Qëndrimet heteroseksuale
- C) Qëndrimet heterokonceptuale
- D) Qëndrimet homofobike

Pyetja 4

Kur adoleshenti arrin të mendojë për idealet, filozofinë, dashurinë dhe koncepte të tjera abstrakte, si dhe të organizojë idetë dhe objektet në mënyrë sistematike dhe të mendojë në mënyrë deduktive, sipas Frojdit, adoleshenti është në stadin:

- A) Sensoromotorik
- B) Paraoperacional
- C) Operacioneve konkrete
- D) Operacioneve formale

Pyetja 5

Në moshën e adoleshencës, shpesh herë vajzat për të qenë në përshtatje me kërkesat shoqërore, si të qënurit e bukur, elegante, i nënshtrohen dietave të rrepta, palestra intensive etj, duke krijuar kështu probleme shëndetësore, por dhe çrregullime psikologjike, të tilla si:

- A) Anoreksia nervore
- B) Bulimia nervore
- C) Amenorea nervore
- D) Bradikardia nervore

Pyetja 6

“Prirja e adoleshentit për të ekzagjeruar rëndësinë, veçantinë dhe seriozitetin e përjetimeve të tyre sociale dhe emocionale”, ka të bëjë me atë që Elkind e quan:

- A) Identiteti i adoleshentit
- B) Egocentrizmi i adoleshentit
- C) Seksualizmi i adoleshentit
- D) Konfuzionizmi i adoleshentit

Pyetja 7

Në moshën e rritur të hershme (20-40vjeç) një ndër karakteristikave të mëposhtme, i përket një periudhe tjetër moshore, si:

- A) Fillimi i menopauzës tek femrat
- B) Zhvillimi mendor është kompleks
- C) Zhvillimi i sensit të identitetit
- D) Zgjedhja e karrierës profesionale

Pyetja 8

Në moshën e rritur të mesme (40-65 vjeç) një ndër karakteristikave të mëposhtme, i përket një periudhe tjetër moshore, si:

- A) Fillimi i menopauzës tek femrat
- B) Përjetimi i krizës së mesit të jetës
- C) Zhvillimi i sensit të identitetit
- D) Përgjegjësi për t'u kujdesur për të moshuarit

Pyetja 9

Simptomat psikologjike të tilla si, depresioni, irritimi, ankthi, ndryshim në marrëdhëniet ndërpersonale, të shfaqura në moshën e rritur të hershme, kanë të bëjnë me atë që quhet:

- A) Sindroma Premenstruale
- B) Sindroma Postmenstruale
- C) Sindroma Proseksuale
- D) Sindroma Menstruale

Pyetja 10

Karakteristika zhvillimore fizike dhe kognitive të tilla, si përjetimi i ndjenjave kulminante mbi familjen karrierën, apo sensin e urgjencës, që përfaqësojnë modelin e krizës së tranzicionit, lidhen me:

- A) Moshën e adoleshencës
- B) Moshën e rritur të hershme
- C) Moshën e rritur të mesme
- D) Moshën e rritur të vonë

Pyetja 11

Karakteristika zhvillimore fizike dhe kognitive të tilla, si humbja e qelizave nervore dhe dobësimi i aktivitetit, qëndrimi i përkulur, ndryshime në sistemin shqisor dhe atë nervor qëndror, lidhen me:

- A) Moshën e adoleshencës
- B) Moshën e rritur të hershme
- C) Moshën e rritur të mesme
- D) Moshën e rritur të vonë

Pyetja 12

Sipas Riegel, të menduarit e të rriturve synon të zbulojë kontrakditat, krizën intelektuale, mungesën e tensioneve dhe stimulimin konstant. Kjo ka të bëjë me stadin e pestë të zhvillimit kognitiv, që Riegel e quan:

- A) Stadi i të menduarit dialektik
- B) Stadi i të menduarit pragmatik
- C) Stadi i të menduarit sistematik
- D) Stadi i të menduarit hipotetik

Pyetja 13

Një ndër elementët e rëndësishëm zhvillimor të moshës së rritur është edhe zhvillimi profesional, pra zgjedhja e një profesioni. Ky cikël kalon në disa stade përfaqësuese, ku Hevigahrsti përjashton stadin e:

- A) Të bërit një person produktiv
- B) Identifikimi me një punëtor
- C) Përvetësimi i shprehive të punës
- D) Tranzicioni drejt të qënurit prind

Pyetja 14

Sipas stileve të ndërveprimit intim, individët që zgjidhin krizën e identitetit, nuk kanë tendencën të sillen në mënyrë të tillë, që:

- A) Të formojë marrëdhënie dashurie të thella dhe afatgjata
- B) Të përkushtohet me emocion dhe ndjenjë marrëdhënies me partnerin
- C) Të mbajnë distancë me të tjerët kur ndihet i kërcënuar prej sjelljes së tyre
- D) Të tërhiqet nga shoqëria dhe t'i përkushtohet partnerit

Pyetja 15

Adoleshenti që zhvillon një sens solid identiteti, ndërton një plan të kënaqshëm për zhvillimin e tij dhe fiton një ndjenjë sigurie, si dhe ata që nuk e zhvillojnë një sens të tillë, të cilët bien pre e konfuzionit të roleve, sidomos seksuale dhe profesionale, sipas Eriksonit, adoleshenti i përket stadi të:

- A) Identiteti kundrejt konfuzionit të roleve
- B) Intimiteti kundrejt izolimit
- C) Gjenerativiteti kundrejt stanjacionit
- D) Integriteti kundrejt dëshpërimit

Pyetja 16

Individët të cilët nuk janë në gjendje të vendosin prioritetet, që janë pa një qëllim në jetë, të ndikueshëm shumë nga të tjerët, si dhe marrin atë që ju ofron momenti, konsiderohen si individë me identitet:

- A) Të difuzuar apo konfuz
- B) Të imponuar nga të tjerët
- C) Në status të moratoriumit
- D) Në status të identitetit të arritur

Pyetja 17

Zhvillimi fizik i vonuar tek adoleshenti ka efekte negative psikologjike, si:

- A) Djemtë veprojnë si lidera në aktivitetet heteroseksuale, ndërsa vajzat ndjehen atraktive dhe popullore me djemtë e rritur.
- B) Djemtë janë më pasivë me vetëbesim të ulët, ndërsa vajzat përjetojnë shumë ankth për ndryshimet në trupin e tyre.
- C) Djemtë janë pozitiv për ndryshimet në trupin e tyre, ndërsa vajzat kanë vetëbesim të lartë
- D) Djemtë janë më të adaptueshëm me bashkëmoshatarët e rritur, ndërsa vajzat i kushtojnë rëndësi pamjes së jashtme fizike.

Pyetja 18

Rrethi i shokëve është shumë i rëndësishëm, pasi ndihmon adoleshentin të zhvillojë shprehjet sociale, llojet e sjelljeve që do të shpërblehen shoqërisht dhe rolet që u përshtaten më mirë atyre. Pikërisht, aftësia e adoleshentit për të bërë shok të rinj dhe për të ruajtur shokët e vjetër, ka të bëjë me:

- A) Kompetencë sociale të adoleshentit
- B) Identitet social të adoleshentit
- C) Moratorium social të adoleshentit
- D) Ndërvarësi sociale të adoleshentit

Pyetja 19

Prirja e një individi për të zgatur sa më tepër martesën, pasi do të shijoj akoma beqarinë, apo refuzimi i një vendi pune, pasi e gjen më të rehatshme të jetoj nga të ardhurat e prindërve, ka të bëjë me:

- A) Miratim të socializimit
- B) Refuzim të socializimit
- C) Pranim të socializimit
- D) Kërkim të socializimit

Pyetja 20

Aftësia thelbësore e individit që të lidh shpresat dhe frikërat e tij me dikë tjetër dhe të pranojë gjithashtu nevojën e një personi tjetër për intimitet, duke zhvilluar kështu sensin intimitetit, ka të bëjë me:

- A) Identiteti kundrejt konfuzionit të roleve
- B) Intimiteti kundrejt izolimit
- C) Gjenerativiteti kundrejt stanjacionit
- D) Integriteti kundrejt dëshpërimit

Pyetja 21

Në moshën e rritur të mesme shumica e njerëzve vendosin rutina dhe kjo mund të zgjojë stanjacionin, që do të thotë që njeriu fokusohet vetëm në nevojat vetjake dhe në komfortin e jetës së tij. Kjo do të thotë, që ky individ, sipas Eriksonit, i përkon stadi:

- A) Identiteti kundrejt konfuzionit të roleve
- B) Intimiteti kundrejt izolimit
- C) Gjenerativiteti kundrejt stanjacionit
- D) Integriteti kundrejt dëshpërimit

Pyetja 22

Një pjesë e konsiderueshme e popullatës mbi 65 vjeç janë beqarë, gjë që pleqërinë e tyre nuk e shohin si kohë të vetmuar, pasi janë mësuar me këtë gjendje beqarie dhe kanë mësuar të mbështeten emocionalisht tek vetja. Faktori kryesor ndikues negativisht kryesisht tek gratë, në të ndjehurit e vetmuar është:

- A) Seksualiteti i tyre
- B) Shëndeti i tyre
- C) Integriteti i tyre
- D) Socialiteti i tyre

Pyetja 23

Referuar moshës së rritur të mesme, studiuesit pohojnë se niveli i divorceve është më i lartë në pesë vitet e para të martesës, që ndodh për arsye të ndryshme, duke eliminuar një ndër arsyet, si:

- A) Tradhëtisë bashkëshortore
- B) Mospërputhjeve martesore
- C) Përputhjeve martesore
- D) Divorceve emocionale

Pyetja 24

Ndryshimi i konceptit të martesës midis moshës së rritur të vonë dhe asaj të rritur të hershme, është që të moshuarit prevalojnë si elementin më të rëndësishëm në marrëdhëniet e tyre bashkëshortore, si:

- A) Sigurinë emocionale

- B) Divorcet emocionale
- C) Intimitetin seksual
- D) Integritet social

Pyetja 25

Euthanasia është termi që përdoret për të emërtuar një vdekje të mirë dhe pa dhimbje. Në rastin kur, ne kemi një të afërmin tonë për të cilin vuajmë dëshpërisht shumë teksa e shohim duke vuajtur, dhe për të mënjeluar këtë gjë, në bashkëpunim me mjekun vendosim t'i heqim aparatit e oksigjenit, apo t'i japim mbidozë morfine, respektivisht jemi duke kryer një vdekje:

- A) Vdekje me dinjitet
- B) Vdekje natyrale
- C) Vdekje klinike
- D) Vdekje për arsye të keqardhjes

Pyetja 26

Në zyrën e psikologut, paraqitet një grua nga një famije me tradita shqiptare, e cila për hir të kushteve social-ekonomike, është dashur të përkujdesej më shumë me fëmijët, sidomos djalin e saj. Në terapi ajo pohon se, pasi djali kishte marrë një apartament të tijin dhe nuk jetonte me të ëmën, pas disa ditësh ajo kishte filluar të përjetonte ankth, nënvlerësim të rolit të saj si nënë, ndjehej e vetmuar dhe sikur i ishte venitur tërësisht roli i saj në familje. Sipas reagimeve emocionale të saj, psikologu evidentoi se tek ajo ishte formuar:

- A) Sindroma e Folesë Bosh
- B) Sindroma e Abuzimit Narcistik
- C) Sindroma e Arrogancës
- D) Sindroma e Dashurisë së Pashlyer

Pyetja 27

Në zyrën e psikologut, paraqitet një nënë e një djali, e cila ishte jashtëzakonisht e mërzitur dhe e dëshpëruar, pasi djali i saj adoleshent ishte larguar nga shtëpia prej disa ditësh. Në terapi ajo pohon se, mësuesja e djalit e kishte marrë në telefon duke i bërë të ditur që ai kishte braktisur shkollën. Përveç kësaj në mënyrë informale nga shokët e klasës kishte kuptuar që djali i saj pothuajse rrinte gjithë natën nëpër diskotekat e qytetit, dhe shumë sjellje të papërshtatshme të tjera. Sipas reagimeve emocionale të saj, psikologu evidentoi se djali i saj po përjetonte atë që Eriksoni e quan:

- A) Konfuzion të identitetit
- B) Egocentrizëm të identitetit
- C) Gjendje të identitetit
- D) Vitalitet të identitetit

Pyetja 28

Periudha ndërmjet pubertetit dhe moshës së rritur të re quhet:

- A) Pre-adoleshencë
- B) Pubshelencë
- C) Adoleshencë
- D) Seneshencë

Pyetja 29

Gjetja që adoleshenca është një periudhë e stuhisë dhe stresit i atribuohet studimeve të:

- A) Carl Gustav Jung
- B) Erik Erickson
- C) Margaret Mead

D) Mary Answorth

Pyetja 30

Gonadet nënkuptojnë:

- A) Testet dhe organet gjenitale mashkullore
- B) Ovariet dhe uterusin femëror
- C) Testikujt mashkullorë dhe ovariet femërore
- D) Pjesë të ventrikulit anterior të majtë

Pyetja 31

Studimet kanë treguar se rritja e nivelit të testosteronit të meshkujt shoqërohet me:

- A) Shtimin e kriminalitetit ekstrem
- B) Shtimin e sjelljes aggressive dhe të dhunshme
- C) Shtimin e sjelljes romantike dhe dashurore
- D) Shtimin e sjelljes melankolike dhe depressive

Pyetja 32

Sipas Piazhës, periudha e zhvillimit konjitiv në adoleshencë quhet ndryshe edhe:

- A) Stadi I operacioneve post-formale
- B) Stadi I operacioneve formale
- C) Stadi I operacioneve konvencionale
- D) Stadi I operacioneve para-konvencionale

Pyetja 33

Sipas eksperimentit të problemit të pendulumit, adoleshentët:

- A) Përdorin të menduarin abstrakt për zgjidhjen sistematike të problemit
- B) Përdorin të menduarin arsyesues për zgjidhjen sistematike të problemit
- C) Përdorin të menduarin sistematik për zgjidhjen e problemit
- D) Përdorin të menduarin asociativ për zgjidhjen e problemit

Pyetja 34

Me rritjen dhe zhvillimin e adoleshentëve, vetë-koncepti i tyre:

- A) Çorganizohet
- B) Unifikohet
- C) Diferencohet
- D) Shkatërrohet

Pyetja 35

Sipas Sullivan, aftësia për intimitet formohet fillimisht në:

- A) Adoloshencën e hershme nga marrëdhëniet me individët e të njëjtës gjini
- B) Adoloshencën e hershme nga marrëdhëniet me individët e gjinive të ndryshme
- C) Adoloshencën e vonë nga marrëdhëniet me individët e të njëjtës gjini
- D) Pre-adoloshencë nga marrëdhëniet me individët e gjinive të ndryshme

Pyetja 36

Sipas Eriksonit, stadi që i përket krizës së adoleshencës quhet:

- A) Autonomi kundrejt ndjenjave të turpshit
- B) Besim kundrejt mosbesimit
- C) Identitet kundrejt konfuzionit të identitetit

D) Maturitet kundrejt çorganizimit

Pyetja 37

Studiuesit e psikologjisë së zhvillimit kanë argumentuar se aftësi konjitive të moshës së rritur ndahen në:

- A) Aftësi konjitive fluide dhe aftësi konjitive të kristalizuara
- B) Aftësi mendore parësore dhe aftësi mendore dytësore
- C) Aftësi konjitive deduktive dhe aftësi konjitive induktive
- D) Aftësi mendore gjykuese dhe aftësi mendore logjike

Pyetja 38

Në studimin longitudinal të Seattle nga K.Warner Schaie u arrit në përfundimin se:

- A) Aftësitë intelektuale në moshën e rritur të re mbeten të pandryshuara nga aftësitë intelektuale të adoleshencës
- B) Aftësitë intelektuale në moshën e rritur të re fillojnë me një rritje të lehtë e më pas reduktohen gradualisht në moshën e rritur të mesme
- C) Aftësitë intelektuale në moshën e rritur të re ngadalësohen në mënyrë progressive dhe të pandërprerë deri në moshën e rritur të mesme
- D) Aftësitë intelektuale mbeten të pandryshuara në të gjitha stadet e zhvillimit konjitiv të njeriut

Pyetja 39

Inteligjenca fluide përshkruan:

- A) Aftësitë që I bëjnë njerëzit gjykues fleksibël, të përshtatshëm dhe që mund të bëjnë lidhje ndërmjet koncepteve
- B) Aftësitë që I bëjnë njerëzit të flasin rrjedhshëm dhe me koherence mendimi
- C) Aftësitë që I bëjnë njerëzit të kuptojnë lidhjet dinamike ndërmjet koncepteve të ndryshme
- D) Aftësitë që I bëjnë njerëzit të arsyetojnë sipas përvojës së kultures së tyre

Pyetja 40

Mbështetur në të dhënat e teorisë të integritimit Parieto frontal, inteligjenca njerëzore:

- A) Është e shpërndarë në rrjetin neural të lobeve frontale dhe parientale të trurit
- B) Është e shpërndarë në rrjetin neural të lobeve pre-frontale dhe temporale të trurit
- C) Është e shpërndarë në rrjetin neural të lobeve frontale dhe oksipitale të trurit
- D) Është e shpërndarë në rrjetin neural të lobeve temporale dhe frontale të trurit

Pyetja 41

Mbështetur në studimet e Kitchener dhe King:

- A) Ekziston një formë e të menduarit postformal në moshën e rritur të re
- B) Ekziston një formë e të menduarit deduktiv në moshën e rritur të re
- C) Ekziston një formë e progresionit sistematik në mendimin reflektiv të moshës së rritur të re
- D) Ekziston një formë e gjykimit sistematik në mendimin reflektiv të moshës së rritur të re

Pyetja 42

Lidhja e ngjarjeve të ardhshme me një kohë ose moshë të caktuar kur këto ngjarje duhet të plotësohen quhet:

- A) Ora biologjike e kontruktit jetësor

- B) Ora psikologjike e konstruktit jetësor
- C) Ora sociale e konstruktit jetësor
- D) Ora fiziologjike e konstruktit jetësor

Pyetja 43

Në psikologjinë e zhvillimit historia jetësore nënkupton:

- A) Tregimin e historisë personale të individit sipas kujtimeve të tij
- B) Narrativë personale që organizon ngjarjet e së shkuarës në sekuenca koherente
- C) Narrativë familjare që jep detaje mbi zhvillimin e individit
- D) Anamnezë personale që jep të dhëna mbi jetën psikike të individit

Pyetja 44

Vetet e mundshme përfaqësojnë:

- A) Vetën që përdorim në një situatë të caktuar psikosociale
- B) Vetën që njohim në jetën tonë të përditshme
- C) Vetën që mund të jemi, që do të donim të ishim dhe vetën që do të përpiqemi të jemi
- D) Vetën që mund të jemi, që do të donim të ishim dhe vetën që kemi frikë që kemi

Pyetja 45

Në hulumtimet e tyre për zhvillimin e veteve të mundshme, studiuesit zbuluan se interesi kryesor për personat mbi moshën 60-vjeç është:

- A) Familja dhe mirëqenia e saj shëndetsore
- B) Mirëqenia shëndetsore dhe sociale personale
- C) Mirëqenia ekonomike dhe sociale personale
- D) Të qenit të vlefshëm për shoqërinë nëpërmjet punës vullnetare

Pyetja 46

Kontrolli i besimeve personale në psikologjinë e zhvillimit përfaqëson:

- A) Shkallën e besimeve psikopatologjike të individit
- B) Shkallën e kontrollit mbi besimet irracionale të individit
- C) Shkallën në të cilën individit beson se performanca e tij varet nga diçka që ai ka bërë
- D) Shkallën në të cilën individit mendon se performanca e tij varet nga diçka që ai s'ka bërë

Pyetja 47

Sjellja ose konjicioni që ka për qëllim ndikimin në botën e brendshme të një individit quhet:

- A) Kontroll parësor
- B) Kontroll dytësor
- C) Kontroll tretësor
- D) Kontroll obsesiv

Pyetja 48

Studimet kanë treguar se studentët e moshës së rritur të re që kanë një rrjet miqësie të fortë:

- A) Përshtaten më mirë me situatat stresante të jetës dhe kanë vetë-vlerësim më të mirë
- B) Kanë siguri më të lartë të vetja dhe janë më tërheqës me të tjerët
- C) Kanë performancë akademike më të lartë se të tjerët
- D) Janë më eficientë në zgjidhjen e problemeve akademike

Pyetja 49

Studimet e Schmeckle, Giarusso dhe Wang treguan se:

- A) Gratë i japin më shumë rëndësi lidhjeve vëllazërore në moshën e rritur të re krahas burrave
- B) Burrat i japin më shumë rëndësi lidhjeve vëllazërore në moshën e rritur të re krahas grave
- C) Gratë dhe burrat nuk kanë dallime në vlerësimin e lidhjeve vëllazërore
- D) Gratë janë më vulnerabël se burrat në moshën e rritur të re

Pyetja 50

Mbështetur në teorinë e Sternberg, zhvillimi emocional dhe intimi në moshën e rritur të hershme:

- A) Përfshin 2 stade dinamike të zhvillimit
- B) Përfshin 4 stade dinamike të zhvillimit
- C) Përfshin 3 stade dinamike të zhvillimit
- D) Përfshin 6 stade dinamike të zhvillimit

Pyetja 51

Në teorinë e Çiftimit Asortativ:

- A) Njerëzit kërkojnë partnerët e tyre në bazë të ngjashmërive mes tyre
- B) Njerëzit kërkojnë partnerët e tyre në bazë të dallimeve mes tyre
- C) Njerëzit kërkojnë partnerët e tyre në bazë të ngjashmërisë fizike
- D) Njerëzit kërkojnë partnerët e tyre në bazë të ngjashmërisë të temperamentit

Pyetja 52

Sindromi i grave të rrahura ndodh kur:

- A) Kur një grua mendon se nuk mund të largohet nga një marrëdhënie abuzive dhe ndihet e dashuruar me abuzuesin e saj
- B) Kur një grua mendon se nuk mund të largohet nga një marrëdhënie abuzive dhe mund të arrijë të vrasë abuzuesin e saj
- C) Kur një grua mendon se mund të vrasë abuzuesin e saj
- D) Kur një grua mendon se mund të shpëtojë nga abuzuesi i saj

Pyetja 53

Modeli i pështatjes ndaj vulnerabilitetit të stresit thekson:

- A) Cilësia e martesës është proces dinamik me të cilin çiftet përballojnë stresin përmes burimeve të tyre
- B) Cilësia e martesës është proces dinamik me të cilin familjet përballojnë stresin përmes burimeve të tyre
- C) Cilësia e marrëdhënieve interpersonale në familje e fokusuar në vulnerabilitetin e anëtarëve
- D) Cilësia e marrëdhënieve intrapersonale në çift e fokusuar në vulnerabilitetin e çiftit

Pyetja 54

Në teorinë e karrierës konjitive-sociale:

- A) Zgjedhja e karrierës është rezultat i aplikimit të teorisë së Eriksonit
- B) Zgjedhja e karrierës është rezultat i aplikimit të teorisë së Banduras
- C) Zgjedhja e karrierës është rezultat i aplikimit të teorisë së Bowlby

D) Zgjedhja e karrierës është rezultat i aplikimit të teorisë së Vygotsky

7. Faktorë me ndikim mbi zhvillimin sipas grupmohave

Pyetja 1

Kur roli i babait nuk është prezent në familje:

- A) Nëna merr rolin e tij që fëmija të mos ketë mungesën e këtij roli;
- B) Fëmijët zhvillohen me probleme të identitetit gjinor;
- C) Vajzat zhvillojnë më shumë role gjinore mashkullore se sa kur babai është prezent;
- D) Djemtë zhvillojnë më shumë role gjinore femërore se sa kur babai është prezent.

Pyetja 2

Prindërit që shfaqin një stil të orientuar drejt ndëshkimit dhe bindjes janë prindër me stil:

- A) Autoritarian;
- B) Autoritativ;
- C) Liberal;
- D) Neglizhent.

Pyetja 3

Studimet afatgjata nxjerrin konkluzionin që të rriturit, të cilët kanë aftësi të larta sociale, vetëbesim dhe më shumë përgjegjësi sociale, janë rritur me një stil prindërimi:

- A) Autoritarian;
- B) Autoritativ;
- C) Liberal;
- D) Neglizhent.

Pyetja 4

Divorci i prindërve tek fëmijët:

- A) Ka efekte më të pakta kur prindërit janë sjellë mirë me to;
- B) Efektet e divorcit janë më të menaxhueshme për fëmijët e moshës 3-9 vjeç;
- C) Nuk ka efekte kur prindërit shpjegojnë me kujdes situatën fëmijëve;
- D) Është më i rëndë kur prindërit janë sjellë mirë me fëmijët.

Pyetja 5

Kur prindërit kanë informacion se ku ndodhen fëmijët e tyre, çfarë aktivitete po ndërmarrin, çfarë janë duke bërë dhe nëse këto aktivitete janë apo jo e përshtatshme për fëmijët e tyre, ato shfaqin:

- A) Autoritet të lartë;
- B) Monitorim të lartë;
- C) Përkujdesje të lartë;
- D) Kontroll të lartë.

Pyetja 6

Prindërit që vazhdimisht ofendojnë fëmijët e tyre shfaqin:

- A) Abuzim fizik;
- B) Dhunë të vazhdueshme;
- C) Refuzim;
- D) Abuzim emocional.

Pyetja 7

Më të rrezikuar për abuzim seksual janë:

- A) Fëmijët që kanë të dy prindërit e punësuar;
- B) Fëmijët që jetojnë me gjyshërit;
- C) Fëmijët që jetojnë vetëm me një prind;
- D) Fëmijët që kanë prindërit me status më të ulët ekonomik.

Pyetja 8

Një ndër efektet negative të televizorit tek fëmijët është:

- A) Dëmton kujtesën;
- B) Dëmton vëmendjen;
- C) Nxit agresionin;
- D) Nxit rebelimin

Pyetja 9

Fëmijët parashkollorë që bëhen me vëllezër apo motra:

- A) E kanë më të lehtë të formojnë lidhje me vëllezërit apo motrat e tyre;
- B) E kanë më të vështirë të formojnë lidhje me vëllezërit apo motrat e tyre;
- C) Arrijnë të kuptojnë që prindërit i duan njëlloj;
- D) Shfaqin më pak egocentrizëm ndaj motrave apo vëllezërve të tyre.

Pyetja 10

Mbështetja prindërore gjatë adoleshencës:

- A) Nxit ndërvarësinë;
- B) Nxit pavarësinë;
- C) Pengon vendimarrjen;
- D) Pengon socializimin.

Pyetja 11

Një prind ka organizuar një drekë me një familjar. Ajo do të marrë fëmijën e saj 2 vjeçar me vete dhe duke menduar që fëmija është në një periudhë që kërkon të jetë aktiv dhe e ka të vështirë të qëndroj ulur për një kohë të gjatë, vendos të drekoj në një restorant që kanë lodra tipike për moshën e fëmijës. Gjithashtu, ajo vendos të marrë dhe disa lodra të tjera që tërheqin vëmendjen e fëmijës kur ai është ulur. Ky prind shfaq cilësi të cilit stil prindërimi:

- A) Lejues;
- B) Demokratik;
- C) Autoritativ;
- D) Empatik.

Pyetja 12

Një prind e ndëshkon djalin e tij adoleshent pasi erdhi vonë në shtëpi. Prindi e mbyll në dhomën e tij dhe i thotë që nuk ka për të dalë nga dhoma derisa të kuptoj gabimin që ka bërë. Ky prind shfaq cilin tip të abuzimit psikologjik?

- A) Izolimin;
- B) Poshtërimi;
- C) Terrorizmi;
- D) Refuzimi.

Pyetja 13

Një djalë i ri shpreh se ka vetë-vlerësim të ulët, përjeton gjendje depresive, dhe shumë herë përjeton zemërim dhe armiqësi ndaj prindërve të tij. Duke u bazuar tek stilet e prindërimit dhe ndikimet afatgjata të tyre, cilin stil prindërimi ka më shumë gjasa të ketë pasur ky i ri?

- A) Stilin neglizhent;
- B) Stilin lejues;
- C) Stilin autoritativ;
- D) Stilin autoritarian.

Pyetja 14

Një djalë 13 vjeçar shprehet se mbasi vjen nga shkolla, del në lagje deri natën vonë. Ai thotë se prindërit e tij kanë shumë besim tek ai, dhe e lënë të lirë të dalë sa të dojë. Prindërit e fëmijës shfaqin:

- A) Monitorim të ulët;
- B) Disiplinë negative;
- C) Disiplinë demokratike;
- D) Papërgjegjshmëri

Pyetja 15

Një vajzë vjen nga shkolla dhe i thotë nënës se duhet të blejnë një fletore pune dhe lapsa me ngjyra për detyrat. Nëna nuk ia blen këto mjete shkollore dhe vajza ikën pa detyra. Cilin tip të abuzimit psikologjik shfaq nëna?

- A) Poshtërimi;
- B) Izolimi;
- C) Shfrytëzimi;
- D) Refuzimi.

Pyetja 16

Shoqëria gjatë adoleshencës bazohet më shumë tek:

- A) Intimiteti;
- B) Besimi;
- C) Ndarja e sekreteve;
- D) Statusi social.

Pyetja 17

Adoleshentët që kanë rrezik më të lartë për sjelljet delikvente:

- A) Janë vajzat nga familjet me status të lartë shoqëror;
- B) Janë djemtë nga familje me status të lartë shoqëror;
- C) Djemtë dhe vajzat që rriten në familje me një prind;
- D) Djemtë që rriten në familje me një prind.

Pyetja 18

Një nga arsyet e depresionit tek vajzat gjatë shkollës së mesme është:

- A) Presioni nga media për të pasur një fizik tërheqës;
- B) Presioni i bashkëmohatarëve për arritjet shkollore;
- C) Presioni i mësuesve për arritjet në shkollë;
- D) Presioni i bashkëmohatarëve për zgjedhjet profesionale.

Pyetja 19

Një nga faktorët që ul rrezikun për depresion tek adoleshentët është:

- A) Marrja e vendimeve në mënyrë të pavarur;

- B) Të pasurit prindër me stil prindërimi lejues;
- C) Të pasurit prindër me stil prindërimi autoritativ;
- D) Të qënit autonom në aktivitetet me shoqërinë.

Pyetja 20

Formimi i një grupi shoqëror të shëndetshëm tek adoleshentët:

- A) Është më e rëndësishme se marrëdhënia me prindërit;
- B) Zhvillon kompetenca sociale tek ato;
- C) Ndhmon në progresin profesional në të ardhmen e tyre;
- D) Është më e rëndësishme se marrëdhënia me mësuesit.

Pyetja 21

Një prind e lë vajzën 15 muajshe të shoh një program për fëmijë të vegjël, ndërsa vetë merret me punët e shtëpisë. Kur të afërmit i thonë që nuk ndikon mirë që fëmija të shoh televizor kaq herët, prindi përgjigjet se emisionet edukuese kanë shumë ndikim pozitiv tek fëmijët. Ju çfarë do të rekomandonit?

- A) Prindi duhet të caktoj orare të kufizuara për kohën që fëmija sheh televizor vetëm në këtë moshë;
- B) Prindi të vazhdojë këtë praktikë pasi të parit të programeve televizive edukuese në këtë moshë rrit fjalorin e fëmijëve;
- C) Prindi të vazhdojë këtë praktikë pasi të parit të programeve televizive edukuese në këtë moshë nxit zhvillimin konjitiv;
- D) Prindi të ndaloj këtë praktikë pasi të parit televizor vetëm në këtë moshë ka ndikim negativ në zhvillimin gjuhësor.

Pyetja 22

Një baba i thotë djalit të tij 10 vjeçar se nuk do t'i blej një makinë tjetër lodër pasi ja mori një për ditëlindjen. Djali i mërzhitur i tregon gjyshit për këtë gjë, dhe gjyshi ja blen makinën. Si e vlerësoni sjelljen e gjyshit?

- A) Ndikon negativisht në disiplinimin e fëmijës;
- B) Nuk ndikon në disiplinimin e fëmijës;
- C) Ndikon pozitivisht në disiplinimin e fëmijës;
- D) Sjellja e gjyshit lidhet me stilin autoritativ të disiplinimit.

Pyetja 23

Një adoleshente i thotë prindërve të saj se do të filloj punë në një supermarket mbas orarit të shkollës, e me rrogën mund të blej shumë gjëra që dëshiron. Prindërit refuzojnë këtë vendim në mënyrë absolute pasi do të ndikonte negativisht rezultatet në shkollë. Vajza rebelohet ndaj prindërve. Si e vlerësoni këtë reagim të prindërve?

- A) Prindërit kanë marrë parasysh më të mirën për vajzën e tyre;
- B) Pavarësisht rebelimit të vajzës, prindërit nuk duhet të lejojnë punësimin e saj;
- C) Prindërit janë mosbesues tek zgjedhjet e vajzës së tyre prandaj vajza rebelohet;
- D) Prindërit kanë shfaqur një reagim që injoron nevojat për autonomi të vajzës së tyre.

Pyetja 24

Një fëmijë 8 vjeçar sapo mbaroi detyrat e shkollës dhe do të shoh një film vizatimor. Ai nuk dëshiron të fle gjumë edhe pse është vonë. Nëna e tij i shpjegon se filmi mbaron shumë vonë, do të ketë pak orë për gjumë dhe nesër në shkollë do të jetë i lodhur. Ajo i premtun se filmin do ta shkarkoj në kompjuter dhe do ta shoh në fundjavë kur të ketë më shumë kohë. Cilin stil prindërimi shfaq nëna?

- A) Stilin autoritativ;
- B) Stilin autoritarian;
- C) Stilin demokratik;
- D) Stilin lejues.

Pyetja 25

Një nënë dëgjon herë pas here vajzën më të vogël 5 vjeçe që shprehet se edhe ajo do të bëj diçka që bën vajza më e madhe 9 vjeçe, pavarësisht se disa ushtrime fizike vajza më e vogël nuk arrin t'i bëj dot. Çfarë do t'i rekomandonit nënës në të tilla situata?

- A) Të ndihmoj vajzën më të vogël për të bërë ushtrimet;
- B) T'i kërkoj vajzës më të madhe të ndihmoj motrën;
- C) T'i kërkoj vajzës më të madhe të mos bëj ushtrimet;
- D) T'i shpjegoj vajzës më të vogël përse disa ushtrime nuk i bën si motra.

Pyetja 26

Një djalë 13 vjeçar ka rezultate të ulta në shkollë, në klasë nuk i përket asnjë grupi shoqëror, ndërsa prindërit nuk shfaqin interes për aktivitetet e fëmijës jashtë shtëpisë, madje e inkurajojnë të dalë në lagje e të gjej shokë. Si e vlerësoni këtë kontekst zhvillimor të djalit?

- A) Shkolla është prioritare dhe djali duhet të ketë ndihmën e mësuesve për të përmirësuar rezultatet në shkollë;
- B) Prindërit duhet të vënë kufizime për kohën që fëmija harxhon jashtë shtëpisë;
- C) Në këtë moshë djali është më pak i rrezikuar për sjelljet riskuese;
- D) Në këtë moshë djali është më shumë i rrezikuar për t'u përfshirë në sjellje riskuese.

Pyetja 27

Në studimet e Lewis et al, Kultura:

- A) Nuk ndikon në zhvillimin e shprehjes së emocioneve të fëmijëve
- B) Ndikon në zhvillimin e shprehjes së emocioneve të fëmijëve
- C) Ndikon në përshtatjen e shprehjes së emocioneve të fëmijëve
- D) Ndikon në pengimin e shprehjes së emocioneve të fëmijëve

Pyetja 28

Faktori sipas të cilës fëmijët kërkojnë mbështetjen e nënës për të interpretuar një situatë të çuditshme quhet:

- A) Marrëdhënie sociale
- B) Referencë sociale
- C) Përfaqësim social
- D) Konjicion social

Pyetja 29

Në studimin e tij longitudinal mbi zhvillimin intelektual të binjakëve, Ronald Wilson:

- A) Tregoi se ekziston një raport i drejtë mes zhvillimit intelektual dhe trashëgimisë të binjakëve identitikë
- B) Tregoi se ekziston një raport i zhdrejtë mes zhvillimit intelektual dhe trashëgimisë të binjakëve identitikë
- C) Tregoi se ekziston një raport i drejtë mes zhvillimit intelektual dhe trashëgimisë së binjakëve vëllazërorë
- D) Tregoi se ekziston një raport i zhdrejtë mes zhvillimit intelektual dhe trashëgimisë së binjakëve vëllazërorë

Pyetja 30

Studimet kanë treguar se që në 14-20 muajt e parë të jetës foshnjat:

- A) Shfaqin reagime empatike ndaj mirëqenies së të tjerëve
- B) Shfaqin personalitet
- C) Shfaqin karakteristikat e introversionit
- D) Shfaqin karakteristikat e neuroticizmit

Pyetja 31

Mbështetur në gjetjet e psikologëve të zhvillimit, individët që nuk kanë lidhje gjenetike ndërmjet tyre por jetojnë në të njëjtin mjedis:

- A) Do të shfaqin të njëjtat karakteristika të personalitetit
- B) Do të shfaqin të njëjtat karakteristika të zhvillimit intelektual
- C) Do të shfaqin të njëjtat karakteristika të zhvillimit emocional
- D) Do të shfaqin të njëjtat karakteristika të zhvillimit social

Pyetja 32

Një nga faktorët e rëndësishëm në zhvillimin social dhe të marrëdhënies prind-fëmijë është:

- A) Statusi ekonomik-social i familjes
- B) Statusi politik i familjes
- C) Përkatësia etnike e familjes
- D) Statusi Intelektual i familjes

Pyetja 33

Me termin “faktor rrishtu” në psikologjinë e zhvillimit kuptohet:

- A) Faktorin konkret që ndikon në lindjen dhe dekursin e një psikopatologjie të zhvillimit
- B) Rrethanat që kur shfaqen në një moment të caktuar në jetën e një individi mund të lindin psikopatologji të zhvillimit
- C) Faktorin e fshehtë që nëse stimulohet nga mjedisi mund të lindë psikopatologji të zhvillimit
- D) Faktorin gjenetik që mund të studiohet për të mbajtur nën kontroll impulset agresive të individit

Pyetja 34

Mbështetur në studimet e Johnson et al. çrregullimet psikologjike më të shpeshta të lidhura me lindjen e parakohshme dhe anormalitetin e zhvillimit të shtatzanisë përfshijnë:

- A) Sindromin Asperger, Çrregullimin Obsesiv-Kompulsiv dhe Çrregullimin Disintegrativ të Zhvillimit
- B) Pika, Enuresis dhe Makthet Nokturne
- C) Anoreksia nervore, Çrregullimet e Identitetit Gjinor dhe Sindromin Tourette
- D) Hiperaktiviteti, Çrregullimet e Spektrit Autik dhe Çrregullimet Emocionale

Pyetja 35

Studiuesit e psikologjisë së zhvillimit kanë zbuluar se trashëgimia jonë është një faktor kyç në lindjen e:

- A) Skizofrenisë dhe Psikozave Infantile
- B) Depresionit Madhor
- C) Çrregullimit të Ankthit të Ndarjes
- D) Bulimisë Nervore

Pyetja 36

Ndërveprimi I faktorëve gjenetikë, mjedisorë dhe shoqërorë në dekursin e zhvillimit të njeriut quhet:

- A) Modeli psikosocial
- B) Modeli psikologjik
- C) Modeli biopsikosocial
- D) Modeli biopsikologjik

Pyetja 37

Kultura si një faktor me ndikim në zhvillimin e shëndetit mendor të njeriut luan një rol të rëndësishëm dhe në:

- A) Mësimin e sjelljeve të përforcimit parësor
- B) Rritjen e aftësive konjitive-gjuhësore të individit
- C) Përvetësimin e aftësive sociale
- D) Përvetësimin e aftësive intelektuale

Pyetja 38

Sëmundjet infective dhe ato që ndikojnë në sistemin imunitar mund të shkaktojnë:

- A) Çrregullim të Ankthit
- B) Çrregullimin Depresiv Madhor
- C) Çrregullim të Stresit Post-traumatik
- D) Skizofreni

Pyetja 39

Karakteristika e ndikuar nga temperamentimi më e studiuar në psikologjinë e zhvillimit quhet:

- A) Frenim sjellor
- B) Frenim instiktiv
- C) Frenim temperamental
- D) Frenim karakterial

Pyetja 40

Kultura mund të ndikojë në shfaqjen e disa sindromave të caktuara sociale që përfshijnë:

- A) Histerinë Arktike, Sindromin Espanto dhe Psikozën Windigo
- B) Sindromi Cleft Palate, Sindromi Down dhe Sindromi Asperger
- C) Sindromi Apert, Sindromi TORCH dhe Sindromi Trisomizë 18
- D) Sindromi i Brishtë i X, Sindromi Gilbert dhe Sindromi Wolf-Hirschhorn

Pyetja 41

Modeli i përshkruar nga Gray që rregullojnë ndjeshmërinë ndaj ndëshkimit dhe kënaqësinë quhet:

- A) Sistemi frenimit sjellor
- B) Sistemi nxitjes sjellore
- C) Sistemi frenimit emocional
- D) Sistemi nxitjes emocionale

Pyetja 42

Sipas studimeve të MacMilan stresi si faktor ndikues në psikologjinë e njeriut ndikon më shumë:

- A) Burrat
- B) Gratë
- C) Fëmijët
- D) Adoloshentët

Pyetja 43

Studimet e Brodsky et al. treguan se të rriturit me simptoma të Depresionit të Rëndë kanë qenë:

- A) Fëmijë të rritur në mjedis me prindër alkoolistë
- B) Fëmijë të abuzuar fizikisht dhe seksualisht
- C) Fëmijë të rritur në mjedis me prindër të divorcuar
- D) Fëmijë të rritur në mjedis me prindër abuzues me drogën

Pyetja 44

Sipas teorisë së transgjeneralitetit, Depresioni Madhor si pjesë e psikopatologjisë së zhvillimit:

- A) Është rezultat i kalimit nga breznia e prindërve te fëmijët
- B) Është rezultat i ndikimit të mjedisit dhe gjenetikës
- C) Është rezultat i ndikimit ekologjik dhe biologjik
- D) Është rezultat i kalimit mes vëllezërve dhe motrave

Pyetja 45

Studimet kanë treguar se çrregullimi I Depresionit Post-Partum është një faktor rrishtës për:

- A) Lindjen e Çrregullimit të Depresionit Madhor
- B) Lindjen e Çrregullimit Bipolar
- C) Lindjen e Çrregullimit Distimik
- D) Lindjen e Çrregullimit Ciklotimik

Pyetja 46

Një faktor i lartë rrishtës që rrit nevojën për afekt dhe mund të shkaktojë depresion dhe ankth quhet:

- A) Stil dinamik
- B) Stil edukues
- C) Stil prindëror
- D) Stil vëllazëror

Pyetja 47

Sipas studimeve të Johnson et al. sjelljet keqpërshtatëse të prindërve:

- A) Ndikojnë në shfaqjen e çrregullimeve psikiatrike të fëmijëve
- B) Ndikojnë në shfaqjen e çrregullimeve neurozhvillimore të fëmijëve
- C) Ndikojnë në shfaqjen e çrregullimeve neurologjike të fëmijëve
- D) Ndikojnë në shfaqjen e çrregullimeve emocionale të fëmijëve

Pyetja 48

Me termin “emocion i shprehur” në psikologjinë e zhvillimit nënkuptohet:

- A) Tregimin me fjalë të ndjesive emocionale të individit
- B) Përfshirjen emocionale të tepruar të familjarëve ndaj një anëtari vulnerabël të familjes
- C) Shprehjen e emocioneve të një anëtari ndaj pjesëtarëve të tjerë
- D) Frenimin e emocioneve të një anëtari ndaj pjesëtarëve të tjerë

Pyetja 49

Sjellja agresive e adoleshentëve mbart një lidhje të drejtpërdrejtë me:

- A) Mendimet për vetvrasje
- B) Abuzimin fizik
- C) Bullizmin
- D) Abuzimin me alkoolin

Pyetja 50

Procesi i pasigurisë ushqimore i shfaqur në studimet e McLaughlin, Greend dhe Gruber nënkupton:

- A) Përfshirjen e fëmijëve nga klasa e varfër socioekonomike në veprimtari bulliste
- B) Përfshirjen e fëmijëve nga klasa e varfër socioekonomike në punë të detyruar
- C) Përfshirjen e adoleshentëve nga klasa e varfër socioekonomike në veprimtari deviante
- D) Përfshirjen e adoleshentëve nga klasa e varfër socioekonomike në veprimtari artistike

Pyetja 51

Problemet psikologjike mund të kthehen në faktorë të mëvetësishëm rrishtur kur:

- A) Bashkëndan faktorët etiologjikë të rrishtit me një patologji tjetër të së njëjtës fushë
- B) Bashkëndan faktorët eziologjikë me një patologji tjetër të përngjashme
- C) Qendron si faktor i vetëm rrishtur dhe nuk krijon patologji të tjera
- D) Bashkëndan faktorët fizikë të rrishtit me një patologji tjetër të përngjashme

Pyetja 52

Studimet e Kendler Ohlsson dhe Sundquist treguan se shoqërimi i adoleshentëve 15 vjeçarë me bashkëmohatarë abuzues me substancat i bën ata:

- A) Dhunues dhe agresivë
- B) Abuzues me substancat
- C) Antisocialë dhe vandalë
- D) Të nënshtruar dhe të bullizuar

KAPITULLI III FUSHA E KOGNACIONIT

1. Organizimi perceptiv, proceset dhe teoritë

Pyetja 1

Perceptimi është:

- A) Proces automatik;
- B) Proces pasiv;
- C) Proces aktiv;
- D) Procesi i ndijimit.

Pyetja 2

Procesi me anën e të cilit njeriu organizon dhe interpreton duke i dhënë kuptim stimujve shqisor quhet:

- A) Ndijim;
- B) Inteligjencë;
- C) Kujtesë;
- D) Perceptim.

Pyetja 3

Kur perceptimi për objektin mbetet i njëjtë edhe pse ne e shohim objektin në distanca apo kënde të ndryshme shfaqim:

- A) Qëndrueshmëri perceptive;
- B) Iluzion pamor;
- C) Kujtesë pamore;
- D) Perceptim i thellësisë.

Pyetja 4

Kur një dritë fiket dhe ndizet me shpejtësi, ne na duket sikur ajo lëviz. Ky perceptim quhet:

- A) Iluzion pamor;
- B) Paqëndrueshmëri perceptive;
- C) Perceptim i thellësisë;
- D) Perspektiva lineare.

Pyetja 5

Kur dikush sheh një figurë të papërfunduar por e percepton si të plotë (të përfunduar), cilin parim Gestaltist po përdor?

- A) Figurë/sfond;
- B) Mbyllja;
- C) Afërsia;
- D) Ngjashmëria.

Pyetja 6

Cilat teori e perceptimit shpreh idenë se perceptimi ndodh pasi formojmë përfaqësime mendore që lidhen me cilësitë më tipike të një kategorie (p.sh. kategori shpendësh)?

- A) Teoria e prototipit
- B) Teoria e tipareve;
- C) Teoria Gestaltiste;
- D) Teoria e procesimit të informacionit.

Pyetja 7

Një vajzë po vrapon në bregdet dhe nga larg sheh diçka që duket si qese e bardhë, por duke u afruar sheh se në fakt është një kandil deti. Cili proces mendor bëri të mundur që vajza të identifikonte kandilin e detit?

- A) Vëmendja;
- B) Ndiçimi;
- C) Kujtesa;
- D) Perceptimi

Pyetja 8

Një i ri është ulur në një lokal ku mund të shoh pamjen e qytetit. Ai vëzhgon se si pallatet janë të ndara, cili është më afër në distancë dhe cili më largë, ai sheh urën ku kalon lumi në mes të qytetit duke e dalluar nga rrjedha e lumit. Cili proces e bën të mundur këtë perceptim?

- A) Perceptimi pamor;
- B) Iluzioni pamor;
- C) Perceptimi i thellësisë;
- D) Vëmendja pamore.

Pyetja 9

Kur ne shohim një gotë uji krijohet një imazh në retinë që nxit sinjale tek zonat pamore. Ky proces quhet:

- A) Procesimi i informacionit nga poshtë-lartë;
- B) Procesim i informacionit nga lart-poshtë;
- C) Procesim i informacionit shqisor pamor;
- D) Procesi i informacionit perceptiv pamor

Pyetja 10

Një fëmijë po bën detyrat e leximit, por sheh se në një paragraf disa gërma nuk janë shtypur qartë. Gjithsesi, ai arrin të gjej kuptimin e fjalëve pasi i ka parë më sipër në tekst. Si quhet ky proces?

- A) Procesimi nga lartë-poshtë;
- B) Procesimi nga poshtë-lartë;
- C) Kodim në kujtesën pamore;
- D) Kodim në kujtesën shqisore.

Pyetja 11

Një fëmijë sapo hyn në shtëpinë e gjyshërve vëren dhuratat e vendosura në tavolinë, por nuk sheh bordurën për të hyrë në dhomë dhe rrëzohet. Sipas Geshtaltistëve:

- A) Fëmija ka organizuar informacionin sipas parimit të ngjashmërisë;
- B) Fëmija ka organizuar informacionin sipas parimit të vazhdimësisë;
- C) Fëmija ka organizuar informacionin sipas parimit të afërsisë;
- D) Fëmija ka organizuar informacionin sipas parimit figurë/sfond.

Pyetja 12

Një edukatore është e shqetësuar pasi djemtë e grupit të saj nuk duan të luajnë me bashkëmoshatarin e tyre pasi ai i ka flokët e gjata dhe jo të shkurtra si to. Duke u bazuar tek Geshtaltistët, cilin parim të perceptimit kanë përdorur fëmijët që përjashton djalin me flokë të gjata?

- A) Parimin simetrik;
- B) Parimin e ngjashmërisë;
- C) Parimin e afërsisë;
- D) Parimin e mbylljes.

Pyetja 13

Një fëmijë habitet shumë kur prindërit i thonë se pinguinët janë shpendë. Fëmija këmbëngul që nuk mund të jetë e vërtetë kjo gjë, ai nuk i percepton pinguinët si shpend, pasi shpendët fluturojnë ndërsa pinguinët notojnë. Si e shpjegoni këtë këmbëngulje të fëmijës për perceptimin e klasës së pinguinëve?

- A) Fëmija ka formuar një prototip për shpendët si zogj fluturues;
- B) Fëmija po përdor asimilimin dhe jo akomodimin e informacionit;
- C) Fëmija fokusohet tek një tipar jo i rëndësishëm i klasës së shpendëve;
- D) Fëmija fokusohet tek tipare të veçanta dhe jo përcaktuese të shpendëve.

Pyetja 14

Një djalë po pret shoqen e tij në vendin ku ato e kanë lënë të takohen. Ai po e pret përafërsisht prej 5 minutash, kur sheh një vajzë nga larg që i duket si shoqja dhe menjëherë shkon afër dhe e përshendet, por ai është ngatërruar. Si e shpjegoni këtë gabim në perceptim të djalit?

- A) Djali ka pasur pritshmëri të larta se shoqja nga momenti në moment do të shfaqet duke ecur;
- B) Djali ka pasur një përfaqësim mendor të shoqes dhe ka aktivizuar atë përfaqësim mendor;

- C) Djali në mënyrë të pandërgjegjshme ka shpresuar që të jetë shoqja e tij dhe të mos priste më;
- D) Djali është ngatërruar pasi nuk është fokusuar tek detajet e tipareve fizike të kalimtares.

Pyetja 15

Pavërsisht muzgut dhe ndriçimit të ulët, një person mund të perceptonte ngjyrat e rrobeve dhe të ushqimeve që po serviroshin. Cili proces i perceptimit e shpjegon këtë aftësi që shfaq personi?

- A) Procesimi i informacionit nga lartë-poshtë;
- B) Procesimi i informacionit nga poshtë-lartë;
- C) Procesimi i informacionit shqisor pamor;
- D) Procesimi i informacionit sipas tipareve të objekteve.

Pyetja 16

Cili nga elementët e mëposhtëm mendohet si kulm i përvojave njohëse dhe që na drejton për të perceptuar botën nga një prespektivë tërësore dhe unike:

- A) Aperceptimi
- B) Qëndrueshmëria perceptivë
- C) Pritshmëria perceptuese
- D) Perceptimi inteligjent

Pyetja 17

Iluzionet, të cilat shkaktohen nga ndjenjat, dëshirat dhe shpresat e individit quhen:

- A) Deluzione
- B) Iluzione operative
- C) Iluzione shqisore
- D) Iluzionet e hënës

Pyetja 18

Lidhja ndërmjet zhvillimit të trurit dhe zhvillimit perceptiv – njohës njihet ndryshe si:

- A) Neuropsikologjia
- B) Neuropsikiatria
- C) Neuroshkenca e sjelljes
- D) Neuroshkenca e zhvillimit

Pyetja 19

“Shkakësia” është procesi që përshkruan:

- A) Marrëdhënien ndërmjet ngjarjeve të drejtpërdrejta nga ato rastësore
- B) Marrëdhënien ndërmjet ngjarjeve jo të drejtpërdrejta nga ato rastësore
- C) Marrëdhënien ndërmjet ngjarjeve të drejtpërdrejta nga ato jo të drejtpërdrejta
- D) Marrëdhënien ndërmjet shkaqeve dhe pasojave të një ngjarjeje rastësore

Pyetja 20

Për sa kohë zhvendosim trupin tonë, sa herë përpiqemi të arrijmë të pozicionojmë veten në botën tripërmasore, këtu kemi të bëjmë me një:

- A) Perceptim të formës
- B) Perceptim të madhësisë
- C) Perceptim të thellësisë
- D) Perceptim të vetes

Pyetja 21

Nëse ne kapim informacione jashtë sferës normale të sistemit të shqisave tona, ne kemi të bëjmë me:

- A) Iluzion perceptiv
- B) Perceptim jashtëshqisor
- C) Perceptim kognitiv
- D) Aperceptim

Pyetja 22

Qëndrueshmëria perceptuese na lejon të përqëndrohemi më shumë tek:

- A) Qëndrueshmëria perceptuese na lejon të përqëndrohemi më shumë tek:
- B) Imazhet e qëndrueshme sesa në tiparet e ndryshueshme retinore
- C) Forma të qëndrueshme të objekteve, pavarësisht këndit nga shihen
- Ngjyra të qëndrueshme të objekteve, pavarësisht ndriçimit të tyre

Pyetja 23

Ju mund të dalloni një shtëpi, që ajo është një shtëpi edhe sikur pemët të pengojnë pjesërisht pamjen tuaj. Cilin prej elementëve, sipas Gestaltistëve paraqet shembulli i mësipërm?

- A) Afërsinë
- B) Ngjashmërinë
- C) Mbylljen
- D) Vazhdimësinë

Pyetja 24

Çfarë na ndihmon, kur ne përdorim “sinjalin e madhësisë së njohur”, për të përcaktuar distancën e një objekti?

- A) Prespektiva e madhësisë së objekteve
- B) Përvoja dhe dija jonë e mëparshme
- C) Prespektiva lineare e objekteve
- D) Ndërvendosja e objekteve me njëri tjetrin

Pyetja 25

Kur një person ndjek me një mendje të hapur shpjegimet që i japin lidhur me një detyrë të caktuar, ai përdor funksionin e:

- A) Gjykimit
- B) Diskutimit
- C) Arsyetimit
- D) Perceptimit

Pyetja 26

Nëse perceptimi që bën individi për të tjerët ndikohet më shumë nga tiparet e tij sesa nga ato të atyre që vëzhgohen, në këtë rast reflektohet:

- A) Ngjashmëri e supozuar
- B) Prirja për t'i shërbyer vetes
- C) Gabim themelor në atribuim
- D) Prirja për t'i shërbyer tjetrit

Pyetja 27

Nëse ne gjatë perceptimit jemi duke përdorur intuitën, kjo gjë reflekton:

- A) Një eksperiencë ndjesore të ndërgjegjshme
- B) Një proces të subkoshiençës tonë
- C) Një eksperiencë ndjesore të paravetëdijes tonë
- D) Një proces të koshiençës tonë

Pyetja 28

Nëse ne bazohemi në vlerësimin që u bëjmë perceptimit të tingujve, në nivelin sensor të tyre, pa përfshirjen e niveleve më të larta që kanë të bëjnë me përpunimin kognitiv ne aplikojmë cilën prej teorive të mëposhtme:

- A) Teorinë e prototipave
- B) Teorinë e perceptimit ndërtues
- C) Teorinë e tipareve
- D) Teorinë pasive

Pyetja 29

Në cilin prej parimeve të mëposhtme do t'i këshillonit mësuesve të bazoheshin, në mënyrë që ata të mund ndihmojnë nxënësir për të zhvilluar prirjet e tyre për të grupuar:

- A) Qeniet njerezore priren të grupojnë objekte të ngjashme
- B) Objektet grupohen nëse tentojnë të formojnë një figurë
- C) Elementët tentojnë të grupohen sipas afërsisë që kanë me njëri-tjetrin
- D) Elementët tentojnë të grupohen bazuar në vazhdimësinë e lehtë

Pyetja 30

Në "Parimet e Psikologjisë", W. James argumentoi se njerëzit:

- A) Perceptojnë jo vetëm fjalët por edhe nënkuptimet dinamike pas tyre
- B) Perceptojnë jo vetëm ngjyrat por edhe ndryshimet ndërmjet tyre
- C) Perceptojnë jo vetëm objektet por edhe marrëdhëniet dinamike mes tyre
- D) Perceptojnë jo vetëm njerëzit por edhe marrëdhëniet dinamike mes tyre

2. Vëmendja dhe procesimi i informacionit

Pyetja 1

Vëmendja, ka të bëjë me:

- A) Paraqitjen mendore të realiteteve të caktuara.
- B) Përjetimin mendor të një ngjarje të pritshme të dëshiruar.
- C) Njohjen, organizimin dhe kuptimin e ndjesive, ngacmimeve apo informatave.
- D) Përqëndrimin e një individi në objektet e njohjes, proceset e informacionit dhe ato konjitive.

Pyetja 2

Në karakteristikat e cilësive të vëmendjes, një ndër elementët e mëposhtëm përjashton mundësinë e trajtimit si komponentë të saj, siç është:

- A) Përqëndrimi.
- B) Shpërndarja.
- C) Kapaciteti.
- D) Objektivi

Pyetja 3

Në nivelet e vëmendjes një ndër elementët e mëposhtëm përjashton mundësinë e përfshirjes si pjesë të saj, siç është:

- A) Niveli i parandërgjegjshëm.
- B) Niveli i proceseve të kontrolluara dhe automatike.
- C) Niveli i familjarizimit.
- D) Niveli i vetëdijësimit

Pyetja 4

Një ndër simptomat më pak të ndeshura në Çrregullimin e mungesës së vëmendjes (ÇMV), është:

- A) Vështirësi në përqëndrimin e vëmendjes.
- B) Impulsivitet dhe reagim i shpejtë ndaj stimujve.
- C) Ndjenja pasigure dhe humbje e kontrollit.
- D) Ndenja optimizmi dhe nivele të larta të menduarit

Pyetja 5

Proceset automatike të vëmendjes kanë të bëjnë me:

- A) Reagim të menjëhershëm të individit kur atij i duhet të përsëritë një procedurë, duke u shkëputur prej proceseve të larta të vetëdijes.
- B) Sasinë e objekteve dhe situatave që një individ arrin të perceptojë në një kohë të caktuar në mënyrë të natyrshme.
- C) Njohjen e procedurave praktike për të manipuluar me sende apo realitete të veçanta për të zgjidhur situata problemore.
- D) Aftësinë e individit për të njohur botën e tij të brendshme dhe për ta kontrolluar në mënyrë sistematike

Pyetja 6

Një ndër funksionet praktike të vëmendjes, sipas së cilës ne zgjedhim për të ndjekur disa stimuj, duke nënvleftësuar të tjerët, ka të bëjë me:

- A) Vëmendjen selektive.
- B) Vëmendjen e shpërndarë.
- C) Vigjilencën.
- D) Kërkimin.

Pyetja 7

Ndryshimi midis vetëdijes dhe vëmendjes qëndron në faktin se, vetëdija:

- A) Ngarkohet me gjithë masën e informacionit që një individ përpunon në një situatë konkrete.
- B) Orientohet ndaj përgjigjeve shpejt dhe qartë të stimujve interesantë dhe rikujtimin qetësisht të informacioneve.
- C) Mundëson monitorimin e bashkëveprimit tonë me mjedisin, planifikimin dhe kontrollimin e veprimeve të së ardhmes.
- D) Mundëson përdorimin e burimeve të kufizuar aktive kognitive informacionit.

Pyetja 8

Në secilën prej detyrave me rëndësi praktike të subjekteve si roje plazhi, dedektivët e policisë, psikolog, etj elementi psikologjik i përbashkët që i karakterizon është:

- A) Të qënurit vigjilent
- B) Të qënurit të vëmendshëm
- C) Të qënurit kontrollues
- D) Të qënurit bashkëpunues

Pyetja 9

“Kur njerëzit përpiqen të zgjidhin dy detyra jashtëzakonisht të shpejta, përgjigjet për secilën nga detyrat janë pothuajse gjithmonë më të ngadalshme, sa herë një detyrë e dytë fillon pasi e para ka nisur”, ky fenomen i ngadalëzimit për shkak të angazhimit të menjëhershëm, është njohur si:

- A) Çrregullim i mungesës së vëmendjes (ÇMV)
- B) Efekti psikologjik i periudhës reflektare (PRP)
- C) Çrregullimi i Vëmendjes së Pamjaftueshme me Hiperaktivitet (ADHD)
- D) Çrregullimi i Hiperaktivitetit (HD)

Pyetja 10

“Mbikqyrja e mjedisit për pamje të veçanta, duke kërkuar në mënyrë aktive për diçka kur jemi të pasigurtë për shfaqjen e saj, se ku dhe kur do të shfaqet” do të thotë se ne jemi duke studiuar:

- A) Dukurinë e kërkimit vizual
- B) Dukurinë e alarmeve fallco
- C) Dukurinë e vigjilencës
- D) Dukurinë e zbulimit të sinjaleve

Pyetja 11

Dukuria në të cilën ne identifikojmë në mënyrë jo korrekte praninë e ndonjë sinjali, që në të vërtetë mungon, kemi të bëjmë me:

- A) Të shquarit
- B) Dështimi
- C) Mënjanimi
- D) Alarmi fallco

Pyetja 12

Ankthi i bazuar në tiparet e personalitetit, si dhe ankthi i bazuar në situatën konkrete, ndikojnë në:

- A) Vetëdijen
- B) Vëmendjen
- C) Ndiçimet
- D) Perceptimet

Pyetja 13

“Nëse ne jemi duke lexuar një tekst mësimor nën shoqërinë e muzikës së radios dhe nuk shqetësohemi për tingujt e fortë të kësaj muzike, por vazhdojmë studimin tonë” do të thotë që:

- A) Procesi automatik i familjarizimit është duke ndodhur gjatë kësaj kohe të studimit.
- B) Procesi automatik i mosfamiljarizimit me tingullin e muzikës është duke ndodhur gjatë kësaj kohe të studimit.
- C) Procesi i strukturuar i vëmendjes së drejtuar është duke ndodhur gjatë kësaj kohe të studimit.
- D) Proceset frenuese të vetëdijes aktivizohen gjatë kohës së studimit.

Pyetja 14

Njohja e menjëhershme e zërave të meshkujve apo femrave, si dhe tonet e fjalëve nga ana jonë, pa u nevojitur procesi i vëmendjes, do të thotë se:

- A) Informacionet e ndiçimit nuk kërkojnë procese të larta perceptimi
- B) Informacionet e ndiçimit kërkojnë procese të larta perceptimi
- C) Informacionet e perceptimit kërkojnë procese të larta ndiçimi
- D) Informacionet e perceptimit nuk kërkojnë procese të larta ndiçimi

Pyetja 15

“Në një klasë ku mësuesi identifikon nxënës me vështirësi në përqëndrimin e vëmendjes, vështirësi në përbushjen e detyrave shkollore, vështirësi për t’u organizuar, si dhe humbje të kontrollit dhe e raporton rastin tek psikologu i shkollës, ky i fundit ka për detyrë:

- A) Të diagnostikoj këtë lloj çrregullimi nëpërmjet testit të sjelljes së vazhdueshme (TSV)
- B) Të trajtojë nxënësin me medikamente që frenojnë pasojat e këtij çrregullimi
- C) Të bashkëpunojë me mësuesin për të zhvilluar një plan edukativ individual, si dhe me prindërit për t’iu ofruar mbështetje emocionale, seanca psikoedukimi mbi sjelljen e tyre positive me fëmijët.
- D) Të ofrojë terapi me medikamente për fëmijën me çrregullim të vëmendjes, si dhe terapi online me prindërit e këtyre fëmijëve, me qëllim menaxhimin e sjelljeve të papërshtatshme të fëmijëve me këtë lloj çrregullimi.

Pyetja 16

Nga pohimet e mëposhtme gjej atë që është i gabuar. Informacioni në nivelin e parandërgjegjshëm:

- A) Qëndron jashtë vetëdijes së individit.
- B) Është i papërshtatshëm për proceset konjitive.
- C) Mund të kalojë tek vetëdija e ndërgjegjshme.
- D) Është i ruajtur por nuk është përdorur për një kohë.

Pyetja 17

Nga pohimet e mëposhtme gjej atë që është i gabuar.

- A) Rendimenti i vëmendjes është më lartë kur kjo është e pavetëdijshme.
- B) Vetëdija e ndërgjegjshme na lejon të lidhim të kaluarën me të tashmen.
- C) Vëmendja na lejon të rikujtojmë qetësisht informacionet.
- D) Informacioni i vëmendjes përshtatet nga kujtesa dhe ndijimet.

Pyetja 18

Proceset konjitive të kontrolluara:

- A) Janë nën kontrollin e pavetëdijes.
- B) Kryhen si procese paralele.
- C) Marrin shumë pak kohë për ekzekutim.
- D) Kërkojnë përpjekje të vëmendshme.

Pyetja 19

Automatizimi shfaqet si rezultat i:

- A) Vëmendjes së shpërndarë
- B) Grumbullimit të njohurive
- C) Praktikës dhe të ushtruarit
- D) Vëmendjes selektive

Pyetja 20

Procesi i familjarizimit:

- A) Kërkon shumë përpjekje të vetëdijshme.
- B) Ka nevojë për shumë burime të vëmendjes.
- C) Është adaptim psikologjik.
- D) Mbështet proceset e vëmendjes.

Pyetja 21

Kërkimi si një nga funksionet e vëmendjes:

- A) Ka të bëjë me pritjen pasive që stimuli të shfaqet.
- B) Lidhet me gjurmimin në mënyrë aktive të stimullit.
- C) Ndodh kur jemi te sigurt se ku do shfaqet stimuli.
- D) Ndodh kur jemi te sigurt se kur do të shfaqet stimuli.

Pyetja 22

Nga pohimet e mëposhtme në lidhje me vëmendjen, gjej atë që është i gabuar.

- A) Vëmendja lejon t'u përgjigjemi shpejtë dhe qartë stimujve.
- B) Vëmendja hap rrugën për proceset e kujtesës.
- C) Vëmendja mundëson përdorimin e burimeve të kufizuara aktive konjitive.
- D) Vëmendja ka rendiment më të lartë kur është e pavetëdijshme.

Pyetja 23

Dukuria “në majë të gjuhës” lidhet me pamundësinë për të kaluar informacione:

- A) Të pandërgjegjes në vetëdijen e ndërgjegjshme
- B) Të parandërgjegjes në vetëdijen e ndërgjegjshme
- C) Të vetëdijes së ndërgjegjshme në atë të pandërgjegjshme
- D) Të vetëdijes së ndërgjegjshme në pavetëdije

Pyetja 24

Procesi ku një ndryshim tek një stimul familjar na nxit përsëri të fillojmë vëzhgimin e tij është proces:

- A) Automatik
- B) I kontrolluar
- C) I vetëdijshëm
- D) I familjarizimit

Pyetja 25

Kur një stimul i pandryshueshëm vizual qëndron në fushën tonë vizuale për një kohë të gjatë, aktiviteti ynë nervor në përgjigje të këtij stimuli:

- A) Mbetet konstant
- B) Mbetet e i lartë
- C) Pëson rritje
- D) Pëson ulje

Pyetja 26

Përgjigjet që kapin adaptimin psikologjik zënë më shumë vend në:

- A) Organet e ndijimit
- B) Trurin tonë
- C) Palcën kurrizore
- D) Sistemin endokrin

Pyetja 27

Efekti Strup tregon se:

- A) Fjala e shkruar ndërhyr në saktësinë e emërtimit të ngjyrës së bojës
- B) Ngjyra e bojës ndërhyr në saktësinë e leximit të fjalës së shkruar
- C) Vëmendja e ndarë studiohet edhe përmes proceseve vizuale
- D) Ne kemi vështirësi për të qenë vigjilent për një kohë të gjatë

Pyetja 28

Radha e përpunimit të informacionit është:

- A) Ngacmimi i jashtëm – Regjistri shqisor – Kujtesa – Vëmendja
- B) Ngacmimi i jashtëm – Regjistri shqisor – Vëmendja - Kujtesa
- C) Regjistri shqisor – Ngacmimi i jashtëm – Kujtesa – Vëmendja
- D) Regjistri shqisor – Ngacmimi i jashtëm – Vëmendja - Kujtesa

Pyetja 29

Vëmendja është procesi i shikimit, dëgjimit, nuhatjes, shijimit dhe prekjes në mënyrë:

- A) Të njëkohshme
- B) Të shpërndarë
- C) Selektive
- D) Automatike

Pyetja 30

Kërkimi i stimulit vështirësohet nga:

- A) Ngjashmëria midis tërheqësve të vëmendjes selektive
- B) Uniformiteti midis tërheqësve të vëmendjes së shpërndarë
- C) Numri i tipareve të dallueshme që janë integruar
- D) Ngjashmëria midis objektivave dhe tërheqësve të vëmendjes

3. Kujtesa, llojet, harresa

Pyetja 1

Procesi psikik, i cili shërben si mjet kryesor për të lidhur përvojën e kaluar me të tashmen ku tek individët veprimtaria mnemonike lind gradualisht mbi bazën e veprimtarisë perceptuese, është:

- A) Vetëdija
- B) Harresa
- C) Kujtesa
- D) Analogjia

Pyetja 2

Procesi psikik i kujtesës, përjashton si karakteristikë të tij:

- A) Procesin psikik enigmatik
- B) Procesin psikik dinamik
- C) Procesin psikik produktiv
- D) Procesin psikik alternativ

Pyetja 3

Lloji i kujtesës që ka të bëjë me memorizimin e gjendje të caktuar emocionale dhe riprodhim të saj kur përsëritet situata, është:

- A) Kujtesa deklarative
- B) Kujtesa procedurale
- C) Kujtesa semantike
- D) Kujtesa emocionale

Pyetja 4

Tipari bazë i kujtesës afatshkurtër, është:

- A) Përsëritja e informacionit
- B) Ruajtja e informacionit
- C) Përzgjedhja e informacionit

D) Njohja e informacionit

Pyetja 5

Lloji i kujtesës, ku individët komunikojnë përmes gjuhës, sipas kuptimit të fjalëve, si dhe ku njohuritë, idetë e konceptet janë të lidhura me përvojat personale, kemi të bëjmë me:

- A) Kujtesë semantike
- B) Kujtesë procedurale
- C) Kujtesë episodike
- D) Kujtesë retrospektive

Pyetja 6

Një element shumë i rëndësishëm, që cilësohet si “karburant për trurin” dhe që ndihmon në rritjen e kujtesës është:

- A) Fructosa
- B) Lactosa
- C) Glucosa
- D) Sucrosa

Pyetja 7

Kur një individ ka mungesa të kujtesës për një ngjarje të caktuar, e cila i ka shkaktuar tronditje të forta emocionale, kemi të bëjmë me:

- A) Amnezi infantile
- B) Amnezi progresive
- C) Amnezi disociative
- D) Amnezi anterograde

Pyetja 8

Procesi me anë të të cilit sistemi ynë nervor krijon përfaqësime mendore të stimujve që perceptohen, është:

- A) Kodimi
- B) Depozitimi
- C) Riprodhimi
- D) Organizimi

Pyetja 9

Lloji i kujtesës që ka pamje autobiografike dhe i referohet dijeve rreth fakteve, ngjarjeve, episodeve dhe realiteteve që kanë ndodhur në një kohë të caktuar, është:

- A) Kujtesë semantike
- B) Kujtesë procedurale
- C) Kujtesë deklarative
- D) Kujtesë episodike

Pyetja 10

Kujtesa afatshkurtër quhet ndryshe:

- A) Kujtesë pune
- B) Kujtesë ekoike
- C) Kujtesë ikonike
- D) Kujtesë episodike

Pyetja 11

Dukuria e lidhur me paaftësinë për të kujtuar e rikujtuar ngjarje që kanë ndodhur në moshën e fëmijërisë, ka të bëjë me:

- A) Amnezi infantile
- B) Amnezi progresive
- C) Amnezi hysterike
- D) Hiperpermnezia

Pyetja 12

Dukuria që lidhet me dobësimin e përkohshëm apo të përhershëm të aftësive riprodhuese të kujtesës individuale, ka të bëjë me:

- A) Kujtesën
- B) Harresën
- C) Vetëdijen
- D) Vëmendjen

Pyetja 13

Ruajtja e çastit të informacionit taktil që ndodh nëqoftëse prekim pëllëmbën e dorës me majës e stilolapsit dhe vazhdojmë të kemi ndijimin për disa çastesh edhe pasi maja e stilolapsit është larguar nga dora jonë, ka të bëjë me:

- A) Kujtesë procedurale
- B) Kujtesë semantike
- C) Kujtesë episodike
- D) Kujtesë shqisore

Pyetja 14

Nëse një i sëmurë kujton ngjarje, të cilat ai i kishte harruar, të shoqëruara me manifestime të delirozave, psikozave maniake, etj, ky individ vuan nga:

- A) Amnezi infantile
- B) Amnezi progresive
- C) Amnezi hysterike
- D) Hiperpermnezia

Pyetja 15

Nëse individi e ka të pamundur të kujtojë përvojën e tij në të kaluar, apo një ngjarje të caktuar në të kaluarën e tij, ky individ vuan nga:

- A) Sindroma Down,
- B) Amnezia
- C) Hiperaktivitet
- D) Autizëm

Pyetja 16

Disa shprehi të mësuara si asociacione midis stimulit dhe përgjigjes, si psh, kur dëgjojmë zilen e telefonit dhe menjëherë ngremë receptorin, apo kur ndalojmë lëvizjen nëse ndodhemi në një kryqëzim me semafor të kuq, etj, janë shprehi të cilat ruhen në:

- A) Kujtesën procedurale
- B) Kujtesën episodike
- C) Kujtesën semantike
- D) Kujtesën deklarative

Pyetja 17

Njohuritë tona të përgjithshme në rigjetjen e rregullave të lojës së futbollit, garave të atletikës, apo formulave kimike, kanë të bëjnë me:

- A) Kujtesën procedurale

- B) Kujtesën episodike
- C) Kujtesën semantike
- D) Kujtesën deklarative

Pyetja 18

Ndryshimi midis kujtesës deklarative dhe asaj procedurale, është:

- A) Kujtesa procedurale përmbledhet me konceptin “të dish si”
- B) Kujtesa procedurale përmbledhet me konceptin “të dish që”
- C) Kujtesa semantike nuk është deklarative.
- D) Kujtesa procedurale është deklarative

Pyetja 19

Në një situatë konkrete, të tashme, kur ty të duket sikur e ke përjetuar më parë, apo njohur më parë diku, edhe pse je i vetëdijshëm që nuk është kështu, ka të bëjë me:

- A) Jamais Vu
- B) Deja Vu
- C) Presque Vu
- D) Dejasque Vu

Pyetja 20

Një ndër dukuritë më të shpeshta të kujtesës siç është ajo “në majë të gjuhës”, ku një person përpiqet të sjellë në mendje një fjalë apo emër, por nuk e bën dot, ndodh për shkak se:

- A) Elemente ndërhyrëse bllokojnë mekanizmin e rigjetjes, gjë që pengon gjetjen e saktë të fjalës apo emrit
- B) Një person ka informacion të gjerë në gjetjen e dukurisë së saktë, por e pamundur për t’a shprehur fjalën apo emrin
- C) Një person ka informacion të kufizuar në gjetjen e dukurisë së saktë, dhe e kufizon veten në shprehjen e fjalës apo emrit
- D) Elemente ta caktuara aktivizojnë mekanizma të rigjetjes, gjë që nuk e pengojnë personin në gjetjen e saktë të fjalës apo emrit

Pyetja 21

Një maturant, i cili është përpara provimeve të Maturës Shtetërore, paraqitet tek psikologu, duke i treguar këtij të fundit që nuk mban mend Ligjet e Njutonit, formula të ndryshme kimie dhe matematike. Në këtë rast psikologu nuk duhet të:

- A) Të këshilloj maturantin mbi rritjen e kujtesës nëpërmjet përsëritjes së vazhdueshme të materialit lëndor
- B) Të këshilloj maturantin mbi rritjen e kujtesës nëpërmjet mbajtjes së shënimeve përgjatë mësimin të materialit lëndor
- C) Të zbatojë teknika të ndryshme me qëllim lehtësimin e gjendjes emocionale të maturantit, me qëllim që ky i fundit të organizojë njohuritë e marra nga materiali lëndor
- D) Të kërkoj prindërin e tij me qëllim vënien para përgjegjësisë të maturantit duke i treguar këtij të fundit mungesën e vëmendjes përkundrejt lëndëve shkencore

Pyetja 22

Kur një individ ka aftësi të jashtëzakonshme për të mbajtur mend, për të kujtuar apo për të riprodhuar ngjarjet të ndodhura para shumë vitesh, kemi të bëjmë me:

- A) Mnemonikën
- B) Metakujtesën
- C) Interferencën

D) Amnezinë

Pyetja 23

Psikologët kognitiv tek pacientët e tyre, që vuajnë nga probleme të kujtesës dhe harresës duhet të përdorin disa teknika, me qëllim përmirësimin e kujtesës së tyre, të cilat quhen:

- A) Teknika motivuese
- B) Teknika mnemonike
- C) Teknika psikologjike
- D) Teknika diagnostikuese

Pyetja 24

Një ndër sindromat më të njohura, që ka të bëjë me aftësitë njohëse të individit, që nuk është pjesë e Dementias, është:

- A) Sindroma Alzheimit
- B) Sindroma Korsakoff
- C) Sindroma Parkinsonit
- D) Sindroma Down

Pyetja 25

Psikologu kognitiv, i cili trajton pacientë me Sëmundjen e Alzheimit, nuk ka për qëllim të:

- A) Të ndihmojë në ndërtimin e mjeteve të rëndësishme, me qëllim rritjen e cilësisë së jetës të pacientit
- B) Të zbatojë strategjitë e ndërhyrjes psikologjike me qëllim krijimin e modeleve dhe politikave të kujdesit të tyre vetjak
- C) Të jetë në bashkëpunim të pandërprerë me mjekun psikiatër, me qëllim plotësimin terapeutik të pacientit
- D) Të jap medikamentet e duhura për trajtimin e këtyre pacientëve, dhe të bisedojë me të afërmit e tyre me qëllim rehabilitimin e tyre në qendra të të moshuarit

Pyetja 26

Sipas psikologëve kognitiv, nëse një pacient i alkolizuar, i cili paraqet një gjendje akute të konfuzionit mendor dhe një disorientim hapësinor – kohor, pamundësi për të kujtuar biseda konkrete etj, ai mbart:

- A) Sindromën Korsakoff
- B) Sindromën Wenicke
- C) Sindromën Wenicke – Korsakoff
- D) Sindromën Alzheimit

Pyetja 27

Tek klientët viktimë të traumës dhe torturës, psikologu kognitiv nuk duhet:

- A) Të zbulojë nëse janë të pranishme boshllëqet e kujtesës dhe të vlerësojë nëse klienti ka vështirësi të flasë për çështje të caktuara
- B) Të mundësojë tek klienti ndjenjën e sigurisë se psikologu i njeh simptomat dhe shqetësimet që ata përjetojnë
- C) Të shpjegojë klientit mbi një sërë simptomash me origjinë psikosomatike, me qëllim përqëndrimin tek emocioni i tij
- D) Të përqëndrojë pacientin në tregimin e ngjarjes së dhunës e torturave, pa mundësuar më parë teknikat ndërhyrëse të lejimit të pacientit në këtë gjendje, pa miratim të këtij të fundit

Pyetja 28

Shpesh herë, situatat të cilat shkaktojnë ankth, si psh vizita tek mjeku onkologjik, tek kardiologu etj, mundësojnë angazhimin tonë në aktivitete të ndryshme me qëllim që të harrojmë këtë takim me mjekun, pra shmangien e detyrimeve tona për shkak të ankthit të krijuar, sipas psikologëve kognitiv kemi të bëjmë me:

- A) Kujtesë të vonuar
- B) Kujtesë të motivuar
- C) Harresë e motivuar
- D) Harresë e vonuar

Pyetja 29

Shpesh herë na ndodh të jemi në një situatë, rrethanë apo ndodhi që edhe pse kemi qenë fizikisht aty, ne mendojmë se përballemi për herë të parë me këtë situatë apo ndodhi, pikërisht besim i gabuar i joni, që në psikologjinë kognitive ka të bëjë me:

- A) Dukurinë e Jamais Vu
- B) Dukurinë e Deja Vu
- C) Dukurinë e Presque Vu
- D) Dukurinë e Dejasque Vu

Pyetja 30

Harresa tek fëmijët e vegjël, e cila nuk është rastësore, mundëson probleme psikologjike në një moshë madhore të tij. Për të shmangur këtë, psikologu duhet:

- A) Të bisedojë me prindin, me qëllim që ky i fundit të bashkëbisedoj me fëmijën e tij, duke i bërë të ditur përgjegjësitë që fëmija duhet të marrë përsipër dhe të ndihmojë atë
- B) Të kontaktojë mësuesin, me qëllim që ky i fundit të kritikojë fëmijën, duke i bërë të ditur përgjegjësitë që fëmija duhet të marrë përsipër dhe t'a ndihmojë atë
- C) Të komunikojë me drejtorin e shkollës, me qëllim që ky i fundit të përjashtojë nga shkolla fëmijën, duke i treguar mungesën e marrjes së përgjegjësisë dhe mos interesimit më për këtë fëmijë
- D) Të bashkëpunojë me mjekun psikiatër, me qëllim që ky i fundit të trajtojë me medikamente fëmijën, për shkak të mungesës së marrjes së përgjegjësisë dhe defiçitit të memories

4. Gjuha dhe teoritë mbi zhvillimin gjuhësor

Pyetja 1

Një mjet komunikimi që përbëhet nga tingujt dhe simbole e që përdoret për të shprehur ide, mendime, përvojat jetësore dhe përjetimet emocionale quhet:

- A) Gjuhë;
- B) Inteligjencë;
- C) Psikolinguistikë;
- D) Të folurit.

Pyetja 2

Gjuha njerëzore ndryshe nga komunikime të tjera që ndodhin midis specieve të tjera, çfarë e karakterizon dhe e bën të veçantë?

- A) Krijimtaria;
- B) Simbolet;
- C) Fonemat;
- D) Gjestet.

Pyetja 3

Një shpjegim që japin teoricienët për mësimin e gjuhës është me anën e përforcimit dhe imitimit. Cila teori ka zhvilluar këtë përjasje?

- A) Teoria e periudhës kritike;
- B) Teoria të mësuarit;
- C) Teoria universale e gjuhës;
- D) Teoria e kushtëzimit klasik.

Pyetja 4

Cili teoricien gjuhësor hedh idenë se gjuha është një aftësi e programuar gjenetikisht?

- A) Chomsky
- B) Skinner
- C) Bandura
- D) Whorf

Pyetja 5

Kuptimi i fjalëve, i shprehjeve që pëdoren në një gjuhë të caktuar lidhet me cilin dimension të gjuhës?

- A) Sintaksa;
- B) Fonetika;
- C) Morfologjia;
- D) Semantika.

Pyetja 6

Një nga vështërsitë që lidhet me mësimin e një gjuhe të huaj është:

- A) Koha e gjatë e përvetësimit;
- B) Interferenca e gjuhës amtare;
- C) Kufizimet në metakonjicion;
- D) Kufizimet metalinguistike.

Pyetja 7

Një baba po dëgjon belbëzimet e para të djalit të tij 7 muajsh, por kur dëgjon “bababa” ai gëzohet shumë dhe i përsërit këto belbëzime me entuziazëm duke parë djalin. Gradualisht djali përdor më shuëm belbëzimin “bababa”. Belbëzimi “bababa” është përsëritur më shpesh nga djali si pasojë e:

- A) Imitimit;
- B) Formësimit;
- C) Maturimit;
- D) Të mësuarit.

Pyetja 8

Një vajzë po dëgjon shoqen e saj në një bisedë, por shoqja kollitet dhe fjalët e fundit nuk i shqipton mirë. Gjithsesi, shoqja i percepton fonemat e munguara dhe arrin të kuptoj mesazhin e shoqes. Kjo ndodh pasi:

- A) Vajza përdor procesim informacioni nga poshtë-lartë për të perceptuar fonemat;
- B) Vajza aktivizon kujtesën e punës për të kuptuar fjalinë;
- C) Vajza aktivizon kujtesën shqisore dëgjimore për të perceptuar fonemat;
- D) Vajza përdor ato fonema që përshtaten me kuptimin e fjalisë.

Pyetja 9

Një fëmijë 6 vjeçar i thotë nënës: “Gjyshi e vuri tortën në frigorifer”, kur e ëma i thotë me shaka që e dëgjoi sikur: “Torta vuri gjyshin në frigorifer”, fëmija i thotë se kjo është e pamundur

dhe gabim. Aftësia e fëmijës për të përdorur në mënyrë korrekte fjalët në fjali duke i dhënë kuptimin e duhur fjalisë lidhet me:

- A) Mekanizma mendor që bëjnë kategorizimin e fonemave;
- B) Mekanizma mendor që bëjnë kategorizimin sintaksor;
- C) Mekanizma mendor që bëjnë kategorizimin morfologjik;
- D) Mekanizma mendor që bëjnë kategorizimin gramatikor.

Pyetja 10

Një fëmijë në klasën e parë po lexon një fjalë të re, ai po i kushton shumë vëmendjen fjalës për ta shqiptuar korrektësisht. Ky fëmijë për të lexuar këtë fjalë po aktivizon më shumë:

- A) Rregullat sintaksore;
- B) Rregullat semantike;
- C) Rregullat leksikore;
- D) Rregullat fonetike.

Pyetja 11

Në studime afatgjatë që janë bërë për t'i mësuar gjuhën shimpanzeve, ato arritën të përdornin kombinime tre fjalëshe si "Banane Nim (emri i shimpazes) jep". Studiuesit kanë arritur në konkluzionin:

- A) Gjuha njerëzore mund t'i mësohet shimpazeve me anën e trajnimeve;
- B) Shimpazet kanë predispozita gjenetike për të mësuar gjuhën;
- C) Shimpazetë nuk shfaqin aftësi për të mësuar fonemat;
- D) Shimpazet nuk shfaqin rregulla gramatikore të gjuhës.

Pyetja 12

Në disa vende Arabike përdoren më shumë se 20 emërtime për devet. Duke u bazuar tek hipoteza e relativitetit gjuhësor:

- A) Njerëzit në Arabi kanë të njëjtin koncept për deven si dhe në vende të tjera;
- B) Zhvillimi i mendimit për deven ka ndikuar në nurmin e lartë të emërtimeve;
- C) Pavarësisht këtyre emërtimeve, njerëzit pak a shumë e kuptojnë botën njëlloj;
- D) Gjuha ndikon mënyrën e të menduarit kështu që koncepti i devës është i ndryshëm për Arabikët.

Pyetja 13

Një djalë është në një vend të huaj dhe di shumë pak gjuhën e vendit. Ai po mundohet të gjej rrugën për në hotelin e tij dhe po pyet kalimtarë që t'a ndihmojnë, por ai keqinterpreton udhëzimet e tyre dhe merr trenin që shkon në një qytet tjetër. Si e vlerësoni këtë situatë duke u bazuar tek hipoteza e relativitetit gjuhësor?

- A) Djali është keqkuptuar pasi fjalët që dëgjon në gjuhën e huaj i jep kuptim sipas gjuhës së tij;
- B) Djali duhet të kishte udhëzime të qarta të vendeve në gjuhën e tij;
- C) Përdorimi i kufizuar i gjuhës ka penguar proceset e të menduarit për të zgjidhur problemin.
- D) Djali më shumë se vështërsi gjuhe, nuk ka pasur një hartë mendore të qartë të qytetit.

Pyetja 14

Vëllai i vogël e pyet vëllain më të madh "A do më ndihmosh me detyrat e matematikës?". Duke u bazuar tek aktet e të folurit, cilës kategori i përket kjo mënyrë e të folurit që shfaq vëllai më i vogël?

- A) Prezantimit;

- B) Direktivës;
- C) Angazhimit;
- D) Deklarimet.

Pyetja 15

Një nënë e pyet djalin e saj: “Do të thyesh arrat për kekun që do bëj?” Djali i përgjigjet: “Po, ja të marrë çekiçin dhe të filloj punën.” Përgjigja e djalit, cilës kategori të akteve të të folurit i përket?

- A) Angazhimit;
- B) Mënyrës së të folurit;
- C) Deklarimit;
- D) Direktivës.

Pyetja 16

Parimi i pare i zhvillimit gjuhësor parashtrohet:

- A) Se gjuha është simbolike
- B) Se gjuha është gjenerative
- C) Se gjuha është arbitrare
- D) Se gjuha është argumentuese

Pyetja 17

Nëse foshnja 2 vjeç thotë shpesh fjalën “ma”, ajo po përdor një:

- A) Fonemë
- B) Morfemë
- C) Sintaksë
- D) Leksik

Pyetja 18

Nga mosha 1-5 muaj foshnjat shfaqin:

- A) Të folur Argumentues
- B) Komunikim Gjykues
- C) Komunikim me një fjalë
- D) Komunikim Refleksiv

Pyetja 19

Aftësia e një personi për të folur 2 gjuhë njëkohësisht quhet:

- A) Dilingualizëm
- B) Dylingualizëm
- C) Bilingualizëm
- D) Trilingualizëm

Pyetja 20

Sipas bihejvioristëve, fëmijët mësojnë gjuhën përmes:

- A) Imitimit, përforcimit dhe parimeve të kushtëzimit
- B) Adaptimit, përforcimit dhe parimeve të kushtëzimit
- C) Akomodimit, përforcimit dhe parimeve të kushtëzimit
- D) Kujtesës, përforcimit dhe parimeve të kushtëzimit

Pyetja 21

Nëse fëmija i aplikon rregullat e përdorimit të gjuhës, në përputhje me rrethanat për të qënë i efektshëm në komunikim, atëherë në këtë rast reflektohet:

- A) Sintaksa e gjuhës

- B) Vetëdijësim metagjuhësor
- C) Pragmatizmi
- D) Leksik receptiv

Pyetja 22

Nëse një fëmijë ju thotë “jep ujë”, ai:

- A) Përdor të folurin telegrafik
- B) Përdor mendimin telegrafik
- C) Përdor të folur metakonjitiv
- D) Përdor mendimin metakonjitiv

Pyetja 23

Cila nga shprehjet e mëposhtme i përket Piazhësë, lidhur me të folurin egocentrik ose vetjak:

- A) Të folurit vetjak nuk është shenjë e paaftësisë kognitive
- B) Të folurit vetjak luajn një rol të rëndësishëm në zhvillimin kognitiv
- C) Të folurit vetjak lind nga bashkëveprimi shoqëror me të tjerët
- D) Të folurit vetjak është shenjë e papjekurisë kognitive

Pyetja 24

Cila nga fazat e mëposhtme është faza e fundit e përvetësimit të gjuhës:

- A) Zhvillimi pragmatikës
- B) Zhvillimi semantik
- C) Zhvillimi fonologjik
- D) Zhvillimi i sintaksës

Pyetja 25

Procesi i “akulturalizmit” nënkupton:

- A) Identifikimin e përjashtimin e një personi të pakulturuar në një shoqëri të caktuar
- B) Identifikimin dhe përfshirjen e një personi të pakulturuar nga një kulturë e caktuar
- C) Shkallën e integritit socio – psikologjik të një personi në një kulturë të caktuar
- D) Përfshirjen e dy ose me shumë personave në një kulturë të caktuar

Pyetja 26

Aftësia e fëmijëve për të zotëruar rregullat e një gjuhe quhet:

- A) Mbizotërim
- B) Mbirregullim
- C) Kontrollim
- D) Analizë sintaksore

Pyetja 27

Qasja ndërvepruese e mësimimit të gjuhës argumenton:

- A) Se mësimi gjuhësor është rezultat i ndërveprimit shëndet-patologji
- B) Se mësimi gjuhësor është rezultat i ndërveprimit mendje-trup
- C) Se mësimi gjuhësor është rezultat i ndërveprimit familje-shkollë
- D) Se mësimi gjuhësor është rezultat i ndërveprimit biologji-mjedis

Pyetja 28

Cila nga shprehjet e mëposhtme i përket Vigotskit, lidhur me gjuhën dhe mendimin:

- A) Gjuha është një manifestim i zhvillimit kognitiv
- B) Gjuha dhe mendimi zhvillohen në mënyrë të pavarur
- C) Zhvillimi kognitiv reflektohet tek gjuha e folur

D) Gjuha është e domosdoshme për të menduarit

Pyetja 29

Nëse një fëmijë përdor vetëdijen metalinguistike ai:

- A) Njeh dhe përdor disa gjuhë të ndryshme
- B) Njeh dhe të kupton gjuhën amtare
- C) Është i ndërgjegjësuar mbi përdorimin e gjuhës
- D) Mund të analizojë dhe përdorë gjuhën

Pyetja 30

Aftësia e fëmijëve për të përdorur kohën e shkuar të kallëzuesit dhe shumësin e emrave:

- A) Ndodh në moshën 2 vjeç
- B) Ndodh në moshën 3 vjeç
- C) Ndodh në moshën 4 vjeç
- D) Ndodh në moshën 5 vjeç

5. Inteligjenca, teoritë dhe matja e saj

Pyetja 1

Aftësia e njeriut për të mësuar nga përvoja dhe për t'iu përshtatur mjedisit quhet:

- A) Adaptim;
- B) Metakonjicion;
- C) Zgjuarsi;
- D) Inteligjencë.

Pyetja 2

Aftësia për të kuptuar dhe menaxhuar emocionet tek vetja dhe tek të tjerët quhet:

- A) Vetë-rregullim;
- B) Ekuilibër emocional;
- C) Inteligjencë emocionale;
- D) Inteligjencë sociale.

Pyetja 3

Koeficienti i inteligjencës prej 125 pikësh është tregues i:

- A) Inteligjencës mbi mesatare;
- B) Zhvillimit të vonuar mendor;
- C) Inteligjencës mesatare;
- D) Inteligjencës nën mesatare.

Pyetja 4

Aftësia për të zgjidhur probleme të reja duke përdorur strategji krijuese lidhet me:

- A) Inteligjencën fluide;
- B) Inteligjencën artistike;
- C) Inteligjencën emocionale;
- D) Inteligjencën e kristalizuar.

Pyetja 5

Aftësia për të lexuar libra, për të kuptuar fjalët, për të shkruar libra, lidhet me cilën tip inteligjencë?

- A) Inteligjencën interpersonale;

- B) Inteligjencën intrapersonale;
- C) Inteligjencën dëgjimore;
- D) Inteligjencën gjuhësore.

Pyetja 6

Aftësia për të zgjidhur probleme me arsyetim logjik, për të bërë bilancet ekonomike lidhet me cilin tip inteligjence?

- A) Inteligjenca logjiko-matematikore;
- B) Inteligjenca e përgjithshme;
- C) Inteligjenca specifike;
- D) Inteligjenca fluide.

Pyetja 7

Aftësia për t`u orientuar, për të lëvizur nga një vend në një vend tjetër lidhet me cilin tip të inteligjencës?

- A) Inteligjencën hapësinore;
- B) Inteligjencën natyraliste;
- C) Inteligjencën kinestetike;
- D) Inteligjencën logjiko-matematikore.

Pyetja 8

Aftësia për të kuptuar veten, për të kuptuar se si mund të ndryshojmë, për të kuptuar kufizimet dhe përparësitë e vetes lidhet me cilin tip inteligjence?

- A) Inteligjenca interpersonale;
- B) Inteligjenca gjuhësore;
- C) Inteligjenca sociale;
- D) Inteligjenca intrapersonale.

Pyetja 9

Sipas Gardnerit, inteligjenca:

- A) Është një faktorëshe, pra njeriu që të jetë inteligjent duhet të ketë aftësi të shumta përshtatëse;
- B) Është më shumë se një aftësi që lidhen me përshtatjen e njeriut;
- C) Është një ose më shumë aftësi që përshtasin njeriun në mjedisin e tij;
- D) Është një ose më shumë aftësi që mësohen në mjedis.

Pyetja 10

Sipas Sternberg, inteligjenca analitike:

- A) Është aftësia për të zgjidhur probleme duke kuptuar elementët dhe natyrën e problemit;
- B) Është aftësia për të zgjidhur probleme duke qenë krijues dhe spontan;
- C) Është aftësia për të zgjidhur probleme duke aplikuar njohuritë tona në kontekstet e përditshme;
- D) Është aftësia për të zgjidhur probleme duke përdor të menduarit divergjent.

Pyetja 11

Sipas teorisë së Sternberg për inteligjencën:

- A) Individu përdor një nga tre aftësitë mendore për të qenë inteligjent e për t`iu përshtatur mjedisit;
- B) Individu përdor të treja aftësitë mendore për të qenë vigjilent ndaj mjedisit e për t`u përshtatur;

- C) Individu që përdor krijimtarinë shfaq inteligjencë më të lartë pasi përshtatet më shumë me mjedisin;
- D) Përdorimi i tre aftësive mendore duke u bazuar tek llojet e përvojave nxit përshtatjen me mjedisin.

Pyetja 12

Sipas Sternberg, testet e inteligjencës masin më shumë:

- A) Aftësitë analitike;
- B) Aftësitë krijuese;
- C) Aftësitë praktike;
- D) Aftësitë akademike.

Pyetja 13

Një turist humbi drejtimin e rrugës. Ai duhet të shkonte për në sheshin kryesor të qytetit. Turisti përsëri nxorri hartën e qytetit, pa rrugën ku ishte dhe gjeti një degëzim për të kaluar tek rruga që të nxjerr në shesh. Aftësia e turistit për të zgjidhur këtë problemin lidhet me:

- A) Inteligjencën fluide;
- B) Inteligjencën hapësinore;
- C) Inteligjencën kinestetike;
- D) Inteligjencën trupore.

Pyetja 14

Një fëmijë ka shumë dëshirë të dëgjoj muzikë, ai përpiqet të këndoj këngët, shfaq interes të lartë ndaj pianos dhe violinës dhe mund të dëgjoj për një kohë të gjatë dikë që po luan në piano apo violinë. Cilin tip inteligjence shfaq ky fëmijë?

- A) Inteligjencën artistike;
- B) Inteligjencën kinestetike;
- C) Inteligjencën intrapersonale;
- D) Inteligjencën muzikore.

Pyetja 15

Në rrugë po ecin dy shokë. Njëri nga shokët ka ngritur zërin dhe duket shumë i zemëruar. Shoku tjetër nuk reagon, po përpiqet të ruaj qetësinë dhe po mundohet të kuptoj motivet e kësaj sjellje të shokut dhe arsyen pse është lënduar kaq shumë. Cilin tip të inteligjences shfaq shoku që po përpiqet të ruaj qetësinë?

- A) Inteligjencë intrapersonale;
- B) Inteligjencë gjuhësore;
- C) Inteligjencë interpersonale;
- D) Inteligjencë sociale.

Pyetja 16

Një i ri po reflekton për një situatë ku ai u zemërua shumë. Ai kupton se mund të zemërohet me shpejtësi në situata të ngjashme pasi e ka të vështirë të menaxhojë zemërimin kur të tjerët e akuzojnë pa të drejtë. I riu vendos që herë të tjera do përpiqet të shpreh me fjalë lëndimin e tij dhe të ruaj qetësinë. Ky reflektim lidhet me cilin tip të inteligjencës?

- A) Inteligjenca interpersonale;
- B) Inteligjenca gjuhësore;
- C) Inteligjenca sociale;
- D) Inteligjenca intrapersonale.

Pyetja 17

Një student harxhoi tërë mbasditen duke studiuar dhe duke iu përgjigjur të gjitha pyetjeve në fund të kapitullit. Sipas teorisë së Sternberg, i riu ka përdorur cilën aftësi të inteligjencës për të studiuar?

- A) Aftësitë gjuhësore;
- B) Aftësitë analitike;
- C) Aftësitë krijuese;
- D) Aftësitë praktike.

Pyetja 18

Një nxënës u shpall fituesi i posterit më të mirë për prezantimin e shkollës së tij. Ai kishte krijuar një poezi për shkollën dhe kishte ngjitur në poster foto që reflektojnë historikun e shkollës. Sipas Sternbergut, ky nxënës ka përdorur cilat aftësi të inteligjencës për të bërë posterin?

- A) Aftësitë analitike;
- B) Aftësitë artistike;
- C) Aftësitë praktike;
- D) Aftësitë krijuese.

Pyetja 19

Një djalë i sapo diplomuar fillon punë në një kompani si asistent në një nga sektorët e kompanisë. Pavarësisht se kjo punë nuk lidhet me aftësitë profesionale që djali ka zhvilluar gjatë studimeve, sërish kjo punë do t'i jap mundësi financiare për të bërë një trajnim më specifik për drejtimin e punës që ai dëshiron në të ardhmen. Sipas Sternberg, ky djalë ka përdorur cilat aftësi të inteligjencës në këtë situatë?

- A) Aftësitë praktike;
- B) Aftësitë analitike;
- C) Aftësitë krijuese;
- D) Aftësitë menaxhuese.

Pyetja 20

Studimet afatgjata për inteligjencën të ndërmarra nga studiuesit me familje me rrezik të lartë socio-ekonomik, është vënë re se:

- A) Fëmijët e këtyre familjeve shfaqin të njëjtin Koefficientë Intelligjence si prindërit e tyre;
- B) Fëmijët që vijnë nga familje të tilla kanë më shumë rrezik për probleme të shëndetit mendor;
- C) Fëmijët shfaqin rritje të dukshme të Koefficientit të Intelligjencës nga ndërhyrjet që marrin;
- D) Fëmijët shfaqin ndryshim minimal të Koefficientit të Intelligjencës nga ndërhyrjet e marra.

Pyetja 21

Studiuesit e inteligjencës, të cilët kanë bërë ndërhyrje më nxënësit në shkolla për konceptin e inteligjencës si një aftësi që nuk ndryshon apo jo, kanë nxjerrë si konkluzion që:

- A) Nxënësit që besojnë se inteligjenca zhvillohet me përvojën rrisin rezultatet e tyre;
- B) Nuk ka dallime midis konceptit që nxënësit kanë për inteligjencën dhe arritjeve akademike;
- C) Nxënësit që besojnë se inteligjenca është aftësi e lindur dhe nuk ndryshon arrijnë rezultate të larta;

D) Nxënësit që besojnë se inteligjenca ndryshon me përvojë kanë rezultate të ulta.

Pyetja 22

Inteligjenca fluide:

- A) Është më e lartë tek të rinjtë;
- B) Është më e lartë tek të moshuarit;
- C) Është më e lartë tek fëmijët;
- D) Është më e lartë tek vajzat se sa tek djemtë.

Pyetja 23

Inteligjenca e kristalizuuar:

- A) Është më e lartë tek më të moshuarit;
- B) Është më e ulët tek të moshuarit;
- C) Është më e lartë tek djemtë se sa tek vajzat;
- D) Ulet gjatë moshës së rinisë.

Pyetja 24

Një grupi etnik në Liberi, kur ju kërkua nga kërkuesë të psikologjisë që të kategorizonin objektet, ato i grupuan sipas funksioneve të tyre (p.sh. patatet me thikën dhe me enën) dhe jo sipas kategorive përfaqësuese të objekteve (p.sh. perimet kategori me vete, enët e kuzhinës me vete). Studiuesit kanë nxjerrë konkluzion se:

- A) Në kultura të ndryshme kategorizimet e objekteve janë të ndryshme;
- B) Pavarësisht kulturave, koncepti i inteligjencës është i njëjtë;
- C) Kultura të ndryshme ndajnë vlera të ndryshme;
- D) Koncepti i inteligjencës lidhet me vlerat kulturore.

Pyetja 25

Një mësuese beson se nxënësit me inteligjencë të lartë janë ato nxënës që arrijnë rezultate të larta në të gjitha lëndët, e sidomos në matematikë. Si e vlerësoni këtë koncept të inteligjencës duke u bazuar tek teoritë e inteligjencës?

- A) Mësuesja beson se inteligjenca lidhet me një faktor të përgjithshëm aftësie;
- B) Mësuesja beson se inteligjenca lidhet me aftësi të shumëfishta;
- C) Mësuesja beson se inteligjenca është aftësi specifike për zgjidhjen e problemeve;
- D) Mësuesja beson se inteligjenca lidhet me arritjet në lëndë të vështira si matematika.

Pyetja 26

Në një kompani kanë ardhur kompjutera të teknologjisë së fundit për stafin. Disa prej punonjësve të cilët janë më të moshuar, kanë bërë gabime duke vonuar procesin e punës. Si e vlerësoni këtë situatë?

- A) Punonjësit kanë nevojë për kohë dhe për trajnime për të mësuar programet e reja kompjuterike;
- B) Punonjësit më të moshuar e kanë më të vështirë të përdorin programet pasi inteligjenca fluide është në rënie;
- C) Punonjësit më të moshuar e kanë më të vështirë të përdorin programet pasi inteligjenca e kristalizuuar është në rënie;
- D) Punonjësit më të moshuar shfaqin më pak përqëndrim dhe kjo ndikon në gabimet që ato kanë bërë.

Pyetja 27

Një psikolog gjeti një test inteligjence në një bibliotekë virtuale, e përshtati në gjuhën shqipe dhe po e përdor me fëmijët sipas udhëzimeve të manualit. Si e gjykoni këtë praktikë të psikologut?

- A) Psikologu po mat inteligjencën me një test jo të besueshëm për kontekstin shqiptar;
- B) Psikologu duhet të përshtaste testin e inteligjencës me ndihmën e një përkthyesi të licensuar;
- C) Psikologu përpara se të përdorte testin duhet të merrte mendimin e një mentori;
- D) Psikologu po mat inteligjencën me një test jo të vlefshëm për kontekstin shqiptar.

Pyetja 28

Një student vazhdimisht gabon rendin e gërmave në shkrimin e fjalëve, ka vështirësi të përdor korrektësisht shenjat e pikëzimit. Nga ana tjetër, ai shfaq aftësi të larta në procesimin numerik dhe është ndër të parët në kurset që lidhen me këto aftësi. Si i vlerësoni këto aftësi duke u bazuar tek teoritë e inteligjencës?

- A) Pavarësisht përparësisë në aftësitë numerike, studenti shfaq aftësi të ulta intelektuale për arsye të problemeve me gjuhën;
- B) Sipas teorisë së inteligjencave të shumëfishta, studenti shfaq aftësi intelektuale të pavarurura nga njëra-tjetra;
- C) Sipas teorisë së Sternberg për inteligjencën, studenti shfaq aftësi praktike të larta por aftësi analitike të ulta;
- D) Studenti shfaq aftësi të larta të inteligjencës fluide por aftësi të ulta të inteligjencës së kristalizuar.

Pyetja 29

Një vajzë e re e sapo diplomuar ndjehet shumë keq pasi nuk po gjen një punë që lidhet me profesionin e saj. Ajo nuk mund ta imagjinoj veten në punë të tjera, edhe pse këto punë mund të jenë të përafërta me punën që dëshiron. Duke u bazuar tek teoritë e inteligjencës, si e vlerësoni këtë vendim të vajzës?

- A) Vajza po përdor aftësi analitike për të zgjidhur një problem praktik;
- B) Vajza shfaq inteligjencë të ulët praktike që nuk e përshtat me mjedisin;
- C) Vajza po shfaq një nivel krijimtarije të ulët dhe nuk arrin të zgjidhë problemin;
- D) Vajza orientohet nga idealet e saj dhe me këmbëngulje do të zgjidhë këtë problem.

Pyetja 30

Një studente e mjekësisë ka një provim për të cilin duhet të mësoj shumë terma mjekësor. Ajo vendos të ngjisë fletushka me termat përkatës në çdo cep të mureve të shtëpisë në mënyrë që t'i shoh dhe t'i lexojë sa më shpesh. Studentja për të zgjidhur problemin po përdor:

- A) Aftësitë krijuese;
- B) Aftësitë analitike;
- C) Aftësitë praktike;
- D) Aftësitë gjuhësore.

6. Teoritë mbi procesin e të nxënimit

Pyetja 1

Përcaktimi, i cili shpreh se sa herë dy apo më shumë ndjesi ndodhin së bashku, me shpeshtësi të mjaftueshme, ato asocohen me njëra – tjetrën, reflekton:

- A) Parimin e ngjashmërisë

- B) Parimin e të kundërtave
- C) Parimin e kushtëzimit klasik
- D) Parimin e kontiguitetit

Pyetja 2

Cila prej teorive të mëposhtme e sheh të nxënësit si një proces i brendshëm që nuk mund të vëzhgohet.

- A) Teoria bihevorale
- B) Teoria konstruktiviste
- C) Teoria kognitiviste
- D) Teoria e kushtëzimit operant

Pyetja 3

Mësuesja për të vënë rregullin në klasë, pas një diskutimi të zhurmshëm, lidhur me Luftën Civile, u thotë nxënësve: “Në rregull, meqë po shoh, që ditkeni kaq shumë për Luftën Civile, mbyllni librat dhe nxirrni penat, do të bëni një test. Keni 20 minuta kohë për ta bërë testin!”.

Në shembullin e mësipërm mësuesja po përdor:

- A) Përforcimin Pozitiv
- B) Ndëshkimin
- C) Përforcimin negativ
- D) Parimin Primack

Pyetja 4

Një stimul neutral që përdoret për të prodhuar një përgjigje të re kur ai shoqërohet me stimulin e pakushtëzuar quhet:

- A) Stimuli i pakushtëzuar
- B) Reagim i pakushtëzuar
- C) Reagimi i kushtëzuar
- D) Stimuli i kushtëzuar

Pyetja 5

Nëse mësuesja shpërblen apo ndëshkon të gjithë klasën për zbatimin apo shkeljen e rregullave të sjelljes qoftë edhe nga një anëtar i vetëm ajo po aplikon:

- A) Pasojat e grupit
- B) Parakorrigjimin
- C) Kontratën me kusht
- D) Përforcimin e tërthortë

Pyetja 6

Nëse kemi një përpunim aktiv dhe ruajtje të përkohëshme të informacionit, atëherë nxënësi ka vënë në përdorim:

- A) Kujtesën afatgjatë
- B) Kujtesën afatshkurtër
- C) Kujtesën e punës
- D) Kujtesa episodike

Pyetja 7

Vëllimi i burimeve të nevojshme për të kryer një detyrë quhet:

- A) Ngarkesë kognitive relevante

- B) Ngarkesë kognitive
- C) Ngarkesë kognitive e brendëshme
- D) Ngarkesë kognitive e jashtme

Pyetja 8

Cila është njohuria që demonstrohet kur ne kryejmë një detyrë? ” Të dish se si të bësh dicka”.

- A) Deklarative
- B) Vetërregulluese
- C) Rregulluese
- D) Procedurale

Pyetja 9

Teknika për të mbajtur mend, e cila përdor shkronjën e parë të çdo fjale në një frazë për të formuar një frazë të re, më të lehtë për tu mbajtur mend, quhet:

- A) Akronim
- B) Metoda loci
- C) Mnemonika zinxhir
- D) Mnemonika

Pyetja 10

Planet e përgjithshme për qasjen ndaj detyrave të të nxënës quhen:

- A) Teknikat e të nxënës
- B) Hartat konceptuale
- C) Strategjitë e të nxënës
- D) Mendimet analogjike

Pyetja 11

Cila prej teorive mbron tezën që të mësuarit social i paraprin zhvillimit?

- A) Teori kognitive
- B) Konstruktivizmi i valës së dytë
- C) Konstruktivizmi i valës së parë
- D) Teoria socio – kognitive

Pyetja 12

Përforsim që jepet pas një numri të caktuar përgjigjesh (p.sh çdo 10 përgjigje) reflekton

- A) Modelin e përforsimit me raport të ndryshuar
- B) Modelin e përforsimit me intervale kohore fikse
- C) Modelin e përforsimit me raport të fiksuar
- D) Modelin e përforsimit me intervale kohore

Pyetja 13

Sipas jush, cila prej shprehje të mëposhtëm përcakton të nxënës:

- A) Të nxënës përfshin atë që është e saktë edhe e gabuar
- B) Të nxënës përfshin vetëm atë që është e saktë
- C) Të nxënës përfshin vetëm atë që është e qartë dhe e saktë
- D) Të nxënës ndodh me një qëllim të caktuar dhe në mënyrë të ndërgjegjshme

Pyetja 14

Mësuesja për të nxitur fëmijët të punojnë në klasë u thotë nxënësve: “Nëse plotësoni pjesën e parë të detyrës me qetësi dhe seriozitet, do të punoni në grupe me pjesën e dytë.”. Mësuesja e dinte që puna në grupe ishte një nga aktivitetet më të pëlqyera të kësaj klasë. Në shembullin e mësipërm për të nxitur nxënësit të punojnë, mësuesja po përdor

- A) Përforcimin Pozitiv
- B) Ndëshkimin
- C) Parimin Primack
- D) Përforcimin negativ

Pyetja 15

Paaftësia për të përdorur objektet apo mjetet në një mënyrë të re lidhet me:

- A) Kokëfortësinë e bindjes
- B) Gabimin e konfirmimit
- C) Fiksimin e përgjigjes
- D) Fiksimin funksional

Pyetja 16

Një nxënës përsërit rregullat “e pjestimit të thyesave apo shumëzimit” dhe pas kësaj përsëritje nxënësit është i aftë t’i thotë rregullat përkatëse. Cilat njohuri reflektohen në shembullin e dhënë?

- A) Njohuritë procedurale
- B) Njohuritë deklarative
- C) Njohuritë vetërregulluese
- D) Njohuritë rregulluese

Pyetja 17

Sipas cilës teori “Përforcimi është një burim i feedbackut të informacionit”:

- A) Teorisë kognitive
- B) Teorisë biheviore
- C) Teorisë konstruktiviste
- D) Teorisë së kushtëzimit klasik

Pyetja 18

Ju nuk doni të harroni se duhet të jeni në orar për takimin me një klient tuajin ditën e nesërme, duhet të respektoni afatin e përcaktuar për shkrimin e raportit të projektit, të cilin sapo e keni përfundur. Atëherë ju imagjinoni një person të huaj të shtrirë në dhomën e ndenjes tuaj, ju imagjinoni një fletë A4 si një perde të varur në derën e hyrjes së shtëpisë tuaj. Në këtë rast ju jeni duke përdorur:

- A) Mnemonikën zinxhir
- B) Metodën e akronimit
- C) Metodën loci
- D) Efektin e pozicionit serial

Pyetja 19

Cila nga shprehjet e mëposhtme është e saktë?

- A) Metakognicioni është shumë i dobishëm kur detyrat janë sfiduese, por jo teje të vështira

- B) Dallimet në aftësitë metakognitive kanë të bëjnë me moshën apo me pjekurinë
- C) Metakognicioni është shumë i dobishëm kur detyrat janë të vështira
- D) Dallimet individuale në aftësitë kognitive shkaktohen nga dallimet biologjike

Pyetja 20

Procesi i të nxëni, në të cilin çdo nxënës është pjesë e një grupi dhe cdo anëtar i të çdo grupi i jepet një pjesë e materialit që duhet mësuar nga i gjithë grupi lidhet me strategjinë:

- A) Debat I strukturuar
- B) Nxitje e bashkësive të nxënësve
- C) Mësimdhënie e ndërsjelltë
- D) Klasë Rebus

Pyetja 21

Angazhimi për të ndërtuar kuptim të përbashkët me të tjerët, duke gjetur pika takimi dhe duke shkëmbyer interpretimet lidhet me:

- A) Negocim shoqëror
- B) Qëndrim ndërsjelltë
- C) Të nxënët situacional
- D) Shpalosje të shumanshme të përmbajtjes

Pyetja 22

Ndërtimi aktiv i njohurive të mbështetura në vëzhgim, ndërveprimi në botën fizike dhe shoqërore dhe vetveprimi që ndihmon zhvillimin – bëhen procese më të vetërregulluara. Ky përcaktim i të nxëni i përket teorisë:

- A) Socio – kognitive
- B) Bihevisoriste
- C) Kognitive
- D) Konstruktiviste

Pyetja 23

Jeni duke përgatitur një modul trajnimi dhe vetëdija juaj në kohë reale lidhur me “si po më shkojnë punët” dhe pyetjet “ A ka kuptim kjo që po bëj?, Mos po eci shumë shpejt?” që vërtiten në kokën tuaj reflektojnë aftësinë e metakognicionit të:

- A) Vlerësimit
- B) Reflektimit
- C) Planifikimit
- D) Monitorimit

Pyetja 24

Në ditën e parë të mësimit mësuesja iu thotë nxënësve se gjatë semestrit do bëjë testime të papritura. Këtu kemi të bëjmë me një plan përforcimi me:

- A) Numër të ndryshueshëm
- B) Interval me kohë fikse
- C) Numër fiks
- D) Interval të ndryshueshëm

Pyetja 25

Klasat në të cilat vlerësimi përfshin punët e nxënësve, vëzhgimet dhe këndvështrimet e tyre si edhe testet dhe në të cilat procesi është po aq i rëndësishëm sa produkti janë:

- A) Klasat biheviore
- B) Klasat kognitiviste
- C) Klasat konstruktiviste
- D) Klasat socio – kognitive

Pyetja 26

Në mënyrë që individët të krijojnë një sjellje të vazhdueshme mbrojtëse për ta në makinë, vendosjen e rripit të sigurimit, projektuesit e makinave vendosën një zhurmë në makinë, e cila pushonte, në momentin e vendosjes së rripit të sigurimit. Tek cili element i teorisë biheviore janë bazuar projektuesit për të rritur sjelljen mbrojtëse tek individët.

- A) Përforcimi pozitiv
- B) Ndëshkimi
- C) Parimi primack
- D) Përforcimi negativ

Pyetja 27

Si mendoni, çfarë lloj përforcuesish janë paratë për njëri-tjetrin?

- A) Përforcues parësor
- B) Përforcues të përgjithshëm
- C) Përforcues dytësor
- D) Përforcues pozitiv

Pyetja 28

Detyrat që kërkojnë nivele të larta procesimi (p.sh. zgjidhje problemesh komplekse, përzgjedhje personale dhe monitorimi i strategjive kognitive) shpesh mësohen më mirë me strategji të rrjedhura nga?

- A) Teoria biheviore
- B) Teoria kognitiviste
- C) Teoria konstruktiviste
- D) Teoria socio – kognitive

Pyetja 29

Nëse ju realizoni një bisedë me dikë ose merrni opinionë nxitëse nga personi mbi mënyrën e realizimit të një detyre specifike, cilin nga burimet e efikasitetit reflekton shembulli në fjalë?

- A) Përvojat direkte
- B) Përvoja të huazuara
- C) Gjallërimi psikologjik
- D) Bindja/kandisja shoqërore

Pyetja 30

Një adoleshent që pi duhan, si pasojë e grupit të tij, sheh se se shokët e tij ndëshkohen për arsye të përdorimit të duhanit ose ai ndjen efektet negative të duhanit, për këtë arsye ai mund ta ndërpresë pirjen e duhanit në mënyrë të papritur. Në shembullin e mësipërm bazuar në teoritë sociale të të mësuarit, cili nga efektet e imitimit reflektohet në sjelljen e këtij adoleshenti?

- A) Efekti modelues

- B) Efekti frenues i modelimit
- C) Efekti shfrenues i modelimit
- D) Efekti nxitës i modelimit

7. Zgjidhja e problemeve dhe marrja e vendimeve

Pyetja 1

Në cilën teori të zgjidhjes së problemeve theksohet roli i provës dhe gabimit?

- A) E kthjellimit psikik
- B) E përpunimit të informacionit
- C) E të mësuarit
- D) E procesit të kundërt

Pyetja 2

Si quhet të menduarit që përfshin gjetjen e shumë përgjigjeve të ndryshme?

- A) Heuristik
- B) Gestaltist
- C) Divergjent
- D) Konvergjent

Pyetja 3

Si quhen informacionet shtesë që jepen për zgjidhjen e problemit pasi individi ka filluar të punojë me problemin?

- A) Algoritme
- B) Aluzione
- C) Analogji
- D) Arsyetime

Pyetja 4

Cili lloj arsyetimi ndërtohet mbi bazën e përdorimit të shembujve konkretë dhe të vërtetë?

- A) Krahasues
- B) Sistemik
- C) Ekzemplar
- D) Analogjik

Pyetja 5

Cilat lloje të vendimeve bazohen në eksperiencë të mëparshme të ngjashme për trajtimin e problemeve?

- A) Taktike
- B) Bazike
- C) Në grup
- D) Të programuara

Pyetja 6

Si quhet strategjia rastësore e kërkimit përmes së cilës provohet çdo zgjidhje e mundshme deri sa gjendet zgjidhja e saktë?

- A) Algoritëm
- B) Heuristikë
- C) Provë-gabim
- D) Rrahja e mendimeve

Pyetja 7

Çfarë jemi duke bërë kur krahasojmë problemin me probleme të tjera të njëjta apo të përafërta?

- A) Analogji personale
- B) Analogji të drejtpërdrejtë
- C) Analogji simboli
- D) Analogji të fantazisë

Pyetja 8

Cila teori e zgjidhjes së problemit e vë theksin në rolin aktiv të zgjidhësit të problemit?

- A) E përpunimit të informacionit
- B) E kapjes së sinjaleve
- C) E shkëmbimit social
- D) E të mësuarit social

Pyetja 9

Nga pohimet e mëposhtme gjej atë që është i gabuar. Skemat mendore fikse:

- A) Mund të ndihmojnë ose pengojnë zgjidhjen e problemit.
- B) Përcaktojnë cilin informacion zgjojmë nga kujtesa për të zgjidhur problemin.
- C) Janë mendime të standardizuara ku problemet e reja shihen në mënyra fikse.
- D) Janë prirje për të kuptuar një numër të kufizuar përdorimesh të një objekti.

Pyetja 10

Si quhet të menduarit që drejtohet vetëm nga një zgjidhje e saktë e problemit?

- A) Krijues
- B) Produktiv
- C) Konvergjent
- D) Divergjent

Pyetja 11

Në cilat llojet të gjykimeve bindshmëria është më e vogël?

- A) Gjykimet që mbështeten në perceptime aktuale.
- B) Gjykimet që mbështeten në evidentimin logjik.
- C) Gjykime që mbështeten në autoritetin shkencor.
- D) Gjykime që mbështeten në përvojën subjektive.

Pyetja 12

Në arsyetimin induktiv:

- A) Arrihet në një konkluzion të sigurt logjik nisur nga premisa të veçanta.
- B) Përcaktohet se çfarë konkluzioni vjen nëse disa premisa janë të vërteta.
- C) Nuk ka më shtim të informacionit semantik në procesin arsyetues.
- D) Bëhet një konkluzion i përgjithësuar nisur nga premisa të situatave të veçanta.

Pyetja 13

Silogjizëm është:

- A) Argument deduktiv që çon në përfundime logjike nga dy premisa.
- B) Strategji e zgjidhjes së problemeve dhe marrjes së vendimeve.
- C) Formë e të menduarit përgjithësues që nisur nga mendime të veçanta
- D) Kuptim i papritur i mënyrës dhe mjeteve për të arritur një qëllim.

Pyetja 14

Cili lloj i të menduarit bazohet kryesisht në dogma?

- A) Intuitiv
- B) Krijues
- C) I verbër
- D) Rixhid

Pyetja 15

Çfarë lloj analogjie jemi duke përdorur kur ne e mendojmë veten si pjesë përbërëse të një dukurie të caktuar?

- A) Personale
- B) E drejtpërdrejtë
- C) Simbolike
- D) Fantazie

Pyetja 16

Stadi i parë i ciklit të zgjidhjes së problemit është:

- A) Vlerësimi i problemit
- B) Organizimi i informacioni
- C) Përcaktimi i problemit
- D) Identifikimi i problemit

Pyetja 17

Cili lloj i të menduarit realizohet përmes supozimeve?

- A) Intuitiv
- B) Produktiv
- C) I verbër
- D) Krijues

Pyetja 18

Me cilin predispozicion lidhet prirja për të parë përfundimet si të pashmangshme?

- A) Për gjykim kompensues
- B) Për gjykim antirealist
- C) Për gjykim retrospektiv
- D) Për gjykim konfirmues

Pyetja 19

Çfarë lloj modeli është vendimmarrja në të cilën zgjedhjet vlerësohen sistematikisht në bazë të kritereve të ndryshme?

- A) Kompensues
- B) Konfirmues
- C) Kundërshtues
- D) Krahasues

Pyetja 20

Si quhet faza në të cilën problemi analizohet nga mendja e pandërgjegjshme dhe së jashtmi duke sikur nuk ndodh asgjë?

- A) Frymëzim
- B) Inkubacion
- C) Argumentim
- D) Inspiracion

Pyetja 21

Si quhen problemet që janë strukturë dhe procedurë të njëjtë ose të përafërt zgjidhjeje me probleme të tjera të ngjashme?

- A) Intuitive
- B) Divergjente
- C) Lineare
- D) Izomorfe

Pyetja 22

Cili tip gabimi gjatë arsytimi ndodh kur kushtet ose konkluzioni janë analizuar keq?

- A) Gabimi i i heuristikës
- B) Gabimi i procesimit
- C) Gabimi i të kuptuarit
- D) Gabimi i algoritmit

Pyetja 23

Nga pohimet e mëposhtme në lidhje me të menduarit si proces psikik njohës, gjej atë që është i gabuar.

- A) Të menduarit realizon një njohje indirekte të realitetit.
- B) Të menduarit ka të bëj me të kuptuarin e lidhjeve të një realiteti.
- C) Të menduarit realizon njohjen e thellë e realitetit që perceptohet.
- D) Të menduarit realizohet i shkëputur nga marrëdhëniet me të tjerët.

Pyetja 24

Praktika e mëparshme dhe eksperiencia në zgjidhjen e problemeve disa herë pengon zgjidhjen e mëtejshme të problemit. Kjo ndodh kur:

- A) Problemi është i ngjashëm me problemin e njohur dhe duket si ti tillë.
- B) Problemi nuk është i ngjashëm me problemin e njohur, por thjesht duket si i tillë.
- C) Nuk i shikojmë problemet e reja në mënyrë fikse, dhe mendimi nuk standardizohet.
- D) Priremi të përpunojmë skema mendore fleksible për zgjidhjen e problemit.

Pyetja 25

Nga pohimet e mëposhtme, gjej atë që është i gabuar. Të menduarit artistik është:

- A) I tipit egocentrik
- B) Jashtë marrëdhënieje kohore reale
- C) Tipik gjatë ëndërrimeve
- D) I bazuar kryesisht në dogma

Pyetja 26

Nga pohime të mëposhtme gjej atë që është i gabuar. Teoritë e rregullave abstrakte të arsytimit:

- A) Quhen ndryshe teori sintaksore.
- B) Marrin parasysh përmbajtjen e kushteve.
- C) Kanë rregulla të përgjithshme.
- D) Aplikohen në arsytimin propozional.

Pyetja 27

Sipas arsytimit sistematik:

- A) Premisat e thëna janë të vërteta dhe korrekte.
- B) E tëra është me e mirë sesa vetëm pjesë të saj.
- C) Konkluzionet dalin duke u nisur nga disa premisa bazë.
- D) Të kuptuarit e pjesës çon në kuptimin e së tërës.

Pyetja 28

Nga pohimet e mëposhtme gjej atë që është i gabuar. Vendimet taktike:

- A) Janë zakonisht rutinë.
- B) Përmbajnë pak alternativa.
- C) Përdorin pak burime.
- D) Merren për objektivat themelorë.

Pyetja 29

Nga pohimet e mëposhtme që lidhen me marrjen e vendimeve në grup, gjej atë që është i gabuar.

- A) Informacioni i grupit është më i madh se informacioni i individit.
- B) Shkalla e pranueshmërisë së një vendimi është e vogël.
- C) Procesi i vendimmarrjes në grup është relativisht i gjatë.
- D) Grupet janë të gatshme për të marrë përsipër riskun.

Pyetja 30

Nga pohimet e mëposhtme që lidhen me arsyetimin pragmatist, gjej atë që është i gabuar. Rregullat pragmatike:

- A) Janë më abstrakte se rregullat formale logjike.
- B) Janë të përgjithshme dhe të gjera.
- C) Janë të aplikueshme në shumë situata.
- D) Janë parime organizuese specifike.

KAPITULLI IV FUSHA E PERSONALITETIT

1. Teoritë psikanalitike, bihevjoriste, kognitiviste dhe humaniste mbi formimin e personalitetit

Pyetja 1

Sipas qasjes psikanalitike mbi formimin e personalitetit ID përfaqëson...

- A) Komponentin instiktiv, të pamoralshëm të personalitetit
- B) Komponentin ideal, absolutist të personalitetit
- C) Komponentin balancues, rregullator të personalitetit
- D) Komponentin social, moralist të personalitetit

Pyetja 2

Sipas Sigmund Frojd e pavetëdijsmja...

- A) Përbën pjesën më të madhe të personalitetit njerëzor
- B) Mund të bëhet lehtësisht e vetëdijsme tek çdokush
- C) Është e pranishme vetëm tek individët me çrregullime
- D) Është pjesa racionale e personalitetit njerëzor

Pyetja 3

Sipas qasjes psikanalitike mbi formimin e personalitetit, Ego ...

- A) Përbën pjesën më të madhe të personalitetit njerëzor
- B) Përfaqëson idealen për individin
- C) Është rregullator i i personalitetit
- D) Është komponenti biologjik i personalitetit

Pyetja 4

Sipas qasjes psikanalitike mbi formimin e personalitetit, Superego është...

- A) Komponenti instiktiv, i pamoralshëm i personalitetit
- B) Komponenti psikologjik, rregullator i personalitetit
- C) Komponenti social i personalitetit që mbart kodin moral
- D) Komponenti biologjik i personalitetit në kërkim të kënaqësisë

Pyetja 5

Sipas Karl Gustave Jung, një individ i cili fokuson vëmendjen kryesisht jashtë vetes dhe në të tashmen do të kategorizohej si:

- A) Ekstravert-Shqisor
- B) Ekstravert-Perceptues
- C) Introvert-Mendues
- D) Introvert- Përjetues

Pyetja 6

Sipas Karl Gustave Jung, një individ i cili fokuson vëmendjen kryesisht së brendshmi dhe merr vendime më tepër të logjikshme, sesa emocionale do të kategorizohej si:

- A) Ekstravert-Shqisor
- B) Ekstravert-Perceptues
- C) Introvert-Mendues
- D) Introvert- Përjetues

Pyetja 7

Sipas Karl Gustave Jung, një individ i cili implementon informacionin në skemat e veta të ngurta dhe merr vendime më tepër të logjikshme sesa emocionale do të kategorizohej si:

- A) Ekstravert-Shqisor
- B) Gjykues-Mendues
- C) Introvert-Përjetues
- D) Perceptues- Përjetues

Pyetja 8

Sipas Karl Gustave Jung, një individ i cili fokusohet në informacionin që merr përmes shqisave dhe e implementon atë në skemat e veta të ngurta do të kategorizohej si:

- A) Ekstravert-Shqisor
- B) Gjykues-Mendues
- C) Shqisor-Gjykues
- D) Perceptues- Përjetues

Pyetja 9

Sipas Karl Gustave Jung, një individ i cili fokusohet në të ardhmen, përdor imagjinatën dhe merr vendime më tepër emocionale sesa të logjikshme do të kategorizohej si:

- A) Introvert-Shqisor
- B) Intuitiv-Mendues
- C) Introvert-Përjetues
- D) Intuitiv- Përjetues

Pyetja 10

Sipas Karl Gustave Jung, një individ i cili fokusohet në të ardhmen, përdor imagjinatën dhe është fleksibël në implementimin e informacionit do të kategorizohet si:

- A) Perceptues-Shqisor
- B) Intuitiv-Mendues
- C) Introvert-Përjetues
- D) Intuitiv- Perceptues

Pyetja 11

Sipas Karl Gustave Jung, një burrë me tipare të theksuara mashkullore (racional, i ftohtë, i ashpër):

- A) Dominohet nga animus
- B) Dominohet nga anima
- C) Ka animus të pazhvilluar
- D) Ka anima të pazhvilluar

Pyetja 12

Sipas Karl Gustave Jung, një burrë që karakterizohet si i butë, emocional dhe empatik...

- A) Dominohet nga animus
- B) Dominohet nga anima
- C) Ka animus të pazhvilluar
- D) Ka anima të pazhvilluar

Pyetja 13

Sipas Karl Gustave Jung, një grua me tipare të theksuara femërore (emocionale, e butë, empatike):

- A) Dominohet nga animus
- B) Dominohet nga anima
- C) Ka animus të pazhvilluar
- D) Ka anima të pazhvilluar

Pyetja 14

Sipas Karl Gustave Jung, një grua e ashpër, logjike, që kontrollon mirë emocionet e saj...

- A) Dominohet nga animus
- B) Dominohet nga anima
- C) Ka animus të pazhvilluar
- D) Ka anima të pazhvilluar

Pyetja 15

Në eksperimentin klasik të Piterit të vogël, fëmija me fobi nga lepujt, ushqehet vazhdimisht në prani të një lepuri. Ky studim vërtetoi efektet e...

- A) Kundër-kushtëzimit
- B) Kushtëzimit veprues
- C) Modelimit
- D) Të mësuarit vëzhgues

Pyetja 16

Në eksperimentin klasik me Albertin e vogël, sa herë fëmija shihte kavian e bardhë, studjuesi provokonte një zhurmë të fortë në mjedis. Fobia e krijuar tek Alberti është një shembull i...

- A) Kundër-kushtëzimit
- B) Kushtëzimit veprues
- C) Të mësuarit vëzhgues
- D) Kushtëzimit klasik

Pyetja 17

Nëse e qara e një fëmije nuk merr më vëmendjen e prindërve, ai nuk do ta përdorë më këtë sjellje për të sinjalizuar prindërit. Ndryshimi i sjelljes së fëmijës është një shembull i:

- A) Formësimit të sjelljes
- B) Shuarjes së sjelljes
- C) Përforcimit të sjelljes
- D) Ndëshkimit të sjelljes

Pyetja 18

Një sjellje e mësuar ka probabilitet më të madh për tu shuar në momentin që ndërpritet...

- A) Programi i përforcimit të vazhdueshëm
- B) Programi i përforcimit me raport të fiksuar
- C) Programi i përforcimit me interval të fiksuar
- D) Programi i përforcimit të ndryshueshëm

Pyetja 19

Një sjellje e mësuar do të jetë më rezistente ndaj shuarjes kur është përdorur...

- A) Programi i përforcimit të vazhdueshëm
- B) Programi i përforcimit me raporti të fiksuar
- C) Programi i përforcimit me interval të fiksuar
- D) Programi i përforcimit të ndryshueshëm

Pyetja 20

Një fëmijë, babai i të cilit ka mjekër, thërret 'babi' cdo burrë me mjekër; ky është një shembull...

- A) Përgjithësimi i stimulit
- B) Diskriminimi i stimulit
- C) Përforcimi i stimulit
- D) Formësimi i stimulit

Pyetja 21

Klasifikimi i tipologjive të personalitetit bazuar mbi stilin e jetës (sipas Adler) e cilëson tipin marrës si:

- A) Dominant
- B) Të varur
- C) Bashkëpunues
- D) Energjik

Pyetja 22

Klasifikimi i tipologjive të personalitetit bazuar mbi stilin e jetës (sipas Adler) e cilëson tipin socialisht të dobishëm si:

- A) Dominant
- B) Të varur
- C) Bashkëpunues
- D) Shmangës

Pyetja 23

Klasifikimi i tipologjive të personalitetit bazuar mbi stilin e jetës (sipas Adler) e cilëson tipin sundues si:

- A) Energjik
- B) Të varur
- C) Bashkëpunues
- D) Shmangës

Pyetja 24

Klasifikimi i tipologjive të personalitetit bazuar mbi stilin e jetës (sipas Adler) e cilëson tipin shmangës si:

- A) Të varur totalisht nga të tjerët
- B) Bashkëpunues drejt zgjidhjes së problemit
- C) Dominant në marrëdhënie me të tjerët
- D) Të pa-aftë për të menaxhuar konfliktin

Pyetja 25

Sipas qasjes humaniste, individi që funksionon plotësisht:

- A) Konformon gjithmonë me kërkesat e shoqërisë
- B) I shmanget ndryshimeve në mjedis
- C) Pranon veten dhe të tjerët ashtu si janë
- D) Pretendon perfeksionizëm nga vetja dhe të tjerët

Pyetja 26

Keqpërshtatja sipas Karl Rogers lind si pasojë e:

- A) Vlerësimin pozitiv me kushte nga agjentet socializues
- B) Zhvillimit të një mendimi të lartë për veten
- C) Mbylljes të individit ndaj eksperiencave të reja
- D) Manipulimit të të tjerëve me qëllim përfitimi

Pyetja 27

Në piramidën e nevojave të Abraham Maslow-t:

- A) Nevoja për siguri duhet të përmbushet përpara nevojës për vetë-vlerësim
- B) Nevoja për vetë-vlerësim duhet të përmbushet përpara nevojës për dashuri
- C) Nevoja për dashuri duhet të përmbushet përpara nevojës për siguri
- D) Nevoja për vetë-vlerësim duhet të përmbushet përpara nevojës për siguri

Pyetja 28

Sipas Abraham Maslow, individi i vetë-aktualizuar:

- A) Konformohet gjithmonë me kërkesat e shoqërisë
- B) I shmanget ndryshimeve në mjedis
- C) Qëndron komfort vetëm me veten
- D) Pretendon maksimumin nga vetja dhe të tjerët

Pyetja 29

Duke pasur parasysh përkufizimin e George Kelly për emocionet si “konstrukte të tranzicionit”, një individ do të ketë ndjenja faji kur:

- A) Konstruktet nuk funksionojnë dhe parashikimet dështojnë
- B) Sjellja e tij nuk është në përputhje me konstruktet bazë
- C) Parashikon ndryshime të mëdha në konstruktet bazë
- D) Konstaton mospërputhje mes konstrukteve dhe realitetit

Pyetja 30

Duke pasur parasysh përkufizimin e George Kelly për emocionet si “konstrukte të tranzicionit”, një individ do të ketë ndjenja ankthi kur:

- A) Konstruktet nuk funksionojnë dhe parashikimet dështojnë
- B) Sjellja e tij nuk është në përputhje me konstruktet bazë
- C) Bën përpjekje për të ndryshuar konstruktet bazë
- D) Reagon për mospërputhjen mes konstrukteve dhe realitetit

Pyetja 31

Duke pasur parasysh përkufizimin e George Kelly për emocionet si “konstrukte të tranzicionit”, një individ do të ndjehet i kërcënuar kur:

- A) Konstruktet nuk funksionojnë dhe parashikimet dështojnë
- B) Sjellja e tij nuk është në përputhje me konstruktet bazë
- C) Parashikon ndryshime të mëdha në konstruktet bazë
- D) Reagon për mospërputhjen mes konstrukteve dhe realitetit

Pyetja 32

Duke pasur parasysh përkufizimin e George Kelly për emocionet si “konstrukte të tranzicionit”, një individ do të shfaqë agresivitet kur:

- A) Konstruktet nuk funksionojnë dhe parashikimet dështojnë
- B) Sjellja e tij nuk është në përputhje me konstruktet bazë
- C) Parashikon ndryshime të mëdha në konstruktet bazë
- D) Nuk e pranon dot mospërputhjen mes konstrukteve dhe realitetit

Pyetja 33

Nëse një individ ka mendime të llojit: “Jam i pavlerë, bota është e keqe, e ardhmja është e errët”, ai po përdor

- A) Skemën kognitive realiste
- B) Triadën kognitive negative
- C) Skemën kognitive pesimiste
- D) Diadën kognitive negative

Pyetja 34

Sipas qasjes kognitive të Beck, skemat kognitive:

- A) Aktivizohen pa nevojën e stimujve të jashtëm
- B) Aktivizohen nga stimuj të jashtëm
- C) Ekzistojnë vetëm tek disa persona
- D) Aktivizohen nga çdo gjendje emocionale

Pyetja 35

Sipas humanistëve hendeku mes unit real dhe unit ideal:

- A) Prodhon inkongruencë dhe keqpërshtatje
- B) Prodhon kongruencë dhe mirëpërshtatje
- C) Motivon individin për të punuar më fort
- D) Nuk ka pasoja për mirëpërshtatjen e individit

Pyetja 36

Sipas humanistëve nëse një individ rritet në një mjedis me qëndrim të kushtëzuar pozitiv...

- A) Do të ketë një hendek më të ngushtë mes unit real dhe ideal
- B) Do të pengohet përmbushja e potencialit të tij
- C) Do të sigurohet përmbushja e potencialit të tij
- D) Nuk do të ketë asnjë ndikim mbi zhvillimin e individit

Pyetja 37

Sipas bihevioristëve, personaliteti i individit:

- A) Është i përcaktuar biologjikisht
- B) Mund të modifikohet gjatë jetës
- C) Është kryesisht i pavetëdijshëm
- D) Është strukturuar në nivele

Pyetja 38

Karl Jung e shpjegon fobinë nga gjarpërinjtë ose nga errësira përmes...

- A) Të pavetëdijshmes personale
- B) Të pavetëdijshmes kolektive
- C) Sjelljes së mësuar gjatë jetës
- D) Ndëshkimeve gjatë rritjes

Pyetja 39

Mekanizmat mbrojtës përdoren me qëllimin për të kontrolluar ankthin...

- A) Duke transformuar realitetin në mënyrë të pavetëdijshme
- B) Duke ndërtuar një barrierë emocionale në nënvetëdije
- C) Duke transformuar eksperiencat sociale në personale
- D) Duke zhytur eksperiencat emocionale në nënvetëdije

2. Teorite psikanalitike, bihevjoriste, kognitiviste dhe humaniste mbi formimin e psikopatologjisë

Pyetja 1

Personat thumbues, grindavec dhe me tipare sadiste, sipas teorisë frojdiane, nuk ia kanë dalë që të kalojnë më sukses:

- A) Stadin oral
- B) Stadin anal
- C) Stadin fallik
- D) Stadin gjenital

Pyetja 2

Nëse fëmija bllokohet në _____, sipas teorisë frojdiane, në të ardhmen mund të shfaqë probleme të identitetit seksual.

- A) Stadin oral
- B) Stadin anal

- C) Stadin fallik
- D) Stadin gjenital

Pyetja 3

Sipas teorisë frejdiane, ankthi shërben si një sinjal për egon në mënyrë që të aktivizojë:

- A) Mekanizmat mbrojtës
- B) Instiktet
- C) Libidon
- D) Superegon

Pyetja 4

Është një mekanizëm mbrojtës ku idetë, impulset dhe kujtimet e papranueshme mbahen jashtë ndërgjegjes. Për shembull, një fëmijë i abuzuar në familje i shtyp kujtimet e dhimbshme dhe bëhet plotësisht i pavetëdijshëm për ekzistencën e tyre. Bëhet fjalë për:

- A) Projeksionin
- B) Represionin
- C) Regresionin
- D) Introjeksionin

Pyetja 5

Me anë të këtij mekanizmi mbrojtës përpiqemi të shmangim ndëshkimin për mendimet ose veprimet e padëshirueshme. Për shembull, një bashkëshort kurorëshkelës mundohet të eliminojë impulsin e brendshëm qortues duke i blerë dhurata gruas së tij. Bëhet fjalë për:

- A) Identifikimin
- B) Zhvendosjen
- C) Zhbërjen
- D) Intelektualizimin

Pyetja 6

Mpirja e një pjese të trupit, zakonisht e duarve ose këmbëve pa një shkak fizik të dukshëm, sipas qasjes psikanalitike është simptomë e:

- A) Neurozave
- B) Psikozave
- C) Anestezisë
- D) Konfluencës

Pyetja 7

Freud besonte se shkaqet kryesore të neurozave janë:

- A) Konfliktet seksuale
- B) Mendimet dhe ndjenja e pashprehura
- C) Frikërat
- D) Inatet

Pyetja 8

Parimi i shuarjes supozon se problemet emocionale mund:

- A) Të mësohen
- B) Të çmësohen

- C) Të shmangen
- D) Të përgjithësohen

Pyetja 9

Sipas qasjes bihejvioriste fobitë:

- A) Kanë bazë gjenetike
- B) Vijnë si rezultat i impulsve të represuara
- C) Formohen përmes kushtëzimit klasik
- D) Formohen përmes besimeve irracionale

Pyetja 10

Sipas qasjes bihejvioriste, psikopatologjia kryesore e mësuar përgjatë jetës, është:

- A) Depresioni
- B) Ankthi
- C) Skizofrenia
- D) Depersonalizimi

Pyetja 11

Prindërit shpesh u kushtojnë vëmendje vetëm gabimeve të fëmijëve, duke i nxitur padashje këta të fundit që të shfaqin vazhdimisht sjellje problematike. Ky fenomen mbështetet në parimet e:

- A) Kushtëzimit klasik
- B) Kushtëzimit operant
- C) Modelimit
- D) Përgjithësimit

Pyetja 12

Frikërat neurotike sipas bihejvioristëve:

- A) Aktivizohen automatikisht
- B) Aktivizohen nga rreziqe reale
- C) Aktivizohen nga rreziqe joreale
- D) Kanë bazë konjitive

Pyetja 13

Eksperimenti i realizuar me Albertin e vogël, i cili ekspozohej në mënyrë të përsëritur ndaj një zhurmë të forte, ndërsa luante me një lepur, tregoi se:

- A) Emocionet kurrsesi nuk mund të kushtëzohen.
- B) Disa emocione si për shembull frika, mund të kushtëzohen.
- C) As sjellja dhe as emocionet nuk mund të kushtëzohen.
- D) Fëmijët nuk kushtëzohen në të njëjtën mënyrë si të rriturit.

Pyetja 14

Besimet e forta joreale dhe që shoqërohen me emocione negative, njihen si:

- A) Besime racionale
- B) Besime irracionale
- C) Iluzione
- D) Haluçinacione

Pyetja 15

“Kur jemi të lumtur, priremi ta shohim botën me ngjyra, ndërsa kur jemi të trishtuar e shohim atë bardh e zi” - ilustron shtrembërimin kognitiv të:

- A) Abstraksioneve selektive
- B) Konkluzioneve arbitrare
- C) Përgjithësimeve
- D) Ekzagjerimeve

Pyetja 16

Greta duket sikur përqendrohet gjithmonë mbi aspektet negative të ngjarjeve, madje edhe atëherë kur nuk ka asnjë arsye për ta bërë. Për shembull, kur Greta mori 10 në provimin e statistikës, ajo menjëherë e justifikoi me faktin që testi ishte shumë i lehtë. Ky shembull ilustron shpërbërjen konjitive të:

- A) Abstraksionit selektiv
- B) Konkluzioneve arbitrare
- C) Gjeneralizimeve
- D) Ekzagjerimit

Pyetja 17

“Do të ishte e tmerrshme sikur të mos e kaloja këtë provim!” - është një besim irracional:

- A) Që mohon preferencat
- B) Alarmues
- C) I mospërballimit të vështirësive
- D) I qëndrimit negativ ndaj vetës

Pyetja 18

Sipas Albert Ellis, një pjesë e mirë e problemeve psikologjike janë pasoje e:

- A) Konflikteve të pavetëdijshme
- B) Modelimit të gabuar
- C) Ankthit ekzistencial
- D) Besimeve irracionale

Pyetja 19

Në modelin ABC të terapisë racional-emocionale, sekuencën e reagimeve mendore që shoqërohet me besime irracionale nuk e nxisin:

- A) Ngjarjet reale ose imagjinare
- B) Konkluzionet personale
- C) Faktet e jetës
- D) Faktorët gjenetikë

Pyetja 20

Triada kognitive e depresionit e Beck përfshin:

- A) Pikëpamje negative për veten, botën dhe të shkuarën
- B) Pikëpamje negative për veten, botën dhe të ardhmen
- C) Pikëpamje negative për veten, të shkuarën dhe të ardhmen
- D) Pikëpamje negative për të tjerët, të shkuarën dhe të ardhmen

Pyetja 21

Të menduarit dikotomik përfshin:

- A) Tendencen për të parë gjithmonë anën pozitive të gjërave.
- B) Tendencen për të kërkuar karakteristika pozitive tek të tjerët.
- C) Tendencen për të qenë jashtëzakonisht pesimist në çdo situatë.
- D) Tendencen për të kategorizuar të gjitha përvojat si tërësisht pozitive ose negative.

Pyetja 22

Ndonjëherë njerëzit detyrohen që të sakrifikojnë nevojat e tyre për vetaktualizim, në mënyrë që të marrin vlerësim pozitiv nga persona të tjerë të rëndësishëm (si për shembull nga prindërit).

Ky është një koncept i teorisë:

- A) Psikanalitike
- B) Bihejvioriste
- C) Humaniste
- D) Konjitiviste

Pyetja 23

Sipas qasjes humaniste, _____ është shkaku kryesor i lindjes së psikopatologjive.

- A) Blllokimi i prirjes për vetaktualizim.
- B) Informacioni i represuar në pavetëdije
- C) Fiksimi në një stad të zhvillimit.
- D) Vlerësimi i pakushtëzuar nga të tjerët.

Pyetja 24

“Unë të dua vetëm nëse i merr të gjitha notat 10!” – është një shembull i:

- A) Vlerësimi të pakushtëzuar pozitiv
- B) Dashurisë së kushtëzuar
- C) Inkongruencës
- D) Kongruencës

Pyetja 25

“Dukem kaq bukur në rrjete sociale dhe do të doja të isha ashtu edhe në jetën reale!” – është një shembull i:

- A) Përputhjes me veten
- B) Vlerësimi të pakushtëzuar pozitiv
- C) Dashurisë së pakushtëzuar pozitive
- D) Mospërputhjes mes vetes reale dhe vetes ideale

Pyetja 26

Eni sapo ka komplimentuar shoqen e dhomës për gatimin e saj, ndërsa kjo e fundit e konsideron veten një kuzhinierë shumë të dobët. Ky shembull përbën një rast të:

- A) Kongruencës
- B) Inkongruencës
- C) Unit real
- D) Unit ideal

3. Teoritë dhe taksonomia mbi tiparet e dallueshme dhe të qëndrueshme të personalitetit

Pyetja 1

Teoritë e tipareve të personalitetit kanë të përbashkët supozimin se...

- A) Individët mund të kategorizohen sipas tipareve të caktuara, të cilat janë të qëndrueshme në kohë dhe në situata
- B) Individët mund të kategorizohen sipas tipareve të caktuara të cilat e kanë bazën biologjike, pra janë të lindura
- C) Individët mund të kategorizohen sipas tipareve të caktuara të cilat janë mësuar gjatë zhvillimit dhe edukimit
- D) Individët mund të kategorizohen sipas tipareve të caktuara bazë, të cilat variojnë nga 3 në 5

Pyetja 2

Sipas modelit PEN të personalitetit nëse një individ ka sistem nervor simpatik tepër të ndjeshëm, ai do të kategorizohet...

- A) Me nivel të lartë psikoticizmi
- B) Me nivel të lartë ekstraversioni
- C) Me nivel të lartë neuroticizmi
- D) Me nivel të lartë ndërgjegjshmërie

Pyetja 3

Nëse një individ është ekstravert-neurotik ai është...

- A) I qetë, i rezervuar, i ndjeshëm, i paqëndrueshëm
- B) Optimist, aktiv, lider, i gëzueshëm
- C) I qetë, i rezervuar, jo-social, analizues
- D) Optimist,aktiv, i ndjeshëm, i paqëndrueshëm,

Pyetja 4

Nëse një individ është pesimist, ankthioz, i rezervuar dhe jo-fleksibël, ai mund të kategorizohet si:

- A) Estravert-Neurotik
- B) Introvert-Psikotik
- C) Introvert-Neurotik
- D) Ekstravert-Psikotik

Pyetja 5

Nëse një individ është pasiv, analitik, i qetë, i qëndrueshëm, ai mund të kategorizohet si...

- A) Introvert me stabilitet emocional
- B) Ekstravert me stabilitet emocional
- C) Introvert pa stabilitet emocional
- D) Ekstravert pa stabilitet emocional

Pyetja 6

Sipas modelit PEN të Eynseck, psikoticizm:

- A) Është një dimension i personalitetit që gjendet vetëm individët me çrregullime psikiatrike

- B) Është një dimension i personalitetit që gjendet vetëm individët me çrregullime psikotike
- C) Është një nga dimensionet e personalitetit që gjendet tek të gjithë individët
- D) Është një nga dimensionet e personalitetit që gjendet vetëm individët me çrregullime humori

Pyetja 7

Sipas modelit PEN, nëse një individ ka stabilitet emocional të lartë, ai...

- A) Ka shumë gjasa për të zhvilluar çrregullime neurotike
- B) Ka pak gjasa për të zhvilluar çrregullime neurotike
- C) Shfaq hiperaktivitet të sistemit nervor simpatik
- D) Ka tendencën të reagojë ekstremisht ndaj situatave

Pyetja 8

Sipas modelit PEN individët ekstravertë në krahasim me introvertët janë më tepër të prirur të zhvillojnë:

- A) Çrregullime të humorit
- B) Çrregullime të Fobive
- C) Çrregullim obsesiv-kompulsiv
- D) Çrregullim disociativ

Pyetja 9

Sipas modelit PEN të Eynseck, cila kategori individësh do të kishte nivelin më të lartë të kreativitetit:

- A) Individët me nivel më të lartë ekstraversioni
- B) Individët me nivel më të lartë neuroticizmi
- C) Individët me nivel më të lartë psikoticizmi
- D) Individët me nivel më të lartë introversioni

Pyetja 10

Modeli BIG FIVE i Personalitetit tregon se:

- A) Çdo individ mund të kategorizohet vetëm në njërin nga 5 kategoritë
- B) 5 kategoritë e personalitetit janë të përcaktuara gjenetikisht
- C) Pesë tiparet themelore të personalitetit shtrihen në intervale/spektrume vlerash
- D) Përcaktimi i individit në këto kategori është konsistent përgjatë rritjes së tij

Pyetja 11

Sipas modelit BIG FIVE të Personalitetit, nëse një individ është i organizuar, planifikues, dhe i saktë, ai ka...

- A) Stabilitet emocional të lartë
- B) Ndërgjegjshmëri të lartë
- C) Empati të shprehur
- D) Ekstraversion të lartë

Pyetja 12

Sipas modelit BIG FIVE të Personalitetit, nëse një individ është kurioz dhe krijues ai mund të karakterizohet si

- A) I mbyllur ndaj eksperiencave

- B) I paqëndrueshëm emocionalisht
- C) I qëndrueshëm emocionalisht
- D) I hapur ndaj përvojave

Pyetja 13

Sipas modelit BIG FIVE të Personalitetit, një individ i cili është i ngrohtë dhe empatik mund të cilësohet me

- A) Neuroticizëm të lartë
- B) Ndërgjegjshmëri të lartë
- C) Pajtueshmëri të lartë
- D) Ekstraversion të lartë

Pyetja 14

Megjithëse 5 tiparet madhore të personalitetit janë relativisht të qëndrueshme gjatë jetës, studimet kanë treguar se me kalimin nga rinia e hershme në moshën e mesme...

- A) Ulet introversioni
- B) Rritet neuroticizmi
- C) Rritet ndërgjegjshmëria
- D) Ulet pajtueshmëria

Pyetja 15

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit të Raymond Catell...

- A) Individët mund të kategorizohen në 16 tipologji të ndryshme përjashtuese të njëra tjetrës
- B) Të 16 faktorët e personalitetit ekzistojnë tek cdo individ por shprehen në nivele të ndryshme
- C) 16 faktorët e personalitetit ndryshojnë në mënyrë sinjifikative me rritjen e moshës
- D) 16 faktorët janë dikotomikë dhe e kategorizojnë cdo individ një njërin nga dy grupet

Pyetja 16

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është i rrëmujshëm, i paorganizuar, spontan dhe entuziast ai po shfaq...

- A) Perfeksionizëm të ulët; Gjallëri të lartë
- B) Vetë-mjaftueshmëri të ulët; Vigjilencë të lartë
- C) Ndjeshmëri të lartë; Qëndrueshmëri të ulët
- D) Perfeksionizëm të ulët; Ndjeshmëri të lartë

Pyetja 17

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është i pavarur, skeptik dhe dyshues ai po shfaq...

- A) Perfeksionizëm të ulët; Gjallëri të lartë
- B) Vetë-mjaftueshmëri të lartë; Vigjilencë të lartë
- C) Ndjeshmëri të lartë; Qëndrueshmëri të ulët
- D) Perfeksionizëm të ulët; Ndjeshmëri të lartë

Pyetja 18

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është sentimental, emocional, mërzhitet lehtësisht, ai po shfaq...

- A) Perfeksionizëm të ulët; Gjallëri të lartë

- B) Vetë-mjaftueshmëri të lartë; Vigjilencë të lartë
- C) Ndjeshmëri të lartë; Qëndrueshmëri të ulët
- D) Perfeksionizëm të ulët; Ndjeshmëri të lartë

Pyetja 19

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është i organizuar, i saktë, dhe mëson shpejt, ai po shfaq...

- A) Perfeksionizëm të lartë; Gjallëri të lartë
- B) Vetë-mjaftueshmëri të lartë; Vigjilencë të lartë
- C) Ndjeshmëri të lartë; Qëndrueshmëri të ulët
- D) Perfeksionizëm të lartë; Arsyetim të lartë

Pyetja 20

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është agresiv, kompetitiv, i paduruar, i frustruar ai po shfaq...

- A) Perfeksionizëm të lartë; Gjallëri të lartë
- B) Vetë-mjaftueshmëri të lartë; Vigjilencë të lartë
- C) Ndjeshmëri të lartë; Qëndrueshmëri të ulët
- D) Dominancë të lartë; Tension të lartë

Pyetja 21

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është këmbëngulës, i vendosur, i disiplinuar dhe i organizuar, ai po shfaq...

- A) Dominancë të lartë; Perfeksionizëm të lartë
- B) Dominancë të ulët;Ndjeshmëri të lartë
- C) Vetë-mjaftueshmëri të ulët; Vigjilencë të ulët
- D) Ndjeshmëri të ulët; Qëndrueshmëri të lartë

Pyetja 22

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është bashkëpunues, i bindur, sentimental, dhe i preکشëm, ai po shfaq...

- A) Dominancë të lartë; Perfeksionizëm të lartë
- B) Dominancë të ulët;Ndjeshmëri të lartë
- C) Vetë-mjaftueshmëri të ulët; Vigjilencë të ulët
- D) Ndjeshmëri të ulët; Qëndrueshmëri të lartë

Pyetja 23

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është i relaksuar, i duruar, jodyshues dhe i hapur ndaj të tjerëve ai po shfaq...

- A) Dominancë të lartë; Perfeksionizëm të lartë
- B) Dominancë të ulët;Ndjeshmëri të lartë
- C) Tension të ulët; Vigjilencë të ulët
- D) Ndjeshmëri të ulët; Qëndrueshmëri të lartë

Pyetja 24

Sipas teorisë së 16 Faktorëve të Personalitetit, nëse një individ është objektiv, racional, i pjekur dhe i qëndrueshëm emocionalisht ai po shfaq...

- A) Dominancë të lartë; Perfeksionizëm të lartë
- B) Dominancë të ulët;Ndjeshmëri të lartë

- C) Tension të ulët; Vigjilencë të ulët
- D) Ndjeshmëri të ulët; Qëndrueshmëri të lartë

Pyetja 25

Modelet PEN dhe BIG FIVE të personalitetit kanë pikëtakim të përbashkët...

- A) 2 Dimensionet Neuroticizëm dhe Përgjegjshmëri
- B) 2 Dimensionet Ekstraversion dhe Neuroticizëm
- C) 2 Dimensionet Ekstraversion dhe Psikoticizëm
- D) 2 Dimensionet Neuroticizëm dhe Psikoticizëm

Pyetja 26

Sipas kategorizimit të tipareve të personalitetit nga Karl Gustave Jung, një individ ekstravert-shqisor...

- A) Fokuson vëmendjen kryesisht në të tashmen dhe jashtë vetes
- B) Fokuson vëmendjen kryesisht në të ardhmen dhe brenda vetes
- C) Fokuson vëmendjen kryesisht në të tashmen dhe brenda vetes
- D) Fokuson vëmendjen kryesisht në të ardhmen dhe jashtë vetes

Pyetja 27

Sipas kategorizimit të tipareve të personalitetit nga Karl Gustave Jung, një individ introvert-mendues...

- A) Fokuson vëmendjen kryesisht së brendshmi dhe merr vendime më tepër emocionale sesa të logjikshme
- B) Fokuson vëmendjen kryesisht së jashtmi dhe merr vendime më tepër emocionale sesa të logjikshme
- C) Fokuson vëmendjen kryesisht së brendshmi dhe merr vendime më tepër të logjikshme sesa emocionale
- D) Fokuson vëmendjen kryesisht së jashtmi dhe merr vendime më tepër të logjikshme sesa emocionale

Pyetja 28

Sipas kategorizimit të tipareve të personalitetit nga Karl Gustave Jung, një individ gjykues-mendues...

- A) implementon informacionin në skemat e veta të ngurta dhe merr vendime më tepër emocionale sesa të logjikshme
- B) implementon informacionin në skemat e veta të ngurta dhe merr vendime më tepër të logjikshme sesa emocionale
- C) implementon informacionin në mënyrë fleksibël dhe merr vendime më tepër të logjikshme sesa emocionale
- D) implementon informacionin në mënyrë fleksibël dhe merr vendime më tepër të emocionale sesa të logjikshme

Pyetja 29

Sipas kategorizimit të tipareve të personalitetit nga Karl Gustave Jung, një individ Shqisor-Gjykues...

- A) fokusohet në të tashmen dhe e implementon informacionin në mënyrë fleksibël
- B) fokusohet në të ardhmen dhe e implementon informacionin në skemat e veta të ngurta

- C) fokusohet në të tashmen dhe e implementon informacionin në skemat e veta të ngurta
- D) fokusohet në të ardhmen dhe e implementon informacionin në mënyrë fleksibël

Pyetja 30

Sipas kategorizimit të tipareve të personalitetit nga Karl Gustave Jung, një individ Intuitiv-Përjetues

- A) fokusohet në të tashmen, përdor imagjinatën dhe merr vendime më tepër logjikshme sesa emocionale
- B) fokusohet në të tashmen, përdor imagjinatën dhe merr vendime më tepër emocionale sesa të logjikshme
- C) fokusohet në të ardhmen, përdor imagjinatën dhe merr vendime më tepër të logjikshme sesa emocionale
- D) fokusohet në të ardhmen, përdor imagjinatën dhe merr vendime më tepër emocionale sesa të logjikshme

Pyetja 31

Sipas kategorizimit të tipareve të personalitetit nga Karl Gustave Jung, një individ intuitiv-perceptues...

- A) fokusohet në të tashmen, përdor imagjinatën dhe është fleksibël në implementimin e informacionit
- B) fokusohet në të tashmen, nuk përdor imagjinatën dhe është jo-fleksibël në implementimin e informacionit
- C) fokusohet në të ardhmen, nuk përdor imagjinatën dhe është jo-fleksibël në implementimin e informacionit
- D) fokusohet në të ardhmen, përdor imagjinatën dhe është fleksibël në implementimin e informacionit

Pyetja 32

Sipas teorisë së tipareve të Gordon Allport, tiparet themelore/kardinale të personalitetit...

- A) Janë të zakonshme dhe pa influencë madhore mbi sjelljen
- B) Janë të rralla dhe dominante mbi sjelljen
- C) Janë të zakonshme dhe dominante mbi sjelljen
- D) Janë të rralla dhe pa influencë mbi sjelljen

Pyetja 33

Sipas teorisë së tipareve të Gordon Allport, tiparet qendrore të personalitetit...

- A) Janë të zakonshme dhe pa influencë mbi sjelljen
- B) Janë të rralla dhe dominante mbi sjelljen
- C) Janë të zakonshme dhe me influencë mbi sjelljen
- D) Janë të rralla dhe pa influencë mbi sjelljen

Pyetja 34

Sipas teorisë së tipareve të Gordon Allport, tiparet dytësore të personalitetit...

- A) Janë të qëndrueshme dhe kanë bazë gjenetike
- B) Ndryshojnë në varësi të kontekstit dhe nuk kanë bazë gjenetike
- C) Janë të qëndrueshme por nuk kanë bazë gjenetike
- D) Ndryshojnë në varësi të kontekstit por kanë bazë gjenetike

Pyetja 35

Sipas Gordon Allport, një individ i cili është analitik, i hapur ndaj eksperiencave, ka qëndrueshmëri emocionale, dhe perceptime realiste

- A) Është i vetë-aktualizuar
- B) Është i plotësuar
- C) Është i pjekur psikologjikisht
- D) Është i shëndetshëm

Pyetja 36

Sipas modelit Big Five, nëse një individ është indiferent ndaj të tjerëve, ka luhatje emocionale të shpeshta, dhe kalon shumicën e kohës vetëm, ai kategorizohet me...

- A) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë, ekstraversion të ulët
- B) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë, ekstraversion të lartë
- C) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të ulët, ekstraversion të ulët
- D) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë, ekstraversion të ulët

Pyetja 37

Sipas modelit Big Five, nëse një individ është altruist, e menaxhon mirë stresin, dhe i pëlqen të jetë qendra e vëmendjes, ai kategorizohet me...

- A) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë, ekstraversion të ulët
- B) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë, ekstraversion të lartë
- C) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të ulët, ekstraversion të ulët
- D) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të ulët, ekstraversion të lartë

Pyetja 38

Sipas modelit Big Five, nëse një individ nuk respekton afatet, manipulon të tjerët dhe stresohet lehtësisht, ai kategorizohet me...

- A) Ndërgjegjshmëri të ulët, pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të ulët
- B) Ndërgjegjshmëri të lartë, pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë
- C) Ndërgjegjshmëri të ulët, pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë
- D) Ndërgjegjshmëri të lartë, pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë

Pyetja 39

Temperamenti i një individi...

- A) I referohet tërësisë së sjelljeve të mësuara nga procesi i socializimit
- B) I referohet një tërësie karakteristikash të individit që kanë bazë gjenetike
- C) Është një sinonim i përdorur për konceptin e personalitetit
- D) Është terminologjia e përdorur për të nënkuptuar 'personalitet' në disa teori

Pyetja 40

Klasifikimi i individëve sipas kategorive: kolerik, flegmatik, melankolik dhe sanguin...

- A) Është klasifikimi më i hershëm i individëve sipas tipologjive të temperamentit
- B) Bazohet në diferenca biologjike të cilat janë vërtetuar shkencërisht
- C) Është klasifikimi më i saktë i tipologjive të personalitetit
- D) Është klasifikimi i tipologjive të temperamentit tek fëmijët e porsalindur

Pyetja 41

Sipas modelit Big Five, nëse një individ është planifikues, empatik dhe mërzitët shpejt, ai kategorizohet me...

- A) Ndërgjegjshmëri të ulët, pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të ulët
- B) Ndërgjegjshmëri të lartë, pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë
- C) Ndërgjegjshmëri të ulët, pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë
- D) Ndërgjegjshmëri të lartë, pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë

Pyetja 42

Një individ me motivim të lartë për të mësuar, do të cilësohej nga ky tipar personaliteti...

- A) Ndërgjegjshmëri të lartë
- B) Neuroticizëm të lartë
- C) Pajtueshmëri të lartë
- D) Pajtueshmëri të ulët

Pyetja 43

Një prind me stilin e prindërimit autoritativ do të cilësohej nga këto tipare personaliteti:

- A) Pajtueshmëri e ulët, Ndërgjegjshmëri e lartë, Neuroticizëm i ulët
- B) Pajtueshmëri e lartë, Ndërgjegjshmëri e lartë, Neuroticizëm i lartë
- C) Pajtueshmëri e lartë, Ndërgjegjshmëri e lartë, Neuroticizëm i ulët
- D) Pajtueshmëri e lartë, Ndërgjegjshmëri e ulët, Neuroticizëm i ulët

Pyetja 44

Një prind me stilin e prindërimit neglizhent do të cilësohej nga këto tipare personaliteti:

- A) Pajtueshmëri e ulët, Ndërgjegjshmëri e lartë
- B) Pajtueshmëri e lartë, Ndërgjegjshmëri e lartë
- C) Pajtueshmëri e lartë, Ndërgjegjshmëri e ulët
- D) Pajtueshmëri e ulët, Ndërgjegjshmëri e ulët

Pyetja 45

Në ndërtimin dhe mbajtjen e një raporti miqësor, do të jetë më i suksesshëm individi me këto tipare personaliteti:

- A) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë
- B) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të ulët
- C) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të ulët
- D) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë

Pyetja 46

Në ndërtimin dhe mbajtjen e një lidhje romantike, do të jetë më i suksesshëm individi me këto tipare personaliteti:

- A) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të lartë
- B) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të ulët
- C) Pajtueshmëri të lartë, neuroticizëm të ulët
- D) Pajtueshmëri të ulët, neuroticizëm të lartë

Pyetja 47

Ka më tepër probabilitet të raportojnë kënaqësi më të lartë nga puna individët me këto tipare personaliteti:

- A) Ekstraversion të lartë, neuroticizëm të ulët
- B) Ekstraversion të lartë, neuroticizëm të lartë
- C) Introversion të lartë, neuroticizëm të lartë
- D) Introversion të lartë, stabilitet emocional të ulët

Pyetja 48

Sipas modelit PEN të Eynseck, nëse një individ është jokonformist, agresiv, dhe armiqësor ai ka...

- A) Nivele të larta introversioni
- B) Nivele të larta psikoticizmi
- C) Nivele të lartë neuroticizmi
- D) Nivele të larta stabiliteti emocional

Pyetja 49

Një nivel i lartë psikoticizmi në modelin PEN të Eynseck do të korrespondonte me këto karakteristika në modelin Big Five:

- A) Nivel të ulët ndërgjegjshmërie; nivel të ulët pajtueshmërie
- B) Nivel të ulët ekstraversioni, nivel të lartë neuroticizmi
- C) Nivel të lartë ndërgjegjshmërie, nivel të ulët ekstraversioni
- D) Nivel të ulët pajtueshmërie, nivel të lartë neuroticizmi

Pyetja 50

Një nivel i ulët psikoticizmi në modelin PEN të Eynseck do të korrespondonte me këto karakteristika në modelin Big Five:

- A) Nivel të lartë ndërgjegjshmërie; nivel të lartë pajtueshmërie
- B) Nivel të ulët ekstraversioni, nivel të lartë neuroticizmi
- C) Nivel të lartë ndërgjegjshmërie, nivel të ulët ekstraversioni
- D) Nivel të ulët pajtueshmërie, nivel të lartë neuroticizmi

Pyetja 51

Sipas Modelit Big Five të Personalitetit ëse një individ ka vështirësi në të kuptuarit e ideve abstrakte dhe nuk ka imagjinatë të mirë, ai...

- A) Ka nivele të ulëta ndërgjegjshmërie
- B) Ka nivele të larta të pajtueshmërisë
- C) Ka nivele të ulëta të hapjes ndaj eksperiencave
- D) Ka nivele të larta të ekstraversionit

Pyetja 52

Raportojnë kënaqësi më të ulët nga jeta, individët me këto tipare:

- A) Neuroticizëm të lartë, pajtueshmëri të ulët
- B) Ekstraversion të ulët, pajtueshmëri të ulët
- C) Ndërgjegjshmëri të ulët, pajtueshmëri të lartë
- D) Ekstraversion të lartë, pajtueshmëri të lartë

Pyetja 53

Raportojnë kënaqësi më të lartë nga jeta, individët me këto tipare:

- A) Neuroticizëm të lartë, pajtueshmëri të ulët
- B) Ekstraversion të ulët, pajtueshmëri të ulët
- C) Ndërgjegjshmëri të ulët, pajtueshmëri të lartë
- D) Ekstraversion të lartë, pajtueshmëri të lartë

4. Vlerësimi dhe matjet e personalitetit

Pyetja 1

Testi Rorschach i personalitetit:

- A) Konsiston në 30 vizatime që i tregohen klientit dhe i kërkohet interpretim
- B) Mat nivelin e tiparit të neuroticizmit tek klienti
- C) Mat qëndrimet dhe motivacionin e pavetëdijshëm të klientit
- D) Është inventar i personalitetit që bën matje objektive të tij

Pyetja 2

Inventari Myers-Briggs vlerëson individin...

- A) Në nivelin e ekstraversionit
- B) Në nivelin e neuroticizmit
- C) Në nivelin e psikoticizmit
- D) Në përcaktimin e një diagnoze klinike

Pyetja 3

Testi TAT i personalitetit...

- A) Konsiston në disa vizatime që i tregohen klientit dhe i kërkohet interpretim
- B) Mat nivelin e tiparit të neuroticizmit tek klienti
- C) Njihet ndryshe si testi i njollave të bojës
- D) Është inventar i personalitetit që bën matje objektive të tij

Pyetja 4

Pyetësori i Personalitetit i Hans Eynseck (EPQ-R) vlerëson...

- A) Nivelin e psikoticizmit tek individi
- B) Nivelin e ndërjegjshmërisë tek individi
- C) Nivelin e hapjes ndaj experiencës tek individi
- D) Prarinë e çrregullimeve të personalitetit

Pyetja 5

Inventari i personalitetit MMPI ...

- A) Mundëson ndërtimin e profilit klinik të individit
- B) Mund të përdoret vetëm në popullata jo-klinike
- C) Është i strukturuar në pesë dimensione të ndryshme
- D) Nuk përdoret për vlerësimin e çrregullimeve të personalitetit

Pyetja 6

Nëse një individ është manipulues dhe egocentrik, në shkallën EPQ-R të Eynseck do të kategorizohet...

- A) Me nivel të lartë neuroticizmi
- B) Me nivel të lartë ekstroversioni
- C) Me nivel të lartë psikoticizmi
- D) Me nivel të lartë introversioni

Pyetja 7

Vlerësimi i personalitetit me qëllim ndërtimin e profilit klinik të klientit mund të realizohet në mënyrën më efikase duke përdorur:

- A) Inventarin MMPI
- B) Testi Rorschach
- C) Inventari Myers-Briggs
- D) Inventari i Personalitetit i Eynseck

Pyetja 8

Test i Personalitetit BIG FIVE është ndërtuar mbi parimin se...

- A) Pesë tiparet themelore të personalitetit shtrihen në intervale/spektrume vlerash
- B) Cdo individ mund të kategorizohet vetëm në njërin nga 5 kategoritë
- C) 5 kategoritë e personalitetit janë të përcaktuara gjenetikisht
- D) Përcaktimi i individit në këto kategori është konsistent përgjatë rritjes së tij

Pyetja 9

Vlerësimi i personalitetit për arsye punësimi në një organizatë mund të realizohet në mënyrë më efikase duke përdorur...

- A) Inventarin MMPI
- B) Testet projektive të personalitetit
- C) Inventarin e personalitetit 16PF
- D) Inventarin e personalitetit të Eynseck

Pyetja 10

Testet projektive të personalitetit...

- A) Kanë besueshmëri më të lartë sesa inventarët e personalitetit (Eynseck, Myers-Briggs, MMPI)
- B) Kanë vlefshmëri më të lartë sesa inventarët e personalitetit (Eynseck, Myers-Briggs, MMPI)
- C) Bazohen mbi konceptin psikanalitik të të pavetëdijshmes
- D) Japin një vlersim objektiv të personalitetit të individit

Pyetja 11

Cili neo-Frojdjan sfidoi idetë e Frojdit për zilinë ndaj penisit:

- A) Adler
- B) Fromm
- C) Jung
- D) Horney

Pyetja 12

Sipas Frojdit, tre komponentët që formojnë mendjen janë:

- A) ego, id, superego
- B) Pavetëdija, morali, imoraliteti
- C) oral, anal, fallik
- D) I parë, i dytë, i tretë

Pyetja 13

Psikologët humanistë përfaquan idenë e:

- A) Represionit
- B) Vullnet i lirë
- C) Shtysat e pavetëdijshme
- D) Id

Pyetja 14

Allport besonte se tiparet mund të organizohen në tre nivele:

- A) parësore, dytësore, terciare
- B) njohëse, emocionale, fiziologjike
- C) id, ego, superego
- D) kardinal, qendror, dytësor

Pyetja 15

Personaliteti mendohet të jetë _____.

- A) afatshkurtër dhe lehtësisht i ndryshueshëm
- B) një model karakteristikash afatshkurtra
- C) i paqëndrueshëm dhe afatshkurtër
- D) afatgjatë, i qëndrueshëm dhe jo lehtësisht i ndryshueshëm

Pyetja 16

Frojdi themeloi qasjen _____ për të kuptuar sjelljen njerëzore.

- A) paliative
- B) psikodinamike
- C) patronimik
- D) psikodelik

Pyetja 17

Testet projektive pretendojnë të zbulojnë informacione për:

- A) aftësinë për karrierë
- B) arritje intelektuale
- C) proceset e pavetëdijshme
- D) stilin e prindërimit

Pyetja 18

Tiparet përkufizohen si:

- A) karakteristikat fizike që na dallojnë nga njerëzit e tjerë
- B) karakteristika relativisht të qëndrueshme që ndikojnë në sjelljen tonë në shumë situata
- C) prirje të pavetëdijshme për të vepruar në mënyra të ndryshme sipas situatës
- D) prirje të përhershme të personalitetit që përcaktojnë sjelljen tonë në çdo situatë

Pyetja 19

Tërësia e tipareve dhe modeleve të qëndrueshme që i shtyjnë individët të mendojnë, ndiejnë dhe sillen vazhdimisht në mënyra specifike njihet si _____.

- A) psikodinamike
- B) temperament
- C) humor
- D) personalitet

Pyetja 20

ID'i funksionon sipas parimit _____.

- A) realitet
- B) kënaqësi
- C) plotësim dëshirash
- D) faji

Pyetja 21

Mekanizmi mbrojtës i egos në të cilin një person që përballet me ankthin kthehet në një fazë më të papjekur të sjelljes quhet _____.

- A) represion
- B) regresion
- C) formim reaksionit
- D) racionalizim

Pyetja 22

Banka universale e ideve, imazheve dhe koncepteve që janë përcjellë nëpër breza nga paraardhësit tanë i referohet _____.

- A) arketipe
- B) intuitës
- C) e pavetëdijshme kolektive
- D) llojet e personalitetit

Pyetja 23

Nëse dikush do të ndjente se nuk arrin pritshmëritë, do të përshkruhej nga Adler që ka:

- A) Vetë realizim të ulët
- B) Kompleksin Adlerian
- C) Kompleksin e inferioritetit
- D) Arritje të pamjaftueshme

Pyetja 24

Zbulimi se trashëgimia e karakteristikave të personalitetit të Pesëshes së Madhe me 40%-50% sugjeron se:

- A) Mjedisi nuk luan asnjë rol në personalitet
- B) Genet nuk luajnë asnjë rol në personalitet
- C) Mjedisi luan një rol të konsiderueshëm në personalitet

D) Pesëshja e Madhe e karakteristikave të personalitetit është i vetmi faktor që formon personalitetin

Pyetja 25

Cila nga të mëposhtmet NUK është një nga tiparet e Pesëshes së Madhe?

- A) sensi humori
- B) hapja ndaj përvojës
- C) ndërgjegjshmëria
- D) ekstraversioni

Pyetja 26

Sipas Eysenck, ekstravertët përpiqen të _____ gjendjen e tyre ndërsa introvertët përpiqen ta _____ atë.

- A) Ulin; rrisin
- B) Fshehin, tregojnë
- C) Rrisin, ulin
- D) Tregojnë, fshehin

Pyetja 27

Ndikimi i prindërve në personalitetin e fëmijëve të tyre është:

- A) inekzistente
- B) më e dobët në fëmijërinë e hershme
- C) më e fortë në fëmijërinë e hershme
- D) konsistente gjatë gjithë jetës

Pyetja 28

Sipas Frojdit, fëmijët kalojnë në 4 faza të zhvillimit psikoseksual. Cila nga të mëposhtmet tregon fazat në rendin e duhur të zhvillimit?

- A) orale, anale, falike, latente
- B) latente, orale, anale, falike
- C) fallik, anal, oral, latente
- D) orale, falike, latente, anale

Pyetja 29

Cila nga të mëposhtmet nuk është mekanizëm mbrojtës?

- A) projeksioni
- B) regresioni
- C) miratim
- D) sublimimi

Pyetja 30

Roani është i vetëdisiplinuar, i fokusuar në arritje dhe i etur për të kryer detyrën e tij. Ai do të pritët të të marrë shumë pikë në faktorin e:

- A) neurotizëm

- B) pajtueshmëria
- C) ekstraversioni
- D) ndërgjegjshmëria

Pyetja 31

Sipas Frojdit, id është për parimin _____ ashtu siç egoja është për parimin _____.

- A) agresive, seksuale
- B) seksual, agresiv
- C) kënaqësi, realitet
- D) realitet, kënaqësi

Pyetja 32

Hana është miqësore, gjithmonë e gatshme për të ndihmuar të tjerët dhe e dhembshur. Ne presim që Lana të marrë shumë pikë në:

- A) ekstraversioni
- B) pajtueshmëria
- C) neurotizëm
- D) hapja ndaj përvojës

Pyetja 33

Kompleksi i Edipit ndodh në fazën _____ të zhvillimit psikoseksual.

- A) orale
- B) anale
- C) fallike
- D) latente

Pyetja 34

Albani beson se ai mori një notë të keqe në provimin e psikologjisë sepse profesori nuk e pëlqen. Albani ka shumë të ngjarë të ketë një lokus kontrolli _____.

- A) të brendshëm
- B) të jashtëm
- C) individual
- D) shoqëror

Pyetja 35

Cila nga të mëposhtmet i referohet nocionit të paragjykimit konfirmues?

- A) Klinikistët shpërfillin informacionet që nuk mbështesin paragjykimet konfirmuese
- B) Klinikistët shpërfillin informacionin që nuk mbështet stereotipet e tyre
- C) Klinikistët interpretojnë informacionin e paqartë si mbështetje të hipotezës së tyre
- D) Të gjitha të mësipërmet

Pyetja 36

Standardizimi i lejon klinikistit të bëjë cilën nga veprimet e mëposhtme.

- A) Sheh se ku është rezultati i një klienti individual në test në lidhje me shpërndarjen normale të pikëve për atë test.
- B) Përdor rezultatin në një test të veçantë për të vlerësuar nëse një klient përmbush kriteret diagnostike për çrregullimin psikologjik.
- C) Vlerëson probabilitetin me të cilin një klient mund të përmbushë kriteret e DSM.
- D) Të gjitha të mësipërmet

Pyetja 37

Çrregullimi obsesiv – kompulsiv mendohet se nuk luan rol në cilin nga konstruktet e mëposhtme njohëse?

- A) intoleranca ndaj pasigurisë
- B) bindjet për përgjegjësinë e
- C) nënvlerësimi i aftësive personale
- D) kontrolli i mendimeve

Pyetja 38

Aleksi nuk e përdori mirë kohën dhe nuk studioi sa duhet për provimin në psikologji, dhe si rezultat i kësaj doli shumë dobët. Aleks fajëson profesorin që ka bërë kaq shumë pyetje "të zgjedhura" dhe fajëson autorin e tekstit të tij që ka shkruar një libër kaq "të varfër dhe të padobishëm". Duket sikur Aleks po angazhohet në:

- A) represioni
- B) racionalizimi
- C) fantazi
- D) projeksioni

Pyetja 39

Cila nga këto është kritika më e vlefshme për shkollën bihejviorale ndaj personalitetit?

- A) E thekson aq shumë mjedisin, sa lë shumë pak për personin e brendshëm, individual.
- B) Ai mbështetet shumë në konceptet e huazuara nga biologjia dhe fiziologjia
- C) Duke u fokusuar vetëm në një nivel të vetëdijes, ai lë jashtë shumë prej strukturës së pasur të proceseve të pavetëdijshme.
- D) Pjesa më e madhe e terminologjisë së kësaj qasjeje është në terma tërësisht të vagullt.

Pyetja 40

Në kontekstin e teorive të personalitetit, çfarë e bën Pesëshen e Madhe kaq mbresëlënëse?

- A) Pesë teoricienët kryesorë të përfshirë kanë rënë dakord se çfarë është personaliteti.
- B) Tani mund të përcaktojmë se kur është mjedisi më i rëndësishëm dhe kur është personaliteti më i rëndësishëm.
- C) Tashmë ekziston një konsensus se si mund të përkufizohet personaliteti.
- D) Në fakt ekzistojnë pesë nivele të vetëdijes, jo vetëm tre që përshkroi Frojdi.

5. Përshtatja: përballimi, tipologjitë e personalitetit

Pyetja 1

Sipas konceptit origjinal propozuar nga Albert Bandura, vetë-efikasiteti...

- A) Është besimi i individit për realizimin me sukses të një sjellje të caktuar
- B) Është besimi që individi ka në lidhje me vlerën e vetes
- C) Është energjia dhe këmbëngulja e individit për të arritur synimet e veta
- D) Është ndjesia e individit se ai është në kontroll të jetës së vet

Pyetja 2

Vetë-efikasiteti i një individi për një sjellje të caktuar do të rritet nëse:

- A) Ai sheh dikë tjetër që kryen me sukses po këtë sjellje
- B) Ai është këmbëngulës dhe e provon disa herë
- C) Ai e ka provuar në të kaluarën por ka dështuar
- D) Ai ka tiparin perfeksionist të personalitetit

Pyetja 3

Vetë-efikasiteti i një individi për një sjellje të caktuar do të ulet nëse:

- A) Ai sheh dikë tjetër që kryen me sukses po këtë sjellje
- B) Ai është këmbëngulës dhe e provon disa herë
- C) Ai e ka provuar në të kaluarën por ka dështuar
- D) Ai ka nivel të lartë vetë-kontrolli

Pyetja 4

Studimet që tregojnë dallime gjinore në vetë-efikasitet kanë arritur në përfundimin se...

- A) Burrat kanë vetë-efikasitet më të lartë se gratë
- B) Gratë kanë vetë-efikasitet më të lartë se burrat
- C) Dallimi gjinor në vetë-efikasitet varet nga sjellja specifike
- D) Dallimi gjinor në vetë-efikasitet ka bazë biologjike

Pyetja 5

Me rritjen e moshës:

- A) Rritet vetë-efikasiteti për të gjitha sjelljet
- B) Ulet vetë-efikasiteti për të gjitha sjelljet
- C) Rritet vetë-efikasiteti për disa sjellje por ulet për të tjerat
- D) Vetë-efikasiteti nuk pëson ndryshime të rëndësishme

Pyetja 6

Në përballje me ngjarjet negative në jetë, individët optimistë kanë tendencën...

- A) Të distancohen nga situata negative
- B) Të angazhohen në problemzgjdhje aktive
- C) Të konsumojnë alkool apo droga të ndryshme
- D) Të mohojnë ekzistencën e problemit

Pyetja 7

Në përballje me ngjarjet negative në jetë, individët pesimistë kanë tendencën...

- A) Ti perceptojnë ato si të përkohshme
- B) Ti shpjegojnë përmes faktorëve të jashtëm

- C) Të përgjithësojnë impaktin negativ
- D) Të largojnë përgjegjësinë nga vetja

Pyetja 8

Në përballje me ngjarjet negative në jetë, individët me lokus kontrolli të jashtëm kanë tendencën...

- A) Të ndërtojnë plan për zgjidhjen e problemit
- B) Të ballafaqohen në mënyrë aktive me situatën
- C) Të zhvendosin përgjegjësinë tek të tjerët
- D) Të mohojnë ekzistencën e problemit

Pyetja 9

Në përballje me ngjarjet negative në jetë, individët me lokus kontrolli të brendshëm kanë tendencën...

- A) Të mbajnë përgjegjësi për zgjidhjen e problemit
- B) Të largojnë përgjegjësinë nga vetja
- C) Të distancohen nga situata
- D) Të mohojnë ekzistencën e problemit

Pyetja 10

Në përballje me ngjarjet negative në jetë, individët me orientim të lartë drejt riskut kanë tendencën...

- A) Të distancohen nga situata negative
- B) Të angazhohen në problemzgjdhje aktive
- C) Të konsumojnë alkool apo droga të ndryshme
- D) Të mohojnë ekzistencën e problemit

Pyetja 11

Në përballje me ngjarjet negative në jetë, individët me stabilitet emocional ...

- A) Janë më të suksesshëm në kërkimin për zgjidhjen e problemit
- B) Janë më pak të suksesshëm në kërkimin për zgjidhjen e problemit
- C) Kanë tendencën të distancohen/arratisen nga situata
- D) Kanë tendencën të mohojnë ekzistencën e problemi

Pyetja 12

Kur individi përballlet me stresorë në mjedisin e tij, sipas sindromës së përgjithshme të përshtatjes, sipas Selye:

- A) Në fazën e alarmit individi përpiqet të përdorë teknika menaxhimi të stresit
- B) Përballja kalon nëpër 4 faza të ndryshme me karakteristika specifike secila
- C) Stresi për një kohë të gjatë ul rezistencën e organizmit dhe e çon në rraskapitje

Pyetja 13

Një studim mbi shëndetin në kampusin e një universiteti raportoi sëmundshmëri më të lartë tek studentët pas sezoneve të provimeve; këto gjetje mbështesin...

- A) Teorinë e Sindromës së Përshtatjes së Përgjithshme
- B) Teorinë e Vlerësimit Psikologjik të Stresit
- C) Modelin e Besimit tek Shëndeti
- D) Modelin PEN të Personalitetit

Pyetja 14

Lufto ose vrapo është përgjigja e organizmit ndaj një kërcënimi në mjedis...

- A) Dhe përfshin vetëm reagimin fiziologjik të organizmit
- B) Dhe përfshin reagimet fiziologjike, emocionale dhe kognitive
- C) Dhe përfshin reagimet emocionale dhe kognitive
- D) Dhe përfshin reagimet fiziologjike, emocionale, kognitive dhe sjellore

Pyetja 15

Pasi Marku humbi punën dhe qëndroi në shtëpi me ditë të tëra, më në fund vendosi të fillonte kërkimet për një punë të re. Periudha e kërkimit për punë e re përkon me fazën e ...

- A) Alarmit
- B) Rezistencës
- C) Raskapitjes
- D) Energjizimit

Pyetja 16

Sipas Teorisë së Vlerësimit Psikologjik të Stresit (Lazarus)...

- A) Dukuritë të cilat perceptohen si të pakontrollueshme janë më tepër stresante se ato që perceptohen si të kontrollueshme
- B) Vlerësimi parësor i referohet perceptimit të individit mbi aftësitë e veta përballuese të stresit
- C) Vlerësimi psikologjik i dukurive të jashtme stresante është kurdoherë objektiv
- D) Nëse individit e vlerëson një ngjarje pozivisht, ai nuk do të perceptojë stres

Pyetja 17

Sipas Teorisë së Vlerësimit Psikologjik, nëse gjatë vlerësimit parësor individit e kategorizon stimulit si 'pozitiv'...

- A) Individit nuk do të përjetojë eksperiencën subjektive të stresit
- B) Individit mund gjithsesi të përjetojë eksperiencën subjektive të stresit
- C) Eksperienca subjektive e stresit do jetë patjetër më e ulët sesa rasti kur stimuli është negativ
- D) Eksperienca subjektive e stresit do jetë patjetër më e ulët sesa rasti kur stimuli është neutral

Pyetja 18

Në përballje me stresin kronik në punë apo shtëpi, individit ka tendencën që...

- A) Të zhvillojë simptoma të sëmundjeve të ndryshme fizike
- B) Të përballojnë më mirë ngjarjet e reja stresante
- C) Të përdorin teknika më efikase menaxhimi të stresit
- D) Të kenë vetë-efikasitet më të lartë për përballimin e situatave

Pyetja 19

Në dallim nga stresi akut, stresi kronik...

- A) Ka efekte më pak negative mbi organizmin
- B) Ka efekte afatgjata mbi organizmin, të cilat nuk janë menjëherë të dukshme
- C) Ka efekte emocionale me intensitet më të lartë por kohëzgjatje më të shkurtër
- D) Ka efekte kognitive me intensitet më të lartë por kohëzgjatje më të shkurtër

Pyetja 20

Nëse një individ përdor Ballafaqimin Aktiv si strategji për menaxhimin e një situatë stresante

- A) Ai do të shprehë hapur mendimet dhe ndjenjat në lidhje me personin/situatën
- B) Ai do të jetë patjetër i suksesshëm në menaxhimin e situatës cilado qoftë
- C) Ai me siguri është një individ introvert, i cili preferon distancën sociale
- D) Ai do të ketë me siguri vetë-kontroll të lartë të sjelljes

Pyetja 21

Nëse një individ përdor rivlerësimin pozitiv si strategji për menaxhimin situatave stresante..

- A) Ai karakterizohet nga skema kognitive të ngurta
- B) Ai karakterizohet nga skema kognitive fleksibël
- C) Ai karakterizohet nga tipari neurotik i personalitetit
- D) Ai karakterizohet nga tendenca perfeksioniste

Pyetja 22

Nëse një individ shfaq tendenca perfeksionizmi, është kompetitiv dhe zemërohet lehtësisht...

- A) Ai ka predispozicion për të zhvilluar sëmundje zemre apo hipertension
- B) Ai e menaxhon stresin dhe ankthin në mënyrë efikase
- C) Ai do të shtypë emocionin dhe evitohet konfliktin
- D) Ai ka aftësi të mira problem-zgjidhëse dhe negociuese

Pyetja 23

Nëse një individ përdor vetë-përmbajtjen si strategji për menaxhimin situatave stresante...

- A) Ai ka inteligjencë emocionale të lartë
- B) Ai ka ekuilibër emocional të dobët
- C) Ai ka tendenca të sjelljes neurotike
- D) Ai ka vështirësi në kontrollin e impulsive

Pyetja 24

Nëse një individ ka tendencë të shtypë emocionin dhe evitohet konfliktin...

- A) Ai karakterizohet si tipologjia A e personalitetit
- B) Ai karakterizohet si tipologjia B e personalitetit
- C) Ai karakterizohet si tipologjia C e personalitetit
- D) Ai e menaxhon stresin në mënyrë të shëndetshme

Pyetja 25

Pas divorcit, Alma pati shumë vështirësi financiare dhe përfundimisht u rikthye të jetonte me prindërit; Cilën strategji menaxhimi të stresit ka përdorur ajo?

- A) Pranimin e përgjegjësisë
- B) Problemzgjidhjen aktive
- C) Kërkimin e mbështetjes sociale
- D) Rivlerësimin pozitiv

Pyetja 26

Kjo ishte puna e tretë që Marku humbiste vetëm në vitin e fundit. Pas një debati të gjatë me bashkëshorten ai vendosi të shkojë tek një këshillues psikologjik për të kuptuar arsyet që lidhen me këto ngjarje të përsëritura. Cilën nga strategjitë e menaxhimit përdori Marku?

- A) Rivlerësimin pozitiv
- B) Distancimin nga problemi

- C) Pranimin e përgjegjësisë
- D) Zhvendosjen e përgjegjësisë

Pyetja 27

Reagimi tipik i një individi me tiparin e theksuar të neuroticizmit, përballë një situatë stresante është...

- A) Kërkimi i një zgjidhje racionale të problemit
- B) Humbja e ekuilibrit emocional
- C) Rivlerësimi pozitiv i situatës
- D) Përballja me situatën

Pyetja 28

Reagimi tipik i një individ me tiparin e theksuar të ndërgjegjshmërisë, përballë një situatë stresante është...

- A) Pranimi i përgjegjësisë
- B) Humbja e ekuilibrit emocional
- C) Distancimi nga situata
- D) Konsumi i alkoolit/substancave narkotike

Pyetja 29

Individët me tiparin e theksuar të ekstraversionit dallojnë nga individët me tiparin e theksuar të introversionit në...

- A) Ruajtjen e ekuilibrit emocional
- B) Vetë-efikasitetin në situata sociale
- C) Ndërgjegjshmërinë
- D) Efikasitetin e problem-zgjidhjes

Pyetja 30

Studimet kanë gjetur dallime gjinore në disa strategji përballjeje me stresin, p.sh. në krahasim me burrat, gratë përdorin më tepër:

- A) Distancimin nga situata
- B) Kërkimin e mbështetjes sociale
- C) Konsumin e alkoolit ose substancave narkotike
- D) Zgjidhjen aktive të problemit

Pyetja 31

Sipas teorisë së vetë-rregullimit të Bandurës, nëse një individ vendos standarde krahasuese shumë të larta, ai ka një problematikë në nivelin e...

- A) Gjykimit
- B) Vetë-vëzhgimit
- C) Vetë-reagimit
- D) Shpërblimit

Pyetja 32

Sipas teorisë së vetë-rregullimit të Bandurës, një individ aplikon vetë-ndëshkimin në nivelin e...

- A) Gjykimit
- B) Vetë-vëzhgimit
- C) Vetë-reagimit

D) Modelimit

Pyetja 33

Sipas teorisë së vetë-rregullimit të Bandurës, raporti që individi vendos mes vetë-shpërblimeve dhe vetë-ndëshkimeve:

- A) Është përcaktues i konceptit për veten
- B) Duhet të anojë në favor të ndëshkimeve
- C) Mbetet i pandryshueshëm gjatë jetës
- D) Është i pavarur nga 2 nivelet e para të vetë-rregullimit

Pyetja 34

Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj stresorëve të cilët perceptohen si të pakontrollueshëm, rezulton në ...

- A) Optimizmin e mësuar
- B) Vetë-ndëshkimin e mësuar
- C) Pa-aftësinë e mësuar
- D) Vetë-kontrollin e mësuar

Pyetja 35

Një studim me fëmijë që jetonin në zona të zhurmshme urbane (trafik), tregoi se në krahasim me fëmijët nga zonat e qeta rurale, të parët kishin më tepër probleme me përqëndrimin dhe memorien. Ky studim vërtetoi:

- A) Efektet kognitive negative të stresit kronik
- B) Efektet emocionale negative të stresit kronik
- C) Efektet kognitive negative të stresit akut
- D) Efektet emocionale negative të stresit akut

Pyetja 36

Cili nga shembujt e mëposhtëm është një situatë stresi akut:

- A) Trafiku i përditshëm në qytet
- B) Përfshirja në një aksident rrugor
- C) Debate të vazhdueshme me bashkëshortin
- D) Kritikë të vazhdueshme nga drejtori

Pyetja 37

Cili nga shembujt e mëposhtëm është një situatë stresi kronik:

- A) Përfshirja në një aksident rrugor
- B) Ndërprerja e elektricitetit në mes të punës
- C) Debate të përditshme me bashkëshortin
- D) Një gjobë për tejkalim shpejtësie

Pyetja 38

Sipas Teorisë së Vlerësimit Psikologjik të Stresit, nëse gjatë vlerësimit parësor individi e kategorizon stimulën si 'neutral'

- A) Individi nuk do të përjetojë eksperiencën subjektive të stresit
- B) Individi mund gjithsesi të përjetojë eksperiencën subjektive të stresit
- C) Individi do të vazhdojë me procesin e vlerësimit dytësor
- D) Individi do të përzgjedhë strategjinë e menaxhimit parësor

Pyetja 39

Sipas Teorisë së Vlerësimit Psikologjik të Stresit, gjatë vlerësimit dytësor...

- A) Individu përcakton nëse stimuli është pozitiv, negativ apo neutral
- B) Individu vlerëson potencialin e vet për të përballuar stresin
- C) Individu përzgjedh teknikën e menaxhimit për përballimin e stresit
- D) Individu shpërblen ose ndëshkon veten në varësi të situatës

Pyetja 40

Përballja e individit me ngjarje të mëdha jetësore (vdekje, ndarje, martesë, lindje etj)...

- A) Ndikon mbi shëndetin fizik të individit më tepër sesa stresi kronik
- B) Ndikon mbi shëndetin fizik të individit më pak sesa stresi kronik
- C) Shkakton nivele të larta stresi, pavarësisht nga kultura e vendit përkatës
- D) Shkakton nivele të larta stresi tek të gjithë individët pa përjashtim

6. Grupet kryesore të çrregullimeve psikologjike (DSM)

Pyetja 1

Fobitë specifike përkufizohen si:

- A) periudha të tepruara të shqetësimit të shkaktuara nga një objekt ose situatë specifike
- B) një ndjeshmëri jonormale ndaj dritës
- C) një frikë e tepruar, e paarsyeshme, e vazhdueshme e shkaktuar nga një objekt ose situatë specifike
- D) një frikë e vazhdueshme nga situata sociale

Pyetja 2

Teoria psikodinamike e Frojdit i përkufizon fobitë si:

- A) ego e represuar
- B) id i represuar
- C) superego e represuar
- D) mekanizëm mbrojtës i represuar

Pyetja 3

Të paktën disa nga fobitë asociohen fort me emocionin e:

- A) të mësuarit e frikës pa asosacione
- B) reagime të mësuara ndaj frikës
- C) përgatitja biologjike
- D) të mësuarit e fobive specifike

Pyetja 4

Studime të viteve të fundit sugjerojnë se të paktën disa nga fobitë asociohen fort me emocionin e:

- A) inatit
- B) neverisë
- C) lehtësimit

D) trishtimit

Pyetja 5

Një çrregullim ankthi është:

- A) një gjendje emocionale e identifikuar nga sulmet e panikut
- B) një gjendje emocionale e klasifikuar nga kontrolli i tepruar
- C) të menduarit të çrregullt
- D) një gjendje e tepruar ose e eksituar e karakterizuar nga ndjenja e frikës, pasiguria dhe frika

Pyetja 6

Skizofrenia katatonike karakterizohet nga simptomat e mëposhtme:

- A) Njerëzit që kanë përjetuar simptomat e skizofrenisë, por nuk po përjetojnë më simptoma
- B) Iluzionet e persekutimit, besimi se të gjithë duan t'i sulmojnë, si dhe halucinacione dëgjimore
- C) Jo në përputhje me ndonjë lloj të veçantë të skizofrenisë
- D) Ngrirje trupore - pa lëvizje dhe mpirje ku nuk ka emocione ose efekt të sheshtë.

Pyetja 7

Një lloj çrregullimi i personalitetit i karakterizuar nga një shkëputje e marrëdhënieve shoqërore njihet si:

- A) Paranojak
- B) Skizoid
- C) Kufitar
- D) I varur

Pyetja 8

Lloji i çrregullimit të personalitetit që karakterizohet nga detyrimi për të qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes:

- A) kufitare
- B) antisociale
- C) histrionike
- D) paranojake

Pyetja 9

Në çrregullimin bipolar, episodet e depresionit madhor alternohen me:

- A) hiperventilim
- B) hipomani
- C) hipotermi
- D) hipoksi

Pyetja 10

Keqinterpretimi i perceptimeve apo eksperiencave të ndryshme në skizofreni njihen si:

- A) haluçinacione
- B) keqperceptime
- C) iluzione

D) refuzime

Pyetja 11

Në skizofreni defiqiti i monitorimit të realitetit i referohet:

- A) probleme që kanë të bëjnë me dallimin ndërmjet mendimeve dhe veprimeve
- B) probleme me humbjen e kujtesës
- C) probleme me orientimin në hapësirë
- D) probleme që kanë të bëjnë me dallimin ndërmjet çfarë ka ndodhur dhe çfarë nuk ka ndodhur

Pyetja 12

Në skizofreni termi unhedoniste ka të bëjë me:

- A) paaftësi për të shijuar ushqimin
- B) paaftësi për të shprehur emocione
- C) paaftësi për të reaguar ndaj ngjarjeve të këndshme
- D) paaftësi për të reaguar ndaj sinjaleve shoqërore

Pyetja 13

Cila është një karakteristikë e dukshme tek personat me çrregullime të të ngrënit?

- A) vetëvlerësim i ulët
- B) vetëvlerësim i lartë
- C) nivele të larta përgjegjësie
- D) narcisizëm

Pyetja 14

Cila nga karakteristikat e mëposhtme lidhet me çrregullimet e të ngrënit?

- A) perfeksionizmi
- B) narcisizmi
- C) ekstraversioni
- D) introversioni

Pyetja 15

Anoreksia dhe bulimia janë komorbide me depresionin madhor. Cilat nga medikamentet e mëposhtme jepen më shumë për të trajtuar çrregullimet e të ngrënit?

- A) antipsikotikët
- B) antibiotikët
- C) antihistaminikët
- D) antidepresantët

Pyetja 16

Në çrregullimet e seksualitetit dhe funksionimit seksual, termi parafili do të thotë:

- A) probleme me ciklin e reagimit normal seksual
- B) nevoja seksuale apo fantazi që përfshijnë burime të pazakonta apo probleme me kënaqësinë
- C) një individ është i pakënaqur me seksin biologjik dhe ka dëshirë të madhe të jetë anëtar i seksit të kundërt

D) probleme me fantazitë seksuale

Pyetja 17

Redi ka përjetuar kohët e fundit simptoma ankthi të lidhura me gjithçka që ai bën duke përfshirë aktivitete që nuk duhet të shkaktojnë ankth. Çfarë është duke përjetuar Jimmy?

- A) skizofreni
- B) çrregullim ankthi i përgjithësuar
- C) depresioni i madh
- D) bipolare

Pyetja 18

Rritja e receptorëve të neurotransmetuesve të dopaminës në tru mund të jetë përgjegjës për fillimin e:

- A) skizofreni
- B) depresioni
- C) fobitë
- D) narcisizëm

Pyetja 19

Me cilin çrregullim psikologjik lidhet mekanizmi mbrojtës i represionit?

- A) skizofreni
- B) fobitë
- C) çrregullimi disociativ i identitetit
- D) çrregullimi obsesiv kompulsiv

Pyetja 20

Në çrregullimin e atakut të panikut ndjeshmëria (sensitiviteti) e ankthit i referohet:

- A) ankthi mund të çojë në depression
- B) frikës se pasojat e simptomave të ankthit mund të jenë të dëmshme
- C) simptomat e ankthit mund të parashikojnë vetë-dëmtim
- D) ndjesia e ankthit gjithnjë çon në ngjarje negative

Pyetja 21

Cila nga simptomat e mëposhtme shfaqet nga individë që vuajnë depresionin unipolar?

- A) sjellje e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit
- B) kontroll kompulsiv
- C) qëndrim në krevat për një kohë të gjatë
- D) sjellje me rituale

Pyetja 22

Teoria kognitive e Beck sugjeron që individët që vuajnë nga depresioni kanë:

- A) skema negative
- B) nivele të ulëta të serotoninës
- C) humbje të brendësuar

D) sjellje negative sociale

Pyetja 23

Në skizofreni simptomat psikotike si: deluzionet haluçinative, e folura e çrregullt, dhe sjelljet e çrregullta apo katatonike njihen si:

- A) simptoma negative
- B) simptoma pozitive
- C) simptoma moderuese
- D) simptoma katastrofike

Pyetja 24

Personat me skizofreni nuk mund të kuptojnë besimet, qasjet dhe synimet e të tjerëve. Atyre u mungon:

- A) empatia
- B) inteligjenca
- C) vetëvlerësimi
- D) vetëperceptimi

Pyetja 25

Pakënaqësia me trupin përcaktohet si:

- A) hendeku ndërmjet peshës së personit dhe mikut/mikeshës së tij/saj më të afërt
- B) hendeku ndërmjet peshës aktuale të personit dhe peshës ideale që mendon se duhet të ketë
- C) hendeku ndërmjet peshës aktuale të personit dhe peshës në lindje
- D) numri i gjërave që dikush do të donte të ndryshonte në trupin e tij/saj

Pyetja 26

Në trajtimin e keqfunksionimit seksual, është e rëndësishme që klienti të udhëheqë sjelljen e tij/saj dhe të reduktojë ankthin. Cila nga të mëposhtmet është një mënyrë për ta arritur këtë?

- A) meditimi
- B) trajnimi duke të udhëzuar partneri
- C) trajnimi duke u vetëudhëzuar
- D) terapi grupi

Pyetja 27

Termi “sociopat” apo “psikopat” përdoret të përshkruar cilin çrregullim të personalitetit?

- A) çrregullimi i personalitetit histrionik
- B) çrregullimi i personalitetit antisocial
- C) çrregullimi i personalitetit paranoid
- D) çrregullimi i personalitetit skizotipik

Pyetja 28

Terapia kognitiv biheviorale mund të përdoret për një individ me çrregullimin e personalitetit obsesiv kompulsiv duke sfiduar:

- A) marrëdhëniet jofunksionale

- B) skemat jofunksionale
- C) sjelljet jofunksionale
- D) modelet e gjumit jofunksionale

Pyetja 29

Kur një individ ka amnezi të disociuar ajo lidhet me disa shqetësime të kujtesës. Amnezia e përgjithësuar ndodh kur:

- A) nuk arrin të kujtojë çfarë ka ndodhur gjithë javën e shkuar
- B) nuk arrin të kujtojë asgjë nga jeta e tij/saj
- C) nuk arrin të kujtojë fëmijërinë e tij/saj
- D) nuk arrin të kujtojë ngjarjen traumatike

Pyetja 30

Shumë teoricinë psikodinamikë besojnë se simptomat disociative shkaktohen nga cila?

- A) represioni
- B) ego
- C) konflikti
- D) çështjet e gjinisë

Pyetja 31

Kur një individ risjell kujtime të fëmijërisë të një traume që nuk ka ndodhur, kjo quhet:

- A) sindroma e kujtimeve të gabuara
- B) trauma e kujtimeve të risjella gabim
- C) sindroma e kujtesës rindërtuese
- D) sindroma e kujtesës shkatërrimtare

Pyetja 32

Në depresionin madhor cila nga të mëposhtmet është një neurotransmetues i rëndësishëm?

- A) serotonina
- B) dopamina
- C) betakarotina
- D) acetilkolina

Pyetja 33

Një ndër trajtimet më të zakonshme për çrregullimin obsesiv kompulsiv, dhe ndoshta më e suksesshme, është ekspozimi dhe parandalimi i ritualit. Një trajtim i tillë është ekspozimi mendor. Për shembull, për dikë të fiksuar me larjen e duarve, ky trajtim do të përfshinte:

- A) ndalimi i mendimeve për ritualin
- B) imagjinimi që të tjerët prekin një pjatë të papastër
- C) imagjinimi që prek vetë një pjatë të papastër
- D) imagjinimi i pasojave negative për shkak se nuk lahen duart

Pyetja 34

Cila nga neurotransmetuesit e mëposhtëm lidhet specifikisht me çrregullimin bipolar?

- A) serotonina

- B) dopamina
- C) betakarotina
- D) norepinefrina

Pyetja 35

Një nga medikamentet më të përdorura për çrregullimin bipolar është:

- A) klorprozamine
- B) karbonat litiumi
- C) Klozapine
- D) Benzodiazepine

Pyetja 36

Në filmin “Një mendje e bukur” (*A beautiful mind*) Russell Crowe portretizon John Nash i cili besonte fort se gjatë gjithë kohës dikush e ndiqte dhe ai ishte në rrezik. Në skizofreni ky lloj besimi njihet si:

- A) iluzioni i madhësisë
- B) iluzioni i persekutimit
- C) iluzioni i kontrollit
- D) iluzioni i nihilizmit

Pyetja 37

Teoria biokimike e skizofrenisë që njihet edhe si hipoteza e Dopaminës i referohet:

- A) aktivitetit të pamjaftueshëm të dopaminës
- B) përdorimi i dopaminës së papastër
- C) aktivitetit i shtuar i dopaminës
- D) ndjeshmëria alergjike ndaj dopaminës

Pyetja 38

Një nga format specifike të terapisë që është përdorur për të trajtuar individët me çrregullime personalitetit përfshin tu ofrosh atyre një alternativë tjetër për mënyrën jo funksionale të të menduarit. Kjo formë terapie përqipet t’ju ofrojë aftësitë e nevojshme për të kapërcyer këto mënyra problematike të të menduarit dhe të të sjellurit. Cila nga të mëposhtmet është kjo terapi?

- A) terapia bihejviorale dialektike
- B) terapia psikodinamike
- C) desensitizim sistematik
- D) parandalim i ekspozimit dhe reagimit

Pyetja 39

Në filmin “Frika bazike” personazhi kryesor shfaq sjellje dhe karakteristika tërësisht të ndryshme, si Aaron dhe Roy. Aaron ishte i qetë, i merrej goja, nuk vinte në gojë alkoolin dhe bënte çfarëdo që i kërkonin; Roy ishte i dhunshëm, fliste shumë qartë, pinte shumë dhe nuk pranonte kurrë urdhra nga të tjerët. Aaron nuk e kishte idenë për ekzistencën e Roy. Si quhet gjendja e Aaron?

- A) çrregullim i personalitetit të zhvendosur

- B) çrregullim i personalitetit të ndarë
- C) çrregullim i personalitetit të papërshtatshëm
- D) çrregullim i personalitetit të disociuar

7. Qasjet kryesore të trajtimit të psikopatologjive dhe teknikat

Pyetja 1

Cila nga teknikat e mëposhtme nuk i përket psikanalizës?

- A) Lojrat dialogjike
- B) Interpretimi i ëndrrave
- C) Asosacionet e lira
- D) Hipnoza

Pyetja 2

Në rastin klasik të Anna O., neurologu Breuer i trajtoi simptomat e saj të histerisë duke përdorur:

- A) Modelimin
- B) Hipnozën
- C) Represionin
- D) Projeksionin

Pyetja 3

Qëllimi kryesor i teknikës së asosacioneve të lira është:

- A) Të ndihmojë klientin të nxjerrë materialin e pavetëdijshëm në sipërfaqe.
- B) Të ndryshojë procesin e të menduarit të klientit.
- C) Të ndryshojë sjelljet negative të klientit.
- D) Të ndryshojë skemat apercetive të klientit.

Pyetja 4

Një klient shpreh një emocion të fortë ndaj terapistit, si një reflektim i ndjenjave ndaj një figure tjetër domethënëse në të shkuaren e tij. Këtë fenomen psikanalistët e quajnë:

- A) Rezistencë
- B) Transferencë
- C) Mohim
- D) Projektim

Pyetja 5

Shprehja e Jung që çdo burrë mbart në vetvete një grua, shpjegohet me:

- A) Parimin e të kundërtave
- B) Parimin e ekuivalencës
- C) Arketipin anima/animus
- D) Arketipin e nënës

Pyetja 6

Cili nga konceptet e mëposhtëm nuk lidhet me shkollën analitike të Jung?

- A) Arketipet
- B) Formësimi
- C) Komplekset
- Parimi i entropisë

Pyetja 7

Sipas Jung, nëse një person nuk e pranon hijen e tij, ai me siguri do të ëndërrojë:

- A) Dashuri dhe ngröhtësi
- B) Sikur fluturon në qiell
- C) Sikur është i suksesshëm
- D) Sikur lufton me demonët dhe përbindëshat

Pyetja 8

Pyetjet Sokratike që sqarojnë besimet bazë të klientit për veten, për të tjerët dhe për jetën në tërësi, përdorën përgjatë:

- A) Terapisë geshtaltiste
- B) Terapisë bihejviorale
- C) Terapisë adleriane
- D) Terapisë psikanalitike

Pyetja 9

Pohimi i gabuar në lidhje me skemat aperceptive është se:

- A) Formohen në adoleshencë
- B) Janë tendencioze
- C) Janë private
- D) Janë ekonomike

Pyetja 10

“Krijimi i lëvizjes” si një teknikë e qasjes adleriane nënkupton:

- A) Ta surprizosh klientin
- B) T’i japësh detyra shtëpie klientit
- C) Ta nxisësh klientin të mendojë me “sikur”
- D) Ta nxisësh klientin të theksojë simptomat e tij

Pyetja 11

Një psikoterapist që përdor parimet e kushtëzimit klasik për të trajtuar fobinë ndaj gjarpërinjve, është duke iu referuar:

- A) Qasjes psikanalitike
- B) Qasjes bihejviorale
- C) Qasjes humaniste
- D) Qasjes konjitive

Pyetja 12

Të gjithë elementët e mëposhtëm janë hapa të teknikës së desensibilizimit sistematik, përveç:

- A) Hierarkisë së ankthit
- B) Relaksimit muskolor
- C) Ekspozimit imagjinar
- D) Interpretimit të ëndrrave

Pyetja 13

Teknika e xhetonëve përbën një ndërhyrje të bazuar në parimet e:

- A) Kushtëzimit klasik
- B) Kushtëzimit operant
- C) Përforcimit negativ
- D) Ndëshkimit

Pyetja 14

Gledi u inkurajua të diskutonte në lidhje me ndjenjat e tij, ndërsa psikoterapisti e dëgjonte atë në mënyrë aktive. Kjo qasje e trajtimit i përket:

- A) Terapisë psikanalitike
- B) Terapisë racional-emocionale
- C) Terapisë bihejviorale
- D) Terapisë humaniste

Pyetja 15

Është koncept i terapisë humaniste:

- A) Geshtalti
- B) Empatia
- C) Rezistenca
- D) Entropia

Pyetja 16

Çfarë ka të përbashkët terapia humaniste me psikanalizën?

- A) Fokusin mbi ngjarjet e së shkuarës.
- B) Marrëdhënien klient – terapist.
- C) Konceptimin në lidhje me natyren njerëzore.
- D) Kritikën për mungesë të provave të qëndrueshme empirike.

Pyetja 17

Një terapist geshtaltist:

- A) Prirret të bëjë interpretime
- B) Është sfidues
- C) I cakton detyra shtëpie klientit
- D) I kushton vëmendje gjuhës joverbale të klientit

Pyetja 18

_____ i jep mundësi klientit që të përfundojë çështjet e hapura dhe t'i thotë mesazhet e pathëna dikujt.

- A) Trajnimi asertiv
- B) Teknika e amplifikimit
- C) Teknika e karriges bosh
- D) Teknika e neveritjes

Pyetja 19

Kjo teknikë përdoret atëherë kur klientët prirren të mohojnë një aspekt të personalitetit të tyre, siç është për shembull të qenit i turpshëm.

- A) Teknika e karriges bosh
- B) Lojërat dialogjike
- C) Amplifimi përmes pyetjeve
- D) Dramatizimet

Pyetja 20

Një terapist detyra kryesore e të cilit është të inkurajojë klientët që të testojnë hipotezat e tyre në realitet, ka të ngjarë të përdorë:

- A) Qasjen psikanalitike
- B) Qasjen bihejviorale
- C) Qasjen humaniste

D) Qasjen konjitive

Pyetja 21

Qëllimi kryesor i terapisë konjitive është:

- A) Të përmirësojë cilësinë e njohurive
- B) Të rrisë sasinë e njohurive
- C) Të përmirësojë aftësinë për të menduar
- D) Të modifikojë mendimet negative

Pyetja 22

Ne terapisë kognitive pohimi i gabuar është:

- A) Terapisti kognitiv është mjaft sfidues gjatë seancave.
- B) Terapisti kognitiv është aktiv dhe direktiv gjatë seancave.
- C) Terapisia kognitive supozon se njeriu e ka potencialin për të qenë racional.
- D) Terapisia kognitive nuk ka rezultuar e suksesshme në trajtimin e klientëve me depresion.

Pyetja 23

Modeli ABC i terapisë racional-emocionale përbëhet nga tre elementë: _____, besimet dhe pasojat e këtyre besimeve.

- A) Afeksioni
- B) Atribuimi
- C) Ngjarja aktivizuese
- D) Ngjarja parashikuese

Pyetja 24

Drejtori i një qendre zhvillimi qorton punonjësin e tij për vonesën dhe ky i fundit përgjigjet duke i kërkuar falje dhe duke i premtuar që kjo sjellje nuk do të përsëritet më në të ardhmen. Cili lloj i transaksioneve ka të ngjarë të zhvillohet në këtë moment?

- A) Transaksionet plotësuese
- B) Transaksionet e kryqëzuara
- C) Transaksionet e fshehta
- D) Transaksionet e hapura

Pyetja 25

Lojërat në analizen transaksionale:

- A) Luhen për t'u argëtuar
- B) Plotësojnë nevoja fiziologjike
- C) Plotësojnë nevoja psikologjike
- D) Përmbajnë vetëm një mesazh social

Pyetja 26

Njerëzit dyshues, tallës dhe që ndihen të përsekutuar nga të tjerët, përdorin skenarin:

- A) Unë jam Ok - ti je Ok
- B) Unë jam Ok - ti nuk je Ok
- C) Unë nuk jam Ok - ti je Ok
- D) Unë nuk jam Ok - ti nuk je Ok

KAPITULLI V

FUSHA E PSIKOLOGJISË SOCIALE/ KOMUNITARE

1. Uni dhe perceptimi social

Pyetja 1

Elementi i vetes i cili na jep Individualitetin, pra na bën të veçantë nga të tjerët, është impulsiv dhe spontan, quhet:

- A) Uni
- B) Mua
- C) Vetëkoncept
- D) Vetëvlerësim

Pyetja 2

Cilin element përbërës të vetes përfshin vetërespekti?

- A) Njohës
- B) Biologjik
- C) Emocional
- D) Sjellor

Pyetja 3

Tendenca për të kujtuar më mirë informacionin që lidhet me veten quhet:

- A) Egocentrizëm
- B) Përfitueshmëri
- C) Konservatizëm njohës
- D) Benefektivitet

Pyetja 4

Pas një ndodhie kemi tendencën të mendojmë sikur e dinim që më parë se çfarë do të ndodhte. Kjo shpjegohet me:

- A) Konservatizmin njohës
- B) Efektin e vetëreferencës
- C) Tendencën egocentrike
- D) Tendencën e parashikimit

Pyetja 5

Ideja që kur njerëzit e përqendrojnë vëmendjen te vetja, ata vlerësojnë dhe krahasojnë sjelljen e tyre me standardet dhe vlerat e tyre të brendshme, i përket:

- A) Teorisë së vetëpërceptimit
- B) Teorisë së krahasimit social
- C) Teorisë së vetëdijshmërisë
- D) Teorisë së vetafirmimit

Pyetja 6

Një student prezantohet për herë të parë para kolegëve të tij. Ai tregon se si e shikon veten në lidhje me cilësitë fizike, të personalitetit dhe synimet e tij për të ardhmen. Në këtë rast studenti na jep informacion në lidhje me:

- A) Vetëkonceptin

- B) Vetafirmimin
- C) Vetën e pavarur
- D) Vetën ideale

Pyetja 7

Introspeksioni është më i vlefshëm kur marrim vendime në lidhje me:

- A) Përvojat romantike
- B) Të bërit e një investimi në bursë
- C) Përzgjedhjen e aromës së një parfumi
- D) Preferencat për një vepër arti

Pyetja 8

Mënyra se si e prezantojmë vetën në rrjete sociale, ka për qëllim shpesh që të nxisë simpati dhe aprovim nga të tjerët. Në këtë rast kemi realizuar:

- A) Vetëprezantimin autentik
- B) Vetëprezantimin strategjik
- C) Konsensusin fals
- D) Optimizmin iluziv

Pyetja 9

“E vërtetë që nuk dhashë maksimumin në ndeshje, por kishte lojtarë që luajten më keq sesa unë” - në këtë rast kemi të ilustruar mekanizmin e:

- A) Vetëpengimit
- B) Nënkrahasimit social
- C) Kompensimit të humbjeve
- D) Atribuimeve të vetëshërbimit

Pyetja 10

Hipoteza e mesazhit të fytyrës e Laird (1974) supozon se:

- A) Ndryshimet në shprehjen e fytyrës mund të shkaktojnë ndryshime në përvojën emocionale.
- B) Njerëzit mund të interpretojnë emocionet e të tjerëve nga shprehjet e tyre të fytyrës.
- C) Shprehjet e fytyrës së një personi mund të kopjohen nga vëzhgues të tjerë.
- D) Shumë mesazhe në komunikimin njerëzor transmetohen përmes shprehjeve të fytyrës.

Pyetja 11

Ne mund të na duket vetja gazmorë, për faktin se të tjerët qeshin me atë që ne themi. Ky është një shembull i:

- A) Vetes reale
- B) Vetes ideale
- C) Vetes së mundshme
- D) Vetes që shihet në xham

Pyetja 12

Njerëzit i shkruajnë më mirë gërmat e emrit të tyre sesa gërmat e tjera të alfabetit. Kjo shpjegohet me:

- A) Veçanësinë false

- B) Konsensusin fals
- C) Optimizmin iluziv
- D) Efektin më të madh të pronësisë

Pyetja 13

Era është e sigurtë që do të dalë mirë në provim, prandaj nuk po studion shumë. Ajo ndjehet euforike në lidhje me rezultatet e pritshme. Ky shembull ilustron:

- A) Veçanësinë false
- B) Konsensusin fals
- C) Optimizmin iluziv
- D) Efektin më të madh të pronësisë

Pyetja 14

“Unë vërtetë u largova shpejt nga konferenca, por ashtu vepruan pjesa më e madhe e pjesëmarrësve”. Kjo shpjegohet me:

- A) Veçanësinë false
- B) Konsensusin fals
- C) Optimizmin iluziv
- D) Efektin më të madh të pronësisë

Pyetja 15

“Është e kotë të diskutosh me Andin, ai nuk ndryshon asnjëherë mendim edhe pse mund t’i sjellësh plot fakte për ta bindur”. Ky shembull ilustron:

- A) Egocentrizmin
- B) Benefektivitetin
- C) Superjustifikimin
- D) Konservatizmin njohës

Pyetja 16

Lëvizjet, mimika e fytyrës dhe shikimi janë shembuj të:

- A) Komunikimit paraverbal
- B) Komunikimit joverbal
- C) Komunikimi verbal
- D) Komunikimit etik

Pyetja 17

Komunikimi paraverbal nuk përfshin:

- A) Tonin e zërit
- B) Volumin e zërit
- C) Shprehjet e fytyrës
- D) Pauzat

Pyetja 18

Ky element nuk ka asnjë ndikim në të folurit hapësinor:

- A) Moshë e pjesëmarrësve
- B) Kultura e pjesëmarrësve
- C) Fondi gjenetik i pjesëmarrësve
- D) Tema e diskutimit

Pyetja 19

Niveli më i lartë i distancës fizike është në _____.

- A) Marrëdhëniet intime
- B) Marrëdhëniet personale
- C) Marrëdhëniet shoqërore
- D) Marrëdhëniet me publikun

Pyetja 20

Në shumë vende të botës, një fjongo ngjyrë rozë përfaqëson _____ që lidhet me fushatën e ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit.

- A) Simbolin
- B) Veprimin
- C) Objektivin
- D) Subjektivin

Pyetja 21

Elementë joverbalë të ngjashëm me gjuhën e veprimit, janë :

- A) Emblemat
- B) Ilustruesit
- C) Shprehësit e ndjenjave
- D) Rregullatorët

Pyetja 22

Një koleg ju pyet se sa është ora, por ju në pamundësi për të folur i tregoni 5 gishtat e dorës. Ky shembull ilustron:

- A) Emblemat
- B) Ilustruesit
- C) Shprehësit e ndjenjave
- D) Përshtatësit

Pyetja 23

Përgjatë një bashkëbisedimi, që të zbulojmë mashtrimin, na ndihmon:

- A) Shmangia e kontaktit me sy
- B) Ulja e papritur e tonit të zërit
- C) Makroshprehjet
- D) Të mbajturit e postures drejt

Pyetja 24

“Të paprekshmit” në kuader të përceptimit social:

- A) Janë të sigurtë në vetvete
- B) Janë më të qetë sesa të tjerët
- C) Janë më ankthiozë sesa të tjerët
- D) Janë më të përpiktë sesa të tjerët

Pyetja 25

Fjalimi zgjati vetëm 10 minuta, por na u duk sikur kishte kaluar një orë. Ky shembull ilustron:

- A) Dimensionin fizik të kohës
- B) Dimensionin psikologjik të kohës

- C) Përmbushjen e profesisë vetjake
- D) Efektin Halo

Pyetja 26

Cili pohim është i saktë në lidhje me diferencat gjinore në komunikimin joverbal?

- A) Meshkujt janë superiore në saktësinë e dërgimit të mesazheve joverbale.
- B) Aftësia për të dalluar ndjenjat negative është më e zhvilluar te meshkujt.
- C) Diferencat gjinore në komunikimin joverbal varen nga faktorë gjenetikë.
- D) Diferencat gjinore në komunikimin joverbal varen nga modele të mësuara të sjelljes.

Pyetja 27

Cili pohim është i gabuar në lidhje me shprehjet e fytyrës?

- A) Transmetojnë gjykime vlerësuese
- B) Zbulojnë nivelin e interesit.
- C) Nuk na japin informacion mbi proceset e të menduarit.
- D) Tregojnë nëse e kemi kuptuar diçka apo jo.

Pyetja 28

Kontakti me sy është maksimal kur:

- A) Flasim me persona me status të ulët social.
- B) Flasim me persona me status të moderuar social.
- C) Flasim me persona me status të lartë social.
- D) Flasim me persona pa një status të caktuar social.

Pyetja 29

Cili pohim është i gabuar në lidhje me informacionin që jep veshja si element i komunikimit joverbal?

- A) Veshja zbulon diçka rreth emocioneve tona
- B) Veshja tregon rreth sjelljeve tona
- C) Veshja ndikon në diferencimin tonë nga të tjerët
- D) Veshja nuk ka asnjë lidhje me vetërespektin

2. Atribuimi: funksioni, burimi dhe gabimet atributive

Pyetja 1

Mënyra se si njerëzit i interpretojnë dhe shpjegojnë marrëdhëniet shkakësore në jetën e përditshme, njihet si:

- A) Qëndrim
- B) Përceptim
- C) Atribuim
- D) Vetëvlerësim

Pyetja 2

Atribuimet e brendshme përfshijnë të gjithë faktorët e mëposhtëm përveç:

- A) Fatit
- B) Aftësive
- C) Qëllimit

D) Përpjekjeve

Pyetja 3

Gerti e dinte se do të bëhej një psikolog i zoti për shkak të aftësisë së tij të zhvilluar për të empatizuar dhe mbështetur emocionalisht të tjerët. Ky është një shembull i:

- A) Atribuimeve të brendshme
- B) Atribuimeve të jashtme
- C) Tendencave vetëshërbyese
- D) Tendencave vetëmohuese

Pyetja 4

Çfarë lloj atribuimesh jemi më të prirur që të bëjmë në lidhje me të tjerët?

- A) Të brendshme
- B) Të jashtme
- C) Të qëndrueshme
- D) Të kontrollueshme

Pyetja 5

“Përpjekjet” dhe “aftësitë” janë dy cilësi që na shërbejnë për të formuluar:

- A) Atribuime të qëndrueshme
- B) Atribuime të pakontrollueshme
- C) Atribuimet të brendshme
- D) Atribuimet të jashtme

Pyetja 6

Cili nga rastet e mëposhtëm përbën një shembull të atribuimit të jashtëm?

- A) Të fajësoni veten që nuk keni lexuar mjaftueshëm për provimin në fjalë.
- B) Të fajësoni profesorët që e kanë bërë tezën kaq të vështirë.
- C) Të mendoni që nuk arrini të përqendrohni për shkak të ankthit.
- D) Të mendoni që jeni shumë të lodhur për të patur një performancë të mirë.

Pyetja 7

Cili nga rastet e mëposhtëm përbën një shembull të atribuimit të brendshëm?

- A) Të fajësoni kushtet atmosferike për humbjen e ndeshjes.
- B) Të fajësoni arbitrin që u tregua i njëanshëm në mbajtjen e ndjeshjes.
- C) Të besoni që nuk ishit stërvitur mjaftueshëm për të fituar ndeshjen.
- D) Të besoni që tifozët nuk u treguan mjaftueshëm mbështetës përgjatë lojës.

Pyetja 8

Atribuimet që synojnë të na mbrojnë vetëvlerësimin ose të paraqesin një imazh pozitiv të vetes sonë janë pjesë e:

- A) Paragjykimeve aktor-vëzhgues
- B) Gabimit atributiv themelor
- C) Tendencave vetëshërbyese
- D) Dizonancës njohëse

Pyetja 9

Nevoja për të besuar se bota është e drejtë dhe se njerëzit marrin atë që meritojnë, duke u treguar shpesh kritik me viktimat, ilustron:

- A) Tendencat vetëshërbyese
- B) Tendencat grupshërbyese
- C) Gabimin atributiv themelor
- D) Dallimet aktor-vëzhgues

Pyetja 10

Ana është e sigurt se u pushua nga puna, pasi shefi i saj ishte paaftë për të vlerësuar siç duhet një punonjës. Ky është një shembull i:

- A) Atribuimeve të brendshme
- B) Dallimeve aktor-vëzhgues
- C) Tendencave vetëshërbyese
- D) Tendencave vetëmohuese

Pyetja 11

Tendenca për të nënvlerësuar ndikimin e faktorëve situativë dhe për të mbivlerësuar ndikimin e faktorëve personalë në gjykimin e sjelljes së dikujt tjetër, njihet si:

- A) Efekt Halo
- B) Gabim atributiv themelor
- C) Tendencë vetëshërbyese
- D) Atribuim

Pyetja 12

Gabimi atributiv themelor ndodh atëherë kur gjykojmë sjelljen e një personi dhe priremi të nënvlerësojmë atributet e tij _____ duke u fokusuar më shumë në atributet _____.

- A) Situative; personale.
- B) Personale; situative
- C) E pavetëdijshme; situative
- D) Situative; të pavetëdijshme.

Pyetja 13

Kur bëjmë gabimin atributiv themelor, priremi të fajësojmë një tjetër person përsa i përket:

- A) Cilësive të tij fizike.
- B) Cilësive të tij të personalitetit.
- C) Faktorëve të jashtëm që i ka nën kontroll.
- D) Faktorëve të jashtëm që nuk varen prej tij.

Pyetja 14

Jemi më të prirur për ta shfaqur gabimin atributiv themelor:

- A) Kur bëjmë atribuime për veten.
- B) Kur bëjmë atribuime për realitetin ku jetojmë.
- C) Kur bëjmë atribuime për njerëz që i njohim mirë.
- D) Kur bëjmë atribuime për njerëz që nuk i njohim mirë.

Pyetja 15

Jani dëgjon profesorin e tij të psikologjisë duke debatuar me tone të larta me një koleg të zyrës. Nisur nga kjo situatë, ai supozon se profesori është një person armiqësor dhe agresiv. Supozimi i Janit mbështetet në:

- A) Tendencat vetëshërbyese
- B) Gabimin atributiv themelor
- C) Përmbushjen e profecisë vetjake
- D) Efektin Halo

Pyetja 16

Sipas efektit aktor-vëzhgues, aktorët kanë tendencë t'ua atribuojnë veprimet e tyre faktorëve:

- A) Situativë
- B) Të brendshëm
- C) Të paqëndrueshëm
- D) Personalë

Pyetja 17

Kur jemi të përfshirë në një ngjarje ne priremi të përqendrohemi në faktorët e jashtëm situativë, ndërsa kur e shikojmë këtë ngjarje nga jashtë ne priremi të përqendrohemi në faktorët e brendshëm personal. Në këtë rast kemi të bëjmë me:

- A) Tendencat vetëshërbyese
- B) Besimin në drejtësinë e botës
- C) Efektin e konsensusit të rremë
- D) Dallimet aktor-vëzhgues

Pyetja 18

Atribuimet grupshërbyese kanë të bëjnë me:

- A) Tendencën për të caktuar një individ në një grup, bazuar në sjelljen e tij.
- B) Tendencën për të supozuar që secili individ kalon në disa rite para se të bëhet pjesë e një grupi.
- C) Tendencën për të supozuar se sjellja e grupit pasqyron qëndrimet individuale të anëtarëve të tij.
- D) Tendencën për të supozuar se një individ duhet të identifikohet me një grup të vetëm.

Pyetja 19

Në modelin e tij të kovariacionit, Kelley (1973) sugjeron se ka tre dimensione që ne përdorim për të bërë gjykimet tona shkakësore. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk është pjesë e këtij modeli?

- A) Dallueshmëria
- B) Konsistenca
- C) Dëshirueshmëria
- D) Konsensusi

Pyetja 20

_____përcakton shkallën në të cilën i njëjti person përgjigjet në mënyrë të ngjashme ndaj stimujve të ndryshëm.

- A) Kovariacioni

- B) Konsistenca
- C) Dallueshmëria
- D) Konsensusi

Pyetja 21

Kur shumë persona kanë të njëjtin reagim ose rezultat ndaj një situatë të ngjashme (për shembull, të gjithë vlerësohen me notë të mirë në provimin e shtetit), kemi të bëjmë me:

- A) Konsensusin
- B) Konsistencën
- C) Qëndrimin
- D) Dallueshmërinë

Pyetja 22

Individët që besojnë se nuk kanë aspak kontroll mbi atë që ndodh përreth tyre, janë të prirur të zhvillojnë:

- A) Simptomave depresive
- B) Atribuimeve të brendshme
- C) Atribuime të qëndrueshme
- D) Atribuimeve të kontrollueshme

Pyetja 23

Cili pohim është i gabuar në lidhje me stilin atributiv depresiv?

- A) Ka të bëjë me refleksin e mësuar të pazotësisë për të ndihmuar veten.
- B) Ka të bëjë me tendencën për t'u atribuar rezultatet negative dhe dështimin shkaqeve të pakontrollueshme.
- C) Në programet e ritrajnimit atributiv, njerëzit me depresion mësohen të formulojnë atribuime të pakontrollueshme.
- D) Kontrolli i perceptuar nga këta individë është më i rëndësishëm se kontrolli aktual.

Pyetja 24

Teoritë e atribuimit:

- A) Bazohen në parimet e psikologjisë shkollore
- B) Nuk mund të hidhen poshtë
- C) Janë teori të konkluzioneve shkakësore
- D) Janë teori të unit social

Pyetja 25

Nuk bën pjesë në teoritë e atribuimit:

- A) Teoria e vetëpërceptimit e Bem
- B) Teoria e kovariacionit dhe e konfigurimit e Kelley
- C) Analiza naive e Heider
- D) Teoria e krahasimit social e Festinger

Pyetja 26

Heider zhvilloi teorinë _____ të veprimit, për të hetuar sesi personi perceptues i përcakton shkaqet e sjelljes të tjerëve.

- A) Konjitive

- B) Bihejvioriste
- C) Naive
- D) Shkakore

Pyetja 27

Cila nga sjelljet e mëposhtme do të përshtatej më së miri me teorinë e vetëperceptimit të Bem?

- A) Ju ndërgjegjësoheni për sjelljen tuaj duke parë të tjerët që sillen në mënyrë të ngjashme me ju.
- B) Ju besoni se jeni vërtetë altruist, prandaj dhuroni çdo vit para për bamirësi.
- C) Ju shikoni një person që sillet në mënyrë të çuditshme në një situatë të caktuar dhe kështu që mundoheni ta vini veten në vendin e tij për ta kuptuar më mirë.
- D) Ju shikoni në raftin tuaj të librave dhe vini re se keni blerë pesë libra psikologjik gjatë muajit të fundit, prandaj supozoni se ju pëlqen vërtet psikologjia.

3. Qëndrimet, formimi dhe ndryshimi i tyre

Pyetja 1

Nga pohimet e mëposhtme që lidhen me ndryshimin e qëndrimeve, gjej atë që është i gabuar. Ne bindemi më lehtë nga:

- A) Njerëzit që ne i pëlqejmë.
- B) Njerëzit që ngjajnë me ne.
- C) Njerëzit që janë jopopullorë.
- D) Njerëzit që na tërheqin fizikisht.

Pyetja 2

Efekti i gjumashit lidhet me:

- A) Aftësinë bindëse të individëve me kredibilitet të ulët.
- B) Aftësinë bindëse të individëve të njohur si personalitete.
- C) Aftësinë bindëse të individëve ekspert.
- D) Aftësinë bindëse të individëve të besueshëm.

Pyetja 3

Mesazhet janë më bindëse kur shoqërohen me ndjenja:

- A) Neutrale
- B) Pozitive
- C) Negative
- D) Apatie

Pyetja 4

Mesazhi i dyanshëm është më efektiv në ndryshimin e qëndrimeve në rastin kur:

- A) Audiencia është dakord me informacionin.
- B) Audiencia nuk dëgjon mesazhin opozitar.
- C) Audiencia përshtatet me informacionin.
- D) Audiencia nuk pajtohet që në fillim me mesazhin.

Pyetja 5

Nga pohimet e mëposhtme që lidhen me ndryshimin e qëndrimeve, gjej atë që është i gabuar.

Folës i shpejtë i jep përshtypjen dëgjuesve sikur:

- A) Është inteligjent
- B) I informuar mirë

- C) Fsheh ndonjë gjë
- D) Ka kredibilitet

Pyetja 6

Në bindjen periferike marrësi i mesazhit:

- A) Mendohet thellë për problemin.
- B) Është shumë i motivuar për problemin.
- C) Është i aftë të mendojë rreth problemit.
- D) Interpreton më shumë burimin e mesazhit.

Pyetja 7

Qëndrimet specifike mund të përdoren për të parashikuar sjelljet:

- A) Specifike
- B) E përgjithshme
- C) Pranuese
- D) Mohuese

Pyetja 8

Cili lloj efekti ndodh në rastin kur njerëzit mbajnë mend argumentin e parë më mirë se të dytin?

- A) Efekti i spektatorit
- B) Efekti parësor
- C) Efekti i fundit
- D) Efekti i bumerangut

Pyetja 9

Kundërveprimi apo reagimi psikologjik ka të bëjë me refuzimin për të ndryshuar qëndrimin kur:

- A) Individidi ndjen se është kërcënuar liria e tij për të zgjedhur vetë.
- B) Individidi është inteligjent dhe kupton natyrën e mesazheve.
- C) Individidi është pak inteligjent dhe mesazhet janë komplekse.
- D) Individidi e percepton burimin e mesazhit si jo ekspert.

Pyetja 10

Tërësia e besimeve që ne kemi në lidhje me një objekt, person, ngjarje apo çështje, njihet si:

- A) Pikëpamje
- B) Përceptim
- C) Qëndrim
- D) Edukim

Pyetja 11

Thënia: “Qëndrimi është një ndjenjë e përgjithshme pozitive ose negative për një ose disa persona, objekte ose situata” – i përket:

- A) Modelit njëdimensional
- B) Modelit tre-komponentësh
- C) Modelit të të mësuarit
- D) Modelit konjitiv

Pyetja 12

Modeli tre-komponentësh, i njohur ndryshe si ABC-ja e qëndrimeve përfshin këto elementë:

- A) A = afeksion; B = besime; C = njohje.

- B) A = afeksion; B = sjellje; C = njohje.
- C) A = aktivizim; B = besime; C = sjellje.
- D) A = aktivizim; B = besime; C = njohje.

Pyetja 13

Të dhënat e shumta tregojnë se sa më tepër të shfaqemi pranë një objekti, aq më të prirur jemi:

- A) Të formojmë një qëndrim pozitiv ndaj tij.
- B) Të formojmë një qëndrim negativ ndaj tij.
- C) Të tentojmë të distancohemi prej tij.
- D) Të krijojmë stereotipe në lidhje me të.

Pyetja 14

Cili pohim është i gabuar në lidhje me qëndrimet?

- A) Qëndrimet formohen kur objekti social shoqërohet vetëm me ndjenja të këndshme.
- B) Qëndrimet formohen nëpërmjet stereotipeve shoqërore të një kulturë të caktuar.
- C) Qëndrimet tona ne i mësojmë në të njëjtën mënyrë siç mësojmë gjuhën.
- D) Disa nga qëndrimet tona bazë janë të trashëguara gjenetikisht.

Pyetja 15

Bindja përmes rrugës qëndrore varet nga:

- A) Argumentët logjikë
- B) Shpejtësia e të folurit
- C) Volumi i informacionit
- D) Kompetenca e folësit

Pyetja 16

Kur njerëzit janë më të predispozuar që të binden nga një mesazh sipas rrugës periferike?

- A) Nëse ata paralajmërohen për mesazhin.
- B) Nëse ata kanë vetëvlerësim të lartë.
- C) Nëse ata përjetojnë ndjenja negative.
- D) Nëse ata e pëlqejnë personin që jep mesazhin.

Pyetja 17

Një mënyrë e matjes direkte të qëndrimeve është dhe :

- A) Shkalla e Likert
- B) Elektromiograma faciale
- C) Reagimi galvanik i lëkurës
- D) Teknika e humbjes së letrës

Pyetja 18

Synimi i reklamës është që të krijojë te njerëzit lidhjen midis ndjenjës pozitive që transmeton një personazh i njohur dhe produktit që duhet shitur. Ky është një parim i:

- A) Ekspozimit të shpeshtë
- B) Kushtëzimit klasik
- C) Kushtëzimit operant
- D) Krahasimit social

Pyetja 19

Në studimin e tyre mbi ndryshimin e qëndrimeve, Festinger dhe Carlsmith (1959) u kërkuan subjekteve që të kryenin detyra të mërzitshme pastaj:

- A) Subjektet ndoqën një diskutim në grup mbi altruizmin.
- B) Subjektet raportuan në dhomën tjetër se detyrat ishin te mërzitshme.
- C) Subjektet raportuan në dhomën tjetër se detyrat ishin interesante.
- D) Subjektet shkruan një ese mbi vlerësimin e tyre për detyren.

Pyetja 20

Dizonanca njohëse lind:

- A) Kur qëndrimi ndaj një objekti përputhet me sjelljen ndaj tij.
- B) Kur qëndrimi ndaj një objekti nuk përputhet me sjelljen ndaj tij.
- C) Kur një person nuk ka një qëndrim të caktuar ndaj një objekti.
- D) Kur një person nuk shfaq një sjellje të dukshme ndaj një objekti.

Pyetja 21

Dizonanca njohëse është e bazuar në nevojën njerëzore për:

- A) Vetaktualizim
- B) Qëndrueshmëri
- C) Afeksion
- D) Vlerësim

Pyetja 22

Cila nga këto situata shkakton dizonacë njohëse?

- A) Dua të këndoj dhe kam një zë të mrekullueshëm.
- B) Më duhet telefoni dhe atë e kam në çantë.
- C) Dua të flas, por të tjerët nuk dëgjojnë.
- D) Dua të blej një libër dhe kam mjaftueshëm para.

Pyetja 23

Në vitin 1957, Leon Festinger zhvilloi teorinë e tij të:

- A) Balancës psikologjike
- B) Dizoncës njohëse
- C) Kushtëzimit klasik
- D) Kushtëzimit operant

Pyetja 24

Cili pohim është i saktë në lidhje me dy rrugët e ndryshimit të qëndrimeve?

- A) Rruga periferike ka një efekt afatgjatë në ndryshimin e qëndrimit.
- B) Burimi tërheqës ka një efekt afatgjatë në ndryshimin e qëndrimit.
- C) Burimi i ngjashëm me ne ka një efekt afatgjatë në ndryshimin e qëndrimit.
- D) Burimi që na nxit të mendojmë ka një efekt afatgjatë në ndryshimin e qëndrimit.

Pyetja 25

Ata që janë të pakënaqur nga martesat e tyre i shmangin këto ndjenja negative nga vetja duke i projektuar te personat e divorcuar. Cilin funksion të qëndrimeve ilustron ky shëmbull?

- A) Funksionin mbrojtës të egos

- B) Funksionin e shprehjes së vlerave
- C) Funksionin utilitar/ instrumental
- D) Funksionin organizues

Pyetja 26

Daniela është mësuese në një shkollë të mesme të qytetit. Ajo beson se është e rëndësishme të jetë e sinqertë në marrëdhëniet e saj me nxënësit dhe kolegët. Cilin funksion të qëndrimeve ilustron ky shëmbull?

- A) Funksionin mbrojtjes të egos
- B) Funksionin e shprehjes së vlerave
- C) Funksionin utilitar/ instrumental
- D) Funksionin organizues

Pyetja 27

Shpeshherë mbajmë qëndrime që janë të dobishme për ne, që na ndihmojnë të përparojmë dhe të jetojmë më mirë. Cilin funksion të qëndrimeve kemi të ilustruar në këtë rast?

- A) Funksionin mbrojtjes të egos
- B) Funksionin e shprehjes së vlerave
- C) Funksionin utilitar/ instrumental
- D) Funksionin organizues

Pyetja 28

Studimi i La Piere (1934) i realizuar me një çift të ri kinezesh që udhëtuan në të gjithë ShBA-në, tregoi se:

- A) Njerëzit në të vërtetë nuk janë paragjykses.
- B) Njerëzit në të vërtetë janë vetëkonsistent.
- C) Qëndrimi dhe sjellja përputhen gjithmonë.
- D) Qëndrimi dhe sjellja nuk përputhen gjithmonë.

Pyetja 29

Nëse ndeshemi me argumentet e folësit që ndryshojnë ose u kundërvihen interesave të tij personale, sipas rrugës periferike të bindjes ne jemi të prirur:

- A) T'i refuzojmë menjëherë ato
- B) T'i pranojmë menjëherë ato
- C) T'i kërkojmë informacion shtesë
- D) T'i japim kohë të reflektojmë

Pyetja 30

Cili pohim është i gabuar në lidhje me matjet indirekte të qëndrimeve?

- A) Janë të paqarta në interpretim
- B) Përfshijnë matjet fiziologjike
- C) Përfshijnë shkallët matëse
- D) Përfshijnë vëzhgimet e sjelljes

Pyetja 31

Shkalla e matjes së qëndrimeve përbëhet prej një sërë mbiemrash të kundërt, të tipit i dobishëm/ i padobishëm, i qetë/ i nervozuar etj. Në këtë rast kemi të bëjmë me:

- A) Shkallen e Likert

- B) Shkallen e distancës sociale
- C) Shkallen e diferencimit kuptimor
- D) Shkallen e intervaleve të barabarta

Pyetja 32

Sipas teorisë së Heider (1958) një formë e triadës së balancuar përmban_____lidhje negative.

- A) Një
- B) Dy
- C) Tre
- D) Katër

4. Ndikimi social dhe proceset grupale

Pyetja 1

Grupi përkufizohet si:

- A) Dy ose më shumë individë që për disa çaste apo periudhë të gjatë ndërveprojnë dhe ndikojnë mbi njëri-tjetrin dhe e perceptojnë njëri-tjetrin si “ne”.
- B) Dy ose më shumë individë që për disa çaste apo periudhë të gjatë eliminojnë dhe dhunojnë mbi njëri-tjetrin dhe e perceptojnë njëri-tjetrin si “ata”.
- C) Dy ose më shumë individë që për disa çaste apo periudhë të gjatë braktisen dhe anashkalojnë njëri-tjetrin dhe e perceptojnë njëri-tjetrin si “askushi”.
- D) Dy ose më shumë individë që për disa çaste apo periudhë të gjatë bullizojnë dhe ofendojnë njëri-tjetrin dhe e perceptojnë njëri-tjetrin si “ne”.

Pyetja 2

Disa nga kriteret që janë përjashtuese në përcaktimin ekzistencës së një grupi, është:

- A) Anëtarët e grupit të jenë të ndërvarur nga njëri-tjetri, pra çfarë ndodh tek njëri ndikon edhe në atë që ndodh tek tjetri
- B) Anëtarët e grupit duhet t’a perceptojnë veten si anëtarë të grupit, pra të njohin ekzistencën e raporteve me njëri-tjetrin.
- C) Anëtarët e grupit duhet të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, drejtpërdrejtë apo indirekt
- D) Anëtarët e grupit të braktisen nga njëri-tjetri, të përjashtojnë njohjen e ekzistencës së raporteve me njëri-tjetrin.

Pyetja 3

Në fazat e krijimit të një grupi, përjashtohet faza:

- A) Formimi
- B) Normimi
- C) Përfundimi
- D) Eliminimi

Pyetja 4

Efekti i thjeshtimit shoqëror, përjashton faktin se:

- A) Njerëzit janë më të shpejtë në detyrat e tyre kur janë në praninë e të tjerëve
- B) Njerëzit janë më të saktë në detyrat e tyre kur janë në praninë e të tjerëve
- C) Njerëzit janë më produktiv në detyrat e tyre kur janë në praninë e të tjerëve
- D) Njerëzit janë më problematik në detyrat e tyre kur janë në praninë e të tjerëve

Pyetja 5

Shpesh herë, të qënurit në praninë e shumë të tjerëve apo turmës, ndikon në reagimet apo sjelljet tona, edhe negativisht sepse:

- A) Të qënurit para një turme mundëson të kemi ndërveprim më të lartë, sesa kur jemi me pak njerëz.
- B) Të qënurit para një turme përforcon reagimet positive dhe negative tonat.
- C) Të qënurit para një turme përforcon nxitjen, e cila thjeshtëzon përgjigjet mbizotëruese
- D) Të qënurit para një turme mundëson frenimin e sjelljeve tona, për shkak të gjendjeve emocionale, e cila vështirëson përgjigjet mbizotëruese

Pyetja 6

Shpesh herë ndodh që ne të pyesim veten “Pse shqetësohemi në prani të të tjerëve?”, proces që ndodh për disa arsye, ku një ndër arsyet përjashtuese është:

- A) Ne shqetësohemi për vlerësimin që të tjerët bëjnë për ne
- B) Ne shqetësohemi për reagimet, sjelljet e të tjerëve përkundrejt veprimeve tona
- C) Ne shqetësohemi për gjykimet dhe paragjykimet e të tjerëve përkundrejt mendimeve tona
- D) Ne qetësohemi nga vlerësimet, gjykimet dhe reagimet përkundrejt veprimeve dhe mendimeve tona

Pyetja 7

“Proçesi me të cilin qëndrimet, besimet, sjellja e një individi modifikohen nga prania dhe veprimi i të tjerëve”, ka të bëjë me:

- A) Pushtet Social
- B) Kognicion Social
- C) Lidërsip Social
- D) Ndikim Social

Pyetja 8

Në rastet kur ne i nënshtrohemi njerëzve me autoritet, si polic, drejtor, epror etj, apo tendenca jonë për të bindur shokët/shoqet të vijnë në kinema me ne, kemi të bëjmë me:

- A) Ndikim Social
- B) Pushtet Social
- C) Lidërsip Social
- D) Grup Social

Pyetja 9

Një ndër problematikat përjashtuese që nuk i atribuohet ndikimit social, është:

- A) Konformizmi
- B) Ekstremizmi
- C) Komplanca
- D) Obedienca

Pyetja 10

Sipas psikologëve social, konformizmi ka të bëjë me:

- A) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me kushtet sociale
- B) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim kërkesën e dikujt
- C) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për t’iu bindur dhe nënshtruar të tjerëve
- D) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me gjykimet e të tjerëve

Pyetja 11

Sipas psikologëve social, komplanca ka të bëjë me:

- A) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me kushtet sociale
- B) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me kërkesën e dikujt
- C) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për t'iu bindur dhe nënshtruar të tjerëve
- D) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me gjykimet e të tjerëve

Pyetja 12

Sipas psikologëve social, obediencia ka të bëjë me:

- A) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me kushtet sociale
- B) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim kërkesën e dikujt
- C) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për t'iu bindur dhe nënshtruar të tjerëve
- D) Ndryshimin vullnetar të sjelljes sonë për të qenë në pajtim me gjykimet e të tjerëve

Pyetja 13

Ne zgjedhim të mos jemi apo të mos i përkasim një grupi social, për shkak se:

- A) Ndihejmë të plotësojmë nevoja të rëndësishme sociale dhe psikologjike
- B) Mundëson të arrijmë qëllimet që nuk i realizojmë dot në mënyrë individuale
- C) Mundëson të formojmë një identitet social pozitiv, që të bëhet pjesë e vetëkonceptit tonë
- D) Mungon vetëdija dhe dëshira jonë për përkatësi sociale në një grup social

Pyetja 14

Nëse anëtarët e një grupi rivalizojnë dhe luftojnë për të marrë pozita dhe role sa më të pëlqyeshme dhe të favorshme në këtë grup, ku shumica prej tyre besojnë se mund të shërbejë si lider efektiv, do të thotë se:

- A) Po përjetohet faza e betejës e zhvillimit të një grupi, ku është shumë e rëndësishme zgjedhja e një lideri
- B) Po përjetohet faza e normimit të zhvillimit të një grupi, ku është shumë e rëndësishme zgjedhja e një lideri
- C) Po përjetohet faza e përfundimit të zhvillimit të një grupi, ku është shumë e rëndësishme zgjedhja e një lideri
- D) Po përjetohet faza e shpërbërjes e zhvillimit të një grupi, ku është shumë e rëndësishme zgjedhja e një lideri

Pyetja 15

Në funksionimin e një grupi, anëtarët kryejnë detyra specifike, të ndryshme nga njëri tjetri, duke luajtur kështu role të caktuara, të cilët diferencohen në zgjedhjet e tyre, kur:

- A) Ato orientohen nga detyra dhe marrëdhëniet
- B) Ato orientohen nga përkatësia dhe bashkëpunimet
- C) Ato orientohen nga barazia dhe bashkëveprimet
- D) Ato orientohen nga drejtësia dhe ligjzbatimet

Pyetja 16

Kur një prind i ri, i cili është i detyruar të luajë dy role njëkohësisht, pasi i duhet të vazhdojë edhe karrierën profesionale, role rivalizues të njëri-tjetrit, themi se po përjeton atë që quhet:

- A) Paqartësi të rolit
- B) Konflikt të rolit
- C) Tregues të rolit
- D) Udhëzues të rolit

Pyetja 17

Sipas psikologëve social, një ndër faktorët që nuk luan asnjë rol ndikues në kohezionin e një grupi është:

- A) Sa më e madhe të jetë kostoja për t'u futur në grup, aq më e madhe është tërheqja e anëtarëve ndaj grupit
- B) Presionet e jashtme i shtojnë anëtarët e grupit të afrohen më tepër dhe të vlerësojnë më shumë anëtarësimin në grup
- C) Grupet që kanë patur suksese në të kaluarën janë më të bashkuar sesa ato grupe që nuk kanë një histori të tillë
- D) Grupet e mëdha kanë kohezion më të lartë sesa grupet e vogla, pasi grupet e mëdha u ofrojnë më shumë mundësi anëtarëve të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin.

Pyetja 18

Shpesh herë ndodh që në praninë e të tjerëve, nëpërmjet bashkëveprimit, si dhe vëzhgimit, ne realizojmë detyrat tona në mënyrë më të saktë dhe më të shpejtë, duke përjetuar kështu stimulim psikologjik, që rrit produktivitetin tonë dhe sipas psikologëve social, ky proces psikologjik quhet:

- A) Lehtësim social
- B) Reagim social
- C) Udhëzim social
- D) Bashkëpunim social

Pyetja 19

Sipas efektit të Ringelmanit, që njihet si dukuria kur individët bëhen më pak produktivë sa më tepër rritet madhësia e grupit, ky efekt ndodh për arsye se:

- A) Kur njerëzit punojnë individualisht, fokusohen në kontributet personale dhe për pasojë arrijnë maksimumin e efikasitetit në grup
- B) Kur njerëzit punojnë më shumë, duke i lënë të tjerët të punojnë më pak, dhe ku anëtarët i ndajnë kontributet mbi bazën e produktivitetit individual të tyre
- C) Kur njerëzit punojnë së bashku, fokusohen në kontributet personale dhe për pasojë nuk arrijnë maksimumin e efikasitetit në grup
- D) Kur njerëzit punojnë më pak, duke i lënë të tjerët përgjegjësini të punojnë, dhe ku anëtarët i ndajnë kontributet mbi bazën e produktivitetit individual të grupit

Pyetja 20

Në një skuadër të tërheqjes së litarit, fuqia që do të përdorin personat e njëjës anë, do të jetë e barabartë me shumën e fuqive që do të tregojnë ata në mënyrë individuale, pra, prirja e njerëzve për të ushtruar përpjekje të vogla kur kanë një qëllim të përbashkët, ka të bëjë me atë që psikologët social do ta quanin:

- A) Thjeshtim shoqëror
- B) Hallakatje shoqërore
- C) Bindje shoqërore
- D) Tërheqje shoqërore

Pyetja 21

Në rrugët e lagjes sime në të cilën isha dëshmitare okulare po rregjistroja ngjarjen ku disa policë ishin duke goditur një të ri dhe disa policë të tjerë po shikonin ngjarjen, duke mos bërë as reagimin më të vogël. Pyesja veten ndërkohë "Çfarë po ndodhte me standartet e sjelljes profesionale të këtyre policëve? Kjo gjendje psikologjike, që po ju ndodhte këtyre të fundit, ka të bëjë me atë që psikologët social, do ta quanin:

- A) Deindividualizim
- B) Disreagim

- C) Disbalanacim
- D) Diskordinim

Pyetja 22

Ndikimi shoqëror normativ është vendi ku zakonisht një person përshtatet me grupin social, për mos u ndjerë i veçuar nga të tjerët. Ky ndikim shoqëror përveç se me përshtatshmërinë, shoqërohet edhe me:

- A) Pajtueshmërinë, ku individi ndryshon sjelljen, por jo bindjen e tij
- B) Përshtatshmërinë, ku individi përshtatet me sjelljet dhe bindjet e të tjerëve
- C) Brendësimin, ku individi është i pasigurtë për situatën
- D) Sigurinë, ku individi është i sigurtë për situatën

Pyetja 23

Sipas psikologëve social, në minimizimin e konformizmit nuk ndikon::

- A) Madhësia e grupit
- B) Unanimiteti i grupit
- C) Përgjigjet privatisht
- D) Diskutimet e grupit

Pyetja 24

Lloji i sjelljes së pamenduar, e cila kryhet nën një presion të caktuar të grupit, si psh “Unë jam si gjithë të tjerët”, kemi të bëjmë me:

- A) Sjellje konfliktuale
- B) Sjellje konformale
- C) Sjellje optimale
- D) Sjellje formale

Pyetja 25

Në shoqërinë tonë shqiptare, shpesh herë ndodh që deviatorët e debateve dhe diskutimeve nuk inkurajohen dhe për pasojë individi ndihet i detyruar dhe i nënshtruar të ndryshojë sjelljen dhe qëndrimin e tij, në këtë rast themi se individi konformohet për arsye të:

- A) Presionit social që ushtrohet drejt tij
- B) Frikës së mospranimit të cilësisë së debatit dhe diskutimit
- C) Shkujdesjes të reagimit mbi aprovimin e debatit dhe diskutimit
- D) Shmangies nga debatet dhe diskutimet në grupin social

Pyetja 26

Shpesh herë në punën tonë ndodh të jemi të sigurtë që kemi të drejtë në ato që themi dhe mendojmë, e mbi të gjitha kur mbështetemi nga mjedisi social. Në këtë mënyrë ne shmangim:

- A) Nevojën të revoltohemi
- B) Nevojën të konformohemi
- C) Nevojën të konfliktohemi
- D) Nevojën të diferencohemi

Pyetja 27

“Para zhvillimit të testit, pedagogu i informatikës njofton studentët se ditën e premte për testim të ndërmjetëm. Një nga studentët, pas përfundimit të orës së leksionit, takon profesorin për t’i kërkuar shtyrje provimi për një orë tjetër, pasi ai nuk ndihej i përgatitur”. Në këtë rast studenti ka përdorur:

- A) Metodën racionale direkte të ndikimit social
- B) Metodën irracionale direkte të ndikimit social

- C) Metodën racionale indirekte të ndikimit social
- D) Metodën irracionale indirekte të ndikimit social

Pyetja 28

Në moshën shkollore, shpesh herë ka ndodhur që kur kemi patur provim në matematikë, apo fizikë, jemi ankuar për dhimbje barku, që prindërit të n'a lejonin të qëndronim në shtëpi. Në këtë rast kemi përdorur taktika të ndikimit social, si:

- A) Metodën racionale direkte të ndikimit social
- B) Metodën irracionale direkte të ndikimit social
- C) Metodën racionale indirekte të ndikimit social
- D) Metodën irracionale indirekte të ndikimit social

Pyetja 29

Shpesh herë ndodh që kur blejmë produkte kozmetike, shitësja jep edhe një produkt tjetër falas, ose një muaj abonim falas për të marrë produkte në ofertë. Sipas psikologëve social, shitësja për të arritur komplaincën përdor atë që quhet:

- A) Teknika e "Këmbës në derë"
- B) Teknika e "Derës në fytyrë"
- C) Teknika e "Vallëzimit të lehtë"
- D) Teknika "Kjo nuk është e gjitha"

5. Pushteti social dhe lidershipi

Pyetja 1

Aftësinë e një individi për të kontrolluar dhe formuar sjelljen e tjetrit, psikologët social do të quanin:

- A) Pushtet Social
- B) Ndikim Social
- C) Grup Social
- D) Lidership social

Pyetja 2

Personi që ushtron influencën më të madhe në një grup për arritjen e qëllimeve të veçanta të grupit, përcaktohet si:

- A) Lider
- B) Drejtor
- C) Profesor
- D) Doktor

Pyetja 3

Në tipologjinë e pushtetit social, nuk përfaqësohet:

- A) Pushteti i shpërblimit
- B) Pushteti i emërimit
- C) Pushteti i ekspertit
- D) Pushteti informativ

Pyetja 4

Personi, i cili është tërheqës për dikë dhe kjo e bën adhuruesin të sillet si ai që adhuron, pra identifikohet me atë që pëlqen, kemi të bëjmë me:

- A) Pushtet referent
- B) Pushtet legjitim
- C) Pushtet informativ

D) Pushtet investigativ

Pyetja 5

Disa nga cilësitë e liderit autokratik, janë:

- A) Ndërtojnë një mjedis psikologjik e social që është i favorshëm për të arritur objektivat
- B) Instalojnë vlerat duke shkëmbyer përvojë me filozofitë e tyre të jetës.
- C) Përballojnë problemet që lindin dhe zgjidhin konfliktet.
- D) Thekson autoritetin personal ne lidhje me vendimet, detyrat për arritjen e qëllimeve të grupit

Pyetja 6

Një ndër sjelljet e papërshtatshme të një lidershipi janë:

- A) Fillimi i komunikimit dhe rritja e besimit
- B) Drejtimi dhe planifikimi i grupit
- C) Bullizmi dhe keqtrajtimi fizik i anëtarëve të grupit
- D) Ndjeshmëria sociale dhe theksimi i produktivitetit

Pyetja 7

Karakteristikat dominante të sjelljes së një lideri, përjashtojnë:

- A) Kategorinë e konsideratës
- B) Strukturën inicuese
- C) Ndjeshmërinë sociale
- D) Përshtatshmërinë grupale

Pyetja 8

Një ndër elementet kryesore që nuk i përkasin karakterit të një lideri socioemocional është:

- A) Ky lloj lideri përdor lloje të ndryshme pushtetesh, si referent, shpërblyes etj
- B) Ky lloj lideri shqetësohet për të krijuar një klimë positive sociale
- C) Ky lloj lideri shqetësohet për mbarëvajtjen e punës
- D) Ky lloj lideri përdor lloje të ndryshme ndëshkimesh, si heqje të ditës së punës, notë të ulët të performancës etj

Pyetja 9

Në teoritë që studiojnë sjelljen e lidershipit, nuk bën pjesë:

- A) Teoria e veçorive
- B) Teoria e situatave
- C) Teoria e ndërveprimit
- D) Teoria e zhvillimit

Pyetja 10

Një ndër veçoritë kryesore të personalitetit të një lideri që ka ndikim negativ në grupin social është:

- A) Inteligjenca
- B) Verboziteti
- C) Karizma
- D) Arroganca

Pyetja 11

Ndryshimi midis pushtetit social dhe influencës sociale qëndron në faktin se:

- A) Pushteti social është aftësia për të nxitur të tjerët dhe për të ndryshuar sjelljet e tyre, ndërsa influenca sociale përfshin procesin apo ushtrimin konkret të këtij pushteti për të ndryshuar sjelljen.
- B) Pushteti social është aftësia për të ndryshuar sjelljen, ndërsa influenca sociale përfshin procesin apo ushtrimin konkret të këtij pushteti për të ndryshuar sjelljen.
- C) Pushteti social ka të bëjë me procesin apo ushtrimin konkret të këtij pushteti për të ndryshuar sjelljen, ndërsa influenca sociale është aftësia për të nxitur të tjerët dhe për të ndryshuar sjelljet e tyre,
- D) Të gjitha alternativat

Pyetja 12

Disa nga dallimet kryesore që nuk janë përfaqësuese në metamorfozën e pushtetit, janë:

- A) Individuale
- B) Moshore
- C) Gjeofizike
- D) Biologjike

Pyetja 13

Universitetet i'u nënshtruan procesit të akreditimit. Rektori pas përfundimit me sukses të Akreditimit Institucional, vendos të akordojë një shumë parash specifike për grupin e punës. Në këtë rast, themi se titullari i institucionit ka ushtruar:

- A) Pushtetin e shpërblimit
- B) Pushtetin e forcës
- C) Pushtetin referent
- D) Pushtetin legjislativ

Pyetja 14

Shpesh herë ndodh të kemi dëgjuar pronarin apo menaxherin e kafenesë, që t'iu bërtasë kamarierëve për shërbim të dobët, për vonesa në orar, madje dhe duke i kërcënuar për heqje të ditës së punës, apo largim nga puna. Në këtë rast, themi se ky pronar lokal, ushtron:

- A) Pushtetin e shpërblimit
- B) Pushtetin e forcës
- C) Pushtetin e zotësisë
- D) Pushtetin legjislativ

Pyetja 15

Në të çdo institucion publik dhe jo publik, midis titullarit të institucionit, eprorit, pra punëdhënësit dhe punëmarrësit nënshkruhet kontrata e vendit të punës, ku përcaktohen dhe detyrimet ligjore të punëmarrësit, siç janë edhe respektimi i orarit të punës, etikës në institucion etj. Midis këtyre aktorëve mbizotëron:

- A) Pushteti i shpërblimit
- B) Pushteti informativ
- C) Pushteti referent
- D) Pushteti ligjor

Pyetja 16

Shpesh herë ka ndodhur që në auditoret e leksioneve, pedagogu sapo ka hyrë për të zhvilluar leksionin, të tjerët kanë pushuar së foluri, të gjithë studentët kanë ndjekur leksionin e tij me

shumë vëmendje, dhe sa herë që ndeshet në korridoret e universitetit ai përshëndetet nga studentët e tij. Ky pedagog zotëron:

- A) Pushtet referent
- B) Pushtet informativ
- C) Pushtet ligjor
- D) Pushtet zotësisë

Pyetja 17

Kur duam të marrim informacion mbi procedurat ligjore të një divorci, apo kur duhet të vendosim mbi hartimin e një testamenti, ne pyesim avokat apo noter, pasi ata në kundërshti me ne zotërojnë:

- A) Pushtet referent
- B) Pushtet informativ
- C) Pushtet ligjor
- D) Pushtet i ekspertit

Pyetja 18

Në një proces gjyqësor, dëshmitari okular zotëron pushtetin:

- A) Referent
- B) Informativ
- C) Ligjor
- D) Ekspertit

Pyetja 19

Lidershipi ndikohet nga shumë faktorë situativë apo të rastësishëm por që kanë influencë të lartë, situatat problemore etj, por në përcaktimin e liderit sipas modelit situativ të lidershipit, nuk ndikojnë:

- A) Situatat përcaktuese
- B) Organizimi i të ulurit
- C) Nevojat e grupit
- D) Marrëdhëniet reciproke

Pyetja 20

Nevoja e liderit është rezultat i karakteristikave të liderit, të pasuesve dhe të situatës, ndaj është situata ajo që ndikon nevojat e pasuesve dhe nevojën e grupit për lider, rrjedhimisht modeli ndërveprues i lidershipit vlerëson në përcaktimin e liderit:

- A) Marrëdhëniet reciproke midis liderit situativ dhe anëtarëve të grupit
- B) Komunikimi është i rëndësishëm në përcaktimin e liderit
- C) Koha e gjatë e qëndrimit si anëtar i grupit përcakton liderin
- D) Identifikimi i liderit në kohë të rëndësishme varet nga detyra që kryen grupi

Pyetja 21

Drejtimi i sjelljes së grupit përcaktohet nga personi i rëndësishëm që drejton, ku sipas modelit të veçorive, përcaktimi i lidershipit nuk do të thotë që:

- A) Liderët lindin, nuk bëhen
- B) Liderët bëhen, nuk lindin
- C) Liderët dominojnë
- D) Liderët motivojnë

Pyetja 22

Liderët e mirë janë në gjendje që të vlerësojnë nevojat e anëtarëve të tyre, të analizojnë situatën dhe të përshtasin sjelljen e tyre në përputhje me situatat. Kjo ka të bëjë me teorinë e kontigjencës, e cila përjashton faktin se situata:

- A) Situata është e favorshme kur marrëdhënia e liderit me anëtarët e grupit janë të mira
- B) Situata është e favorshme kur lideri ka pozitë me fuqi të madhe tek anëtarët e grupit
- C) Situata është e favorshme për liderin kur detyra është e qartë për secilin anëtar të grupit
- D) Situata është e favorshme kur marrëdhënia e liderit me anëtarët e grupit janë konfliktuale dhe kur detyrat janë të paqarta për anëtarët e grupit

Pyetja 23

Efektiviteti i liderit përcaktohet në marrjen e vendimeve reciproke në bashkëpunim me anëtarët e grupit, ndaj dhe stilet udhëheqëse të lidërshiptit ndryshojnë në varësi të marrjes së vendimeve. Kjo marrëdhënie e ndërsjelltë vendimmarje përjashton faktin se:

- A) Liderët që pranojnë një pjesëmarrje të konsiderueshme të pasuesve në vendimet që marrin janë më efektivë sesa ata që pranojnë shumë pak
- B) Liderët që përshtasin stilin e marrjes së vendimit me kushtet ekzistuese janë më të suksesshëm sesa ata që janë rregullisht autokratik
- C) Liderët që kontrollojnë konfliktet ndërpersonale, kur pranimi i vendimit është i rëndësishëm është më i suksesshëm sesa ata që nuk kanë aftësi të tilla
- D) Liderët që nuk kanë aftësi kontrolluese, përshtatjeje apo pranimi në vendimet e rëndësishme që ata marrin është më i suksesshëm sesa ata që kanë aftësi të tilla

Pyetja 24

Studiuesit e lidërshiptit kanë përcaktuar programme të ndryshme, ku një ndër këto programme i quajtur “LeaderMatch”, synon:

- A) Të ndihmoj liderët të identifikojnë situata që janë më të përshtatshme për stilin e tyre të lidërshiptit
- B) Të ndihmoj liderët të përjashtojnë situata që janë më të papërshtatshme për stilin e tyre të lidërshiptit
- C) Të ndihmoj liderët të kundërshtojnë situata që janë më të përshtatshme për stilin e tyre të lidërshiptit
- D) Të ndihmoj liderët të krijojnë situata që janë më të papërshtatshme për stilin e tyre të lidërshiptit

Pyetja 25

Një individ, i cili mendon se si gjithë të tjerët edhe ai mund të bëjë detyrën që i është dhënë, psh të një parlamenti, ku vazhdon të mbajë kontakte me të njohurit e mëparshëm, ruan modestinë, njëkohësisht vendos kontakte të reja me kolegët, premtan për reforma të reja për institucionin e tij, por gradualisht nuk gjen më kohë t’iu përkushtohet të afërme, apo kontakteve të mëparshme, vendos rregulla personale, ndërrohet stafin, fillon të joshet nga makina e telefoni celular i markës së fundit, ndryshon ndonjë zakon, i pëlqen të dalë në media etj, sipas psikologëve social, kemi të bëjmë me:

- A) Faza e joshjes së metamorfozës së pushtetit
- B) Faza e eksitimit të metamorfozës së pushtetit
- C) Faza e orgazmës së metamorfozës së pushtetit
- D) Faza e shpërbërjes së metamorfozës së pushtetit

Pyetja 26

Një individ, i cili tashmë nuk e ndjen më veten të ri në postin e tij, që mendon se ai e bën më mirë se të tjerët detyrën që ka merituar. Tashmë për të është e rëndësishme të ruhet posti që ai mban, kontaktimi me të njohurit e mëparshëm nuk shikohet më e arsyeshme për të. Kolegët, vartësit dhe të tjerët e parëndësishëm janë me interes, vetëm kur i bëjnë qejfin, ky proces sipas psikologëve social, ka të bëjmë me:

- A) Faza e joshjes së metamorfozës së pushtetit
- B) Faza e eksitimit së metamorfozës së pushtetit
- C) Faza e orgazmës së metamorfozës së pushtetit
- D) Faza e shpërbërjes së metamorfozës së pushtetit

Pyetja 27

Një individ, i cili tashmë është i bindur se përveç tij nuk mund t'a bëjë tjetër detyrën tepër të rëndësishme që i është ngarkuar. Tani ai nuk i përket familjes, miqësisë së mëparshme, madje as vetes, por profesionit, shtetit. Tashmë ai nuk është konkret, por abstrakt, me ide dhe imazhe të shumta dhe i paprekshëm nga të tjerët, ky proces sipas psikologëve social, ka të bëjmë me:

- A) Faza e joshjes së metamorfozës së pushtetit
- B) Faza e eksitimit së metamorfozës së pushtetit
- C) Faza e orgazmës së metamorfozës së pushtetit
- D) Faza e shpërbërjes së metamorfozës së pushtetit

Pyetja 28

Një individ, i cili është i pakënaqur dhe shpesh i revoltuar se nuk e lanë të tregonte aftësitë e tija të jashtëzakonshme, se nuk e kuptuan të tjerët se vetëm ai mund t'a shpëtonte institucionin e tij. Koha bën të vetën, dhe ngushëllohet me ndonjë shok të vjetër që i rikthehet me modesti, ose vë në përdorim paratë e mbledhura gjatë viteve të punës për të gjeneruar përsëri pushtetin e humbur, ky proces sipas psikologëve social, ka të bëjë me:

- A) Faza e joshjes së metamorfozës së pushtetit
- B) Faza e eksitimit së metamorfozës së pushtetit
- C) Faza e orgazmës së metamorfozës së pushtetit
- D) Faza e shpërbërjes së metamorfozës së pushtetit

Pyetja 29

Kur një lider në një situatë të caktuar është personi bazë dhe kompetent i njohurive në atë fushë dhe aftësi të mjaftueshme, për të cilin mund të marrë një vendim të caktuar për grupin, që nuk kërkon aprovimin e epiorëve, ai mund të ushtrojë:

- A) Autoritetin e tij mbi marrjen e vendimit, pa mendimet e të tjerëve, përse kohë vendimi nuk është cilësor dhe nuk cënon mbarëvajtjen e punës tek grupi
- B) Autoritetin e tij mbi marrjen e vendimit, pa mendimet e të tjerëve, përse kohë vendimi është cilësor dhe cënon mbarëvajtjen e punës tek grupi
- C) Autoritetin e tij mbi marrjen e vendimit, bazuar në mendimet e të tjerëve, përse kohë vendimi nuk është cilësor dhe nuk cënon mbarëvajtjen e punës tek grupi
- D) Autoritetin e tij mbi marrjen e vendimit, me miratim të epiorit, përse kohë vendimi është cilësor dhe cënon mbarëvajtjen e punës tek grupi

6. Proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore në organizatë

Pyetja 1

Procesi i gjetjes dhe inkurajimit të aplikantëve të mundshëm për të aplikuar për një hapje pune ekzistuese ose të parashikuar quhet _____.

- A) përzgjedhje
- B) vendosje
- C) rekrutim
- D) performancë

Pyetja 2

Referimi nga një punonjës është:

- A) rekrutim i brendshëm
- B) rekrutim indirekt
- C) rekrutim nga palë të treta
- D) rekrutim nëpërmjet internetit

Pyetja 3

_____ është procesi gjatë të cilit rriten njohuritë apo aftësitë e një punonjësi për të bërë një punë.

- A) trajnim
- B) zhvillim
- C) motivim
- D) drejtim

Pyetja 4

_____ është një makineri ose situatë që replikon kërkesat e punës në vendin e punës.

- A) rrahja e mendimeve
- B) simulimi
- C) inteligjenca artificiale
- D) analiza transversale

Pyetja 5

Për të përcaktuar vlerën e një vendi pune zhvillohet procesi.....

- A) dizenjimi i punës
- B) analiza e punës
- C) vlerësimi i punës
- D) ndryshimi i punë

Pyetja 6

Procesi i studimit dhe mbledhjes së informacionit për një vend të caktuar pune quhet:

- A) menaxhimi i burimeve njerëzore
- B) dizenjimi i punës
- C) analiza e punës
- D) vlerësimi i punës

Pyetja 7

Cila nga alternativat e mëposhtmet mund të përdoret si shpërblim monetar?

- A) bonus shtesë për ditët e pushimit që nuk përdoren

- B) kontratë pa afat
- C) pjesëmarrje në vendimarrje
- D) vlerësime

Pyetja 8

Një ndër qasjet që po rritet shumë për të rekrutuar punonjës është:

- A) interneti
- B) rrjetet sociale
- C) gazetat
- D) televizioni

Pyetja 9

_____ është një kampion i zgjeruar i punës.

- A) test inteligjence
- B) qendër vlerësimi
- C) test personaliteti
- D) test interesash

Pyetja 10

Një person vjen për intervistë pune. Cilin nga faktorët e mëposhtëm duhet të marrë në konsideratë intervistuesi që të marrë një vendim për ta marrë në punë ose jo:

- A) mosha
- B) të ardhurat familjare të kandidatit
- C) përkatësia partiake
- D) përputhshmëria e aftësive të kandidatit

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtmet konsiderohet si metodë moderne e vlerësimit të performancës?

- A) raporte konfidenciale
- B) metoda e krahasimit
- C) metoda e qendrave të vlerësimit
- D) metoda e formularëve bosh

Pyetja 12

Për të marrë një informacion të detajuar për performancën mblidhen të dhënat nga kolegët, eprorët, vartësit si dhe vetëvlerësimi nga punonjësi. Kjo metodë njihet si:

- A) vlerësimi 360⁰
- B) sistemi i vlerësimit njerëzor
- C) vlerësimi i plotë
- D) sistemi vlerësimit objektiv

Pyetja 13

Kur personat janë shumë të përshtatshëm në vendin e punes me aftësitë e tij/saj, edhe performanca rritet. Si quhet ky proces?

- A) trajnim
- B) rekrutim
- C) vendosje
- D) performancë

Pyetja 14

Jeni duke shqyrtuar disa CV nga disa kandidatë potencialë. Për mungesën e cilës rubrikë do ta skualifikoni menjëherë një kandidat?

- A) kontaktit
- B) gjini
- C) referencë
- D) edukim

Pyetja 15

Cila nga sjelljet e mëposhtme është sjellje e përshtatshme në një interviste pune?

- A) Të vishesh si çdo ditë.
- B) Të vësh shumë makiazh dhe/ose parfum që të lësh një përshtypje sapo të hysh në intervistë.
- C) Të sjellësh një CV dhe letër motivimi me vete.
- D) Të miratosh gjatë gjithë kohës intervistuesin, se ai/ajo i di të gjitha)

Pyetja 16

Kur ofrojmë këshillim në karrierë, pjesë e të dhënave personale që duhen paraqitur është:

- A) të ardhurat mujore personale
- B) preferenca seksuale
- C) besimet për pasojat e veprimeve
- D) talent në një fushë të caktuar, p.sh.: muzikë

Pyetja 17

Një grup ka një projekt X. Anëtarët e grupit e kanë “frikë” drejtuesin e grupit se çdo koment negativ mbi punën e tyre, do të ndikojë drejtpërsëdrejti nivelin e bonusit që marrin në fund të vitit. Çfarë lloj fuqie ka drejtuesi i grupit?

- A) fuqi formale
- B) fuqi detyruese
- C) fuqi eksperti
- D) fuqi referuese

Pyetja 18

Genta është menaxhere projekti e cila i merr të gjitha vendimet vetë, pavarësisht komenteve apo kundërshtive që kanë anëtarët e tjerë të grupit. Ky është një shembull i cilit lloj drejtuesi?

- A) autokratike
- B) demokratike

- C) fantastike
- D) *laissez-faire*

Pyetja 19

Analiza e punës ndryshon nga përshkrimi i punës sepse:

- A) analiza dhe përshkrimi i punës nuk ndryshojnë nga njëra tjetra
- B) analiza e punës është procesi; përshkrimi i punës është rezultati
- C) përshkrimi i punës është procesi; analiza e punës është rezultati
- D) analiza e punës kërkon më pak kohë për tu zhvilluar

Pyetja 20

Të gjitha alternativat e mëposhtme janë aktivitete të departamentit të Burimeve Njerëzore, përveç njëres.

- A) përfshirja e punonjësve
- B) planifikimi i forcës së punës
- C) menaxhimi i inventarit
- D) rekrutimi dhe përzgjedhja

Pyetja 21

Planifikimi i burimeve njerëzore është i rëndësishëm sepse:

- A) kompanitë rriten çdo ditë dhe ka nevojë për punonjës
- B) punonjësit largohen vazhdimisht nga kompanitë për arsye nga më të ndryshmet
- C) kjo fushë është shumë e famshme këto dy dekadat e fundit
- D) në thelb, nuk është aq e rëndësishme, por duhet bërë

Pyetja 22

Vlerësimi i performancës përdoret në disa procese të burimeve njerëzore. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një nga këto përdorime:

- A) planifikimi i burimeve njerëzore
- B) përmirësimi i performancës
- C) identifikimi i punonjësve me potencial
- D) disiplinimi i punonjësve

Pyetja 23

Jeni duke intervistuar një kandidat duket se ka potencial por nuk i plotëson të gjitha kushtet që duhen për t'u punësuar. Cila është një nga opsionet që mund t'i ofroni?

- A) ndërprerja e intervistës
- B) trajnim
- C) përshkrim pune
- D) punësim i menjëhershëm

Pyetja 24

Bazuar një teori të Hofstede një nga dimensionet që ai ka marrë në konsideratë për kulturat është:

- A) maskuliniteti
- B) kultura e organizatës
- C) autoritare
- D) ankthi

Pyetja 25

Cila nga të mëposhtmet **Nuk** është një nga problemet me të cilat përballet një punonjës që shkon të punojë në të njëjtën kompani, por në një shtet tjetër:

- A) gjuha
- B) shoku kulturor
- C) risia e kompanisë
- D) papërshtatshmëria

Pyetja 26

Cili është një informacion i dobishëm që kompania mund të mësojë nga niveli i largimit të punonjësve të saj?

- A) sa e duan kompaninë
- B) si ndjehen punonjësit në punë
- C) papërshtatshmëria e punonjësve
- D) niveli i pamjaftueshëm i rekrutimit

Pyetja 27

Leo është 48 vjeç; ka 9 vjet i punësuar pranë një banke dhe merret me kreditë. Ai ka performancë të mirë dhe i kryen detyrat e veta si duhet. Leo është i pakënaqur me punën e tij, dhe duke eksploruar ka marrë një ofertë pune pranë një kompanie që merret me promovimin e vlerave historike të Shqipërisë. Leo mendon që ky vend pune është puna e tij e ëndrrave, por heziton ta pranojë. Sipas jush cila prej alternativave të mëposhtmeve është fusha me të cilën duhet të punojë Leo me veten?

- A) marrëdhënia me kolegët
- B) vendimmarrja
- C) performanca
- D) familja

Pyetja 28

Jeni duke këshilluar për karrierën një të ri që sapo është larguar nga puna e tij e parë ku ishte punësuar prej 8 muajsh. Nga një i njohur ju mësoni rastësisht se atij i ra performanca sepse u nda me të dashurën. A do ta ndanit këtë informacion me punëdhënësin e tij potencial?

- A) Po, sepse tregon që unë kam aftësi shumë të mira për të gjetur informacione.
- B) Jo, se nuk është puna ime.
- C) Po, se tregon që ka një problem me marrëdhëniet personale dhe mund të influencojë edhe në punë.
- D) Jo, se është çështje personale e cila nuk ka pse përmendet në ambiente profesionale.

Pyetja 29

Andi është një programues shumë i shkathët që i jep zgjidhje edhe problemeve më të vështira në mënyrë shumë efikase. Të gjithë që kanë probleme shkojnë tek Andi që të marrin një zgjidhje. Pas 3 vjetësh në kompani, Andi ende vret mendjen përse ka aq shumë kolegë që shkojnë dhe e pyesin atë. Sipas modelit të Joharit në cilin rajon është Andi?

- A) i hapur
- B) i fshehur
- C) i verbër
- D) i panjohur

Pyetja 30

Cili është ndryshimi ndërmjet një CV dhe një letre motivimi?

- A) CV është më e përgjithshme, letra e motivimit është më specifike për pozicionin e punës.
- B) CV flet për edukimin; në letrën e motivimit edukimi nuk përmendet.
- C) Në CV jepen referencat; në letrën e motivimit nuk jepen.
- D) CV dhe letra e motivimit janë në thelb i njëjti dokument

Pyetja 31

Një punonjës paraqet letrën e parevokueshme të dorëheqjes. Për të kuptuar çfarë e ka shkaktuar largimin, duhet:

- A) t'i shtohet paga
- B) të bëhet një intervistë largimi
- C) të përcillet letra të drejtuesi i kompanisë që ai/ajo t'i mbushë mendjen të qëndrojë
- D) nëse do të largohet është zgjedhja e tij/saj

Pyetja 32

Kur sekretarja e saj u largua nga puna, Ambra punësoi një person të përkohshëm nga një agjenci punësimi, në vend që të punësonte një sekretare të re të përhershme. Ky është një shembull i:

- A) përdorimit të burimeve të jashtme (outsourcing)
- B) trajnimit në punë
- C) vlerësimit 360 gradë
- D) zëvendësimit sipas nevojave

7. Struktura dhe kultura organizacionale

Pyetja 1

Strukturat funksionale ndihmojnë të krijohet:

- A) puna në grup
- B) specializimi
- C) grupet në bazë projektesh
- D) punonjës me shumë aftësi

Pyetja 2

Çfarë është një organizatë virtuale?

- A) një organizatë që përdor informacionin dhe teknologjitë e komunikimit për të koordinuar aktivitetet pa kufij ndërmjet funksioneve të ndryshme
- B) një organizatë që përdor teknologjitë e internetit për t'i shitur prodhimet klientëve
- C) një organizatë që menaxhon zinxhirin e furnizimit duke përdorur teknologji dixhitale
- D) një organizatë që koordinon forcën punëtorë nëpërmjet videokonferencave

Pyetja 3

Çfarë është aleanca strategjike?

- A) çdo formë partneriteti ndërmjet dy kompanive
- B) marrëveshje formale ku dy ose me shumë kompani angazhohen të shkëmbejnë burimet për të prodhuar produkte ose ofruar shërbime
- C) marrëveshje formale për të ndarë fitimet nga një investim i përbashkët
- D) marrëveshje formale për të ndarë njohuri

Pyetja 4

Cila nga të mëposhtmet është një nga qëllimet e strukturës së kompanisë?

- A) të lënë punonjësit të veprojnë si ta mendojnë ata më të përshtatshme
- B) të formalizojë linjat e komunikimit
- C) të ketë autoritet sipas pëlqyeshmërisë së punonjësve
- D) të kufizojë të drejtat e punonjësve

Pyetja 5

Procesi nëpërmjet të cilit menaxherët përcaktojnë marrëdhënien ndërmjet punonjësve dhe kompanisë quhet:

- A) planifikim
- B) drejtim
- C) kontrollim
- D) organizim

Pyetja 6

Një menaxher shton numrin e detyrave që një punonjës duhet të bëjë në mënyrë që ta bëjë punën më tërheqëse për punonjësin. Kjo quhet:

- A) thjeshtim i punës
- B) pasurim i punës
- C) rritje e funksionalitetit të punës
- D) zgjerim i punës

Pyetja 7

Kur një menaxher ridizenjon punën e një punonjësi në mënyrë që punonjësi të ketë më shumë përgjegjësi, kjo quhet:

- A) thjeshtim i punës
- B) pasurim i punës

- C) rritje e funksionalitetit të punës
- D) zgjerim i punës

Pyetja 8

Niveli në të cilin një punë të lejon të përcaktosh dhe të vendosësh se si do t'i zhvillosh detyrat e punës, quhet:

- A) identitet i detyrës
- B) autonomi
- C) varietet
- D) angazhim

Pyetja 9

Si njihet marrëdhënia ndërmjet të gjitha departamenteve të kompanisë?

- A) struktura e vogël
- B) struktura e proceseve
- C) struktura funksionale
- D) struktura gjeografike

Pyetja 10

Cilat struktura organizative përfshijnë atë që njihet si “dy shefa”?

- A) strukturë produkti
- B) strukturë matriks
- C) strukturë tregu
- D) strukturë gjeografike

Pyetja 11

_____ organizative fokusohet në perceptimin e një individi për ngjarjet dhe sjelljet e pritura në një organizatë të caktuar.

- A) kultura
- B) klima
- C) të mësuarit
- D) përpjekje

Pyetja 12

Sipas Herzberg, cila nga alternativat e mëposhtme është faktor “mirëmbajtjeje”?

- A) paga
- B) puna në vetvete
- C) përgjegjësitë
- D) mirënjohja

Pyetja 13

_____ organizativ është procesi sistematik me anë të të cilit një organizatë sjell një punonjës të ri në kulturën e saj.

- A) socializimi

- B) zhvillimi
- C) sjellja
- D) struktura

Pyetja 14

Si mund të përshkruhet organizata që është demokratike dhe ka stile menaxhimi gjithëpërfshirëse?

- A) hierarkike
- B) burokratike
- C) e sheshtë
- D) funksionale

Pyetja 15

Cila është një nga avantazhet e strukturës hierarkike?

- A) zinxhiri i komandës është i paqartë
- B) i përgjigjet shumë shpejt ndryshimeve
- C) nivel i lartë kontrolli
- D) disiplina dhe stabiliteti

Pyetja 16

Një këshillues që punon me familjet e adoleshentëve që janë të varur nga droga ka _____ krahasuar me një punonjës që lan makinat në një lavazh.

- A) më pak autonomi
- B) më pak varietet në punë
- C) më shumë përgjegjësi
- D) më pak variacion

Pyetja 17

Një punonjës që prodhon abazhur duke gdhendur drurin ka _____ se sa një punonjës që punon në linjën e prodhimit në një fasoneri.

- A) identitet më të lartë të detyrës
- B) identitet më të ulët të detyrës
- C) më pak përgjegjësi
- D) më pak autonomi

Pyetja 18

Gjatë katër viteve të fundit në një organizatë ka pasur një problem të përhapur i cili i ka rezistuar ndërhyrjeve të mëparshme. Cila pjesë e organizatës duhet të ndryshohet?

- A) kultura
- B) stafi
- C) programi
- D) drejtuesit

Pyetja 19

Roza solli një ide inovatore që punëdhënësja e saj e miratoi dhe më vonë e përfshiu në literaturën e korporatës edhe pse vetë Roza u largua shumë shpejt nga kompania. Ky shembull, i cilit lloj të të mësuarit është?

- A) të mësuarit individual
- B) të mësuarit dypalësh
- C) të mësuarit nga punonjësi
- D) të mësuarit organizativ

Pyetja 20

_____ kulturore kërkon(jnë) kohë, dhe nëse drejtuesit nuk janë të përgatitur për një fushatë të qëndrueshme, atëherë fokusi do të humbasë dhe përpjekja do të pakësohet dhe do të vdesë.

- A) përforcimet
- B) përshtatja
- C) ndryshimet
- D) indoktrinimet

Pyetja 21

Nëse kultura organizative është e vlefshme dhe e rrallë, ajo mund të jetë një burim për _____.

- A) tensione të brendshme
- B) përshtatje të brendshme
- C) avantazh konkures
- D) dizavantazh konkures

Pyetja 22

Mënyra si menaxhohen krizat nga menaxherët dhe punonjësit jep informacion mbi nivelin _____ në organizatë.

- A) kulturor
- B) shoqëror
- C) mjedisor
- D) strukturor

Pyetja 23

Përputhja ndërmjet personalitetit të punonjësit dhe kulturës së organizatës çon në:

- A) paqartësi dhe kaos
- B) humbje të interesit për të punuar
- C) nivel i ulët morali dhe kënaqësi nga puna
- D) motivim dhe angazhim për të punuar

Pyetja 24

Studimet Hawthorne sollën risi në fazat e zhvillimit të sjelljes organizacionale. Cila nga fushat e mëposhtme janë të lidhura drejtpërdrejt më këto studime?

- A) lëvizja e marrëdhënieve njerëzore
- B) sjellja organizative

- C) menaxhimi shkencor
- D) revolucioni industrial

Pyetja 25

Për të krijuar një kulturë etike organizative, vlerësimet e performancës duhet të vlerësohen edhe nga _____ edhe në cilin nivel janë përmbushur.

- A) ekonomia
- B) mjedisi
- C) rëndësia
- D) mjetet

Pyetja 26

Një kulturë _____ thekson rritjen duke u bazuar tek pikat e forta të punonjësve dhe përforcon më shumë sesa ndëshkon, dhe thekson vitalitetin dhe rritjen.

- A) pozitive
- B) e centralizuar
- C) e formalizuar
- D) funksionale

Pyetja 27

Nëse ambienti i jashtëm i një organizate është i qëndrueshëm dhe paqartësia është e ulët atëherë nevojitet _____ koordinim ndërmjet punonjësve për të arritur burimet dhe menaxherët mund të sjellin _____ formalitet në strukturën organizative.

- A) më shumë; më pak
- B) më pak; më shumë
- C) më pak; më pak
- D) më shumë; më shumë

Pyetja 28

Kompania Pfizer organizoi laboratorët e prodhimit të vaksinave sipas rajoneve të ndryshme në botë ku këto vakcina do shpërndareshin. Ky është një shembull i:

- A) strukturë produkti
- B) strukturë matriks
- C) strukturë tregu
- D) strukturë gjeografike

Pyetja 29

Adi punon prej 5 vjetësh në një bankë dhe e ka shumë të qartë dhe e pranon se eprorët që janë më lart në hierarki fitojnë shumë më tepër para ndërsa punojnë shumë më pak orë se vartësit e tyre. Në çfarë lloj organizatë punon Adi?

- A) distancë e lartë fuqie
- B) distancë e ulët fuqie
- C) evitimi i pasigurisë së lartë
- D) evitimi i pasigurisë së ulët

Pyetja 30

Kur u pyetën se cili është qëllimi i organizatës së tyre, të gjithë punonjësit e një kompanie që merrej me modën u përgjigjën: "Për të ofruar rrobaqepësinë më të mirë të mundshme për të gjithë klientelën tonë të veshur mirë." Çfarë tregon ky shembull?

- A) kulturën e organizatës
- B) integrimin e brendshëm
- C) misionin e kompanisë
- D) vlerat në organizatë

Pyetja 31

Punonjësit e Nike rrëfejnë historinë se si bashkëthemeluesi Bill Bowerman shkoi në punishten e tij dhe derdhi gomë në makinerinë ku gruaja e tij piqte waffles, që të krijonte një këpucë më të mirë vrapimi. Kjo histori nxjerr në pah kulturën e _____ të Nike.

- A) inovacionit
- B) socializimit
- C) diversitetit
- D) agresivitetit

Pyetja 32

Ema, Serena dhe Jana janë sekretare të departamenteve të ndryshme dhe secila raporton tek një kryetar departamenti të ndryshëm. Ata planifikojnë pushimin e tyre të mëngjesit në të njëjtën kohë në mënyrë që të mund të bisedojnë për jetën e tyre personale. Ky është një shembull i cilit lloj grupi?

- A) grup formal
- B) grupi i miqësisë
- C) grup virtual
- D) grupi interesi

IV PSIKOLOGJI EDUKIMI/ SHKOLLORE

1. Rolet profesionale të psikologut shkollor në marrëdhëniet me mësuesit, prindërit, nxënësit dhe agjencitë komunitare

Pyetja 1

Një nga rolet e psikologut shkollor është:

- A) Konsultimi me prindërit për nevojat social-ekonomike të familjes;
- B) Konsultimi me drejtuesit e shkollës për nevojat social-ekonomike të nxënësve;
- C) Konsultimi me nxënësit për nevojat e tyre;
- D) Konsultimi me mësuesit për formulimin e planit edukativ të individualizuar.

Pyetja 2

Identifikimi i rastit më së shumti ndodh nga:

- A) Mësuesit/edukatorët;
- B) Psikologët;
- C) Stafi drejtues i shkollës;
- D) Prindërit

Pyetja 3

Një ndër rolet e psikologut shkollor është:

- A) Konsultimi me stafin drejtues;
- B) Vlerëson problemet social-ekonomike të nxënësve;
- C) vlerësimi në shtëpi;
- D) Konsultimi me nxënësit për nevojat e tyre ekonomike.

Pyetja 4

Kur mësuesit informojnë stafin drejtues të shkollës për sjellje me rrezikshmëri të lartë për nxënësit, stafi drejtues vepron duke:

- A) Informuar prindërit;
- B) Thirrur nxënësit në drejtori;
- C) Informuar dhe konsultuar psikologun për situatën;
- D) Udhëzuar mësuesit si të menaxhojnë situatën

Pyetja 5

Roli i psikologut në rastin kur identifikon abuzim të fëmijëve apo adoleshentëve nga familjarët është:

- A) Të raportojë rastin te stafi drejtues i shkollës;
- B) Të referojë rastin te prindërit;
- C) Të raportojë rastin te njësia përkatëse e mbrojtjes së fëmijës;
- D) Të raportojë rastin te punonjësi social

Pyetja 6

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk lidhet me rolin e psikologut shkollor:

- A) Psikologu shkollor bën vlerësime në shtëpi për familjet;
- B) Psikologu shkollor ofron këshillim për fëmijët dhe të rinjtë;
- C) Psikologu shkollor ofron konsultim për prindërit, mësuesit dhe stafin drejtues;
- D) Psikologu shkollor planifikon dhe organizon shërbimin psikologjik në kopshte dhe shkolla

Pyetja 7

Rastet e fëmijëve që shfaqin rrezik të ulët:

- A) Raportohen menjëherë nga psikologu;
- B) Raportohen menjëherë nga mësuesi;
- C) Raportohen brenda 24 orëve nga punonjësi social;
- D) Raportohen brenda 24 orëve nga mësuesi ose ofruesit e shërbimit psikosocial në shkollë

Pyetja 8

Psikologu raporton për fëmijë që kanë nevojë për mbrotje:

- A) Duke shkruar një e-mail te strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës;
- B) Duke telefonuar shërbimin psiko-social pranë njësisë arsimore vendore;
- C) Duke bërë një shkrësë zyrtare pranë orgave të Policisë së Shtetit;
- D) Me çdo mjet komunikimi pranë njësisë vendore të mbrojtjes së fëmijës ose në organet policore.

Pyetja 9

Vlerësimin fillestar për nivelin e rrezikut të fëmijët dhe adoleshentët në shkollë e ndërmerr:

- A) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës;
- B) Mësuesit që identifikojnë rastin;
- C) Stafi drejtues i shkollës;
- D) Psikologu shkollor.

Pyetja 10

Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes së fëmijës realizohet nga:

- A) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës;
- B) Psikologu shkollor;
- C) Punonjësit e shërbimit psikosocial në shkolla;
- D) Shërbimi psikosocial në drejtorinë arsimore rajonale.

Pyetja 11

Personi përfaqësues i institucionit arsimor, që ka përgjegjësi të asistojë në raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrotje dhe që koordinon punën në shkollë në kuadër të menaxhimit të rastit është:

- A) Punonjësi social;
- B) Punonjësit e shërbimit psikosocial në shkollë;
- C) Punonjësi që përcaktohet nga drejtuesi i institucionit arsimor;
- D) Punonjësi që përcaktohet nga zyra e shërbimit psikosocial pranë drejtorive rajonale arsimore.

Pyetja 12

Në rastin kur një anëtar i stafit pedagogjik të shkollës kërkon prej psikologut një vlerësim të një nxënësi, cili është hapi i parë që duhet të ndërmarrë psikologu?

- A) Merr miratimin e informuar të prindërve;
- B) Bën një planifikim për këshillim dhe vlerësim në institucionet arsimore ku punon;
- C) Konsultohet me mësuesit përpara se të bëjë vlerësim dhe këshillim;
- D) Konsultohet me stafin drejtues të shkollës përpara vlerësimit apo këshillimit.

Pyetja 13

Cili është roli i psikologut, kur prindërit refuzojnë të pranojnë një vlerësim që ka bërë psikologu me fëmijën e tyre?

- A) Duhet të bindë prindërit që vlerësimi është i duhur;
- B) Orienton prindërit te një psikolog tjetër për një vlerësim të dytë;
- C) Konsultohet me mësuesin për situatën;
- D) Referon prindërit te një agjensi komunitare.

Pyetja 14

Psikologët shkollorë në institucionet e arsimit të mesëm të lartë, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, sa nxënës pritet të kenë mesatarisht nën mbikëqyrje:

- A) 500-800;
- B) 700-1000;
- C) 1200-1500;
- D) 1800-2300

Pyetja 15

Një psikolog shkollor, gjatë mbledhjes dhe analizës së të dhënave për sjelljen e fëmijës apo adoleshentit, në rolin e tij si vlerësues i sjelljes merr parasysh:

- A) Intensitetin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e sjelljes;
- B) Intensitetin, cilësinë dhe shpeshtësinë e sjelljes;
- C) Cilësinë, shpeshtësinë dhe sasinë e sjelljes;
- D) Sasinë, kohëzgjatjen dhe intensitetin e sjelljes.

Pyetja 16

Psikologët shkollorë pasi japin një shërbim psikologjik për të rritur performancën e punës, rekomandohen:

- A) Të mos kontaktojnë më personat që kanë marrë shërbimin;
- B) Të marrin një vlerësim për shërbimin e dhënë te personat përkatës;
- C) Të kontaktojnë vazhdimisht me personat që kanë marrë shërbimin;
- D) Të marrin një vlerësim për shërbimin e dhënë nga stafi drejtues.

Pyetja 17

Stafi drejtues shpesh e kufizon rolin e psikologut shkollor duke e parë punën e tij:

- A) Të fokusuar te këshillimi i nxënësve, konsultimi i mësuesve dhe prindërve;

- B) Më shumë të fokusuar te hartimi dhe implementimi i planit edukativ të individualizuar;
- C) Të fokusuar te vlerësimi psikologjik për fëmijët dhe adoleshentët;
- D) Të fokusuar te vlerësimi psikologjik dhe puna me planin edukativ të individualizuar

Pyetja 18

Një psikologu shkollor që sapo ka filluar punë, i rekomandohet:

- A) Të formojë marrëdhënie profesionale me aktorët e shkollës duke informuar për rolet e tij.
- B) Të informojë prindërit dhe nxënësit për shërbimet psikologjike që ofron në shkollë;
- C) Të vendosë marrëdhënie pozitive me prindërit, nxënësit, mësuesit dhe stafin drejtues;
- D) Të informojë drejtuesit për shërbimet psikologjike që ofron në shkollë.

Pyetja 19

Cila nga alternativat e mëposhtme, rrit rrezikun që psikologu shkollor të familjarizohet me shkollën aq sa të pengohet në përgjegjësitë profesionale?

- A) Psikologu ka njohuri të thella për kompetencat ligjore, kodet administrative dhe rregulloret;
- B) Psikologu formon marrëdhënie të afërta në shkollë me individë që kanë ngjashmëri me të;
- C) Psikologu merr parasysh praktika që respektojnë të drejtat e individëve pavarësisht sfondit kulturor;
- D) Psikologu merr parasysh praktika që respektojnë të drejtat e individëve pavarësisht moshës apo gjinisë.

Pyetja 20

Për psikologun shkollor, vëzhgimi i mësuesit është i rëndësishëm sepse:

- A) Mësuesit bëjnë krahasime ndërmjet nxënësit që shfaq vështirësi me nxënësit e tjerë;
- B) Mësuesit janë më objektivë se prindërit kur vlerësojnë sjelljet e nxënësve;
- C) Mësuesit rrinë më gjatë me nxënësit në shkollë se prindërit;
- D) Mësuesit marrin trajnime të vazhdueshme dhe kanë aftësi më të larta për vlerësimin e nxënësve.

Pyetja 21

Cili nga faktorët e mëposhtëm është më parësor që një psikolog shkollor të mbështesë suksesin në shkollë të nxënësve?

- A) Gjithëpërfshirja;
- B) Standartizimi i kurrikulës;
- C) Statusi socio-ekonomik;
- D) Përfshirja e familjes.

Pyetja 22

Një ndër mënyrat se si psikologu shkollor nxit bashkëpunimin ndërmjet prindërve, mësuesve, drejtuesve dhe komunitetit është me anë të:

- A) Konsultimit;
- B) Vlerësimit;
- C) Planifikimit;
- D) Ndërhyrjeve.

Pyetja 23

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është pjesë e vlerësimit psikologjik në shkollë:

- A) Vlerësimi i klimës në shkollë;
- B) Vlerësimi socio-emocional;
- C) Vlerësimi socio-ekonomik;
- D) Vlerësimi për edukim special.

Pyetja 24

Gjatë prezantimit të rezultateve të vlerësimit psikologjik, psikologu shkollor:

- A) Njofton prindërit të jenë të pranishëm;
- B) Njofton nxënësin të jetë i pranishëm;
- C) Njofton një përfaqësues të agjencive komunitare të jetë i pranishëm;
- D) Njofton stafin drejtues të jenë të pranishëm.

Pyetja 25

Një nga avantazhet e prezantimit të raportit psikologjik në ekipin multidisiplinar është që:

- A) Ulet rreziku për të marrë vendime të njëanshme;
- B) Prindërit kanë mundësi të konsultohen me të gjithë profesionistët;
- C) Prindërit kanë kohën e mjaftueshme për të shprehur qëndrimin e tyre për ndërhyrjen;
- D) Ulet rreziku për të marrë vendime të nxituara.

Pyetja 26

Psikologët shkollor bëjnë vlerësime të përgjithshme (universal screening) për nxënësit në shkolla. Cili është roli i këtyre vlerësimeve?

- A) Të masin të nxënësit tregues akademik, sjellor, social dhe emocional që për shkollën dhe komunitetin janë të rëndësishme për sukses;
- B) Të masin të nxënësit tregues për sjelljet antisociale që përbëjnë rrezikshmëri të lartë shoqërore;
- C) Të masin tregues që lidhen me kurrikulën, mësimdhënien apo mjedisin e të nxënësit që nxisin klimën në shkollë;
- D) Të masin tregues të suksesit akademik, sjellor, social dhe emocional të nxënësit me nevoja të veçanta në klasat gjithëpërfshirëse.

Pyetja 27

Një ndër rolet e psikologut shkollor është të referojë në agjensitë komunitare nxënësit që kanë nevojë për shërbime specifike të cilat këto agjensi i ofrojnë. Psikologu shkollor ka më shumë gjasa të referojë në agjensi komunitare cilin nga rastet e mëposhtme:

- A) Kur nxënësi shfaq motivim të ulët në të nxënë dhe rezultate të ulta;
- B) Kur nxënësi refuzon të shkojë në shkollë pasi nuk e pëlqen shkollën;
- C) Kur prindërit kërkojnë kurse shtesë për fëmijët në mënyrë që ato të bëjnë progres në shkollë;
- D) Kur e tërë familja ka nevojë për shërbime dhe mbështetje psikologjike.

Pyetja 28

Një psikolog gjatë vlerësimit të një nxënësi vëren se ai shfaq rrezik për vetëvrasje. Cili është hapi i mëtejshëm për të menaxhuar këtë rast?

- A) Referon rastin në një qendër të shëndetit mendor;
- B) Informon prindërit për gjendjen e nxënësit;
- C) Informon stafin drejtues të shkollës;
- D) Informon mësuesit dhe nxënësit për situatën

Pyetja 29

Në një shkollë do të ndërmerret një projekt pilot për vendosjen e një kurrikule të re te cikli fillor. Staf i drejtues i shkollës:

- A) Zbaton me përpikmëri planin për të vendosur kurrikulën sipas projektit;
- B) Implementon kurrikulën e re duke u konsultuar me mësuesit por jo psikologun;
- C) Informon nxënësit për ndryshimet në kurrikulë;
- D) Konsultohet me psikologun për implementimin e kurrikulës.

Pyetja 30

Një nxënës i rrëfen mësuesit se shoku i tij i bankës i tha se do të vriste veten duke i treguar dhe planin e tij. Mësuesi menjëherë informon psikologun për situatën. Psikologu mbasi interviston nxënësin, del në konkluzionin se ai shfaq rrezikshmëri të lartë për vetëvrasje. Cili është hapi tjetër i menjëhershëm që duhet të ndërmarrë psikologu?

- A) Psikologu duhet të informojë prindërit për situatën dhe të bëjë një vlerësim më specifik për gjendjen psikologjike të nxënësit;
- B) Psikologu duhet të informojë të paktën një anëtar të stafit drejtues që të vijë në klasë për të mbikëqyrur nxënësin;
- C) Psikologu duhet të referojë nxënësin tek agjensitë komunitare të shëndetit mendor që të trajtohet atje;
- D) Psikologu duhet të thërrasë punonjës social që të dy bashkë të supervizojnë nxënësin derisa të mbarojë mësimin.

Pyetja 31

Një nxënës në klasën e parë ka hasur vështirësi në shkrim dhe lexim. Në fund të vitit shkollor, prindërit e fëmijës këmbëngulin që ai të përsërisë sërish klasën e parë. Në rolin e psikologut shkollor, çfarë do të rekomandonit prindërve?

- A) Të përsërisë vitin shkollor dhe të inkurajohet në arritjet shkollore;
- B) Të vazhdojë shkollimin e tij në klasën e dytë duke e mbështetur vazhdimisht në arritjet shkollore;
- C) Të merret një vendim mbas një konsulte me stafin drejtues dhe mësuesit;
- D) Të merret një vendim mbas një konsulte me mësuesin dhe prindërit.

Pyetja 32

Psikologu shkollor i jep një prindi dhe mësuesit të njëjtin test për vlerësimin kognitiv të fëmijës. Kur merr përgjigjet, psikologu vëren se rezultatet janë shumë të ndryshme nga njëri-tjetri. Psikologu:

- A) Informon mësuesin dhe prindin që rezultatet janë të pavlefshme dhe jo të besueshme;

- B) Informon mësuesin dhe prindin të përsërisin testin pasi përgjigjet janë shumë të ndryshme;
- C) Përdor teste të tjera me fëmijën për të analizuar më mirë problemin e tij;
- D) Konsultohet me prindin dhe mësuesin për të krahasuar reagimet e fëmijës në shtëpi dhe në shkollë.

Pyetja 33

Një psikolog shkollor vëren se një mësuese vazhdimisht dërgon nxënësit e saj te psikologu për thyerje të rregulloreve në klasë. Në të tilla raste, rekomandohet që psikologu shkollor:

- A) Të referojë nxënësit në drejtorin e shkollës për të diskutuar problemin të gjithë së bashku;
- B) Të konsultohet me mësuesen për zbatimin e një programi për menaxhimin e sjelljeve të vështira në klasë;
- C) Të konsultohet me prindërit e fëmijëve për të zbatuar një program të menaxhimit të sjelljeve të vështira në shtëpi;
- D) Të referojë nxënësit në agjensitë komunitare që merren me problemet e devijancës dhe sjelljeve kundërshtësuese.

Pyetja 34

Një psikolog shkollor është shumë i ngarkuar me kërkesat për referime që merr nga mësuesit në shkollat ku punon. Drejtori i njëres prej shkollave informoi psikologun që mësuesja e matematikës ka identifikuar një nxënësi, që sipas saj është me sjellje shumë të mirë, por nuk shfaq progres në këtë lëndë. Cili është hapi i parë i psikologut për referim në këtë rast?

- A) Të informohen prindërit dhe t'i kërkohej më shumë informacion për sfondin jetësor të nxënësit;
- B) Të krijojë grupin për planin edukativ të individualizuar për të filluar vlerësimin e nxënësit;
- C) Të flasë me mësuesen që e ka referuar për të përcaktuar më qartë problemin;
- D) Të flasë me mësuesit e nxënësit për të parë nëse ka probleme të tilla në lëndë të tjera.

Pyetja 35

Drejtori i një shkolle është shumë i shqetësuar për rastet e bullizmit në shkollën e tij. Ai i kërkon psikologut të shkollës ta ndihmojë për të ulur rastet e bullizmit në shkollë. Një ndër hapat e parë që psikologu ndërmerr është:

- A) Trajnimi i të gjithë nxënësve të shkollës duke planifikuar takime të shpeshta;
- B) Trajnimi i disa nxënësve në klasat që janë më problematike;
- C) Trajnimi i prindërve që kanë fëmijë me sjellje agresive në shkollë;
- D) Trajnimi dhe edukimi i stafit mësimor të shkollës.

Pyetja 36

Drejtori i një shkolle informoi psikologun shkollor për rastin e një nxënësi të klasës së shtatë që ka ngacmuar një nxënësi të klasës së pestë. Në rolin e psikologut shkollor, cilën nga përjasjet e mëposhte do të zgjidhni si më efektive për të përdorur në këtë rast?

- A) Zbatimi i një programi për zgjidhjen e konfliktit duke bashkëpunuar me prindërit e të dy nxënësve;
- B) Këshillim me nxënësin bullizues për të menaxhuar zemërimin në mënyrë efektive;
- C) Këshillim me nxënësin bullizues por më parë do të kërkohej leje prindërore;

D) Këshillim në grup me nxënës të tjerë që shfaqin sjellje bullizuese.

Pyetja 37

Një mësues po has shumë vështirësi në procesin e mësimdhënies të klasës së tij. Nxënësit duket sikur nuk kanë interes dhe vëmendje gjatë orës. Cili është rekomandimi juaj për mësuesin?

- A) Të trajnojë nxënësit për të qënë aktiv në klasë;
- B) Të informojë drejtorin e shkollës për këtë problematikë;
- C) Të kërkojë një konsultë me psikologun shkollor për këtë problem;
- D) Të bëjë një mbledhje prindërisht për t'i informuar për situatën.

Pyetja 38

Një mësues i ri gjatë konsultës me psikologun shkollor po i tregon se nxënësit e tij kanë vështirësi në përvetësimin e koncepteve të reja. Cila nga këto udhëzime që i ka dhënë psikologu shkollor mësuesit nuk rekomandohet?

- A) Të japë detyra shtesë kur prezantohet një koncept i ri;
- B) Të korrigjojë detyrat duke dhënë komente specifike;
- C) Të prezantojë konceptet e reja duke marrë parasysh moshën e fëmijëve;
- D) Të prezantojë konceptin e ri mbasi është bërë një diskutim për njohuritë e mëparshme.

Pyetja 39

Pritshmëritë e një mësuesi të ri janë që të gjithë nxënësit duhet të përvetësojnë konceptin njëjloj. Sipas mësuesit, ato që nuk e përvetësojnë njohurinë nuk kanë interes për të dëgjuar mësimin dhe për shkollën. Ndërkohë, disa nxënës që shfaqin vështirësi të kuptojnë informacionin shprehen se kanë nevojë për më shumë shembuj dhe udhëzime praktike për të kuptuar njohurinë. Rekomandohet që mësuesi:

- A) Të pyesë për mësimin nxënësit që shfaqin interes më të ulët;
- B) Të konsultohet me psikologun për metoda të mësimdhënies me në fokus nxënësin;
- C) Të informojë prindërit që fëmijët e tyre kanë interes të ulët për shkollën;
- D) Të referojë nxënësit me interes të ulët tek psikologu shkollor.

Pyetja 40

Drejtori i shkollës ka marrë disa ankesa nga prindërit për mësuesen e fizikës. Ai thërret psikologun dhe mësuesen përkatëse për një konsultë. Mësuesja shprehet se nxënësit kanë shumë vështirësi në projektet e fizikës. Në rolin e psikologut shkollor, çfarë do t'i rekomandonit mësueses së fizikës?

- A) Të rishohë detyrat me projekte dhe të bëjë një analizë të shkallës së vështirësisë së tyre;
- B) Të vëzhgojë nxënësit gjatë projektit për t'i ndihmuar ato kur shfaqin vështirësi;
- C) Të bëjë analizën e notave mesatare të nxënësve në fizikë dhe të krahasojë notat me lëndët e tjera;
- D) Të bëjë një mbledhje me prindërit për t'u ballafaquar me ankesat e tyre.

Pyetja 41

Një psikolog shkollor lexon rregulloren e shkollës dhe vëren se rregullat disiplinore për nxënësit fokusohen te ndëshkimi se sa te disiplina pozitive. Me anën e një konsulte me stafin

drejtues dhe mësuesit, rregullorja ndryshon duke specifikuar rregullat, duke dhënë modele të qarta të sjelljeve që priten dhe pasojave të tyre. Çfarë lloj ndërhyrje përdori psikologu në këtë rast?

- A) Ndërhyrje strategjike;
- B) Ndërhyrje për disiplinë pozitive;
- C) Ndërhyrje universale;
- D) Ndërhyrje intensive.

Pyetja 42

Një psikolog shkollor në një anketim që përfshiu nxënës nga të gjitha klasat e shkollës së mesme ku ai punon, vuri re se pjesa më e madhe e tyre perceptojnë shkollën si një vend vetëm për nxënësit me rezultate të larta. Sipas tyre, nxënësit me rezultate të larta janë inteligjentë ndërsa nxënësit e tjerë nuk janë inteligjentë dhe mësuesit kanë pritshmëri të ulta për to e nuk i aktivizojnë në mësim. Ky perceptim lidhet me cilin faktor që rrezikon në këtë rast arritjet e nxënësve?

- A) Klimën e shkollës;
- B) Inteligjencën e nxënësve;
- C) Qëndrimin e mësuesve;
- D) Klimën e klasës.

Pyetja 43

Një psikolog konsultohet me stafin drejtues për të nxitur aktivitete ekstrakurrikulare për nxënësit e shkollës. Së bashku, ato kontaktojnë disa agjensi komunitare që mbështesin të tilla aktivitete. Ky bashkëpunim për të rritur aktivitetet ekstrakurrikulare dhe për të nxitur përfshirjen e nxënësve në të tilla aktivitete, pozitivisht ndikon:

- A) Në përfshirjen e familjarëve;
- B) Në marrëdhëniet e mësuesve me nxënësit;
- C) Në planin kurrikular;
- D) Në arritjet shkollore të nxënës.

Pyetja 44

Një psikolog shkollor mbas konsultës me prindërit e një nxënësi, nxjerr konkluzionin se një nga arsyet për sjelljen agresive të nxënësit është stili i prindërimit. Ai vërejti se prindërit shumë herë tregonin raste se si përforconin sjelljet agresive të fëmijës pa qenë në dijeni as vetë ata për të tilla pasoja. Psikologu shkollor në këtë rast:

- A) Planifikon seanca konsultimi dhe këshillimi me prindërit e fëmijës;
- B) Konsulton dhe referon prindërit në agjensi komunitare që ofrojnë trajnime prindërimi;
- C) Konsulton prindërit dhe zhvillon seanca këshillimi me nxënësin;
- D) Referon prindërit te një psikolog i licensuar për terapi dhe zhvillon seanca këshillimi me nxënësin.

Pyetja 45

Ndërhyrjet universale në shkollë që ofrohen nga psikologu shkollor në bashkëpunim me stafin e shkollës dhe në disa raste me agjensi komunitare, kanë si qëllim parësor:

- A) Të rrisin disiplinën pozitive;
- B) Të rrisin motivimin në të nxënë;
- C) Të ulin numrin e nxënësve që janë në rrezik për probleme në të nxënë dhe emocionale;
- D) Të ulin numrin e nxënësve që janë në rrezik për edukim special.

Pyetja 46

Një psikolog shkollor pasi mori rezultatet e një anketimi për bullizmin në shkollë, u shqetësua pasi rastet e bullizmit ishin rritur. Ai konsultohet me stafin drejtues dhe mësuesit për të hartuar një program kundër bullizmit për nxënësit e shkollës. Kjo ndërhyrje quhet:

- A) Ndërhyrje strategjike;
- B) Ndërhyrje universale;
- C) Ndërhyrje intensive;
- D) Ndërhyrje kundra dhunës.

Pyetja 47

Një mësuese u konsultua me psikologun shkollor për edukimin e nxënësve adoleshentë. Gjatë konsultës, psikologu dha ekspertizën e tij që mësuesi të hartojë objektiva mësimorë që janë në përputhje me zonën e zhvillimit të përafërt të adoleshentëve. Si quhet lloji i shërbimit që ofroi psikologu shkollor në këtë rast:

- A) Shërbim i drejtpërdrejt;
- B) Shërbim jo i drejtpërdrejt;
- C) Këshillim psikologjik;
- D) Trajnim psikologjik.

Pyetja 48

Një nxënës adoleshent vjen në zyrën e një psikologu duke qarë. Ai shprehet se ndjehet shumë keq pasi një ndër shokët e tij më të mirë humbi jetën në një aksident rrugor. Në këtë situatë, psikologu shkollor:

- A) Qetëson me fjalë nxënësin por nuk jep këshillim derisa sa të marrë aprovimin e prindërve;
- B) Këshillon nxënësin në situatën e krizës pavarësisht se nuk ka një aprovim nga prindërit;
- C) Referon rastin në agjensi komunitare dhe informon prindërit për aprovim;
- D) Njofton stafin drejtues, mësuesin kujdestar dhe prindërit për situatën e nxënësit.

Pyetja 49

Drejtori informon psikologun për rastin e një prindi, i cili është ankuar për mësuesin e gjeografisë pasi i ka vënë notë jo kaluese fëmijës së tij. Nxënësi ka bërë mungesa prej dy javësh pasi i është nënshtruar një operacioni, dhe në orën e gjeografisë ka bërë një provim pa lajmërim. Si do të vepronit në këtë rast?

- A) Psikologu i shpjegon drejtorit se kjo ka pasojë të thellë psikologjike te nxënësi;
- B) Psikologu kërkon një konsultë së bashku me prindërit, mësuesin dhe drejtorin;
- C) Psikologu kërkon në fillim një konsultë me mësuesin, më pas me prindërit dhe drejtorin;
- D) Psikologu kërkon një seancë këshillimi me nxënësin për të kuptuar më thellë situatën.

Pyetja 50

Disa mësuesë janë të shqetësuar sepse nxënësit me ngjyrë të bardhë largojnë nxënësit Romë, e nuk duan të qëndrojnë me to. Mësuesit shprehen se prindërit e nxënësve të bardhë zemërohen shumë me to kur fëmijët e tyre vendosen në një bankë me fëmijët Romë. Si do të vepronit ju për këtë problem në rast se do të ishit psikologu shkollor?

- A) Në bashkëpunim me stafin e shkollës dhe agjensi komunitare do të hartonit një program ndërhyrje kundra racizmit dhe diskriminimit;
- B) Në bashkëpunim me stafin e shkollës dhe prindërit do të hartonit një program ndërhyrje kundra racizmit dhe diskriminimit;
- C) Do të konsultoheshit me stafin drejtues për të marrë direktiva për planin e ndërhyrjes në këtë rast;
- D) Do të këshilloheshit me nxënësit dhe prindërit e klasave përkatëse për të ulur qëndrimet diskriminuese.

Pyetja 51

Një mësues kujdestar vëren se dy nxënës në klasën e tij kanë bërë shumë mungesa, aq sa rrezikohen për braktisje të shkollës. Nxënësit shprehen se ato e kanë të pamundur të vijnë pasi punojnë për prindërit e tyre. Mësuesi kujdestar vë në dijeni psikologun shkollor dhe stafin drejtues për këtë problem. Psikologu shkollor:

- A) Thërret prindërit në një konsultë për të zgjidhur problemin;
- B) Së bashku me stafin e shkollës dhe agjensi komunitare identifikojnë nevojat individuale të nxënësve dhe hartojnë planin e ndërhyrjes;
- C) Psikologu thërret prindërit dhe fëmijët në një këshillim në grup;
- D) Njoftohen prindërit dhe njësia e mbrojtjes së fëmijëve.

Pyetja 52

Një edukator vëren se një nga fëmijët e grupit parashkollorë ka filluar të urinojë gjatë gjumit të drekës. Gjithashtu, edukatori vëren disa shenja në krahun e fëmijës. Si duhet të veprojë edukatori në këtë rast?

- A) Të informojë stafin drejtues të kopshtit për të dhënë direktivat e duhura;
- B) Të informojë në çast psikologun e kopshtit për të bërë një vlerësim më të detajuar;
- C) Të pyes fëmijën se çfarë mund t'i ketë ndodhur e më pas të njoftojë stafin drejtues të kopshtit;
- D) Të informojë prindërit e fëmijës dhe të marrë më shumë informacion se çfarë mund të ketë ndodhur.

Pyetja 53

Prindërit e grupit parashkollor po ankohen te psikologu në kopshtin e tyre se i jepen shumë detyra fëmijëve. Ato shprehen se fëmijët nuk duan të bëjnë detyra me gërma dhe numra në shtëpi. Psikologu shkollor në këtë rast:

- A) Bën një vlerësim të detyrave që i jepen fëmijëve dhe konsulton edukatorët për sasinë e detyrave që i jepen fëmijëve në përputhje me stadin zhvillimor;
- B) Bën një vlerësim të detyrave që i jepen fëmijëve dhe konsulton edukatorët dhe stafin drejtues të kopshtit për sasinë e detyrave që i jepen fëmijëve në përputhje me stadin zhvillimor;

- C) Bën një vlerësim të detyrave dhe planifikon një ndërhyrje për stafin e kopshtit për aktivitete në përputhje me stadin zhvillimor të fëmijës;
- D) Planifikon ndërhyrje në formën e trajnimit prindëror për të zhvilluar prindërit aftësi që të mbështesin fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë.

Pyetja 54

Në një grup me fëmijë të moshave të përziera në kopsht, prindërit e fëmijëve më të vegjël janë ankuar disa herë se fëmijët më të rritur i gjuajnë fëmijëve të tyre. Psikologu në kopsht:

- A) Bën një mbledhje me prindërit dhe i shpjegon se të tilla situata ndodhin për arsye të numrit të lartë të fëmijëve në kopsht në krahasim me edukatorët që i mbikëqyrin;
- B) Së bashku me stafin drejtues dhe edukatorët e kopshtit bëjnë një plan ndërhyrje për të menaxhuar agresionin që ndodh midis fëmijëve;
- C) Thërret prindërit e fëmijëve me moshë më të madhe në grupin e përzier dhe i trajnon që fëmijët të ulin agresionin e tyre;
- D) Bën konsultime me edukatorët e kopshtit që të rrisin monitorimin për sjelljet e fëmijëve në grupet përkatëse.

Pyetja 55

Një psikolog shkollor është i shqetësuar pasi në një shkollë, në të cilën ai shkon 1 herë në javë, është informuar nga stafi drejtues se nxënësit flasin për drogën dhe se ka njerëz në komunitetin afër shkollës që shpërndajnë drogë. Duke u bazuar te roli i psikologut shkollor, si do të vepronit në këtë situatë që të ishte sa më rezultative?

- A) Do bashkëpunonit me prindërit, shkollën dhe agjensitë komunitare përkatëse për ndërhyrjen;
- B) Do të nisnit një fushatë kundra drogës në të gjithë shkollën duke bashkëpunuar me stafin drejtues;
- C) Do të hartonit një program kundra përdorimit të substancave narkotike për klasat më të rrezikuara;
- D) Do të trajnonit mësuesit se si të komunikojnë me nxënësit rreth substancave narkotike.

Pyetja 56

Një adoleshent u bullizua nga një adoleshent tjetër. Mësuesja kujdestare informoi drejtorin, i cili ndërhyri në këtë situatë. Mbas një muaji, mësuesja informon drejtorin se situata është përsëritur, dhe ai në këtë rast përjashton adoleshtin që ka bullizuar nga shkolla për një javë. Cili është rekomandimi juaj në këtë rast?

- A) Adoleshenti bullizues të vlerësohet për probleme social-emocionale;
- B) Drejtori të konsultohet me psikologun dhe të informohen prindërit përkatës;
- C) Adoleshenti i bullizuar të këshillohet me psikologun;
- D) Drejtori të konsultohet me psikologun që ai të zhvillojë një seancë këshillimi me të dy adoleshentët.

Pyetja 57

Një mësues ka identifikuar një fëmijë me rrezik të lartë në shkollë. Mësuesi:

- A) Pret ditën që psikologu do të jetë i pranishëm në shkollë dhe raporton tek ai;
- B) Raporton menjëherë te stafi drejtues dhe stafi pedagogjik i shkollës;

- C) Thërret prindërit e fëmijës në një mbledhje për të diskutuar për problemin;
- D) Raporton menjëherë pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijës apo organeve të Policisë së Shtetit.

Pyetja 58

Një mësues së bashku me një psikolog identifikojnë një fëmijë me rrezikshmëri të lartë por ato nuk po arrijnë të komunikojnë me punonjësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë administrative ku ndodhen. Si duhet të veprojnë në këtë rast?

- A) Të komunikojnë në çast me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për të raportuar rastin;
- B) Të presin deri në 24 orë dhe nëse nuk arrihet komunikimi, njoftohet policia;
- C) Të njoftohet stafi drejtues i shkollës për problemin;
- D) Të njoftohen koordinatorët e shërbimit psikosocial pranë njësisë arsimore vendore.

Pyetja 59

Një psikolog përdori një test inteligjence me një nxënës që është referuar për edukim special. Në testin e inteligjencës nxënësi mori 78 pikë. Mbas testit nxënësi kërkon të informohet për rezultatet. Si duhet të veprojnë psikologu në këtë rast?

- A) Psikologu i shpjegon nxënësit që do të marrë aprovimin e prindërve dhe më pas mund të diskutojnë për rezultatet e testit;
- B) Psikologu i lë një takim prindërve, mësuesit dhe nxënësit për të diskutuar për rezultatet;
- C) Psikologu i shpjegon nxënësit që ai nuk mund të japë rezultatet pasi janë konfidenciale;
- D) Psikologu i thotë nxënësit që rezultatet do të jepen në një moment të dytë, dhe informon stafin drejtues për situatën.

Pyetja 60

Prindërit e një nxënësi e kanë shumë të vështirë të pranojnë rezultatet e vlerësimit psikologjik që ka bërë psikologu shkollor. Ato kërkojnë të kenë manualin e testit, të njihen me procedurat që ka ndjekur psikologu dhe të marrin një kopje të vlerësimit. Si duhet të veprojnë psikologu në të tilla raste?

- A) T'i shpjegojë prindërve në një konsultë procedurat e vlerësimit dhe të interpretojë rezultatet por jo të japë një kopje të tij;
- B) T'i shpjegojë prindërve që vlerësimi ka ndodhur në grup dhe ai mund të shpjegojë vetëm detaje për vlerësimin e tij;
- C) T'i japë një kopje të vlerësimit prindërve dhe të shpjegojë procedurat e vlerësimit;
- D) T'i sugjerojë që të ribëjnë edhe njëherë vlerësimin për të parë nëse do të ndryshojnë apo jo rezultatet.

Pyetja 61

Një psikolog shkollor vendos të implementojë një program kundër bullizmit që fokusohet te pasoja të forta të sjelljes për të gjithë nxënësit që shfaqin bullizëm, duke u munduar të japë mesazhin se sjelljet bulliste nuk kanë asnjë tolerancë dhe ndëshkohen. Cili është qëndrimi juaj për këtë program?

- A) Ky program nuk është efikas pasi fokusohet te ndëshkimi i nxënësve që shfaqin sjelljet bulliste;
- B) Ky program është shumë efikas pasi zhvillon një klimë kundra bullizmit në shkollë duke ndëshkuar nxënësit bullist;
- C) Ky program është deri diku efikas por duhet të shoqërohet me programe të tjera kundër bullizmit;
- D) Psikologu duhet të implementojë programin duke bashkëpunuar me stafin mësimor që të ketë rezultat.

Pyetja 62

Një psikolog shkollor ka bërë një anketim te nxënësit e shkollës për mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve. Ai vëren se nxënësit kanë një kënaqësi të ulët për mësimin, përjetojnë shpesh ankth dhe frikë në orët mësimore. Psikologu vëren se një pjesë e lartë e nxënësve shfaqin demotivim. Si do të vepronit ju në këtë rast?

- A) Konsultë me stafin drejtues për të diskutuar dhe planifikuar ndërhyrjen për këtë problem;
- B) Konsultë me mësuesit për të zhvilluar strategji të mësimdhënies efikase;
- C) Trajnim me nxënësit për të zhvilluar motivim në të nxënë;
- D) Trajnim me prindërit për të zhvilluar aftësi prindërore që mbështesin nxënësit në shkollë.

Pyetja 63

Cili nga këto tipare të personalitetit është i rëndësishëm për psikologun shkollor përgjatë ushtrimit të funksioneve të tij si psikolog në shkollë?

- A) Të kesh ekspertizë dhe trajnime;
- B) Të jesh i respektueshëm nga stafi pedagogjik;
- C) Të jesh empatik dhe i besueshëm;
- D) Të kesh njohuri të larta profesionale.

Pyetja 64

Një mësuese e klasës së dytë është e shqetësuar për një vajzë e cila ka vështirësi të përqëndrohet, të mbarojë detyrat në klasë, dhe shpesh ngacmon shoqet e saj afër bankës. Ajo konsultohet me psikologun shkollor. Psikologu shkollor duke u bazuar te njohuritë kërkimore që lidhen me llojin e ndërhyrjes në të tilla raste vendos të planifikojë:

- A) Një takim me stafin drejtues, mësuesen dhe prindërit;
- B) Një takim me mësuesen dhe prindërit;
- C) Një takim me stafin drejtues dhe prindërit;
- D) Një takim me mësuesen, nxënësen dhe prindërit.

Pyetja 65

Një nxënës vjen në zyrën e një psikologu shkollor dhe i thotë se babai i shokut të bankës përdor drogë dhe se ai në disa raste e ka rrahur. Ai e informon psikologun se shoku i bankës i ka treguar çfarë ka ndodhur dhe ka frikë të kthehet në shtëpi. Si do të vepronit ju në rolin e psikologut shkollor në një situatë të tillë?

- A) Do të sugjeronit nxënësin të vijë bashkë me shokun e tij në zyrë;
- B) Do të informonit stafin drejtues për situatën dhe do të prisnit një reagim nga to;

- C) Do të intervistoni mësuesen për situatën duke marrë më shumë informacion;
- D) Do të raportoni rastin pranë njesisë vendore të mbrojtjes së fëmijës.

Pyetja 66

Një mësuese e përgjithshme konsultohet me një mësuese të edukimit special të shkollës për një nxënës, që shfaq çrregullim të ankthit të përgjithshëm. Pavarësisht se nxënësi shfaq aftësi të larta kognitive, notat e tij janë kaluese. Mësuesja e përgjithshme i kërkon mësueses së edukimit special që nxënësi të marrë edukim special. Cila është rruga që ndjek mësuesja e edukimit special në këtë rast?

- A) Fillon procedurat për edukim special për nxënësin;
- B) Informon prindërit dhe merr aprovimin e tyre për edukim special;
- C) Informon stafin drejtues dhe psikologun shkollor për situatën;
- D) Referon rastin te psikologu shkollor për të vlerësuar situatën.

Pyetja 67

Prindërit e një adoleshenti që vuan nga çrregullimi i depresionit, janë shumë të zemëruar pasi fëmija i tyre merr nota kaluese dhe nuk është marrë asnjë masë që të marrë shërbime të specializuara në edukim për të rritur mesataren. Ato kërcënojnë stafin e shkollës se do i hedhin në gjyq. Në rolin e psikologut shkollor, si do të vepronit në këtë rast?

- A) Do të konsultoheshit me prindërit duke gjetur mundësi që fëmija i tyre të marrë shërbime të specializuara;
- B) Do të konsultoheshit me stafin drejtues duke i shpjeguar se nxënësi nuk ka të drejtë ligjore për shërbime të specializuara;
- C) Do të referoni rastin në agjensi komunitare për të ofruar shërbime të specializuara në edukim;
- D) Do t'i shpjegoni prindërve se fëmija i tyre arrin objektivat kurrikulare e nuk ka nevojë për edukim special.

Pyetja 68

Psikologu njoftohet për situatën e një nxënësi i cili ka dalë në ballkonin e katit të dytë të shkollës dhe kërcënon se do të vrasë veten. Si do të vepronit në këtë situatë nëse do të ishit në vendin e psikologut?

- A) Do të ndërhynit në çast për të menaxhuar situatën e krizës duke mos e lënë vetëm nxënësin;
- B) Urgjentisht do të merrni aprovimin e prindërve dhe më pas do ndërhynit me këshillim;
- C) Do informoni në çast stafin drejtues që të menaxhonin këtë situatë;
- D) Do informoni prindërit që të vijnë, të flasin e të qetësojnë fëmijën e tyre.

2. Vlerësimi dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Pyetja 1

Problemet e shqiptimit të fjalëve që vijnë si pasojë e një kontrolli të ulët të muskujve të folurit lidhen me cilën vështirësi gjuhësore?

- A) Artikulimin;
- B) Fonologjinë;

- C) Semantikën;
- D) Pragmatikën.

Pyetja 2

Probleme me përdorimin e gjuhës në kontekstin social lidhen me cilën vështirësi gjuhësore?

- A) Sintaksën;
- B) Morfologjinë;
- C) Fonologjinë;
- D) Pragmatikën.

Pyetja 3

Mjedisi i hershëm gjuhësor i fëmijës:

- A) Nuk ndikon në zhvillimin gjuhësor pasi gjuha është e programuar gjenetikiisht;
- B) Ndikon në vështirësitë gjuhësore të fëmijës kur ky mjedis nuk ofron mjaftueshëm përvoja gjuhësore;
- C) Është më i rëndësishëm në rastet kur fëmija ka ndërveprim me fëmijët e tjerë;
- D) Nuk është përcaktues për zhvillimin gjuhësor në vitet e mëvonshme.

Pyetja 4

Aftësitë që shfaq një fëmijë për të zbatuar rregullat shoqërore, për të ndërvepruar me të tjerët sipas normave shoqërore lidhen me:

- A) Aftësitë njohëse;
- B) Aftësitë gjuhësore
- C) Aftësitë sociale;
- D) Aftësitë emocionale.

Pyetja 5

Mutizmi selektiv që shfaqet tek disa fëmijë lidhet me vështirësi:

- A) Gjuhësore;
- B) Emocionale;
- C) Të artikulimit të fjalëve;
- D) Kognitive.

Pyetja 6

Fëmijët me çrregullim të spektrit të autizmit të lehtë shfaqin dëmtim në cilën nga këto fusha?

- A) Kognicion social;
- B) Kujdesi për veten;
- C) Inteligjencë;
- D) Arritje akademike.

Pyetja 7

Për diagnostikimin e fëmijëve me çrregullim të spektrit të autizmit kërkohet bashkëpunimi me:

- A) Psikologë klinikë dhe psikologë shkollor;
- B) Terapistë gjuhësor dhe psikiatër për fëmijë;

- C) Mësuesë të edukimit special dhe punonjës social;
- D) Ekipin multidisiplinar.

Pyetja 8

Ndërhyrjet e hershme me fëmijët me çrregullim të spektrit të autizmit fokusohen:

- A) Te ndërveprimet e fëmijëve me të tjerët;
- B) Tek ushtrimi i gjuhës me terapi individuale;
- C) Te menaxhimi i sjelljeve agresive;
- D) Te menaxhimi i ankthit që shfaqin fëmijët.

Pyetja 9

Nxënësit që shfaqin vështirësi specifike në të nxënë:

- A) Pengohen në arritje kurrikulare në një fushë të veçantë të saj;
- B) Pengohen në arritje kurrikulare në një apo disa fusha të kurrikulës;
- C) Shfaqin paaftësi në të nxënit global;
- D) Shfaqin inteligjencë nën mesatare.

Pyetja 10

Kërkimet në fushën e psikologjisë së edukimit nxjerrin si konkluzion se përvetësimi i shkrimit dhe leximit ndodh në mënyrë më efikase sipas cilit rend:

- A) Përvetësimi i gërmave, fonemave dhe më pas formimi i fjalëve;
- B) Përvetësimi i fjalëve si një e tërë;
- C) Përvetësimi i kuptimit të fjalëve dhe fjalive në tekst;
- D) Përvetësimi i kuptimit të paragrafeve të tekstit.

Pyetja 11

Aftësia për të procesuar tingujt e gjuhës së folur quhet:

- A) Artikulim;
- B) Fonologji;
- C) Procesim fonologjik;
- D) Procesim auditiv.

Pyetja 12

Vështirësitë që has fëmija në lexim dhe që e pengon të arrijë objektivat e kurrikulës së përgjithshme lidhen me:

- A) Disgrafinë;
- B) Disleksinë;
- C) Diskalkulinë;
- D) Dispraksinë.

Pyetja 13

Ndërhyrjet fonologjike që përdoren për nxënësit që shfaqin probleme gjatë leximit dhe shkrimit:

- A) Përmirësojnë saktësinë në lexim dhe shkrim, si dhe ndikojnë në funksionimin e trurit;

- B) Përmirësojnë saktësinë në lexim dhe shkrim por nuk ka të dhëna që ndikojnë në ndryshimin e funksionimit të trurit;
- C) Deri diku përmirësohen aftësitë në lexim dhe shkrim, veçanërisht aftësitë e deshifrimit fonologjik;
- D) Lidhen me shkallën e shfaqjes së problemit, ku nxënësit me vështirësi të thella kanë shumë më pak përmirësime.

Pyetja 14

Vështirësia për të zhvilluar aftësi matematikore lidhet me cilin çrregullim?

- A) Disgrafinë;
- B) Diskalkulinë;
- C) Dispraksinë;
- D) Disleksinë.

Pyetja 15

Sipas teorisë së Chomsky-t:

- A) Fëmijët e mësojnë gjuhën nga përvojat me të tjerët;
- B) Fëmijët që kanë një mjedis të varfër gjuhësor nuk e përvetësojnë gjuhën;
- C) Aftësitë në lexim janë aftësi të lindura;
- D) Fëmijët kanë një predispozitë gjenetike për të përvetësuar gjuhën.

Pyetja 16

Një nga sfidat kryesore të edukimit gjithëpërfshirës për nxënësit që nuk dëgjojnë është:

- A) Pjesëmarrje aktive në klasë;
- B) Përdorimi i mjeteve të komunikimit;
- C) Përshtatja me bashkëmoshatarët;
- D) Përshtatja me mjedisin e shkollës.

Pyetja 17

Kur një nxënës shfaq vështirësi ndaj udhëzimeve, pyet shpesh për të njëjtën detyrë në klasë, sheh të tjerët dhe ndjek veprimet e tyre, nuk e lokalizon folësin apo burimin e zhurmës, fikson sytë të lëvizjet e gojës së folësit, bërtet pa kuptuar që po ngre zërin, ky nxënës shfaq:

- A) Probleme me kujtesën;
- B) Probleme me vëmendjen;
- C) Probleme me hiperaktivitetin;
- D) Probleme me dëgjimin.

Pyetja 18

Kur një nxënës shfaq fërkim të shpeshtë të syve, lëvizje të pakontrolluara të syve, kopjimin e materialit nga shoku i bankës por jo nga dërrasa, shkruan me papastërti dhe nuk ndjek vijëzimet e fletores, ky nxënës shfaq:

- A) Dispraksi;
- B) Disgrafi;
- C) Probleme me shikimin;

D) Probleme emocionale.

Pyetja 19

Për fëmijët dhe nxënësit me dëmtime në shikim, shkollat gjithëpërfshirëse kanë prioritet kryesor:

- A) Të ofrojnë edukim special në çdo fushë të kurrikulës;
- B) Të kenë mjedise të sigurta dhe të ndriçuara sipas nevojave;
- C) Të kenë ndriçim të lartë në çdo ambient të shkollës;
- D) Të sigurojnë libra jashtë shkollorë në formatin Breil.

Pyetja 20

Fëmijët dhe nxënësit që kanë një koeficient të inteligjencës së përgjithshme më të ulët se mesatarja e popullatës shfaqin:

- A) Zhvillim të vonuar intelektual;
- B) Sindroma Down;
- C) Dëmtim intelektual;
- D) Inteligjencë të ulët.

Pyetja 21

Studimet afatgjata kanë nxjerrë konkluzionin se adoleshentët me Sindromen Down që kanë marrë ndërhyrje gjatë viteteve të shkollës:

- A) Shfaqin progres të ngadaltë në të gjitha dimensionet e zhvillimit;
- B) Pavarësisht ndërhyrjeve adoleshentët nuk shfaqin progres krahasuar me nxënësit që nuk kanë marrë ndërhyrje;
- C) Shfaqin progres të dukshëm në dimensionet e zhvillimit krahasuar me nxënësit që nuk kanë marrë ndërhyrje;
- D) Shfaqin më shumë arritje në shkrim dhe lexim por jo në matematikë.

Pyetja 22

Ndërhyrjet rezultative te fëmijët me zhvillim të vonuar marrin parasysh:

- A) Ofrimin e një game të gjerë shërbimesh në shkollë;
- B) Vlerësimin dhe krijimin e profilit të nxënësit sipas nevojave specifike të tij;
- C) Garantimin e ekipit multidisiplinar;
- D) Garantimin e edukimit special në klasa të veçanta.

Pyetja 23

Përsëritja e pakuptimtë e një fjale apo grupi fjalësh që janë shqiptuar më parë nga një folës tjetër quhet:

- A) I folur ekolalik;
- B) I folur holofrazik;
- C) I folur telegrafik;
- D) I folur imitues.

Pyetja 24

Fëmijët që nuk orientohen nga dëgjimi i emrit të tyre, që nuk mbajnë kontakt me sy, e që nuk shfaqin vëmendje të përbashkët me kujdestarët e tyre shfaqin tregues të cilit çrregullim?

- A) Të spektrit të autizmit;
- B) Të hiperaktivitetit;
- C) Të sjelljeve kundërshtuese;
- D) Të Sindromes Down.

Pyetja 25

Kur psikologu mat aftësinë e fëmijës për të përsëritur sekuenca rrokjesh të pakuptimta, psikologu po mat:

- A) Funksionet ekzekutive të fëmijës;
- B) Kapacitetin e kujtesës afatshkurtër;
- C) Kapacitetin e kujtesës së punës;
- D) Kapacitetin e kujtesës fonologjike.

Pyetja 26

Përdorimi i vëmendjes për të arritur qëllime pa u penguar nga shpërqëndrues të ndryshëm lidhet me cilën aftësi mendore?

- A) Funksionet ekzekutive;
- B) Inteligjencën;
- C) Inteligjencën emocionale;
- D) Kujtesën e punës.

Pyetja 27

Një nxënës shfaq aftësi të kuptimit të gjuhës por nuk shfaq aftësi të artikulimit të gjuhës. Nxënësi shfaq cilin çrregullim:

- A) Të afazisë;
- B) Të spektrit të autizmit;
- C) Të disgrafisë;
- D) Të disleksisë.

Pyetja 28

Kur një fëmijë kujton disa informacione njëkohësisht ndërkohë që po zgjidh një problem, apo është i angazhuar në një detyrë, cilën kujtesë po aktivizon?

- A) Kujtesën shqisore pamore;
- B) Kujtesën e punës;
- C) Kujtesën shqisore dëgjimore;
- D) Kujtesën procedurale.

Pyetja 29

Kur një nxënës është vazhdimisht duke lëvizur duart, këmbët, krahët, nuk qëndron ulur në bankë kur të tjerët janë duke bërë detyra, vepron me shpejtësi pa menduar, flet kur mësuesja apo nxënës të tjerë po flasin, atëherë nxënësi shfaq tregues të çrregullimit:

- A) Të spektrit të autizmit;
- B) Të vëmendjes me ose pa hiperaktivitet;
- C) Të ankthit;
- D) Të sjelljes.

Pyetja 30

Kur një fëmijë mërzhitet shpejt me një detyrë, shpërqëndrohet nga detyra, harron udhëzimet e detyrës, nxënësi shfaq cilën nga këto vështirësi?

- A) Gjendje depresive;
- B) Probleme të vëmendjes;
- C) Impulsivitet;
- D) Vetë-kontroll të ulët.

Pyetja 31

Kur një nxënës e ka të vështirë të qëndrojë ulur në një vend, e ka të vështirë të qëndrojë qetë dhe pa lëvizur duart, këmbët apo trupin, ai shfaq cilën nga këto vështirësi?

- A) Impulsivitet;
- B) Probleme të vëmendjes;
- C) Ankth të lartë;
- D) Hiperaktivitet.

Pyetja 32

Kur një nxënës ka vështirësi të presë në radhë, ka vështirësi të presë të mbarojë nxënësi tjetër për të folur, i përgjigjet pyetjeve shumë shpejt pa reflektuar për një përgjigje, nxënësi shfaq cilën vështirësi?

- A) Ankth të lartë;
- B) Probleme të vëmendjes;
- C) Impulsivitet;
- D) Hiperaktivitet.

Pyetja 33

Si quhet vlerësimi që bën psikologu shkollor për të krijuar një profil të përparësive dhe nevojave të fëmijës apo nxënësit që më pas shërbejnë për të planifikuar ndërhyrjen?

- A) Vlerësim psiko-edukativ;
- B) Vlerësim psikologjik;
- C) Vlerësim sjellor;
- D) Vlerësim diagnostik.

Pyetja 34

Kur nxënësit kanë arritje nën nivelin e pritshëm në të shumtën e lëndëve kurrikulare, ato shfaqin:

- A) Vështirësi specifike në të nxënë;

- B) Vështirësi të moderuara në të nxënë;
- C) Vështirësi të dukshme në të nxënë;
- D) Vështirësi të shumëfishta në të nxënë.

Pyetja 35

Nxënësit me dëmtime në shikim në cilin aspekt gjuhësor shfaqin më shumë vështirësi?

- A) Zhvillimin i semantikës;
- B) Zhvillimin e pragmatikës;
- C) Zhvillimin e sintaksës;
- D) Zhvillimit fonologjik.

Pyetja 36

Kur një nxënës shfaq vështirësi për të ruajtur kontaktin me sy me bashkëfolësin, kur ai flet dhe komunikimi i tij nuk ka një lidhje me atë se çfarë bashkëfolësi po pyet, nuk përdor intonacion, nxënësi shfaq probleme me cilin aspekt gjuhësor?

- A) Të pragmatikës;
- B) Të fonologjisë;
- C) Të leksikut;
- D) Të morfologjisë.

Pyetja 37

Për fëmijët që nuk dëgjojnë, komunikimi duke përdorur mjete pamore është kritik sepse:

- A) Fëmijët zhvillojnë njohuri për shkrimin;
- B) Fëmijët zhvillojnë aftësi kognitive dhe socio-emocionale;
- C) Fëmijët zhvillojnë aftësi për lexim;
- D) Fëmijët zhvillojnë njohuri matematikore.

Pyetja 38

Një mësuese konsultohet me psikologun shkollor për një detyrë që do t'i japë nxënësve. Nxënësit do të bëjnë një prezantim me poster në klasë, por një nga nxënësit është me dëmtim në shikim dhe mësuesja nuk e di nëse duhet të kërkojë apo jo detyrë me prezantim për nxënësin. Si do të udhëzonit mësuesen në këtë rast?

- A) Të flasë me nxënësin për mjetet apo akomodimet që nevojiten për të prezantuar detyrën;
- B) Të flasë me nxënësit e tjerë që të bëjnë prezantimin për shokun e tyre;
- C) Të japë një detyrë tjetër për nxënësin që ka dëmtime në shikim;
- D) Të flasë me prindërit e nxënësit që të përgatisin posterin për të.

Pyetja 39

Metakognicioni është një aftësi e rëndësishme për arritje akademike. Te fëmijët me zhvillim të vonuar kjo aftësi është e dëmtuar. Si zhvillohet metakognicioni te këto fëmijë me anën e ndërhyrjeve?

- A) Duke ndërgjegjësuar fëmijët për mënyrën se si ato mendojnë për veten e tyre;
- B) Duke ndërgjegjësuar fëmijët për strategjitë që përdoren për të nxënë informacionin e ri;
- C) Duke zhvilluar strategji efikase të të nxënësve për lexim, shkrim dhe matematikë;

D) Duke zhvilluar aftësi për të aktivizuar njohuri të mëparshme për informacionin e ri.

Pyetja 40

Një mësues i klasës së parë identifikoi një nxënës i cili kishte shumë vështirësi si në lexim, si në shkrim dhe matematikë. Mësuesi e referon rastin te psikologu shkollor. Psikologu shkollor bëri një test për inteligjencën dhe pikëzimi që doli ishte 65. Si do të interpretoni këto pikë?

- A) Nxënësi ka inteligjencë në përputhje me moshën e tij biologjike;
- B) Nxënësi ka një inteligjencë afër mesatares dhe ka nevojë për mbështetje;
- C) Nxënësi ka një çrregullim të të nxënës dhe ka nevojë për edukim special;
- D) Nxënësi ka një paaftësi intelektuale që kërkon edukim special.

Pyetja 41

Çfarë duhet të marrë në konsideratë psikologu shkollor kur përdor një instrument të standartizuar në një vend të huaj por jo në Shqipëri?

- A) Nëse instrumenti do të përdoret për fëmijët që shkojnë në kopsht, instrumenti nuk do të jetë i besueshëm sepse maturimi i aftësive nuk ndodh njëjloj në kontekste të ndryshme kulturore;
- B) Instrumenti nuk është i standartizuar në Shqipëri dhe ai nuk duhet të përdoret se është i pavlefshëm;
- C) Instrumentat e huazuar nuk janë të besueshëm të përdoren as tek fëmijët as tek nxënësit në shkolla;
- D) Instrumenti mund të mos ketë të reflektuara pohime që masin aftësi që vlerësohen në kulturën tonë se në kulturën ku është standartizuar instrumenti.

Pyetja 42

Matjet kurrikulare përdoren për të vlerësuar:

- A) Progresin në shkollë;
- B) Aftësitë profesionale të mësuesit;
- C) Progresin e nxënësve me nevoja të veçanta;
- D) Progresin e nxënësve në lëndët përkatëse.

Pyetja 43

Në cilin takim merret vendimi për të marrë nxënësi edukim special dhe për të modifikuar apo jo kurrikulën?

- A) Në takimin ku mësuesi apo prindi referon fëmijën te psikologu shkollor;
- B) Në takimin e parë kur grupi i punës për hartimin e planit edukativ të individualizuar takohet me prindërit;
- C) Në mbledhjen e stafit drejtues me mësuesit përkatës dhe psikologun;
- D) Në mbledhjen e stafit drejtues me mësuesit, përfaqësuesit e agjensive komunitare dhe psikologun.

Pyetja 44

Një mësues ka shprehur shqetësim për një nxënës që has vështirësi të mëdha në përvetësimin e njohurive të reja. Psikologu shkollor do të bëjë një vlerësim për shpejtësinë e procesimit të

informacionit, për të kuptuar sa kohë i duhet fëmijës për të kuptuar dhe për të reaguar ndaj informacionit të ri. Cili është një moment i përshtatshëm për të bërë një vlerësim të tillë?

- A) Vlerësimi bëhet në çdo moment të qëndrimit të fëmijës në shkollë;
- B) Vlerësimi bëhet mbasi psikologu ka vëzhguar fëmijën në disa orë mësimore;
- C) Vlerësimi bëhet në një ditë kur fëmija të ketë më pak orë mësimore;
- D) Vlerësimi bëhet gjatë orëve të para mësimore pasi koha e procesimit të informacionit është më e shpejt.

Pyetja 45

Çrregullimi i spektrit të autizmit është një çrregullim zhvillimor që lidhet me:

- A) Formimin e lidhjeve atashuese të pasigurta herët në jetë;
- B) Funksionimin jo tipik të disa zonave të trurit;
- C) Çrregullimin gjenetik të kromozomit X;
- D) Vaksnimin e fëmijëve të vegjël në një periudhë kritike të maturimit të trurit.

Pyetja 46

Testet mendore që përdorin aktivitete me blloqe te fëmijët vlerësojnë:

- A) Funksionimin e hemisferës së majtë;
- B) Funksionimin e hemisferës së djathtë;
- C) Funksionimin e korteksit cerebral;
- D) Funksionimin e lobit temporal.

Pyetja 47

Një mësues konsultohet me psikologun shkollor për të vendosur për llojin e akomodimit për provimin final për një nxënës me disgrafi në klasën e tij. Sipas psikologut shkollor, provimi për nxënësin me disgrafi:

- A) Do të jetë dyfishin e kohës në krahasim me nxënësit e tjerë;
- B) Mbas çdo 20 minutash do të ketë pushime 5 minutëshe;
- C) Fleta e provimit do të ketë hapësirë të bollshme midis pyetjeve;
- D) Provimi do të jetë me pyetje me alternativa.

Pyetja 48

Psikologët shkollor përpara se të bëjnë vlerësime formale dhe të standartizuara bazohen në vlerësime autentike për të vlerësuar sjelljen e nxënësve që mund të kenë nevojë për edukim special. Cili është dallimi midis këtyre vlerësimeve?

- A) Vlerësimet e standartizuara bazohen në analiza statistikore duke krahasuar nxënësin me një grup normativ;
- B) Vlerësimet autentike janë vlerësime të cilat nuk kanë kritere profesionale;
- C) Vlerësimet autentike kërkojnë më pak kohë;
- D) Vlerësimet e standartizuara kërkojnë më pak kohë.

Pyetja 49

Në cilin rast psikologu shkollor i sugjeron prindërve që të bëjnë një konsultë me mjekun përkatës për të marrë më shumë informacion nëse është e nevojshme trajtimi me medikamente për çrregullimin e vëmendjes me ose pa hiperaktivitet që shfaq fëmija i tyre?

- A) Psikologu shkollor në asnjë rast nuk rekomandon medikamente;
- B) Psikologu shkollor sugjeron konsultën nëse vlerësimi i tij nxjerrë se nxënësi shfaq probleme të dukshme të vëmendjes dhe hiperaktivitetit;
- C) Psikologu shkollor rekomandon prindërit të bëjnë konsultën me mjekun specialist në rastet kur stafi drejtues i jep leje psikologut për një rekomandim të tillë;
- D) Psikologu shkollor rekomandon konsultën në rastet kur fëmija përveç këtij çrregullimi shfaq dhe një çrregullim të dytë.

Pyetja 50

Mësuesja vëren se një nxënës në klasën e saj i përgjigjet me korrektësi pyetjes që ajo bën duke i fiksuar sytë në dërrasë. Kur i bën pyetje të tjera përreth njohurisë, nxënësi jep përgjigje të saktë, por ka vështirësi të mbaje kontaktin me sy, ul kokën, duket i shqetësuar, bashkon duart me njëra-tjetrën. Gjithashtu, ajo vëren se nxënësi nuk përfshihet në lojra me bashkëmoshatarët, por në kohën e pushimit ai shkruan në fletore informacione nga librat. Duke u bazuar në këto informacione, nxënësi mund të shfaqe:

- A) Çrregullim të spektrit të autizmit të lehtë;
- B) Çrregullim të vëmendjes me dhe pa hiperaktivitet;
- C) Sjellje antisociale;
- D) Çrregullim emocional.

Pyetja 51

Një psikolog shkollor po bën një vlerësim. Ai po pyet një nxënës të klasës së dytë të thotë një emër. Më pas psikologu e udhëzon fëmijën të thotë emrin pa njërën nga gërmat. Çfarë po vlerëson psikologu me këtë detyrë?

- A) Aftësitë auditive të nxënësit;
- B) Lidhjen midis gërmave dhe rrokjeve të fjalës;
- C) Kujtesën fonologjike;
- D) Ndërgjegjësimin fonologjik.

Pyetja 52

Një nxënës shfaq vështirësi të perceptojë simbolet pamore. Cila zonë e trurit mund të jetë dëmtuar?

- A) Lobi oksipital;
- B) Sistemi limbik;
- C) Lobi sensoromotorik;
- D) Lobi parietal.

Pyetja 53

Si rekomandohet që psikologët të bëjnë vlerësimin për të përcaktuar nëse një nxënës ka nevojë për edukim special apo jo?

- A) Të marrë informacione specifike nga mësuesi i përgjithshëm dhe mësuesi i edukimit special e më pas të vendos bazuar në këtë informacion;
- B) Të bëjë vlerësim formal dhe autentik përpara se të marrë një vendim;
- C) Të bëjë vlerësim dinamik të nxënësit në orët mësimore;
- D) Të bëjë të paktën dy vëzhgime të nxënësit në ambiente të ndryshme të shkollës.

Pyetja 54

Fëmijët që shfaqin çrregullimin e vëmendjes me ose pa hiperaktivitet, cilën nga këto depozita të kujtesës kanë më të dëmtuar?

- A) Kujtesën e punës fonologjike;
- B) Kujtesën e punës pamore-hapësinore;
- C) Kujtesën shqisore;
- D) Kujtesën semantike.

Pyetja 55

Një psikolog po bën një vlerësim për një nxënës që shfaq vështirësi në lexim. Ai i ka dhënë nxënësit një paragraf, ku nxënësit i kërkohet të përshkruajë se për çfarë flitet në të. Më pas, nxënësi do të shkruaj një paragraf të dytë që lidhet me mënyrën se si ka rrjedhur ngjarja duke u bazuar në atë që ka lexuar në paragrafin e parë. Çfarë aftësish po vlerëson psikologu?

- A) Aftësi të deshifrimit të informacionit;
- B) Aftësi të kodimit të informacionit;
- C) Aftësi të kuptimit të informacionit;
- D) Aftësi të hartimit dhe shkrimit.

Pyetja 56

Trajnimi i aftësive sociale përdoret gjerësisht si ndërhyrje për nxënësit që shfaqin çrregullim të spektrit të autizmit. Fokusi kryesor i kësaj ndërhyrje është:

- A) Mësimdhënie e drejtpërdrejtë për sjelljen e përshtatshme, demonstrim, imitim dhe praktikë;
- B) Përforsim pozitiv për sjelljen e përshtatshme dhe pasoja për sjelljen keqpërshtatëse;
- C) Zhvillimi i aftësive të kognicionit social dhe metakognitive në mënyrë që të kuptohen situatat sociale;
- D) Zhvillimi i aftësive për të kuptuar perspektivën e tjetrit, përforsim pozitiv dhe praktikë.

Pyetja 57

Kur bëhet një vlerësim nëse një nxënës ka nevojë për edukim special apo jo, cili është kriteri kryesor që përcakton nevojën për këtë lloj edukimi?

- A) Nxënësi diagnostikohet me një çrregullim psikologjik;
- B) Paaftësia që shfaq nxënësi pengon progresin në kurrikulën e përgjithshme;
- C) Paaftësia që shfaq nxënësi pengon zhvillimin e aftësive social-emocionale;
- D) Nxënësi shfaq një problem zhvillimor që kërkon ndërhyrje me anën e edukimit special.

Pyetja 58

Cila nga këto ndërhyrje është më rezultative për nxënësit që shfaqin çrregullime në të nxënë?

- A) Terapia kognitive-bihejviorale;

- B) Terapia e lojës;
- C) Ndërhyrje me anën e të nxënit bashkëpunues;
- D) Ndërhyrje me anën e të nxënit shumë shqisore.

Pyetja 59

Një psikolog shkollor përfundoi një test inteligjence me një nxënës i cili mund të kërkojë edukim special për arsye të paaftësisë intelektuale. Psikologu përveç testit të inteligjencës ndërmerr edhe një test tjetër që të masë:

- A) Sjelljet përshtatëse dhe keqpërshtatëse;
- B) Socializimin;
- C) Aftësitë në komunikim;
- D) Kompetencat emocionale të nxënësit.

Pyetja 60

Cilat janë hapat që ndiqen për vlerësimin funksional të sjelljes?

- A) Vëzhgimi i sjelljes së fëmijës, intervistimi i prindërve, formulimi i planit të ndërhyrjes;
- B) Intervistimi i prindërve, intervistimi i mësuesit, vëzhgimi i fëmijës dhe formulimi i planit të ndërhyrjes;
- C) Përcaktimi i problemit, vëzhgimi i sjelljes së fëmijës, përcaktimi i hipotezave, formulimi i planit të ndërhyrjes;
- D) Zhvillimi i hipotezës, vëzhgimi i fëmijës, intervistimi i mësuesit dhe prindërit, formulimi i planit.

Pyetja 61

Një mësues i edukimit special po punon me një nxënës të klasës së tretë që shfaq nivel të moderuar të çrregullimit të spektrit të autizmit. Mësuesi po i mëson fëmijës rutina ditore që janë të përshtatshme në shkollë dhe që kërkojnë disa periudha tranzitore. Mësuesi ka ndarë detyrat në hapa të vegjël duke renditur aftësitë që janë më të lehta për t'u arritur e deri tek ato më të vështira. Kjo ndërhyrje ndryshe quhet:

- A) Analiza e zbatuar e sjelljes;
- B) Analiza funksionale e sjelljes;
- C) Analiza e detyrave;
- D) Analiza e aftësive të nxënësit.

Pyetja 62

Mësuesi referon një nxënëse te psikologu shkollor për vështirësitë që shfaq në lexim. Psikologu ndërmerr një test të standartizuar që mat vështirësitë në arritje të nxënëses. Nga rezultatet e testit, del se nxënësja jo vetëm shfaq vështirësi në lexim por dhe në konceptet numerike. Duke u bazuar në gjetjet e reja, nxënësja cilin çrregullim tjetër të të nxënit shfaq?

- A) Disleksi;
- B) Paaftësi intelektuale;
- C) Çrregullim të të nxënit;
- D) Diskalkuli.

Pyetja 63

Psikologu po bën një vlerësim me një nxënës. Ai i tregon nxënësit foto me njerëz që janë duke ndërvepruar me njëri-tjetrin në ambiente të jashtme, në organizime festive. Psikologu e pyet nxënësin se si ndjehen personat në fotot përkatëse. Me anën e kësaj detyre çfarë po vlerëson psikologu?

- A) Teorinë e mendjes;
- B) Empatinë e nxënësit;
- C) Aftësitë sociale;
- D) Rregullimin emocional.

Pyetja 64

Mësuesi është i shqetësuar për një nxënës pasi gjatë të folurit ai bën shpesh gabime gramatikore. Cili aspekt gjuhësor mund të jetë i dëmtuar te nxënësi?

- A) Leksiku;
- B) Semantika;
- C) Sintaksa;
- D) Fonologjia.

Pyetja 65

Cila nga alternativat e mëposhtme jep shembullin e një akomodimi për një nxënës që has shumë vështirësi gjatë procesit të leximit?

- A) Nxënësi në vend që të shkruaj përgjigjen, zgjedh letrën që ka përgjigjen e saktë;
- B) Nxënësi bën një provim që është më afër nivelit të tij në lexim;
- C) Nxënësit i bëhet një provim me më pak ushtrime në lexim se sa nxënësit e tjerë;
- D) Nxënësi merr dyfishin e kohës për të lexuar pyetjet e testit.

Pyetja 66

Një mësuese e klasës së parë vëren se një nxënës shfaq vështirësi në artikullimin e fjalëve. Ai duket sikur i kupton fjalët, shfaq aftësi të kuptimit gjatë leximit të fjalëve por në shumë raste nuk i artikulon korrektësisht fjalët. Çfarë vështirësie shfaq nxënësi?

- A) Dispraksi;
- B) Çrregullim gjuhësor;
- C) Dispraksi gjuhësore;
- D) Çrregullim të koordinimit të muskujve.

Pyetja 67

Cili nga neurotransmetuesit e mëposhtëm lidhet me çrregullimin e vëmendjes me ose pa hiperaktivitet?

- A) Serotonina;
- B) Kortizoli;
- C) Gaba;
- D) Dopamina.

Pyetja 68

Një nxënës ka të dëmtuar disa zona të hemisferës së djathtë. Cilin nga problemet e mëposhtme ka më shumë gjasa të shfaq nxënësi?

- A) Dëmtim në procesimin e informacionit fonologjik;
- B) Dëmtim në kujtësën afatgjatë;
- C) Dëmtim në procesimin e informacionit të ri;
- D) Dëmtim në leximin e fjalëve.

Pyetja 69

Modelimi i sjelljes dhe vënia në role janë teknika që përdoren në ndërhyrje të ndryshme për nxënësit që shfaqin nevoja të veçanta në edukim. Këto teknika janë më të suksesshme për cilat nga këto vështirësi të fëmijëve?

- A) Në lexim dhe shkrim;
- B) Në aftësitë sociale;
- C) Në rregullimin e gjendjeve hiperaktive;
- D) Në gjendjet depresive.

Pyetja 70

Nxënësit me Sindromën Down hasin shumë vështirësi në përvetësimin e:

- A) Gramatikës;
- B) Leksikut;
- C) Komunikimit;
- D) Pragmatikës gjuhësor.

Pyetja 71

Një nxënës pëson një goditje në pjesën e pasme të kokës. Cilat mund të jenë vështirësitë e nxënësit dhe si mund të ndihmohet në vazhdimësi?

- A) Nxënësi mund të ketë dhimbje të shpeshta të kokës, psikologu duhet të lejojë nxënësin të shkojë në shtëpi e të qetësohet në raste të tilla;
- B) Nxënësi mund të shfaqe probleme me kujtesën afatshkurtër, psikologu duhet të lejojë pushime të shpeshta sipas nevojës;
- C) Nxënësi mund të shfaqe probleme me përqëndrimin, psikologu duhet të flas me prindërit për të nxitur rekuperimin e nxënësit në shtëpi;
- D) Nxënësi mund të shfaqe vështirësi pamore dhe ndjeshmëri të lartë ndaj dritës, psikologu duhet të lejojë pushime të shpeshta dhe mbajtjen e syzeve të diellit në shkollë.

Pyetja 72

Një nxënës në klasën e dytë has shumë vështirësi në shkrim. Shkrimi i tij është jashtë vizave të fletores, gërmat e mëdhaja dhe në disa raste fjalët janë shkruar gabim. Nxënësi shfaq vështirësi në të nxënë që kategorizohen te cili çrregullim?

- A) Disgrafi;
- B) Dispraksi;
- C) Diskalkuli;
- D) Disleksi.

Pyetja 73

Një mësuese e ciklit të ulët konsultohet me stafin drejtues të shkollës për një nxënës, i cili shfaq çrregullim të ankthit të përgjithshëm. Pavarësisht se nxënësi shfaq aftësi të larta kognitive, notat e tij janë kaluese. Mësuesja kërkon që nxënësi të marrë edukim special. Stafi drejtues thërret psikologun shkollor në një takim. Si do të vepronit në rast se do të ishit ju psikologu i kësaj shkolle?

- A) Do të rekomandonit mësuesen të mbaje shënime për ecurinë e fëmijës gjatë vitit shkollor dhe të bëhet një vlerësim për edukim special në fund të vitit;
- B) Do të rekomandonit mësuesen të vazhdojë ecurinë e mësimdhënies pasi nuk shfaqet një nevojë aktuale për edukim special;
- C) Do të informonit mësuesin e edukimit special për të marrë një gjykim nga to për situatën;
- D) Do të informonit prindërit e nxënësit dhe do t'i kërkonit atyre të marrin një vendim në lidhje me edukimin e fëmijës.

Pyetja 74

Cila është një ndër hapat e parë të ndërhyrjes me nxënësit që shfaqin çrregullim të vëmendjes me ose pa hiperaktivitet?

- A) Nxënësi të lejohet të dalë nga klasa nën mbikqyrjen e mësuesit në çdo moment;
- B) Të ulët nxënësi vetëm në fund të klasës, në një qoshe ku ka mundësi të qetësohet;
- C) Të rritet ndërgjegjësimi i nxënësit dhe informimi i tij për çrregullimin;
- D) Nxënësi përpara se të vijë në shkollë, të bëjë ushtrime fizike për të ulur hiperaktivitetin.

Pyetja 75

Një psikolog shkollor bëri një vlerësim kognitiv të një nxënës që mësuesi dhe prindi e kanë referuar. Nga rezultatet del se nxënësi shfaq pikëzime më të larta dhe brenda normës për aftësi të zgjidhjes së problemeve pamore, por në aftësitë për të kuptuar dhe arsyetuar për zgjidhjen e një problemi nxënësi ka marrë pikë më të ulta dhe nën mesataren e popullatës. Psikologu shkollor:

- A) Bën një vlerësim më specifik për të konfirmuar apo jo nëse fëmija ka nevojë për edukim special;
- B) Vlerësimi i marrë është i mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin që fëmija shfaq një paaftësi intelektuale;
- C) Vlerësimi i marrë është i mjaftueshëm për të nxjerrë konkluzionin që fëmija shfaq vështirësi në të nxënë;
- D) Konsultohet me familjarët dhe mësuesin referues për të marrë një vendim.

Pyetja 76

Një mësues ka dilema për zhvillimin mendor të një nxënësi në klasën e tij që është me dëmtim në dëgjim. Ai kërkon mbështetjen e psikologut shkollor për një vlerësim më specifik. Cili vlerësim mund të jetë më i përshtatshëm në këtë rast?

- A) Vlerësim i inteligjencës së përgjithshme;
- B) Vlerësim i inteligjencës verbale;
- C) Vlerësim i inteligjencës ndërpersonale;
- D) Vlerësim i inteligjencës jo verbale.

Pyetja 77

Një mësuese e edukimit special vazhdimisht i thotë nxënësit se nëse nuk arrin të bëjë detyrën e përcaktuar, nuk do të bëjë orën e muzikës që nxënësi e pëlqen shumë. Në disa raste mësuesi nuk e ka çuar fëmijën në orën e muzikës. Si psikolog shkollor si do të vepronit në këtë rast?

- A) Do të informoni prindërit për rastet kur fëmija nuk bën muzikë që ato të ofrojnë aktivitete të tilla në shtëpi;
- B) Do të konsultoni mësuesin se kjo metodë nuk është rezultative dhe se fëmija ka nevojë për përforsim dhe komente pozitive;
- C) Do të konsultoni mësuesin se ndërhyrja e tij nxit motivimin e jashtëm të fëmijës duke ulur dëshirën për të mësuar;
- D) Do të informoni stafin drejtues të shkollës dhe do të diskutoni se si kjo metodë kërcënon mirëqenien e nxënësit.

Pyetja 78

Një psikologu shkollor i kërkohet një vlerësim socio-emocional për një nxënëse në klasën e shtatë, për të vendosur nëse ka nevojë apo jo për edukim special. Cilën procedurë i rekomandoni psikologut të ndjek për vlerësimin përkatës?

- A) Vlerësim të sjelljes së nxënëses duke përdorur instrument të standartizuar;
- B) Vlerësim të sjelljes së nxënëses duke intervistuar prindërit dhe duke vëzhguar atë në situata loje;
- C) Vlerësim funksional i sjelljes dhe intervistim i nxënëses;
- D) Vlerësim i sjelljes së nxënëses me një instrument të standartizuar dhe vlerësim funksional.

Pyetja 79

Një nxënëse e klasës së dytë has vështirësi në fokusimin te detyra dhe mbarimin e saj. Ajo nuk shfaq probleme kundërshtuese të sjelljes. Psikologu shkollor pasi bën një vlerësim funksional të sjelljes, nxjerr konkluzionin që nxënësjka ka dëshirë të komunikojë me shoqet e bankës dhe i pëlqen të ketë shoqëri. Duke u bazuar te problemi i fëmijës dhe te të dhënat e marra nga vlerësimi funksional, si do të vepronit për të përcaktuar strategjinë e ndërhyrjes me këtë nxënëse?

- A) Hartimi i një plani edukativ të individualizuar për nxënësen;
- B) Modifikimi i mjedisit imediat që të përforsohet sjellja e fokusimit dhe përfundimit të detyrës;
- C) Modifikimi i mjedisit mbasi ndodh sjellja e padëshiruar duke e udhëzuar nxënësen për sjelljen korrekte;
- D) Zbatimi i një ndërhyrje që bazohet te modelimi i sjelljeve të përshtatshme.

Pyetja 80

Cila nga alternativat e mëposhtme ka më shumë rezultat në ndërhyrjet sjellore?

- A) Dhënia e ndihmës së bashku me përforsuesit pozitiv;
- B) Përdorimi i përforsuesve dhe i ndëshkimit;
- C) Përdorimi i udhëzimeve gjatë fazës fillestare të përvetësimit të aftësisë e më pas duke u hequr gradualisht;
- D) Modelimi i sjelljes së plotë dhe praktikimi i saj.

Pyetja 81

Një mësues referon një nxënës të klasës së tetë te psikologu shkollor për të vlerësuar nevojën për edukim special apo jo. Mësuesja shprehet se nxënësi has vështirësi të vëmendjes dhe hiperaktivitetit. Psikologu ndërmerr një test për inteligjencën dhe një test për sjelljen e nxënësit. Nga testet e standartizuara del se fëmija ka një nivel mbi mesatar të inteligjencës dhe një pikëzim për vështirësitë e vëmendjes dhe hiperaktivitetit pak më të lartë se vlerat normale. Si do të rekomandonit psikologun në këtë rast?

- A) Psikologu duhet të bëjë një vëzhgim të sjelljes së nxënësit gjatë rutinave ditore në shkollë;
- B) Psikologu duhet të bëjë një rishikim të vlerësimeve të mëparshme të nxënësit;
- C) Psikologu duhet të bëjë një rishikim të rezultateve akademike të nxënësit për çdo lëndë;
- D) Psikologu duhet të bëjë një intervistë me prindërit për të specifikuar problemin.

Pyetja 82

Një mësuese është e shqetësuar për klimën në klasën e saj. Ajo ka një nxënëse që shfaq çrregullime të të folurit. Artikulimi nuk është korrekt por në shumë raste i kuptueshëm. Nxënësja është duke marrë edukim special. Në të shumtën e rasteve kur nxënësja flet, fëmijët e tjerë fillojnë të qeshin e të tallen me të folurin e saj. Ajo konsultohet me psikologun se si të veprojë në këtë rast. Psikologu:

- A) Planifikon një ndërhyrje për të trajnuar nxënësit rreth vështirësive gjuhësore;
- B) Planifikon një mbledhje me prindërit e klasës, nxënësit dhe mësuesen në lidhje me sjelljet fyese të nxënësve;
- C) Konsulton mësuesen që të përdor pasoja të sjelljes për nxënësit që tallen;
- D) Planifikon të ndërmarrë këshillim individual me nxënësen që shfaq problemin gjuhësor.

Pyetja 83

Modifikimi i kurrikulës bën të mundur që nxënësit me nevoja të veçanta në edukim të bëjnë progres në përputhje me nevojat e tyre. Ky modifikim ndodh duke bashkëpunuar me stafin e shkollës. Por, cili nga profesionistët që punojnë me fëmijët ka përgjegjësi kryesore për modifikimin e kurrikulës?

- A) Mësuesi i përgjithshëm;
- B) Mësuesi i arsimit special;
- C) Psikologu shkollor;
- D) Stafi drejtues i shkollës.

Pyetja 84

Një fëmijë me çrregullim të spektrit të autizmit acarohet dhe irritohet shumë gjatë kohës së mbarimit të një aktiviteti dhe përgatitjes për të filluar aktivitetin tjetër. Çfarë modifikimi në klasë do të sugjeroni për nxënësin?

- A) Krijimin e një liste me aktivitete ditore me fotot përkatëse, që nxënësi të jetë i informuar për aktivitetin e rradhës dhe periudhat tranzitore;
- B) Krijimin e një vendi brenda klasës ku fëmija të qetësohet gjatë periudhave tranzitore në klasë;

- C) Krijimin e një rutine ditore të parashikueshme ku në periudhat tranzitore nxënësi të orientohet nga mësuesi i edukimit special për aktivitetin e ardhshëm;
- D) Në periudhat e ndryshimit të aktiviteteve në klasë, nxënësi do të udhëzohet nga bashkëmoshatarët e tij për aktivitetin e rradhës.

Pyetja 85

Për nxënësit që shfaqin zhvillim të vonuar, fokusi kryesor i edukimit të tyre është:

- A) Përvetësimi i aftësive sociale;
- B) Arritjet sipas kurrikulës së modifikuar;
- C) Përvetësimi i aftësive funksionale;
- D) Përvetësimi i aftësive në komunikim.

Pyetja 86

Një nxënës me zhvillim të vonuar në një aktivitet në klasë, ku ai bëri rolin e shitësit, arriti me sukses të kryente veprime të mbledhjes dhe të zbritjes. Kur mësuesja e edukimit special i jep ushtrime të ngjashme me mbledhje dhe zbritje, nxënësi gabon. Si i shpjegoni gabimet e nxënësit?

- A) Nxënësi ka nevojë për më shumë praktikë që të përvetësojë njohuritë;
- B) Nxënësi ka vështirësi në transferimin dhe përgjithësimin e njohurive;
- C) Nxënësi ka vështirësi me kujtesën e punës;
- D) Nxënësi ka vështirësi me procesimin numerik të informacionit.

Pyetja 87

Mësuesja e edukimit special liston një sërë aktivitete për një nxënës me zhvillim të vonuar që ai shfaq interes dhe që lidhen me aktivitete të jetës së përditshme të nxënësit si për shembull, shkrimi i një mesazhi në telefon për një person të afërt, leximi i një menuje në restorant, shkrimi i një kartoline dhe blerjen e ushqimeve. Duke u bazuar në objektivat mësimore për nxënësin, ajo planifikon mësimin e javës sipas këtyre aktiviteteve. Si e vlerësoni këtë përqsaje të të nxënësit që përdor mësuesja?

- A) Aktivitetet janë në përputhje me nevojat e veçanta të nxënësit por nuk janë të mjaftueshme pasi mungojnë aktivitete të kurrikulës së përgjithshme;
- B) Mësuesja shfaq një organizim të punës praktike me nxënësin por sipas objektivave të kurrikulës së përgjithshme;
- C) Mësuesja ka përzgjedhur aktivitete praktike për zhvillimin e aftësive në lexim, shkrim dhe matematikë të fëmijës;
- D) Mësuesja ka përzgjedhur aktivitete në përputhje me nevojat e fëmijës për të përvetësuar aftësi që kanë funksione në jetën e tyre të përditshme.

Pyetja 88

Një nxënës po përpiqet të mbarojë një hartim që i ka dhënë mësuesja në klasë. Ai në disa raste shgarravit fjalë që i shkruan gabim, në disa raste nuk e shkruan të qartë mendimin, dhe nga nxitimi shkrimi i del nga vijat e fletores. Nxënësi mbasi mbaron hartimin e dorëzon menjëherë

te mësuesja. Cila nga këto aftësi të funksioneve ekzekutive shfaqet në nivele më të ulta te nxënësi:

- A) Frenimi i sjelljes;
- B) Monitorimi i detyrës;
- C) Kalimi nga një aktivitet në një tjetër;
- D) Planfikimi i detyrës.

Pyetja 89

Një nxënës po merr edukim special për diskalkuli të lehtë. Mësuesja e edukimit special gjatë orës së matematikës, e ka vënë nxënësin në një klasë me nxënës me vështirësi të thella në matematikë. Mësuesja shprehet se nxënësi merr mësimdhënie të diferencuar sipas nevojave të tij për mësimin e matematikës. Cili është qëndrimi juaj për këtë rast?

- A) Nxënësi ka të drejtë të qëndrojë në ambiente sa më pak të kufizuara e në këtë rast kjo e drejtë i çenohet;
- B) Edukimi special është më efikas kur ndodh në klasa speciale;
- C) Mësuesja e edukimit special shfaq ndjeshmëri të lartë ndaj nevojave individuale të nxënësit për mësimin e matematikës;
- D) Duhet të informohet prindi, stafi drejtues dhe psikologu për të marrë një vendim gjithëpërfshirës për nxënësin.

Pyetja 90

Një prind kërkon që fëmija i tij, i cili vuan nga çrregullimi i i skizofrenisë, të marrë edukim special. Neuropediatri i fëmijës është dakord me prindin. Nxënësi merr ilaçe dhe trajtimi është i suksesshëm për të pasur nën kontroll simptomat. Nxënësi shfaq arritje në të gjitha lëndët dhe po bën progres. Si do të vepronit nëse do të ishit në vend të psikologut shkollor?

- A) Ofrimi i edukimit special nuk është i nevojshëm në këtë rast pasi nxënësi po bën progres kurrikular;
- B) Edhe pse edukimi special nuk është i nevojshëm, shkolla duhet të garantojë këtë shërbim kur kërkohet nga prindërit;
- C) Shkolla është e detyruar të ofrojë edukim special pasi nxënësi ka rekomandim nga neuropediatri;
- D) Nxënësit që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor duhet të marrin edukim special si formë parandalimi apo përkeqësimi i situatës së tyre në shkollë.

3. Vlerësimi i ecurisë mësimore dhe i sjelljes joadaptive të nxënësve

Pyetja 1

Hapi i parë i vlerësimit psikologjik në mjedisin shkollor përfshin:

- A) Identifikimin e problemit
- B) Identifikimin e nxënësit
- C) Identifikimin e patologjisë
- D) Identifikimin e klasës

Pyetja 2

Modeli problem – zgjidhës i vlerësimit psikologjik në shkollë njihet ndryshe edhe si:

- A)Modeli problem-zgjidhës IDEA
- B)Modeli problem-zgjidhës SFAA
- C)Modeli problem-zgjidhës SFCM
- D)Modeli problem-zgjidhës IDEAL

Pyetja 3

Të dhënat që duhet të grumbullohen për një proces të mirë të vlerësimit përfshijnë edhe:

- A)Të dhënat demografike të nxënësit
- B)Të dhënat e historikut të zhvillimit dhe familjare
- C)Të dhënat mbi performancën akademike të nxënësit
- D)Të dhënat mbi shijet dhe opinionet personale të nxënësit

Pyetja 4

Modeli konceptual i vlerësimit neuropsikologjik në shkollë lidhet me studimet e:

- A)Miller
- B)Gresham
- C)Skinner
- D)Flanagan

Pyetja 5

Modeli i Vlerësimit Neuropsikologjik në shkollë mbështetet në:

- A)Tre qëllime kryesore
- B)Katër qëllime kryesore
- C)Pesë qëllime kryesore
- D)Gjashtë qëllime kryesore

Pyetja 6

Modeli i integruar i vlerësimit kognitiv (Modeli konceptual neuropsikologjik shkollor i integruar, SNP-CHC) përbëhet nga:

- A)Tre klasifikime bazë
- B)Katër klasifikime bazë
- C)Pesë klasifikime bazë
- D)Gjashtë klasifikime bazë

Pyetja 7

Në vlerësimin e fëmijëve të moshës parashkollore, mjeti, i cili jep informacion të gjithanshëm për fëmijën, një tablo të punimeve të tij, dhe e përfshin fëmijën në procesin e vetëvlerësimit quhet:

- A)Dosja e fëmijës
- B)Dëshmi anektodike
- C)Buletini pjesmarrës
- D>Listëkontroll

Pyetja 8

Vlerësimi i aftësive mendore të nxënësit në ecurinë e tij shkollore përfshin edhe:

- A)Aftësitë kognitive
- B)Aftësitë sensoriale
- C)Aftësitë fizike
- D)Aftësitë psikosomatike

Pyetja 9

Një listë ku renditen hapat, aktivitetet, aftësitë, objektivat ose temat për të cilat do të vlerësohet fëmija quhet:

- A)Dëshmi anektodike
- B)Listëkontroll
- C)Buletini pjesmarrës
- D)Vrojtim i drejtpërdrejtë

Pyetja 10

Sipas teorisë së sjelljes vetë – dëmtuese (Self-injurious behavior SIB) të Carr zhvillimi i sjelljeve jo-adaptive të nxënësve është pasojë e:

- A)Përforcuesve pozitivë
- B)Ndëshkuesve pozitivë
- C)Ndikimit të mjedisit
- D)Ndikimit familjar

Pyetja 11

Testi i vlerësimit kognitiv i mbështetur në baterinë e testeve Luria-Nebraska është:

- A)NEPSY-II
- B)Weschler
- C)WAIS-II
- D)MMPI-II

Pyetja 12

Me akronomin ABA nënkuptohet edhe :

- A)Analiza funksionale e sjelljes
- B)Analiza e aplikuar e sjelljes
- C)Analiza e besimeve dhe sjelljeve
- D)Analiza e sjelljes së përvetësuar

Pyetja 13

Kontigjenca prej tre elementësh e ABA-s përfshin:

- A)Paraprijësin-Sjelljen-Pasojën
- B)Sjelljen-Analizën-Pasojën
- C)Sjelljen-Aplikimin-Pasojën
- D)Paraprijësin-Sjelljen-Përmbylljen

Pyetja 14

Vlerësimi i sjelljes keqpërshtatëse njihet edhe si:

- A) Sjellje Nxitëse
- B) Sjellje Shkatërruese
- C) Sjellje Agresive
- D) Sjellje Jo-adaptive

Pyetja 15

Në vlerësimin e sjelljes keqpërshtatëse përfshihet edhe vlerësimi i:

- A) Impulsivitetit
- B) Kompulsivitetit
- C) Agresivitetit
- D) Qendrimit

Pyetja 16

Në vlerësimin e sjelljes keqpërshtatëse të nxënësit në klasë duhet mbajtur në monitorim edhe:

- A) Niveli i përshtatshmërisë interpersonale
- B) Niveli i përshtatshmërisë intrapersonale
- C) Niveli i përshtatshmërisë me familjen
- D) Niveli i përshtatshmërisë me mjedisin rrethues

Pyetja 17

Në instrumentat formalë të vlerësimit të problemeve emocionale-sjellore të nxënësit nga psikologu në shkollë përfshihen edhe:

- A) Shkallët e vlerësimit
- B) Testet e vlerësimit
- C) Vëzhgimi
- D) Intervista

Pyetja 18

Në analizën e aplikuar të sjelljes fokusi i vlerësimit qëndron në:

- A) Marrëdhënien mes ngjarjeve traumatike dhe sjelljes
- B) Marrëdhënien mes aspekteve linguistike dhe sjelljes
- C) Marrëdhënien mes aspekteve konjitive dhe sjelljes
- D) Marrëdhënien mes ngjarjeve mjedisore dhe sjelljes

Pyetja 19

Qasja problem-zgjidhëse e vlerësimit psikologjik në shkollë përafrohet me qasjen filozofike të:

- A) Dialektikës funksionale
- B) Kontekstualizmit funksional
- C) Analizës funksionale
- D) Strukturalizmit funksional

Pyetja 20

Në qasjen problem-zgjidhëse të vlerësimit psikologjik në shkollë analiza shkencore shërben:

- A)Për parashikimin dhe ndikimin e sjelljes për të përmbushur objektivat
- B)Për parashikimin dhe planifikimin e ndërhyrjes
- C)Për parashikimin dhe analizën funksionale të sjelljes jo-adaptive të nxënësit
- D)Për parashikimin dhe profilaksinë e sjelljes deviante në shkollë

Pyetja 21

Qasja moderne problem-zgjidhëse e vlerësimit psikologjik në shkollë i atribuohet autorëve:

- A)Standford dhe Binet
- B)Reschly dhe Ysseldyke
- C)Bransford dhe Stein
- D)Cronbach dhe Spearman

Pyetja 22

Dy aspektet thelbësore të çdo procesi problem-zgjidhës përfshijnë:

- A)Organizimin dhe planifikimin
- B)Monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm
- C)Analizën dhe interpretimin
- D)Modifikimin e rezultateve në rast se ato nuk përputhen me objektivat

Pyetja 23

Në kryerjen e një analize të mirë funksionale të sjelljes përfshihet edhe:

- A)Vlerësimi indirekt
- B)Vlerësimi direkt
- C)Analiza funksionale
- D)Vlerësimi i përgjithshëm

Pyetja 24

Ndër lehtësuesit dhe frenuesit e Modelit të Integruar SNP-CHC (Modeli konceptual neropsikologjik shkollor i integruar, SNP-CHC) përfshihet edhe vlerësimi i:

- A)Kujtesës afat-shkurtër
- B)Kujtesës deklarative
- C)Kujtesës së punës
- D)Kujtesës mnemonike

Pyetja 25

Për të vlerësuar dhe trajtuar nxënësit me sjellje jo-adaptive dhe ADHD shërben:

- A)Programi për Fëmijët Sfidues
- B)Programi për Fëmijët me ADHD
- C)Programi për Fëmijët me sjellje keqpërshtatëse
- D)Programi për Prindërit e Fëmijëve Sfidues

Pyetja 26

Në qëllimin e vlerësimit të tipologjisë psikoedukative përfshihet edhe:

- A) Identifikimi i mangësive të programeve të mëparshme të ndërhyrjes
- B) Identifikimi i mangësive në zhvillimin edukativ të nxënësit
- C) Identifikimi i mangësive në procesin psikopedagogjik të përdorur
- D) Identifikimi i mangësive në zhvillimin psiko-social të nxënësit

Pyetja 27

Ndër tipologjitë e gabimeve që mund të kryhen gjatë Vlerësimit funksional të sjelljes përfshihet edhe:

- A) Gabimi i ekzagjerimit
- B) Gabimi i imagjinatës
- C) Gabimi i fantazisë
- D) Gabimi i mashtruesit

Pyetja 28

Gabimi sipas të cilit psikologu vlerëson sjelljen e tashme sipas problemeve të së shkuarës quhet:

- A) Gabimi i përgjithësimit
- B) Gabimi i përsëritjes të perceptimit
- C) Gabimi i perceptimit disociativ
- D) Gabimi i AFS

Pyetja 29

Për kryerjen e një Analize Funksionale të Sjelljes, mund të shfrytëzohen:

- A) Një metodë analize
- B) Dy metoda analize
- C) Tri metoda analize
- D) Katër metoda analize

Pyetja 30

Në elementët klasifikues të vlerësimit të integruar kognitiv SNP-CHC përfshihet edhe:

- A) Vlerësimi i funksioneve sensoromotore bazë
- B) Vlerësimi i funksioneve neurologjike bazë
- C) Vlerësimi i funksioneve linguistike bazë
- D) Vlerësimi i funksioneve neurale bazë

Pyetja 31

Modeli më i zakonshëm i shfaqjes së sjelljes së fëmijëve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes është modeli i:

- A) Sjelljes vetë-dëmtuese
- B) Sjelljes antisociale
- C) Sjelljes integrative
- D) Sjelljes vetë-shpërblyese

Pyetja 32

Në përdorimin e integruar të testit Weschler, psikologu vlerësues në shkollë mund të shfrytëzojë:

- A)5 nën-teste
- B)15 nën-teste
- C)25 nën-teste
- D)35 nën-teste

Pyetja 33

Nëse vlerësimi përdoret për të përcaktuar anët e forta dhe të dobëta dhe aspektet për mbështetje dhe zbulimin e nevojave speciale, në këtë rast reflektohet qëllimi i vlerësimit:

- A)Ekzaminues
- B)Mësimor
- C)Diagnostikues
- D)Për vlerësim programi/llogaridhënie

Pyetja 34

Nëse karakteristikat e të nxënit të një fëmijë, i cili depërton shpejt në marrëdhëniet shkak-pasojë; përpiqet të zbulojë marrëdhëniet duke bërë pyetje provokative; do të dijë gjithmonë sesi bëhen gjërat, atëherë ai fëmijë i përket grupit të nxënësve:

- A)Të talentuar
- B)Në vështirësi
- C)Të vështirësive në të nxënë
- D)Shumë të mirë në mësim

Pyetja 35

Nëse sjellja keqpërshtatëse është me karakteristika patologjike në afat më të shkurtër se 6-muaj ajo përbën:

- A)Sindromin e sjelljes keqpërshtatëse
- B)Sindromin e sjelljes antisociale
- C)Sindromin e sjelljes agresive
- D)Sindromin e sjelljes sfiduese

Pyetja 36

Lidhja e dobët e shkollës me familjen, e cila sjell vështirësi emocionale dhe të sjelljes tek fëmijët përfshihet në grupin e faktorëve:

- A)Të shkollës
- B)Të familjes
- C)Të vetë fëmijëve
- D)Të bashkëmoshatarëve

Pyetja 37

Në gamën e trajtesave të modelit problem-zgjidhës përfshihet edhe:

- A)Klasifikimi i sjelljes jo-adaptive

- B)Eksplorimi i impaktit të efikasitetit të një ndërhyrjeje të caktuar
- C)Klasifikimi i problemeve sjellore të nxënësit
- D)Eksplorimi i impaktit të efikasitetit të programit të parandalimit

Pyetja 38

Mbështetur në studimet e Glover dhe Vaughn, modeli më i përshtatshëm për vlerësime gjithëpërfshirëse është:

- A)Modeli i mbështetur në evidenca (EBP)
- B)Modeli i mbështetur në parandalim (PBM)
- C)Modeli i mbështetur në ndërhyrje (RTI)
- D)Modeli i mbështetur në profilaksi (PTI)

Pyetja 39

Në instrumentat e vlerësimit të ecurisë së nxënësit në sferat kryesore të të nxënës janë:

- A)Shkallët e Aftësive të Diferencuara (DAS)
- B)Testi i Aftësive Kognitive Woodcock-Johnson
- C)Instrumentat matës të mbështetur në kurrikul (CBM)
- D)Testi i Arritjeve në Edukim i Kaufman (KTEA)

Pyetja 40

Nëse nxënësi nuk ka dhënë përgjigje të vlerësueshme statistikiisht në vlerësim, atëherë mund të përdoret edhe :

- A)Plani i ndërhyrjes së targetuar
- B)Vlerësimi Psikoedukativ
- C)Vlerësimi Neuro-kognitiv
- D)Vlerësimi informal i kryer nga mësuesi

Pyetja 41

Modeli i Vlerësimit Neuropsikologjik në shkollë është ndikuar më së tepërmi nga teoria konjitive e të mësuarit të:

- A)Baddeley
- B)Hitch
- C)Kaplan
- D)Mirsky

Pyetja 42

Lehtësuesit që nxisin performancën edhe të funksioneve të tjera konjitive të nxënësit përfshijnë:

- A)Vëmendjen, përqëndrimin dhe kujtesën afat-mesme
- B)Vëmendjen, shpejtësinë e procesimit të informacionit dhe kujtesën e punës
- C)Vëmendjen, shpejtësinë e procesimit të informacionit dhe kujtesën mnemonike
- D)Vëmendjen, përqëndrimin dhe kujtesën semantike

Pyetja 43

Vlerësimi funksional sjellor direktiv në stadin e tij bazë përfshin edhe:

- A) Vëzhgimin dhe regjistrimin e sjelljes dhe të paraprijësve e pasojave të saj
- B) Vëzhgimin dhe regjistrimin e sjelljes disfunktionale
- C) Vëzhgimin dhe analizën e paraprijësve dhe pasojave të sjelljes
- D) Vëzhgimin dhe analizën e sjelljes disfunktionale

Pyetja 44

Testet e vlerësimit kognitiv të mbështetura në parimet neuropsikologjike të vlerësimit janë më të përshtatshme për fëmijët e moshave:

- A) 2-9 vjeç
- B) 3-10 vjeç
- C) 3-12 vjeç
- D) 4-11 vjeç

Pyetja 45

Modeli i integruar i testit Weschler në vlerësimin kognitiv në shkollë njihet edhe:

- A) Weschler-2
- B) WAIS-2
- C) WISC-2
- D) WISC-IV

Pyetja 46

Sjelljet e keqpërshtatura të nxënësit ndryshe nga sjelljet e tjera, kanë cilën nga këto karakteristika dalluese?

- A) Sjellja shfaqet kur përjetohet stres i lartë por nuk është dëmtuese;
- B) Nxënësi e sfidon dhe e kundërshton mësuesin;
- C) Sjellja nuk është e qëndrueshme në kohë;
- D) Sjellja është e vazhdueshme dhe pengon arritjet e nxënësit.

Pyetja 47

Nxënësit që shfaqin probleme të shëndetit mendor, marrin më shumë mbështetje në shkollë nga cilët profesionistë?

- A) Mësuesi i klasës së përgjithshme;
- B) Mësuesi i edukimit special;
- C) Stafi drejtues i shkollës;
- D) Psikologu shkollor.

Pyetja 48

Një nga metodat e vlerësimit që përdoret për nxënësit që shfaqin vështirësi emocionale është:

- A) Intervistimi;
- B) Këshillim individual;
- C) Vëzhgimi sistematik;

D) Konsultimi individual.

Pyetja 49

Një nga strategjitë e sjelljes që përdoret më shpesh me fëmijët që shfaqin çrregullime të sjelljes apo emocionale për të nxitur sjelljen pozitive është:

- A) Përforcimi;
- B) Ndëshkimi;
- C) Shuarja;
- D) Reflektimi.

Pyetja 50

Një strategji kognitive që përdoret në ndërhyrjet për fëmijët dhe nxënësit që shfaqin sjellje jo përshtatëse, në mënyrë që të ndryshojnë perceptimet e gabuara për veten e tyre është:

- A) Përmirësimi i vetvlerësimit;
- B) Përforcimi pozitiv dhe negativ;
- C) Përmirësimi i marrëdhënieve me të afërmit;
- D) Përmirësimi i klimës në klasë.

Pyetja 51

Fëmijët apo nxënësit që reagojnë me emocione të forta negative ndaj frustrimeve më të vogla që mund të përjetojnë, kanë rrezik të lartë për të shfaqur cilin nga këto çrregullime psikologjike të mëposhtme?

- A) Çrregullimin e ankthit të përgjithësuar;
- B) Çrregullimin e sjelljes kundërshtuese;
- C) Çrregullimin e vëmendjes me dhe pa hiperaktivitet;
- D) Çrregullimin bipolar.

Pyetja 52

Adoleshentët kanë shumë gjasa që të kenë provuar për herë të parë substancat narkotike:

- A) Në mjedis shoqëror;
- B) Në mjedis me persona më të mëdhenjë në moshë;
- C) Në mjediset familjare;
- D) Në festa që organizohen mbas shkollës.

Pyetja 53

Përjetimi subjektiv se marrja e substancës narkotike është e vetmja mënyrë për të funksionuar lidhet me:

- A) Varësinë fizike;
- B) Simptomat e tërheqjes fizike;
- C) Simptomat e tërheqjes psikologjike;
- D) Varësinë psikologjike.

Pyetja 54

Dëshira për të marrë sasi më të mëdha të substancave narkotike për të përjetuar të njëjtin efekt lidhet me:

- A) Varësinë fizike;
- B) Varësinë psikologjike;
- C) Tërheqjen;
- D) Tolerancën.

Pyetja 55

Mosha më kritike për krijimin e varësisë ndaj substancave narkotike është:

- A) Adoleshenca e hershme;
- B) Adoleshenca e mesme;
- C) Adoleshenca e vonë;
- D) Mosha e rinisë.

Pyetja 56

Prindërimi i paparashikueshëm, me monitorim të ulët, e ndëshkime të ashpra:

- A) Rrit rrezikun që adoleshentët të shfaqin sjellje riskuese;
- B) Rrit rrezikun për sjellje riskuese por jo aq sa ndikimi që kanë bashkëmoshatarët;
- C) Nuk ka ndikim në shfaqjen e sjelljeve riskuese pasi faktorët kryesor për të tilla sjellje janë gjenetike;
- D) Ul rrezikun për sjellje riskuese tek adoleshentët por rrit rrezikun për probleme të shëndetit mendor.

Pyetja 57

Nxënësit që prishin gjumin pasi luajnë lojra në kompjuter gjatë natës, nga cili problem i mëposhtëm rrezikohen?

- A) Çrregullim të vëmendjes me dhe pa hiperaktivitet;
- B) Vështirësi me kujtesën dhe të nxënimit;
- C) Çrregullim të sjelljes kundërshtuese;
- D) Aftësi të ulta sociale.

Pyetja 58

Një fëmijë ose një nxënës që shfaq një frikë intensive dhe të paarsyeshme se do të poshtërohet dhe do të turpërohet përpara bashkëmoshatarëve të tij shfaq:

- A) Turp;
- B) Fobi;
- C) Anxetë specifike;
- D) Fobi sociale.

Pyetja 59

Adoleshentët që shfaqin depresion janë më të rrezikuar:

- A) Të braktisin shkollën;
- B) Të shfaqin çrregullime të sjelljes;
- C) Të largohen nga shtëpia;

D) Të shfaqin çrregullim të spektrit të autizmit.

Pyetja 60

Kur një fëmijë apo nxënës shfaq për afërsisht për dy javë lodhje, ndjenjat të fuqishme faji, vështirësi në përqëndrim, në gjumë, prishje të oreksit, dhe ka mendime për të dëmtuar veten, nxënësi po shfaq:

- A) Ankth;
- B) Depresion;
- C) Distimi;
- D) Çrregullim bipolar.

Pyetja 61

Abuzimi prindëror dhe mungesa e dashurisë prindërore:

- A) Rrisin rrezikun për depresion te fëmijët;
- B) Nuk lidhen me depresionin e fëmijëve;
- C) Kanë pak ndikim në depresionin e fëmijëve duke qenë se faktorët gjenetik luajnë një rol parësor;
- D) Rrisin rrezikun për depresion por pasojat janë afatshkurtra.

Pyetja 62

Fëmijët apo nxënësit që vuajnë nga gjendjet depresive besojnë se nuk janë të aftë dhe kompetentë në shkollë, ato shfaqin një nënvlerësim shumë të ulët për veten e tyre. Cilin aspekt të zhvillimit personal pengon ky besim?

- A) Vetë-konceptin;
- B) Vetë-aktualizimin;
- C) Vetë-respektin;
- D) Vetë-imazhin.

Pyetja 63

Fëmijët apo nxënësit që formojnë ndërveprime me të tjerët duke respektuar normat e komunikimit dhe duke shmangur reagime të papranueshme, shfaqin:

- A) Aftësi sociale;
- B) Inteligjencë të lartë;
- C) Aftësi kognitive;
- D) Aftësi të pragmatikës gjuhësore.

Pyetja 64

Një mësuese është e shqetësuar pasi një nga nxënësit në klasë ka ulur rezultatet e tij, shpesh vjen në klasë me rroba të palara, ka rënë në peshë, sytë i ka të skuqur dhe të zmadhuar. Nxënësi ka mavijosje në trup, kollitet shpesh dhe rruftit hundët vazhdimisht. Sipas këtij përshkrimi, nxënësi shfaq:

- A) Varësi nga substancat narkotike;
- B) Një problem shëndetësor;
- C) Një problem psikologjik;

D) Përkujdesje të ulët ndaj vetes.

Pyetja 65

Në orën e vizatimit, një nga nxënësit me nevoja të veçanta, shgarraviti në fletën e shokut të bankës duke menduar se ishte e tij. Shoku i bankës reagoi duke i bërtitur, duke i grisur fletën, e duke i thënë mësueses se ishte fleta e tij. Reagimi i nxënësit tregon:

- A) Një reagim të drejtë pasi nxënësi me nevoja të veçanta duhet të merrte leje;
- B) Aftësi të ulët sociale dhe reagim jo të përshtatshëm për situatën;
- C) Irritim dhe fustrim të lartë nga ana e tij;
- D) Aftësi të ulëta të funksioneve ekzekutive pasi nuk orienton vëmendjen drejt punës së tij.

Pyetja 66

Nxënësit që shfaqin kompetenca të larta sociale:

- A) Shfaqin arritje më të larta në shkollë se nxënësit e tjerë;
- B) Nuk ka dallime midis arritjeve në shkollë dhe kompetencave sociale;
- C) Kanë arritje më të ulta se nxënësit me më pak kompetenca sociale;
- D) Njohin më shumë emocionet të tjerët se sa vetja e tyre.

Pyetja 67

Në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të motivuar drejt procesit mësimor dhe të ulin rrezikun për sjellje keqpërshtatëse, mësuesit me mbështetjen e psikologut shkollor, vendosin qëllime mësimore:

- A) Që rrisin performancën e nxënësve dhe ulin shqetësimet për notë;
- B) Që janë në përputhje me klimën pozitive në klasë;
- C) Që formojnë pritshmëri të larta të nxënësit për arritje;
- D) Që janë në përputhje me zonën e zhvillimit të përafërt të nxënësit.

Pyetja 68

Cili nga këto neurotransmetues nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në çrregullimin e depresionit?

- A) Acetilkolina;
- B) Dopamina;
- C) Serotonina;
- D) Norepinefrina.

Pyetja 69

Një prind është i shqetësuar për fëmijën e tij dhe i kërkon psikologut shkollor të bëjë një vlerësim për gjendjen emocionale të fëmijës. Prindi i thotë psikologut që fëmija është i tërhequr, i trishtuar, nuk del me shokët, ka shumë shqetësim dhe gjendje paniku për çdo gjë. Duke u bazuar te të dhënat e prindit, cili do të ishte fokusi i vlerësimit të psikologut shkollor?

- A) Vlerësim për gjendjen depressive;
- B) Vlerësim për sjelljet e fëmijës;
- C) Vlerësim për gjendjen e ankthit;
- D) Vlerësim për inteligjencën emocionale.

Pyetja 70

Një nga ndërhyrjet më rezultative për nxënësit me sjellje keqpërshtatëse është terapia kognitive-bihejviorale. Cili është qëllimi i kësaj terapie?

- A) Ndryshimi i mendimeve dhe sjelljeve të keqpërshtatura;
- B) Modifikimi i sjelljes së keqpërshtatur;
- C) Modifikimi i mendimeve të keqpërshtatura;
- D) Arritja e rezultateve duke bashkëpunuar me familjen e nxënësit dhe shkollën.

Pyetja 71

Një mësues i klasës së parë është shumë i shqetësuar për një nxënës që nuk flet në mësim, duke e penguar nxënësin të përgjigjet gjatë orës së mësimit kur mësuesja e pyet. Pavarësisht se nxënësi i bën detyrat, ai pengohet pjesërisht në arritjet akademike. Prindërit shprehen se fëmija është shumë i ndrojtur në ambiente të panjohura për të. Si mendoni, cila është ndërhyrja më efikase në këtë rast?

- A) Implementimi i një plani të individualizuar edukativ për fëmijën;
- B) Terapia e sjelljes duke formësuar sjellje të fëmijës që nxisin komunikimin në mjedise të panjohura;
- C) Terapi kognitive-bihejviorale duke përdorur modelim të sjelljeve të përshtatshme;
- D) Terapia e lojës duke përdorur lojra që ulin ankthin.

Pyetja 72

Vlerësimi psikoanalitik që bazohet te testet projektive më së shumti përdoret në rastet kur psikologu shkollor:

- A) Ka një përjasje psikoanalitike dhe kërkon të kuptojë konflikte të pandërgjegjshme te nxënësi apo fëmija;
- B) Kërkon të zhvillojë një raport besimi me nxënësin apo fëmijën;
- C) Kërkon të marrë informacione shtesë për nxënësin apo fëmijën;
- D) Kërkon të vlerësojë shkallën e sjelljeve manipuluese të nxënësit apo fëmijës.

Pyetja 73

Një mësues konsultohet me psikologun në lidhje me sjelljen e një nxënësi. Mësuesi shprehet se kur ai e urdhëron nxënësin të qëndrojë në klasë gjatë pushimit të madh për të mbaruar detyrat, nxënësi rebelohet, shfaq sjellje kundërshtuese, nuk zbaton rregullin dhe del jashtë klasës. Kjo sjellje sa vjen e përkeqësohet. Psikologu del në konkluzionin se mësuesi:

- A) Ka përforcuar negativisht sjelljen e nxënësit;
- B) Ka përforcuar nxënësin për sjelljen e tij;
- C) Ka përforcuar pozitivisht sjelljen e nxënësit;
- D) Ka vepruar në mënyrë të nxituar sepse fëmijët kanë nevojë për pushim.

Pyetja 74

Mësuesja e një klase informon psikologun për rastin e një nxënëseje adoleshente që kërcënon me jetë dy nxënese në klasë, të cilat vazhdimisht e kanë tallur dhe ofenduar. Shënimi është shumë i detajuar për planin e saj. Cili është reagimi i parë i psikologut shkollor në këtë situatë?

- A) Informon prindërit e nxënësve që janë kërcënuar;
- B) Informon prindërit e nxënëses që ka kërcënuar;
- C) Informon stafin drejtues të shkollës;
- D) Informon organet policore.

Pyetja 75

Mësuesja informon psikologun për një nxënës adoleshent që vazhdimisht ul kokën dhe nuk përfshihet në aktivitetet mësimore. Nxënësi duket shumë i trishtuar dhe i pashpresë. Psikologu shkollor gjatë këshillimit me nxënësin vëren se ai ka besimin se gjërat e këqija i ndodhin vetëm atij, dhe se nuk ka kontroll ndaj asnjë gjëje në jetën e tij. Sipas psikologut, ky nxënës shfaq:

- A) Lokus kontrolli të jashtëm;
- B) Lokus kontrolli të brendshëm;
- C) Besime negative;
- D) Pesimizëm.

Pyetja 76

Mësuesi informon psikologun shkollor për rastin e një nxënësi i cili detyrat e shtëpisë i bën shumë mirë por në klasë nuk bën asnjë detyrë dhe duket i shpërqëndruar. Në konsultën me psikologun shkollor, prindi i shpreh atij se ai i bën detyrat e fëmijës së tij në shtëpi, pasi të ishte për fëmijën nuk i bënte ato. Psikologu i shpjegon se kjo sjellje e tij:

- A) Dëmton vetë-besimin e fëmijës;
- B) Rrit pavarësinë e fëmijës ndaj prindit;
- C) Zhvillon motivimin e fëmijës për të bërë detyrat në të ardhmen;
- D) Zhvillon empatinë e fëmijës.

Pyetja 77

Një psikolog gjatë këshillimit me një nxënës që shfaq sjellje impulsive në klasë, e pyet nxënësin të thotë se çfarë ndodh me të para sjelljes. Ai shprehet se në moment që i vjen për të bërë diçka ai thotë me vete se nuk mund të prese, por menjëherë duhet të bëjë atë që i vjen në mendje, dhe kjo gjë bëhet më e fortë kur mësuesja e ndalon dhe e ngre tonin e zërit. Duke u bazuar te ky informacion, çfarë lloj vlerësimi po ndërmerret psikologu?

- A) Vlerësim autentik;
- B) Vlerësim të faktorëve që ndikojnë sjelljen e fëmijës;
- C) Vlerësim dinamik të sjelljes;
- D) Vlerësim funksional të sjelljes.

Pyetja 78

Gjatë vlerësimit për rrezikshmërinë e një kërcënimi në shkollë, ku bazohet grupi i vlerësimit për të marrë informacionin e nevojshëm për të bërë vlerësimin?

- A) Intervista me mësuesit, nxënësit dhe prindërit;
- B) Intervista me nxënësin që bën kërcënimin, prindërit, stafin mësimor dhe bashkëmoshatarët;
- C) Intervista me nxënësin që bënë kërcënimin, nxënësit që janë ndjerë të kërcënuar, dhe prindërit;
- D) Intervista me mësuesen kujdestare, prindërit dhe nxënësin që ka bërë kërcënimin.

Pyetja 79

Gjatë një interviste me një nxënës që ka bërë kërcënim në shkollë, ai shprehet se ka përdorur dhunë më përpara, shprehet së në shkollë asnjë se kupton, në klasë mësuesit nuk e ndihmojnë dhe ai është në rrezik për të përsëritur vitin, si dhe në disa raste del me thikë nga shtëpia. Nga këto thënie cila është thënia më shqetësuese për psikologun që tregon se kërcënimi ka rrezikshmëri të lartë?

- A) Nxënësi në disa raste mban thikë me vete;
- B) Nxënësi ka shfaqur sjellje agresive më parë;
- C) Nxënësi ka rezultate jo kaluese;
- D) Nxënësi është armiqësor ndaj mësuesëve.

Pyetja 80

Grupi i vlerësimit të rrezikshmërisë së kërcënimit të një nxënësi, në përfundim konkludoi që nxënësi ka bërë kërcënim me qëllim për të lënduar nxënësin tjetër përtej situatës momentale. Grupi i vlerësimit i përbërë nga stafi drejtues, psikologu, mësuesi kujdestar i nxënësit vendosi që nxënësit t'i lejohet të ndjeke shkollën vetëm pasi të hartohet një plan për menaxhimin e situatës duke ulur rreziqet për kërcënime të tjera. Cili është elementi kyç i këtij plani që e bën atë efikas?

- A) Duhet të ndodh zbatohet plani në me ndihmën e psikologut;
- B) Duhet që nxënësit t'i bëhet një vlerësim i shëndetit mendor nga ekipi multidisiplinar;
- C) Duhet që nxënësi të mbikëqyret si në shkollë dhe në shtëpi;
- D) Duhet që nxënësi të bëjë terapi grupi për menaxhimin e sjelljeve të dhunshme.

Pyetja 81

Një psikolog shkollor po ndërmerr një trajnim për dhunën në shkollë. Një mësues e pyet nëse ka ndikim dhuna në televizor për sjelljet agresive. Psikologu duke u bazuar te studimi i Bandurës përgjigjet:

- A) Fëmijët nuk e mësojnë sjelljen agresive nga televizori por nga të afërmit e tyre;
- B) Fëmijët mësojnë sjellje agresive duke parë televizor ose duke vëzhguar të tjerët;
- C) Ndikimi i dhunës në televizor është shumë i ulët krahasuar me ndikime të tjera;
- D) Prindërit me sjellje agresive janë faktori kryesor i sjelljeve agresive të fëmijët.

Pyetja 82

Një psikolog shkollor ka bërë një vlerësim të sjelljeve përshtatëse dhe keqpërshtatëse të fëmijës duke përdorur një instrument të standartizuar. Nga rezultatet e marra nga fëmija, nëna dhe babai dalin dallime të mëdha. Fëmija ka dhënë pikëzimin më të ulët, ndërsa nëna pikëzimin më të lartë. Këto dallime ekstreme të rezultateve vijnë si pasojë e:

- A) Gabimeve që lidhen me instrumentin, si vlefshmëri e ulët dhe besueshmëri e ulët;
- B) Faktorëve të ndryshëm që ndikojnë sjelljen e fëmijës në situata të ndryshme;
- C) Prindërit ose fëmija nuk kanë qënë të vëmendshëm në plotësimin e instrumentit;
- D) Perceptimeve të ndryshme që kanë fëmija dhe prindërit për sjelljet përshtatëse dhe keqpërshtatëse.

Pyetja 83

Sipas psikologëve të edukimit, një nga mënyrat për të nxitur arritjet akademike të nxënësve që shfaqin sjellje jo adaptive është duke zhvilluar motivimin e brendshëm. Cilën strategji përdorin psikologët shkollorë për të zhvilluar këtë motivim?

- A) Ofrimin e alternativave dhe mundësitë për të zgjedhur vetë;
- B) Përdorimin e përforcuesve pozitivë dhe negativë;
- C) Përdorimin e lavdërimeve pas sjelljeve të dëshirueshme;
- D) Përdorimin e shpërblimeve të menjëhershme pas çdo performance të arrirë.

Pyetja 84

Një psikolog shkollor është përballur me shumë referime të mësuesve për nxënës që shfaqin sjellje kundërshtuese, bullizëm dhe vandalizëm. Ai po planifikon:

- A) Të implementojë një program kundër dhunës në shkollë me ndihmën e stafit;
- B) Të shpërndajë një anketim për nxënës që të hulumtojnë përhapjen e bullizmit në shkollë dhe nevojat e nxënësve;
- C) Të bashkëpunojë me stafin drejtues për të implementuar programe për sjelljet pozitive;
- D) Të bëjë një konsultë me stafin e shkollës dhe drejtorin për të parandaluar probleme të tilla në të ardhmen.

Pyetja 85

Stafi drejtues i shkollës i kërkon psikologut të bëjë një vlerësim se sa efikase ka qënë ndërhyrja për disiplinën pozitive në shkollë. Psikologu ndërmerr një vlerësim të nevojave në lidhje me këtë ndërhyrje dhe më pas prezanton gjetjet. Gjatë prezantimit të gjetjeve për vlerësimin e nevojave cila nga çështjet e mëposhtme është më e rëndësishme të diskutohen?

- A) Pengesat më të mëdha që janë hasur në implementimin e ndërhyrjes për disiplinën pozitive në shkollë;
- B) Diskriminimin dhe paragjykimin që i bëhet nxënësve që vijnë nga zonat rurale;
- C) Rekomandimin e mënyrave se si prindërit mund të përfshihen në hartimin e ndërhyrjeve për disiplinën pozitive;
- D) Analizimi i politikave të shkollës dhe rregullores së saj të sjelljeve të nxënësve.

Pyetja 86

Një nxënës i thotë mësuesit se kur ishte në tualet, dy nxënës të klasave të teta e kërcënuan se do t'i merrnin varësen por dikush erdhi në tualet dhe nxënësit ikën me vrap. Mësuesja informon drejtorin e shkollës, dhe drejtori i shkollës konsultohet me psikologun. Ato intervistojnë nxënësit që bënë kërcënimin dhe vendosën:

- A) Që të bëjnë një kallëzim në polici;
- B) Që të bëjnë një vlerësim se sa i rrezikshëm është kërcënimin;
- C) Që të ndëshkojnë nxënësit që bënë kërcënimin me pezullim nga shkolla;
- D) Që nxënësit duhet të kërkojnë falje dhe të premtojnë që nuk do të bëjnë një veprim të tillë më.

Pyetja 87

Një nxënës Rom vjen pa libra dhe pothuajse nuk i bën asnjëherë detyrat. Mësuesja është e shqetësuar dhe konsultohet me psikologun për këtë rast. Psikologu thërret në një konsultë prindërit e fëmijës. Ato shprehen se nuk kanë para për të blerë librat e fëmijës, se shkolla nuk është e rëndësishme për fëmijën e tyre dhe nuk ofron punë, e se i çojnë fëmijët në shkollë vetëm se është e detyrueshme. Në këtë situatë cila është pengesa më e madhe që has nxënësi në integrimin e tij në shkollë?

- A) Mundësitë e pakta ekonomike të familjes;
- B) Mungesa e shërbimeve për fëmijët Rom në shkollë;
- C) Mungesa e mbështetjes së fëmijës në kontekste përtej kontekstit familjar;
- D) Vlerat kulturore të prindit për edukimin formal të fëmijës.

Pyetja 88

Në rastin kur një fëmijë Rom vjen në shkollë pa libra, fletore, pa bërë detyra dhe është i tërhequr nga të tjerët, si do të ndihmohej fëmija të integrohej në shkollë duke bashkëpunuar me agjensitë komunitare?

- A) Agjensitë komunitare mund të ofronin lojra me bashkëmoshatarë, në mënyrë që fëmija të socializohej me fëmijë të tjerë Rom;
- B) Agjensitë komunitare për Romët do të ofronin shërbime ekstrakurrikulare mbas shkollës;
- C) Agjensitë komunitare mund të ofronin mësimdhënie intensive, aktivitete ekstrakurrikulare mbas shkollës për nxënësin dhe trajnime prindërore;
- D) Agjensitë komunitare mund të ofronin shuma monetare për blerjen e materialeve shkollore.

Pyetja 89

Një mësues njofton menjëherë psikologun shkollor për rastin e një adoleshenti që në detyrat e klasës ka shkruajtur se si ai do të kryej vetëvrasje në ambientet e shkollës. Psikologu vjen në klasë dhe takon nxënësin duke u munduar të flasë e të bëj një vlerësim të plotë të rrezikut të adoleshentit për vetëvrasje. Cila është gjëja më kritike që psikologu duhet të bëj në këtë situatë?

- A) Të informojë stafin drejtues të shkollës;
- B) Të informojë prindërit për situatën dhe t'i marrë leje për të intervistuar adoleshentin;
- C) Të njoftojë një profesionist tjetër të shëndetit mendor për të bërë vlerësimin;
- D) Të mos e lë vetëm adoleshentin dhe te pasupervizuar.

Pyetja 90

Psikologut shkollor i kërkohet të drejtojë grupin për vlerësimin e rrezikut të kërcënimit në shkollën e tij. Roja e shkollës kapi një nxënës me një bidon benzine dhe në një fletë kishte emrin e disa mësuesve, që donte të hakmerrej për notat që i kishin vënë. Mbas intervistimit me nxënësin, grupi i vlerësimit vendosi se rreziku i kërcënimit ka qenë i lartë. Si veprohet në të tilla raste?

- A) Grupi i vlerësimit ndan informacionin me organet policore dhe më pas merret një vendim për rehabilitimin e nxënësit;
- B) Grupi i vlerësimit rikthen nxënësin në shkollë vetëm kur ai të kërkojë falje;
- C) Grupi i vlerësimit ndan informacionin me prindërit dhe së bashku marrin një vendim;
- D) Grupi i vlerësimit së bashku me prindërit dhe nxënësin hartojnë një plan për rikthimin e nxënësit në shkollë.

4. Etika profesionale e psikologut shkollor/ edukimit

Pyetja 1

Çdo psikolog shkollor në ushtrimin e profesionit të tij, duhet të udhëhiqet nga parimet dhe standardet e përbashkëta, të përcaktuar sipas:

- A)Kodit të Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve në RSH
- B)Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologëve
- C)Rregullores së Edukimit në Vazhdim në Psikologji
- D)Rregullores për Anëtarësim, Rregjistrim dhe Linçensim në UP

Pyetja 2

Parimi bazë i etikës profesionale të psikologut shkollor është:

- A)Konfidencialiteti
- B)Serioziteti
- C)Nervoziteti
- D)Formaliteti

Pyetja 3

Parimi i sjelljes etike profesionale të psikologut shkollor bazuar në krijimin e marrëdhënies së besimit me ata që punon, duke shmangur konfliktet e interesit, që mund të dëmtojnë të tjerët, ka të bëjë me:

- A)Përfitimin dhe mosdëmtimin
- B)Besimin dhe përgjegjësinë
- C)Respektin për të drejtat e njeriut
- D)Drejtësinë dhe integritetin.

Pyetja 4

Psikologët shkollorë e kanë të ndaluar të japin mësim, apo çdo veprimtari tjetër mësimore, në lëndët Sociologji, Filozofi, etj, pasi:

- A)Ai nuk mund të ushtrojë profesionin e tij si mësues lënde
- B)Ai nuk mund të ushtrojë kompetenca jashtë fushës së tij,
- C)Ai mund të ushtrojë kompetenca jashtë fushës së tij,
- D)Ai mund të ushtrojë profesionin e tij si mësues lënde

Pyetja 5

Psikologët shkollorë, gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, e kanë të ndaluar të:

- A)Delegojnë punën e tyre te të tjerët,
- B)Zhvillojnë dhe ruajnë kompetencat e tyre vazhdimisht
- C)Ofrojnë shërbime psikologjike në kushtet emergjence
- D)Përfshihen në ngacmime seksuale, apo sjellje poshtëruese.

Pyetja 6

Në punën e tij, psikologu shkollor konsultohet me mësuesin, rreth dosjes së një nxënësi, dokument i cili është konfidencial, si rrjedhojë psikologu shkollor:

- A) Duhet të vëj në dijeni mësuesin mbi gjeneralitetet e nxënësit
- B) Duhet të vëj në dijeni drejtorin e shkollës mbi gjeneralitetet e nxënësit
- C) Duhet të vëj në dijeni institucionet arsimore mbi gjeneralitetet e nxënësit
- D) Duhet të ruajë tërësisht anonimatën dhe privatësinë e nxënësit.

Pyetja 7

Psikologu shkollor administron të dhëna, që lidhen me punën profesionale dhe shkencore, me qëllim që:

- A) Të përmbushë kërkesat/detyrimet e dhëna nga institucioni ku punon
- B) Të mbrojë interesin më të lartë të nxënësve/fëmijëve
- C) Të promovohet nga të tjerët praktika e tij profesionale.
- D) Të promovohet në media, për të përfutur klientë/pacientë.

Pyetja 8

Në rastet kur një mësues referon te psikologu shkollor për testim një nxënës, për të ditur arsyen e sjelljeve të papërshtatshme të këtij të fundit, nuk përbën shkelje etike, nëse:

- A) Psikologu shkollor i bën të ditur vetëm mësuesit rezultatet e testimit
- B) Psikologu shkollor i bën të ditur vetëm sekretarisë shkollëre rezultatet e testimit
- C) Psikologu shkollor i bën të ditur vetëm klasës rezultatet e testimit
- D) Psikologu shkollor i bën të ditur të gjithë mësuesve rezultatet e testimit

Pyetja 9

Një ndër situatat më të zakonshme të psikologut shkollor është që mund të ndodhë që ai duhet të sqarojë kufizimin e konfidencialitetit tek nxënësi. Kjo situatë nuk përbën shkelje të etikës profesionale, pasi:

- A) Psikologu e ka gjykuar si të tillë, për të mirën e nxënësit duke marrë leje prej tij
- B) Psikologu e ka menduar si të tillë, për të mirën e shkollës duke marrë leje prej tij
- C) Psikologu e ka menduar si të tillë, për të mirën e klasës duke marrë leje prej tij
- D) Psikologu e ka menduar si të tillë, për të mirën e mësuesit duke marrë leje prej tij

Pyetja 10

Në rastet kur, raportet e vlerësimeve të nxënësve duhet të konsultohen nga psikologu shkollor me profesionistë të tjerë, vetëm për qëllime profesionale, psikologu shkollor mund të:

- A) Pasqyrojë rezultatet e vlerësimeve duke ruajtur konfidencialitetin e nxënësve
- B) Pasqyrojë rezultatet e vlerësimeve duke referuar të dhënat e nxënësve
- C) Pasqyrojë rezultatet e vlerësimeve duke cënuar konfidencialitetin e nxënësve
- D) Pasqyrojë rezultatet e vlerësimeve duke diferencuar të dhënat e nxënësve

Pyetja 11

Në rastet kur psikologu shkollor informon nxënësit për natyrën e shërbimit psikologjik, qëllimet e këtij shërbimi, si dhe kufizimet e mundshme që mund të vijnë nga ofrimi i këtij shërbimi psikosocial, përpara se nxënësit t'i ofrohet ky shërbim, ka të bëjë me:

- A)Parimin e konfidencialitetit
- B)Parimin e konfliktit të interesit
- C)Parimin e pëlqimit të informuar
- D)Parimin e diversitetit shoqëror

Pyetja 12

Bazuar në parimin e pëlqimit të informuar, psikologu shkollor duhet të:

- A)Marrë pëlqimin e drejtuesve me shkrim
- B)Marrë pëlqimin e mësuesve me shkrim
- C)Marrë pëlqimin e nxënësve me shkrim
- D)Marrë pëlqimin e bashkëmoshatarëve me shkrim

Pyetja 13

Në rastet kur psikologu shkollor kryen vëzhgime në klasë, pa marrë paraprakisht pëlqimin e informuar, ky i fundit:

- A)Ka vepruar në përputhje me etikën profesionale
- B)Ka vepruar në kundërshti me etikën profesionale
- C)Ka vepruar në kundërshti me normën shoqërore
- D)Ka vepruar në përputhje me normën shoqërore

Pyetja 14

“Psikologu shkollor duhet të ketë njohuri mbi kulturat e nxënësve të tij dhe të jetë në gjendje të tregojë kompetencë në ofrimin e shërbimeve që janë të ndjeshme për grupet kulturore”, ka të bëjë me:

- A)Parimin e konfidencialitetit
- B)Parimin e konfliktit të interesit
- C)Parimin e pëlqimit të informuar
- D)Parimin e diversitetit shoqëror dhe kulturor

Pyetja 15

“Psikologu shkollor përfshihet vetëm në praktika profesionale dhe që ruajnë dinjitetin e të gjithë atyre, me të cilën ata punojnë, të tregojnë respekt për autonomi, privatësinë e personave dhe trajtim të drejtë e të duhur të tyre”, ka të bëjë me:

- A)Parimin e respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të gjithë personave
- B)Parimin e ndershmërisë dhe integritetit në marrëdhëniet profesionale
- C)Parimin e kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë
- D)Parimin e diversitetit shoqëror dhe kulturor

Pyetja 16

“Psikologët shkollor duhet të respektojnë të drejtën e pronësisë intelektuale të atyre profesionistëve të tjerë që prodhojnë teste, material trajtimi, manuale etj”, ka të bëjë me:

- A)Parimin e respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të gjithë personave
- B)Parimin e ndershmërisë dhe integritetit në marrëdhëniet profesionale
- C)Parimin e kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë

D)Parimin e diversitetit shoqëror dhe kulturor

Pyetja 17

“Psikologu shkollor duhet të jetë besnik ndaj të vërtetës dhe t’i përmbahen premisave të tyre profesionale, të jenë të hapur ndaj kualifikimeve dhe bashkëpunojë me profesionistë të fushave të tjera”, ka të bëjë me:

- A)Parimin e respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të gjithë personave
- B)Parimin e ndershmërisë dhe integritetit në marrëdhëniet profesionale
- C)Parimin e kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë
- D)Parimin e diversitetit shoqëror dhe kulturor

Pyetja 18

“Psikologët shkollor promovojnë shkolla të shëndetshme, familje dhe mjedise komunitare të shëndetshme. Ata marrin një rol aktiv në identifikimin e padrejtësive sociale që çenojnë fëmijët dhe shkollat dhe inkurajojnë sjellje etike e prosociale te fëmijët”, ka të bëjë me:

- A)Parimin e respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të gjithë personave
- B)Parimin e ndershmërisë dhe integritetit në marrëdhëniet profesionale
- C)Parimin e kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë
- D)Parimin e përgjegjësisë ndaj shkollës, familjes, komunitetit dhe shoqërisë

Pyetja 19

Sipas parimit të konfidencialitetit, psikologët shkollorë duhet të:

- A)Jenë tepër të kujdesshëm në marrjen e miratimit të informuar para terapisë
- B)Jenë tepër të kujdesshëm në shmangien e konfliktit të interesit gjatë terapisë
- C)Jenë tepër të kujdesshëm në ruajtjen e anonimatit të nxënësve gjatë terapisë
- D)Jenë tepër të kujdesshëm në kuptimin e kulturave të nxënësve para terapisë

Pyetja 20

Bazuar në parimin e konfidencialitetit, psikologut shkollor i lejohe:

- A)Të ndajnë informacione rreth nxënësve vetëm me kolegët profesionistë të fushës
- B)Të ndajnë informacione rreth nxënësve vetëm me kolegët jo kompetent të fushës
- C)Të ndajnë informacione rreth nxënësve me të gjithë kolegët e institucionit shkollor
- D)Të ndajnë informacione rreth nxënësve me të gjithë kolegët e drejtorive arsimore

Pyetja 21

Sipas parimit të pëlqimit të informuar, psikologu shkollor, para se të ofrojë shërbimin psikologjik te nxënësit, duhet të:

- A)Marrin pëlqim me shkrim nga vetë nxënësit
- B)Japin pëlqim me shkrim tek vetë nxënësit
- C)Marrin pëlqim me shkrim nga vetë kolegët
- D)Japin pëlqim me shkrim tek vetë kolegët

Pyetja 22

Psikologu shkollor mund të ofrojë shërbimin psikologjik të nxënësit e moshave më të rritur, pa marrë pëlqimin e informuar nga prindërit, vetëm në rastet kur:

- A) Kjo lejohet me ligj për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve
- B) Kjo lejohet me vendime nga institucionet arsimore
- C) Kjo lejohet me rregullore të vetë shkollës
- D) Kjo lejohet me urdhra nga ministritë përkatëse.

Pyetja 23

Sipas parimit të konfliktit të interesit, psikologu shkollor duhet të:

- A) Injorohet nxënësit kur lind konflikti i vërtetë dhe të anashkaloj çështjen
- B) Diferencojë nxënësit kur lind konflikti i vërtetë dhe të anashkaloj çështjen
- C) Ofendojë nxënësit kur lind konflikti i vërtetë dhe të anashkaloj çështjen
- D) Informojë nxënësit kur lind konflikti i vërtetë dhe të marrë masa të zgjidhë çështjen

Pyetja 24

Në rastin kur psikologu shkollor ndeshet në konflikt interesi përkundrejt nxënësve të tij, dhe kur nuk gjendet asnjë zgjidhje e mundshme, ai detyrimisht duhet:

- A) Të ndërpresë marrëdhënien profesionale dhe të referojë nxënësin tek një profesionist tjetër.
- B) Të vazhdojë marrëdhënien profesionale me nxënësit nën mbikqyrjen e një profesionist tjetër.
- C) Të vazhdojë marrëdhënien profesionale me nxënësit nën mbikqyrjen e mësuesve të tjerë
- D) Të vazhdojë marrëdhënien profesionale me nxënësit nën mbikqyrjen e prindërve.

Pyetja 25

Sipas parimit të respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të gjithë personave, psikologët shkollorë, duhet të:

- A) Ofrojnë shërbim psikologjik për nxënësit të caktuar sipas preferencave të tyre vetjake.
- B) Tregojnë mosrespekt për autonominë e personave dhe të drejtë së tyre për vetëpërcaktueshmëri, për privatësinë si dhe trajtim diskriminues të të gjithë personave.
- C) Tregojnë respekt për autonominë e personave dhe të drejtë së tyre për vetëpërcaktueshmëri, për privatësinë si dhe trajtim të duhur të të gjithë personave.
- D) Ofrojnë shërbim psikologjik për nxënësit dhe prindërit të caktuar sipas preferencave të tyre vetjake.

Pyetja 26

Një psikolog shkollor, përveç se duhet të respektojë të drejtat e nxënësve për të ndarë mendimet, ndjenjat, besimet dhe sjelljet e tyre, ai gjithashtu duhet të:

- A) Kundërshtojë të drejtën e tyre për të qenë pjesëmarrës në vendimet që ndikojnë në mirëqënien e tyre.
- B) Respektojë të drejtën e tyre për të qenë pjesëmarrës në vendimet që ndikojnë në mirëqënien e tyre.
- C) Mohojë të drejtën e tyre për të qenë pjesëmarrës në vendimet që ndikojnë në mirëqënien e tyre.

D)Parandalojë të drejtën e tyre për të qenë pjesëmarrës në vendimet që ndikojnë në mirëqënien e tyre.

Pyetja 27

Bazuar në parimin e kompetencës profesionale dhe përgjegjësisë, një psikolog shkollor duhet:

- A)Të ushtrojë praktikën e tyre profesionale brenda njohurive shkencore psikologjike, fushës së tyre të studimit
- B)Të ushtrojë praktikën e tyre profesionale brenda njohurive shkencore sportive, fushës së tyre të studimit
- C)Të ushtrojë praktikën e tyre profesionale brenda njohurive shkencore mjekësore, fushës së tyre të studimit
- D)Të ushtrojë praktikën e tyre profesionale brenda njohurive shkencore gjuhësore, fushës së tyre të studimit

Pyetja 28

Një psikolog shkollor, duhet të ketë në vëmendjen e tij çdo herë parimin e kompetencës profesionale, sidomos në rastet kur:

- A)Duhet të përvetësojë të drejtën e pronësisë intelektuale të specialistëve që prodhojnë teste, materiale ndërhyrjeje etj.
- B)Duhet të respektojë të drejtën e pronësisë intelektuale të specialistëve që prodhojnë teste, materiale ndërhyrjeje etj.
- C)Duhet të marrë në konsideratë të drejtën e pronësisë intelektuale të specialistëve që prodhojnë teste, materiale ndërhyrjeje etj.
- D)Duhet të vlerësojë të drejtën e pronësisë intelektuale të specialistëve që prodhojnë teste, materiale ndërhyrjeje etj.

Pyetja 29

Sipas parimit të ndershmërisë dhe integritetit në marrëdhëniet profesionale, çdo psikolog shkollor duhet:

- A)Të jenë mospërfillës ndaj të vërtetës dhe t'i përmbahen premisave të tyre profesionale
- B)Të jenë manipulues ndaj të vërtetës dhe t'i shmangen premisave të tyre profesionale
- C)Të jenë deformues ndaj të vërtetës dhe t'i shmangen premisave të tyre profesionale
- D)Të jenë besnik ndaj të vërtetës dhe t'i përmbahen premisave të tyre profesionale

Pyetja 30

Çdo psikolog shkollor duhet të jetë i hapur ndaj kualifikimeve, të sinqertë dhe transparent lidhur me shërbimet psikologjike që ofrojnë, rolet e tyre profesionale, etj, me qëllim që:

- A)Të jenë komform ndaj parimit të ndershmërisë dhe integritetit në marrëdhëniet profesionale.
- B)Të jenë komform ndaj parimit të përgjegjësisë ndaj familjeve, shkollës, komunitetit dhe shoqërisë
- C)Të jenë komform ndaj parimit të respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të gjithë personave
- D)Të jenë komform ndaj parimit të diversitetit kulturor dhe shoqëror.

Pyetja 31

Çdo psikolog shkollor që ushtron profesionin e tij në institucione shkollore, nuk mund të jetë efikas në shërbimet ofruese, nëse ai:

- A)Nuk njih sesi funksionon shkolla, dinamikën e zhvillimit njerëzor, stilet e të nxënësve etj.
- B)Nuk njih sesi funksionon familja, dinamikën e zhvillimit njerëzor, stilet e të nxënësve etj.
- C)Nuk njih sesi funksionon shoqëria, dinamikën e zhvillimit njerëzor, stilet e të nxënësve etj.
- D)Nuk njih sesi funksionon jeta, dinamikën e zhvillimit njerëzor, stilet e të nxënësve etj.

Pyetja 32

Nën përgjegjësi të profesionale të çdo psikologu shkollor, ky i fundit duhet domosdoshmërisht të realizojë:

- A)Matje të inteligjencës dhe përdorim të testeve të personalitetit të nxënësve
- B)Matje të inteligjencës dhe përdorim të testeve të personalitetit të mësuesve
- C)Matje të inteligjencës dhe përdorim të testeve të personalitetit të prindërve
- D)Matje të inteligjencës dhe përdorim të testeve të personalitetit të drejtuesve

Pyetja 33

Përbën shkelje etike profesionale, nëse një psikolog shkollor në punën e tij:

- A)Promovon tolerancën, mirëkuptimin dhe diversitetin mes nxënësve
- B)Bashkëpunon me mësuesin, prindërit dhe drejtorin për nxënësve
- C)Ndërhyn nëpërmjet këshillimeve psikologjike për zgjidhjen e problemeve
- D)Mjekon me medikamente nxënësve me probleme të shëndetit mendor

Pyetja 34

Përbën shkelje etike profesionale, nëse një psikolog shkollor:

- A)Kryen vlerësime të drejtpërdrejta psikologjike me nxënësve
- B)Rekomandon medikamente nxënësve me vështirësi në të mësuar
- C)Konsultohet me prindërit e nxënësve me vështirësi në të mësuar
- D)Konsultohet me stafin pedagogjik për çështje të ndryshme të nxënësve

Pyetja 35

Një ndër përgjegjësi të profesionale të një psikologu shkollor, përveç shërbimeve psikologjike me nxënësve, është edhe:

- A)Ofrimi i shërbimeve psikologjike personale për prindërit në përballimin e stresit të punës
- B)Ofrimi i shërbimeve psikologjike personale për nxënësve në përballimin e stresit të punës
- C)Ofrimi i shërbimeve psikologjike personale për mësuesin në përballimin e stresit të punës
- D)Ofrimi i shërbimeve psikologjike personale për drejtuesin në përballimin e stresit të punës

Pyetja 36

Përbën shkelje etike profesionale, nëse një psikolog shkollor në disa praktika këshillimi:

- A)Informon gojarisht klientin mbi specifikat e këshillimit për miratimin e informuar
- B)Informon me shkrim klientin mbi specifikat e këshillimit për miratimin e informuar
- C)Informon publikisht klientin mbi specifikat e këshillimit për miratimin e informuar
- D)Informon interaktivisht klientin mbi specifikat e këshillimit për miratimin e informuar

Pyetja 37

Në rastin kur një psikolog shkollor është në dijeni, që një nxënës është me aftësi ndryshe, dhe njëkohësisht ai beson se mund të jetë homoseksual, nuk përbën shkelje të etikës profesionale nëse ai:

- A) Ndan me mësuesin detajin e homoseksualitetit dhe atë të aftësisë së kufizuar
- B) Ndan me mësuesin vetëm detajin e aftësisë së kufizuar dhe jo atë të homoseksualitetit
- C) Ndan me drejtorin detajin e aftësisë së kufizuar dhe atë të homoseksualitetit
- D) Nuk ndan me askënd as detajin e aftësisë së kufizuar as atë të homoseksualitetit

Pyetja 38

Në rast se psikologu shkollor thërret në zyrën e tij një nxënës me probleme të sjelljes për të ofruar shërbim psikologjik, dhe ky i fundit heziton të tregojë gjendjen e tij emocionale apo faktorët ndikues të çrregullimeve të sjelljes, sipas Kodit të Etikës, nënkuptohet se:

- A) Profesionisti nuk është treguar etik në institucion, ndaj nxënësi nuk beson tek ai
- B) Profesionisti është treguar etik në institucion, ndaj nxënësi beson tek ai
- C) Profesionisti është treguar etik në institucion, por nxënësi nuk beson tek ai
- D) Profesionisti nuk është treguar etik në institucion, por nxënësi beson tek ai

Pyetja 39

Nëse një nxënës me aftësi të kufizuar apo probleme të sjelljes kërkon të transferohet në një institucion tjetër arsimor, psikologu shkollor duhet që të transferojë dosjen në konfidencialitet të plotë, duke mundësuar:

- A) Dërgimin e një raporti zyrtar me shkrim bashkëshoqëruar me dosjen e nxënësit
- B) Dërgimin e notave mësimore përgjatë viteve shkollore të nxënësit
- C) Dërgimin e dëftesës shkollore vetëm të atij viti frekuentues të nxënësit
- D) Dërgimin e opinionëve dhe mendimeve të mësuesve për nxënësin.

Pyetja 40

Një psikolog shkollor në institucion e tij arsimor kryen një sondazh lidhur me efektet negative të përdorimit të lëndëve narkotike. Ai pasi jep sqarimet përkatëse lidhur me përmbajtjen e këtij sondazhi, e shpërndan atë te nxënësit. Në pyetësor psikologu ka vendosur hapësirën për të shkruar emër dhe mbiemër të nxënësit. Respektivisht psikologu nuk i është përmbajtur Kodit të Etikës, pasi:

- A) Ai ka marrë miratimin e informuar nga nxënësit
- B) Ai nuk ka marrë miratimin e informuar nga nxënësit
- C) Ai ka marrë miratimin e informuar nga nxënësit dhe ka ruajtur konfidencialitetin e nxënësve
- D) Ai nuk ka marrë miratimin e informuar nga nxënësit dhe nuk ka ruajtur konfidencialitetin e nxënësve

Pyetja 41

Shpesh herë ndodh që psikologët shkollorë në punën e tyre të mbajnë dhe leksione të hapura teorike mbi problematika të ndryshme të adoleshentëve dhe të rinjve. Për të qenë në përputhje me Kodin e Etikës, si dhe ligjit në fuqi, ata:

- A) Duhet që të vendosin referencat dhe autorët përkatës të literaturës së përdorur

- B)Nuk duhet që të vendosin referencat, por autorët përkatës të literaturës së përdorur
- C)Duhet që të vendosin vetëm autorët përkatës të literaturës së përdorur
- D)Nuk duhet që të vendosin as referencat as autorët përkatës të literaturës së përdorur

Pyetja 42

Çdo psikolog shkollor, me qëllim përmbushjen e plotë të nevojave të nxënësve, familjeve të tyre dhe për të shmangur marrëdhëniet e shumëfishta, që reduktojnë efikasitetin e tyre profesional, nuk mund të konsiderohet thyerje e etikës profesionale nëse:

- A)Ata nuk bashkëpunojnë me profesionistë të fushave të tjera profesionale
- B)Ata nuk bashkëpunojnë me profesionistë të së njëjtës fushë profesionale
- C)Ata bashkëpunojnë me profesionistë të fushave të tjera profesionale
- D)Ata bashkëpunojnë me joprofesionistë të fushave të tjera profesionale

Pyetja 43

Me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj nxënësve, familjeve, shkollës, si dhe promovimit të mirëqënies së fëmijëve, çdo psikolog shkollor inkurajohet për të kontribuar në njohuritë e fushës së psikologjisë, përmes:

- A)Pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së kërkimit shkencor
- B)Pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së kërkimit mjekësor
- C)Pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së kërkimit farmaceutik
- D)Pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së kërkimit inxhinierik

Pyetja 44

Shpesh herë psikologët shkollor mund të përjetojnë burn out, ose ngarkesa të mëdha emocionale, që ndikojnë negativisht në ushtrimin e përditshëm të profesionit të tyre. Në këtë rast, kundrejt psikologut shkollor nuk mund të quhet mungesë profesionalismi apo shkelje të Kodit të Etikës, nëse:

- A)Ai vetëkurohet me medikamente antidepressive
- B)Ai këshillohet te një profesionist i shëndetit mendor
- C)Ai vetëizolohet nën gjendjen e tij emocionale
- D)Ai dorëzohet nga heqja dorë e ushtrimit profesional

Pyetja 45

Gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, hapi i parë i çdo psikologu shkollor është mbajtja e shënimeve, mënyra e të cilave janë tërësisht individuale. Mbajtja e këtyre shënimeve, që janë të sakta e të qarta dhe mbi të gjitha të bazuara në fakte reale, nuk përbëjnë mungesë të zbatimit të Kodit të Etikës, por konsiderohen si të tilla kur këto shënime përmbajnë:

- A)Gjykime subjektive të pabazuara në fakte reale
- B)Shënime specifike për nxënësin në trajtim
- C)Shënime specifike për dosjen e nxënësit në trajtim
- D)Intervistime të nxënësit nëpërmjet miratimit të informuar

5. Këshillimi dhe konsultimi psikologjik në shkollë

Pyetja 1

Sipas studiuesve, shkolla si konceptualitet i të mësuarit, pajis nxënësit edhe me:

- A) Mundësi të të nxënit në formë dhe përbajtje
- B) Mundësi të të nxënit në distancë
- C) Mundësi të të nxënit në prezencë
- D) Mundësi të të nxënit përmes dijes së vazhdueshme

Pyetja 2

Përzgjedhja e një sjelljeje të caktuar për analizë në këshillimin në shkollë quhet edhe:

- A) Dinamizëm target
- B) Target kontekstual
- C) Target i kushtëzuar
- D) Variabël target

Pyetja 3

Fusha e këshillimit në shkollë filloi si lëvizje në Byronë Profesionale të Bostonit më 1909 nga:

- A) Lightner Witmer
- B) Wilhem Wundt
- C) Frank Parsons
- D) Thomas K. Fagan

Pyetja 4

Lloji i gabimit kognitiv që përfshin të menduarin dhe interpretimin në terma “të gjitha ose asgjë” ose kategorizimin e përvojave në “të thjeshta ose ekstreme” është i njohur si:

- A) Zmadhim ose ekzagjerim
- B) Të menduar polarizues
- C) Përfundim arbitrar
- D) Mbi-përgjithësim

Pyetja 5

Ndër shkathtësitë e këshillimit psikologjik që ndihmon nxënësin të vetëhapet është:

- A) Respektimi i kodit të heshtjes
- B) Të dëgjuarit
- C) Shfaqja e empatisë
- D) Vetë-hapja e këshilluesit

Pyetja 6

Cila nga të mëposhtmet nuk është pjesë e tagrit të punës të Konsulentit në shkollë:

- A) Vlerësimi psiko-emocional i nxënësit
- B) Raportimi i problematikave të drejtuesit të shkollës
- C) Mbështetja emocionale ndaj nxënësit
- D) Nxitja dhe përmirësimi i procesit të të nxënit të nxënësit

Pyetja 7

Në trajtimin e rasteve të bullizmit në shkollë, këshilluesit duhet të mbajnë në konsideratë edhe:

- A)Menaxhimin e ideve suicidave
- B)Menaxhimin e sjelljeve abuzuese me substancat
- C)Menaxhimin e sjelljeve të dhunshme të vetë të bullizuarit
- D)Menaxhimin e inatit dhe zemërimit të të bullizuarit

Pyetja 8

Qasja e këshillimit në shkollë me personin në qendër mbështetet në teorinë psikologjike të:

- A)James Bugental
- B)Carl Rogers
- C)Erich Fromm
- D)Louis Hoffman

Pyetja 9

Qasja e këshillimit në shkollë me qendër personin njihet ndryshe edhe si:

- A)Qasja Epistemiologjike
- B)Qasja Hedoniste
- C)Qasja Eudiamike
- D)Qasja Epistemike

Pyetja 10

Në tërësinë e tij të zhvillimit, këshillimi në shkollë përfshin:

- A)Praninë e më shumë se dy personave në marrëdhënie me njëri-tjetrin
- B)Aftësinë e këshilluesit për të zgjidhur problemet e të gjithë nxënësve me problematika psikologjike
- C)Veprimtari të kryera edhe nga punonjësit socialë në shkollë
- D)Kryerjen e konsultave të rregullta dhe të përditshme

Pyetja 11

Gjatë cilës fazë mund të vërehen lehtësisht dështimet e këshilluesëve/psikologëve shkollor në programet e këshillimit shkollor?

- A)Planifikimit
- B)Organizimit
- C>Zbatimit
- D)Vlerësimit të procedurave

Pyetja 12

Në tipologjinë e punës së Konsulentit në shkollë përfshihet edhe:

- A)Vlerësimi psiko-emocional i mësuesit
- B)Raportimi i përhershëm i problematikave të prindërit
- C)Mbështetja kognitive-sjellore e stafit pedagogjik
- D)Krijimi i protokolleve të vlerësimit psiko-social

Pyetja 13

Përdorimi i shprehjes “aha” nënkupton edhe një aftësi të këshilluesit si:

- A) Dëgjimin aktiv
- B) Shprehjen e empatisë
- C) Pranimin e pakushtëzuar pozitiv
- D) Kongruencën e vetes

Pyetja 14

Lejimi i analizës së rezistencave dhe marrja e insight të subjektit lidhet me funksionet e:

- A) Interpretimit të gjuhës jo-verbale
- B) Hezitimit
- C) Heshtjes
- D) Analizës së procesit të vetë-hapjes

Pyetja 15

Përsëritja fjalë për fjalë të asaj që na ka thënë nxënësi në këshillim, quhet edhe:

- A) Perifrazim
- B) Parafrazim
- C) Prefrazim
- D) Pentafrazim

Pyetja 16

Një nga funksionet e punës së këshilluesit psikologjik në shkollë është edhe:

- A) Të komentojë me kolegët detaje rreth rastit
- B) Të marrë paraprakisht Miratimin e Informuar nga kujdestarët ligjorë të fëmijës
- C) Të marrë në shqyrtim të gjithë historinë e zhvillimit të prindërve
- D) Të komentojë me mësuesit formën e ndërhyrjes

Pyetja 17

Vlerësimi i sjelljeve funksionale dhe disfunksionale të nxënësit lidhet me tipologjinë e ndërhyrjes:

- A) Sistemike
- B) Psikoedukative
- C) Psikofenomenologjike
- D) Funksionale

Pyetja 18

Vlerësimi diferencial njihet ndryshe edhe si :

- A) Diagnozë Diferenciale
- B) Këshillim Diferencial
- C) Oriëntim Diferencial
- D) Veçanti Diferenciale

Pyetja 19

Një program i mirë kurrikular i këshillimit në shkollë duhet:

- A)Të fokusohet në kushtet psikologjike të fëmijës
- B)Të fokusohet në kushtet juridike-politike të fëmijës
- C)Të fokusohet në kushtet e zhvillimit të fëmijës
- D)Të fokusohet në aftësitë reziliente të fëmijës

Pyetja 20

Ardi,16 vjeç shkon në shkollën e mesme, por, ai shpesh has vështërsi me konceptet abstrakte dhe nuk arrin dot të krijojë metafora. Në cilin stad të formimit intelektual ndodhet Ardi, referuar modelit të Piaget?

- A)Stadi post-formal
- B)Stadi i operacioneve konkrete
- C)Stadi i operacioneve formale
- D)Stadi i operacioneve fine

Pyetja 21

Zhvillimi i aftësive të inteligjencës emocionale përfshihet në:

- A)Qëllimet e këshillimit
- B)Objektivat e këshillimit
- C)Metodat e këshillimit
- D)Rezultatet e këshillimit

Pyetja 22

Vlerësimi holistik i nxënësit nga këshilluesi në shkollë nënkupton:

- A)Vlerësimin psikosocial
- B)Vlerësimin biopsikosocial
- C)Vlerësimin sociobiologjik
- D)Vlerësimin biopsikik

Pyetja 23

Këshillimi i nxënësve në perspektivë holistike, fenomenologjike dhe të orientuar drejt shoqërisë është pjesë e qasjes:

- A)Fenomenologjike
- B)Me personin në qendër
- C)Adleriane
- D)Holistike

Pyetja 24

Në modelin e të kuptuarit humanist në procesin e këshillimit në shkollë përfshihet:

- A)Pranimi i pakushtëzuar pozitiv
- B)Pranimi i kushtëzuar
- C)Pranimi i kushtëzuar pozitiv
- D)Pranimi i pakushtëzuar

Pyetja 25

Arsyetimi që përdorin nxënësit për të justifikuar stilin e tyre të jetës sipas qasjes së këshillimit Adlerian quhet:

- A)Logjikë e justifikimit
- B)Logjikë e dështimit
- C)Logjikë private
- D)Logjikë personale

Pyetja 26

Eksplorimi, ndërhyrja dhe fuqizimi janë pjesë e modelit:

- A)Të punës
- B)Tri-fazësh
- C)Pesë-fazësh
- D)Të ndërhyrjes

Pyetja 27

Në karakteristikat e një këshilluesi të mirë shkollor përfshihet edhe:

- A)Fleksibiliteti
- B)Inkurajimi
- C)Kontrolli
- D)Vetë-hapja

Pyetja e 28

Këshilluesit psikologjikë në shkollë që punojnë me fëmijët dhe adoleshentët:

- A)Njohin dhe zbatojnë të njëjtat parime etike si për të gjitha moshat e tjera
- B)Njohin dhe zbatojnë parimet etike vetëm për këto grupmosha
- C)Njohin dhe zbatojnë parimet etike të vendosura nga shkolla për trajtim
- D)Njohin dhe zbatojnë parimet etike të vendosura personalisht për trajtim

Pyetja 29

Cilët nga të mëposhtmet përbëjnë modelin e këshillimit tri-fazësh:

- A)Eksplorim-Analizë-Interpretim
- B)Eksplorim-Aleancë Terapeutike-Fuqizim
- C)Eksplorim-Ndërhyrje-Fuqizim
- D)Eksplorim-Fuqizim-Ndërhyrje

Pyetja 30

Trajtimi i familjarëve, miqve dhe të njohurve në këshillim, kundër rregullave etike, njihet edhe si:

- A)Marrëdhënie shfrytëzuese
- B)Marrëdhënie duale
- C)Marrëdhënie diadike
- D)Marrëdhënie devijante

Pyetja 31

Vepra e konsideruar si bazë e formimit të qasjes së këshillimit shkollor Ekzistencialist European i përket autorit:

- A)Rollo May
- B)Viktor Frankl
- C)Irvin Yalom
- D)Sigmund Freud

Pyetja 32

Gjatë këshillimit në shkollë me një nxënës ju i drejtoni atij pyetjen “A ka raste kur gjërat nuk shkonin dhe aq keq?” Sipas jush kjo pyetje bën pjesë në grupin e:

- A)Pyetjeve përjashtuese
- B)Pyetjeve përballuese
- C)Pyetjeve përshkallëzuese
- D)Pyetjet e mrekullisë

Pyetja 33

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme këshillimi mund të shërbejë si masë e ndërhyrjes së hershme:

- A)Kur një fëmijë me ADHD shihet se ka filluar të ketë probleme me kontrollin e impulsit
- B)Kur një adoleshent fillon të kuptojë se diçka po ndryshon në trupin e tij
- C)Kur një 39-vjeçar ka filluar të shfaqë probleme me pagjumësinë si pasojë e divorcit të para pak kohëve
- D)Kur një mësues ka probleme me përqëndrimin

Pyetja 34

Ndër faktorët që ndikojnë në efikasitetin e këshillimit në shkollë sipas qasjes me fokus-zgjidhjen përfshihen edhe:

- A)Faktorët e shpresës
- B)Faktorët e mjedisit
- C)Faktorët antropometrikë
- D)Faktorët e lumturisë

Pyetja 35

Teoria e zgjedhjes së aplikuar njihet ndryshe edhe si forma e këshillimit e mbështetur në:

- A)Teorinë e sjelljes së aplikuar
- B)Terapinë e realitetit të aplikuar
- C)Teorinë e zgjedhjes paradoksale
- D)Terapinë e racionalitetit në veprim

Pyetja 36

Parimi etik i ruajtjes së konfidencialitetit:

- A)Është i ndryshëm nga parimi juridik i ruajtjes së konfidencialitetit

- B) Është i njëjtë me parimin juridik i ruajtjes së konfidencialitetit
- C) Është i njëjtë me parimin e ruajtjes së personit nga mësuesit
- D) Është i ndryshëm nga parimi juridik i mbrojtjes së privatësisë së subjektit

Pyetja 37

Ndër elementët e domosdoshëm e këshillimit në shkollë përfshihet edhe:

- A) Të qenit një specialist i famshëm
- B) Të kesh një sens humori dhe të jesh motivues
- C) Të jesh një menaxhues i mirë i përgjegjësive
- D) Të jesh një specialist i disiplinuar dhe të jesh motivues

Pyetja 38

Ndër qëllimet e përdorimit të motivacionit dhe studimit në konsultimin në shkollë përfshihet edhe:

- A) Identifikimi i qëllimeve të pavetëdijshme për mospë suksesin
- B) Identifikimi i burimeve të forta të brendshme të subjektit
- C) Identifikimi i strategjive më të mira të të nxënësit
- D) Identifikimi i pikëpamjeve të nxënësit për ndryshim

Pyetja 39

Vlerësimi i fokusuar në sjelljet e caktuara përfshin:

- A) Sjelljen e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme
- B) Sjelljen në mjedis dhe funksionet e sjelljes
- C) Sjelljen e hapur dhe të fshehtë
- D) Sjelljen me të tjerët dhe funksionet e sjelljes

Pyetja 40

Studiuesit Frank & Frank përdorën termin “mjedis shërues” për të nënkuptuar:

- A) Aleancën terapeutike që synon të shndërrohet në trajtim për nxënës
- B) Instalimin e shpresës dhe motivacionit pozitiv në këshillim
- C) Krijimin e një mjedisi të ngrohtë dhe dashamirës në këshillim
- D) Rritjen personale të nxënësit në këshillim

Pyetja 41

Për të monitoruara dekursin e sjelljes agresive të nxënësit, shërben vrojtimi sistematik në një periudhë të paktën:

- A) Dy ditore
- B) Një javore
- C) Dy javore
- D) Dy mujore

Pyetja 42

Sipas qasjes së këshillimit shkollor me qendër personin në thelb të sjelljes të individit qëndron koncepti i:

- A) Vetes Reale
- B) Vetes Ideale
- C) Egocentrizmit
- D) Vetë-konceptit

Pyetja 43

Perceptimet unike të përvojave personale të lidhura me përvojat në qasjen e këshillimit shkollor me qendër personin quhen:

- A) Vetë-organizim
- B) Vetë-strukturim
- C) Vetë-ndërtim
- D) Vetë-konstrukt

Pyetja 44

Sipas Roxhersit, për të arritur procesin e vlerësimit organizmik janë të nevojshme:

- A) 4 gjendje të ndryshimit
- B) 5 gjendje të ndryshimit
- C) 6 gjendje të ndryshimit
- D) 7 gjendje të ndryshimit

Pyetja 45

Për qasjen e këshillimit shkollor me qendër personin, fëmijët e vegjël:

- A) Shprehen më mirë përmes lojës
- B) Shprehen më mirë përmes lojës dhe sjelljes
- C) Shprehen më mirë përmes imitimit të të rriturit
- D) Shprehen më mirë përmes vizatimit

Pyetja 46

Për qasjen e këshillimit shkollor me qendër personin, në zhvillimin e tyre, adoleshentët i:

- A) Japin rëndësi pavarësisë dhe bashkëmoshatarëve
- B) Japin rëndësi pavarësisë dhe mendimit personal
- C) Japin rëndësi pavarësisë dhe mendimit të të rriturve
- D) Japin rëndësi pavarësisë dhe mendimit të prindërve

Pyetja 47

Një ndër tiparet kryesore të punës së psikologut në shkollë është:

- A) Dhënia e këshillave dhe shmangia e konflikteve;
- B) Puna në dinamika triadike të konsultimit non-direktiv;
- C) Dëgjimi i problemeve dhe delegimi për zgjidhje te palët të treta;
- D) Shmangia e komunikimit të personalizuar

Pyetja 48

Studimet kanë treguar se një nga problematikat më të hasura të nxënësve nga psikologët shkollorë është:

- A)Çrregullimi i personalitetit Narcistik
- B)Çrregullimi Depresiv Madhor
- C)Çrregullimi i Vëmendjes me dhe pa Hiperaktivitetit
- D)Çrregullimi i Personalitetit Antisocial

Pyetja 49

Me masë ndërhyrjesh të hershme në këshillimin shkollor kuptojmë:

- A)Përgatitjen e planeve të ndërhyrjes të mundshme që në fillim të vitit shkollor
- B)Ndërhyrjen e menjëhershme që në shfaqjen e parë të simptomave
- C)Përgatitjen e protokolleve për ndërhyrje të herë-pas-hershme
- D)Ndërhyrjen në situata të traumash

Pyetja 50

Përdorimi i transferencës në procesin e këshillimit nxit:

- A)Procesin e vetë-reflektimit
- B)Procesin e individizimit të këshillimit
- C)Procesin e identifikimit projektiv
- D)Procesin e subjektivitetit të këshilluesit

Pyetja 51

Në tiparet dalluese të këshillimit në shkollë si process ndërhyrjeje përfshihet edhe:

- A)Protokollet e ndërhyrjes
- B)Analiza dhe interpretimi i psikopatologjisë
- C)Analiza e profilit të personalitetit
- D)Protokollet e parandalimit

Pyetja 52

Në përgatitjen e një programi kurrikular përfshihet edhe:

- A)Historiku i psikopatologjisë së zhvillimit të nxënësit
- B)Anamneza familjare e nxënësit
- C)Dhënia e këshillave për problem-zgjidhje
- D)Dhënia e orjentimeve për takimeve të mëtejshme

Pyetja 53

Planifikimi individual është pjesë përbërëse e:

- A)Modelit Individual të Udhëzimit
- B)Modelit Komunitar të Udhëzimit
- C)Modelit Gjithëpërfshirës të Udhëzimit
- D)Modelit Pedagogjik të Udhëzimit

Pyetja 54

Për vlerësimin e drejtë të Çrregullimit të Autizmit në shkollë, DSM 5 parashikon:

- A)1 Nivel
- B)4 Nivele

- C)2 Nivele
- D)3 Nivele

Pyetja 55

Në thelbin e problematikave të adoleshentëve sipas qasjes së këshillimit Adlerian qëndron:

- A)Inkurajimi
- B)Dekurajimi
- C)Individualiteti
- D)Individizimi

Pyetja 56

Mbështetur në analizën e stilit të jetës të Adlerit, Mosak ka kategorizuar:

- A)4 stile të jetës
- B)5 stile të jetës
- C)6 stile të jetës
- D)9 stile të jetës

Pyetja 57

Reduktimi i veprimtarisë së nxënësit për një arsye që vetëm ai e njeh, quhet :

- A)Apraksi
- B)Abuli
- C)Alogi
- D)Asocialitet

Pyetja 58

Nxënësit me Sindromin e Angelman manifestojnë simptomat e:

- A)Individëve që qeshin dhe janë vazhdimisht të lumtur
- B)Individëve që qajnë dhe janë vazhdimisht të trishtuar
- C)Individëve që kryejnë vazhdimisht grimasa
- D)Individëve që flasin dhe janë vazhdimisht të stimuluar

Pyetja 59

Teknika e “nëse”mbështetet në konceptin që nxënësit:

- A)Duhet të ndryshojnë personalitetin e tyre për të parë reagimin e të tjerëve
- B)Duhet të ndryshojnë sjelljen e tyre për të parë reagimin e të tjerëve
- C)Duhet të ndryshojnë karakterin e tyre për të parë reagimin e të tjerëve
- D)Duhet të ndryshojnë temperamentin e tyre për të parë reagimin e të tjerëve

Pyetja 60

Forma e keqtrajtimit, e cila reflektohet me mosregjistrimin në shkollë, braktisjen e shkollës, mosvëmendjen ndaj rezultateve shkollore, të nevojave materiale e të mungesës së interesimit në përgjithësi quhet:

- A)Keqtrajtim emocional
- B)Neglizhim edukativ

- C)Keqtrajtim psikologjik
- D)Keqtrajtim psikologjik/emocional

Pyetja 61

Sipas udhëzimeve të fundit të Kodit Etik të APA-s këshilluesit psikologjikë në shkollë:

- A)Nuk duhet të ndajnë të dhëna të vlerësimit me subjektin pasi ai mund ti keqinterpretojë ato
- B)Duhet të ndajnë të dhëna të vlerësimit me subjektin pasi kështu forcojnë aleancën terapeutike
- C)Nuk duhet të ndajnë të dhëna të vlerësimit me subjektin pasi ai mund të pësojë shqetësime të tjera emocionale
- D)Duhet të ndajnë të dhëna të vlerësimit me subjektin vetëm pasi ka marrë një rekomandim të shkruar nga eprori ose kujdestarët ligjorë të subjektit

Pyetja 62

Komunikimi me fëmijën ose adoleshentin në rast se ai/ajo ka nevojë për trajtim të specializuar:

- A)Bëhet në formë të qartë dhe të thjeshtë me vetë subjektin
- B)Bëhet në formë të qartë dhe të thjeshtë me mësuesin kujdestar
- C)Bëhet në formë të qartë dhe të thjeshtë me prindin ose kujdetarin ligjor
- D)Bëhet në formë të qartë dhe të thjeshtë me drejtuesin e shkollës

Pyetja 63

Mbështetur në parimet e Teorisë së Zgjedhjes, studiuesit kanë shqyrtuar:

- A)3 nevoja bazë universale të njeriut
- B)5 nevoja bazë universale të njeriut
- C)10 nevoja bazë universale të njeriut
- D)15 nevoja bazë universale të njeriut

Pyetja e 64

Sipas studiuesve, kur vlerësimi i këshilluesit të parë është kontradiktor:

- A)Raporti i tij i vlerësimit quhet i pavlefshëm juridikisht
- B)Rekomandimet e tij të vlerësimit bëhen të pavlefshme për trajtimin
- C)Vlerësimi të tij i shtohet edhe vlerësimi i një eksperti të dytë
- D)Vlerësimi të tij mund ti modifikohet pjesa e kontradiktës për ta bërë të pranueshëm

Pyetja 65

Një këshillues, i cili gjatë procesit të këshillimit synon të ndryshojë karakteristikat specifike të lidhura me fëmijën, duke krijuar ndryshime në një pjesë tjetër të një sistemi ose në një sistem tjetër për të mbështetur më mirë zhvillimin e fëmijës po përdor këshillimin:

- A)Bihevioral
- B)Kognitiv-bihevioral
- C)Ekobihevioral
- D)Bihevioral i bashkërenduar

Pyetja 66

Stadi i fundit i procesit të këshillimit lidhet me :

- A)Përfundimin
- B)Përfundimin dhe follow-up
- C)Follow-up
- D)Prognozën dhe përfundimin

Pyetja 67

Sipas Dobson dhe Dozois, të gjitha modelet e këshillimit të mbështetura në teorinë kognitive-sjellore përbëhen nga :

- A)Tre tipare kryesore
- B)Katër tipare kryesore
- C)Pesë tipare kryesore
- D)Gjashtë tipare kryesore

Pyetja 68

Cili nga pohimet e mëposhtme lidhur me programet kurrikulare të mirë-organizuara është një përfitim i fokusuar për psikologët :

- A)Siguron një supervizim më të mirë në praktikën e specializimit për këshilluesit e shkollës
- B)Siguron një integrim më të mirë të shkollës me mjedisin akademik
- C)Siguron dhënien e një ekspertize më të lartë përmes vlerësimit të grupit multidisiplinar
- D)Paraqet informacion për këshillimin në komunitet

Pyetja 69

Cili nga parimet e mëposhtme të punës së psikologut siguron monitorimin e kompetencave dhe efekshmërisë së tij:

- A)Parimi 3 Sistemet mbështetëse
- B)Parimi 6 Zhvillimi profesional
- C)Parimi 5 Supervizimi dhe mentorimi
- D)Parimi 2 Klima e punës

Pyetja 70

Në cilën nga situatat e mëposhtme “këshillimi parandalues parësor” është më i volitshëm:

- A)Kur më shumë se 50% e nxënësve janë raportuar me probleme të sjelljes në klasë
- B)Kur vetëm një nxënës është raportuar me probleme të sjelljes në klasë
- C)Kur e gjithë klasa është raportuar për probleme të sjelljes
- D)Kur vetëm mësuesi raportohet për mos-aftësi në menaxhimin e mirë të klasës

Pyetja 71

Kur një nxënës përpiqet të zgjedhë midis disa mundësive pas mbarimit të kolegjit dhe kërkon perspektiva nga bashkëmohatarët, anëtarët e familjes ose këshilluesi i shkollës, nxënësi po kërkon:

- A)Konsultim
- B)Këshillim
- C)Terapi

D)Rrahje mendimesh

Pyetja 72

Takoni një nxënës që në fillim duket shumë tërheqës,por më vonë ju zbuloni që ai/ajo manipulon shokët,lëndon të tjerët pa u menduar dy herë dhe nuk merr në konsideratë asgjë nga ajo që i thonë mësuesit.Çfarë problematike mund të ketë ky nxënës:

- A)Çrregullim të personalitetit Narcistik
- B)Çrregullim të personalitetit Borderline
- C)Çrregullim Depresiv Madhor
- D)Çrregullim të personalitetit Antisocial

Pyetja 73

Në linjën e këshillimit në shkollë, nxënësit me çrregullime të sjelljes njihen edhe si:

- A)Nxënës me çrregullime psikologjike
- B)Nxënës me çrregullime të brendësuara
- C)Nxënës me çrregullime të jashtëzuara
- D)Nxënës me çrregullime kognitive

Pyetja 74

Në vlerësimin e fëmijëve dhe adoleshentëve që i përkasin komunitetit Romë dhe Egjiptianë, këshilluesit duhet t'i referohen:

- A)Standardeve etike të UP të RSH
- B)Standardeve të Zhvillimit të Identitetit Etnik
- C)Standardeve të kriterit të IV-rt të DSM
- D)Standardeve të përgjithshme të trajtimit të të miturve

Pyetja 75

Ndër qëllimet e këshillimit në shkollë, të identifikuar nga Bugental, sipas qasjes Eksistencialiste përfshihet edhe:

- A)Njohja e subjektit me qenien e vet eksistencial
- B)Promovimi i subjektit për të ndryshuar drejt autenticitetit të tij
- C)Ndryshimi i gjendjes ambigje të subjektit për të marrë kontroll në sjelljen e tij
- D)Zhvillimi i kuptimit për veten në një linjë dialektike dhe të personalizuar

Pyetja 76

Në argumentat e tij për zhvillimin e qasjes së këshillimit shkollor Ekzistencialist, Bigelow përfshiu edhe parimin e:

- A)Takimit me asgjënë
- B)Takimit me panikun
- C)Takimit me frikën
- D)Takimit me veten

Pyetja 77

Ndër të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve në procesin e këshillimit përfshihet edhe:

- A) Të mos pranojnë këshillimin edhe kur ka një urdhër gjykatë për vlerësim psikologjik në shkollë
- B) Të mos pyeten për çështje dhe ngjarje që kanë rëndësi për procesin
- C) Të mos përfshihen në procesin e këshillimit pa lejen e shkruar të prindit ose kujdestarit
- D) Të mos përfshihen në procesin e këshillimit nëse ata nuk dëshirojnë të përfshihen

Pyetja 78

Sipas Gottlieb, identifikimi i sjelljeve jo-etike të këshilluesit ndikohet nga tre faktorë, që përfshijnë:

- A) Pushtetin, Kohëzgjatjen dhe Përfundimin
- B) Fuqinë, Kohëzgjatjen dhe Përfundimin
- C) Manipulimin, Kohëzgjatjen dhe Përfundimin
- D) Gënjeshtrën, Kohëzgjatjen dhe Përfundimin

Pyetja 79

Vlerësimi i sjelljes së përgjithshme sipas qasjes së teorisë së zgjedhjes është rezultat i:

- A) Veprimeve, dialogjeve të brendshme dhe emocioneve
- B) Veprimeve, kognicioneve dhe emocioneve
- C) Veprimeve, lokusit të kontrollit dhe emocioneve
- D) Veprimeve, zgjedhjeve dhe emocioneve

Pyetja 80

Në stadin e fundit të nevojave të përgjithshme dhe universale sipas qasjes së këshillimit me fokus zgjedhjen përshihen:

- A) Nevojat për vetë-aktualizim
- B) Nevojat për mbijetesë dhe mbrojtje
- C) Nevojat për vetë-efikasitet
- D) Nevojat për liri dhe pavarësi

Pyetja 81

Ndër manualët e përdorur për intervistimin e standardizuar me nxënësit përfshihet:

- A) DSM-V
- B) OPD-2
- C) ICD-11
- D) SCID-II

Pyetja 82

Në studimet e këshillimit psikologjik në shkollë është evidentuar se mosha e fëmijëve e prekur nga çrregullimet psikologjike të rënda varion në:

- A) 9-11 vjeç
- B) 10-15 vjeç
- C) 9-17 vjeç
- D) 10-17 vjeç

Pyetja 83

Në rastet e krizave shkollore psikologu shkollor bazohet më së shumti në:

- A)Parimin e sigurimit të një mjedisi vet-esplorues përgjatë menaxhimit të krizave
- B)Parimin e minimizimit të dëmit dhe maksimizimit të përfitimit përgjatë krizave
- C)Parimin e unifikimit të trajtimit dhe menaxhimit të krizave shkollore
- D)Parimin se të gjitha qëniet njerëzore janë të denja për respekt dhe kanë dinjitet

Pyetja 84

Në hipotezën funksionale sjellore ose të komunikimit të Carr përfshihet edhe:

- A)Vlerësimi i herë-pas-hershëm i sjelljes problematike
- B)Vlerësimi semestral i sjelljes problematike
- C)Vlerësimi funksional i sjelljes problematike
- D)Vlerësimi holistik i sjelljes problematike

Pyetja 85

Në procesin e inferioritetit organik,këshilluesit shkollorë të qasjes Adleriane vlerësojnë:

- A)Ndikimin e paaftësisë fizike në personalitet
- B)Ndikimin e pamjes së jashtme në vetë-vlerësim
- C)Ndikimin e zakoneve të të ngrënit në imazhin për veten
- D)Ndikimin e zakoneve të të ngrënit në personalitet

Pyetja 86

Në vlerësimin e çrregullimeve psikotike në shkollë të nxënësit,përfshihet:

- A)Asosacionet Laxas
- B)Inkognuencat e mendimit
- C)Deliret auditive
- D)Deliret kinestezike

Pyetja 87

Sipas studiuesve ndër faktorët ndikues në strukturimin e punës për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollë përfshihet:

- A)Dhënia e prioritetit për shkollim të integruar
- B)Dhënia e prioritetit për asistencë edukative
- C)Dhënia e prioritetit për shkollim me bazë komunitare
- D)Dhënia e prioritetit për shkollim të veçuar

Pyetja 88

Vlerësimi diferencial nga këshilluesi psikologjik në shkollë kryhet:

- A)Për të diferencuar një nxënës të talentuar nga të tjerët
- B)Për të diferencuar problematikën specifike të nxënësit
- C)Për të diferencuar kompetencat sociale të nxënësit
- D)Për të diferencuar problematikën sistemike të nxënësit

Pyetja 89

Sipas parimit të 5-të të punës së këshillimit në shkollë :

- A)Këshillimi është i drejtuar kah zhvillimit të nxënësit
- B)Këshillimi është i strukturuar sipas situatave të të nxënësit
- C)Këshillimi është një process me fokus parandalimin dhe trajtimin
- D)Këshillimi është një proces vullnetar për nxënësin

Pyetja 90

Nxënësit në moshën e adoleshencës do të ndihen të vlerësuar dhe kuptuar kur ata kanë mundësi:

- A)Të personalizojnë mjedisin dhe të mësojnë
- B)Të mësojnë përmes gabimeve
- C)Të nxisin të menduarit abstrakt
- D)Të ndihen të rëndësishëm

6. Metodatat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë së edukimit

Pyetja 1

Çfarë kanë të përbashkët metoda e anketimeve dhe metoda e vëzhgimit?

- A) Janë metoda eksperimentale;
- B) Janë metoda ku përdoren listë-kontrolle të sjelljes;
- C) Janë metoda gjysmë eksperimentale;
- D) Janë metoda përshkruese.

Pyetja 2

Kërkuesit shkencor kur kanë si qëllim të gjejnë lidhjen shkak-pasojë të një fenomeni, cilën metodë kërkimore përdorin?

- A) Studimin vezhgues;
- B) Studimin eksperimental;
- C) Studimin përshkrues;
- D) Studimin cilësor.

Pyetja 3

Në një studim eksperimental, variabli që studiuesi do të masë quhet?

- A) Variabël i matshëm;
- B) Variabël i varur;
- C) Variabël i pavarur;
- D) Variabli ndërmjetësues.

Pyetja 4

Kur rezultatet e një studimi kërkimor mund të përgjithësohen në popullatë, ky studim shfaq:

- A) Vlefshmëri të brendshme;
- B) Vlefshmëri të jashtme;
- C) Besueshmëri të brendshme;
- D) Besueshmëri të jashtme.

Pyetja 5

Kur në një studim lidhja shkak-pasojë shpjegohet nga variablat e marra në studim dhe jo faktorë të tjerë, studimi shfaq:

- A) Vlefshmëri të brendshme;
- B) Vlefshmëri të jashtme;
- C) Besueshmëri të brendshme;
- D) Besueshmëri të jashtme.

Pyetja 6

Çfarë tregon Alfa Kronbahut për një instrument?

- A) Vlefshmërinë e jashtme;
- B) Besueshmërinë e instrumentit;
- C) Vlefshmërinë e brendshme;
- C) Sa të ndarë janë faktorët që maten në instrument nga njëri-tjetri.

Pyetja 7

Cilat lloj pyetjesh kërkimore na ndihmojnë për zhvilluar një studim kërkimor ku priremi të kuptojmë përjasjen e pjesëmarrësve në studim dhe të marrim perspektivat e tyre për një fenomen?

- A) Pyetjet zbuluese;
- B) Pyetjet vlerësuese;
- C) Pyetjet shpjeguese;
- D) Pyetjet përshkruese.

Pyetja 8

Cilat lloj pyetjesh kërkimore na ndihmojnë kur hulumtojmë se sa i përhapur është një fenomen?

- A) Pyetjet zbuluese;
- B) Pyetjet vlerësuese;
- C) Pyetjet shpjeguese;
- D) Pyetjet përshkruese.

Pyetja 9

Cilat pyetje kërkimore na ndihmojnë kur kemi si qëllim të hulumtojmë shkaqet dhe pasojat e një fenomeni?

- A) Pyetjet zbuluese;
- B) Pyetjet vlerësuese;
- C) Pyetjet shpjeguese;
- D) Pyetjet përshkruese.

Pyetja 10

Si quhet variabli që është përgjegjës për ndikimin që një variabël ka te variabli tjetër?

- A) Variabël ndërmjetës;
- B) Variabël ndërlidhës;

- C) Variabël i pavarur;
- D) Variabël i varur.

Pyetja 11

Si quhet variabli që përforcon pozitivisht ose negativisht një lidhje ekzistuese midis dy variablash?

- A) Variabël ndërmjetës;
- B) Variabël ndërlidhës;
- C) Variabël i pavarur;
- D) Variabël i varur.

Pyetja 12

Si quhet një studim kërkimor që merr të dhëna numerike dhe ka si qëllim të përgjithësojë rezultatet?

- A) Studim përshkrues;
- B) Studim sasior;
- C) Studim cilësor;
- D) Studim eksplorues.

Pyetja 13

Cila nga alternativat është një disavantazh i kërkimit sasior?

- A) Studimi mund të parashikojë fenomene;
- B) Studimi është preciz në matjet që përdor;
- C) Studimi hulumton lidhje shkak-pasojë;
- D) Studimi thjeshtëzon natyrën komplekse të qenies njerëzore.

Pyetja 14

Si quhet lloji i studimit kërkimor që ka si qëllim të kuptojë përjasjet e pjesëmarrësve duke analizuar narrativat e tyre?

- A) Studim përshkrues;
- B) Studim sasior;
- C) Studim cilësor;
- D) Studim vlerësues.

Pyetja 15

Cila nga alternativat është një avantazh i kërkimit cilësor?

- A) Studimi cilësor ka vlefshmëri dhe besueshmëri;
- B) Studimi cilësor përsëritet;
- C) Studimi cilësor bën parashikim të sjelljes;
- D) Studimi cilësor vlerëson përvojën subjektive të pjesëmarrësve.

Pyetja 16

Operacionalizimi i koncepteve në një studim kërkimor nënkupton:

- A) Matjen e koncepteve me instrumenta;
- B) Dokumentimin e punës kërkimore;

- C) Matjen e koncepteve me intervista;
- D) Matjen e koncepteve me vëzhgime.

Pyetja 17

Grupi i pjesëmarrësve në studimin kërkimor quhet:

- A) Popullatë;
- B) Grupi eksperimentues;
- C) Grupi studimor;
- D) Kampionim.

Pyetja 18

Variabli që studiuesi manipulon për të parë ndikimin te një variabël tjetër quhet:

- A) Variabël i pavarur;
- B) Variabël i varur;
- C) Variabël bazik;
- D) Variabli ndërmjetës.

Pyetja 19

Variablat që kategorizohen si për shembull gjinia apo etnia quhen ndryshe?

- A) Variabla nominalë;
- B) Variabla ordinalë;
- C) Variabla të vazhdueshëm;
- D) Variabla me intervale.

Pyetja 20

Variablat që renditen pasi ka një dallim ndërmjet thënieve të instrumentit quhen:

- A) Variabla nominalë;
- B) Variabla ordinal;
- C) Variabla të vazhdueshëm;
- D) Variabla me intervale.

Pyetja 21

Ndryshe nga variablat kategorikë, variablat e vazhdueshëm:

- A) Kanë një numër të kufizuar vlerash numerike;
- B) Marrin çdo vlerë që nga më e ulta deri te vlera më e lartë në instrument;
- C) Janë të besueshëm dhe përdoren më shpesh;
- D) Lidhen me gjininë, kategoritë e moshës apo etninë.

Pyetja 22

Në rastin kur studiuesit, bëjnë disa matje tek i njëjti kampion studimor për të parë sa të qëndrueshme janë rezultatet e instrumentit, ata po testojnë:

- A) Vlefshmërinë e brendshme;
- B) Vlefshmërinë e instrumentit;

- C) Besueshmërinë;
- D) Standartizimin.

Pyetja 23

Një nxënës ka bërë progres në detyrat javore të shkrimit. Ajo ka marrë 3, 5, 5, 7, 9, dhe 10. Cila është mesatarja e këtij pikëzimi?

- A) 5.5;
- B) 6;
- C) 6.5,
- D) 7.

Pyetja 24

Kur intervista nuk është e planifikuar sipas një rendi pyetjesh quhet:

- A) Intervistë e pastrukturuar;
- B) Intervistë e strukturuar;
- C) Intervistë gjysmë e strukturuar;
- D) Intervistë eksploratore.

Pyetja 25

Cili është një nga avantazhet e intervistave të pastrukturuara?

- A) Është sistematike;
- B) Merr të dhëna të pasura dhe të verteta;
- C) E lehtë për të analizuar të dhënat;
- D) Nuk varet nga komunikimi midis intervistuesit dhe atij që bën intervistën.

Pyetja 26

Kur një intervistë është e planifikuar, ka një rend të organizuar pyetjesh quhet:

- A) Intervistë e pastrukturuar;
- B) Intervistë e strukturuar;
- C) Intervistë gjysmë e strukturuar;
- D) Intervistë eksploratore

Pyetja 27

Në rastin kur studiuesi, me anën e vëzhgimit, merr të dhëna sistematike në një mjedis të kontrolluar, ky vëzhgim quhet:

- A) Vëzhgim laboratorik;
- B) Vëzhgim autentik;
- C) Vëzhgim gjysmë i strukturuar;
- D) Vëzhgim në natyrë.

Pyetja 28

Një psikolog shkollor duke u bazuar në rezultatet e anketimit që bëri me nxënësit e shkollës, doli në konkluzionin se nxënësit që shfaqnin kompetenca më të larta emocionale kishin rezultate më të larta në shkollë. Cilën metodë kërkimore shkencore ka përdorur psikologu?

- A) Metodën eksperimentale;
- B) Metodën e intervistimit;
- C) Metodën cilësore;
- D) Metodën korrelacionale.

Pyetja 29

Një psikolog shkollor po implementon një program për menaxhimin e ankthit te nxënës që shfaqin probleme me ankthin. Psikologu po ndërmerr një studim gjysmë eksperimental me dy grupe (grupi i ndërhyrjes dhe grupi i kontrollit). Çfarë lloj variabli është ankthi në këtë studim?

- A) Variabël ndërmjetësues;
- B) Variabël i varur;
- C) Variabël i pavarur;
- D) Variabël bazik.

Pyetja 30

Një psikolog shkollor po implementon një program për menaxhimin e ankthit te nxënës që shfaqin probleme me ankthin. Psikologu po ndërmerr një studim gjysmë eksperimental me dy grupe (grupi i ndërhyrjes dhe grupi i kontrollit). Çfarë lloj variabli është programi për menaxhimin e ankthit?

- A) Variabël ndërmjetësues;
- B) Variabël i varur;
- C) Variabël i pavarur;
- D) Variabël bazik.

Pyetja 31

Një psikolog shkollor po studion ndikimin e përdorimit të substancave narkotike në braktisjen e shkollës nga adoleshentët. Në këtë studim, përdorimi i substancave narkotike është:

- A) Variabël i pavarur;
- B) Variabël i varur;
- C) Variabël ndërmjetësues;
- D) Variabëli moderues.

Pyetja 32

Një psikolog shkollor, mbasi përfundoi programin për menaxhimin e ankthit, vuri re se disa nxënës shfaqnin tipare të temperamentit që ndihmonin ose pengonin menaxhimin e ankthit pavarësisht nëse ishin pjesë apo jo e programit. Çfarë çënohet në këtë studim?

- A) Vlefshmëria e brendshme;
- B) Vlefshmëria e jashtme;
- C) Besueshmëria e programit;
- D) Vlefshmëria e matjeve të programit.

Pyetja 33

Psikologu shkollor vërejti se Alfa Kronbahut për instrumentin e ankthit ishte .87. Çfarë tregon kjo gjë për instrumentin?

- A) Pohimet e instrumentit të ankthit janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën;
- B) Pohimet e instrumentit bashkohen në një faktor të vetëm, që është ankthi;
- C) Pohimet e instrumentit kanë vlefshmëri të brendshme;
- D) Pohimet e instrumentit kanë vlefshmëri të jashtme.

Pyetja 34

Një psikolog shkollor kërkon të hulumtojë se cili grup të rinjsh ka më shumë probabilitet të bëhet përdorues i substancave narkotike? Çfarë lloj pyetje kërkimore po ngre psikologu?

- A) Pyetje zbuluese;
- B) Pyetje shpjeguese;
- C) Pyetje vlerësuese;
- D) Pyetje përshkruese.

Pyetja 35

Një psikolog shkollor do të hulumtojë nëse programet kundra bullizmit të fëmijët që bullizojnë do të ulin rastet e bullizmit në shkollën ku ai punon. Çfarë lloj pyetje kërkimore ngre psikologu?

- A) Pyetje zbuluese;
- B) Pyetje shpjeguese;
- C) Pyetje vlerësuese;
- D) Pyetje përshkruese.

Pyetja 36

Një psikolog shkollor do të hulumtojë se cilat janë përjetimet e adoleshentëve që vuajnë nga depresioni. Ai ka ndërmend të hartojë disa pyetje në lidhje me këtë fenomen dhe të bëjë dy intervista me adoleshentë që janë duke përjetuar depresion. Çfarë lloj pyetje kërkimore ngre psikologu?

- A) Pyetje zbuluese;
- B) Pyetje shpjeguese;
- C) Pyetje vlerësuese;
- D) Pyetje përshkruese.

Pyetja 37

Për psikologun shkollor marrja në intervistim është një proces i rëndësishëm i punës për të mbledhur të dhëna. Cila nga këto teknika të intervistimit ka vlefshmëri të lartë dhe e lejon psikologun të bëjë pyetje shtesë?

- A) Intervistat e standartizuara;
- B) Intervistat e pastrukturuara;
- C) Intervistat e strukturuara;
- D) Intervistat gjysmë të strukturuara.

Pyetja 38

Testet projektive mund të jenë efikase për të kuptuar më shumë rreth vlerësimit të fëmijës apo nxënësit, por ato janë kritikuar pasi:

- A) Kërkojnë specialistë që janë të trajnuar për të tilla teste;
- B) Koha për të ndërmarrë këto teste është shumë më e gjatë se për teste të tjera;
- C) Besueshmëria e këtyre testeve është më e ulët se e testeve të standartizuara;
- D) Këto teste nuk janë të vlefshme për t'u përdorur me nxënësit në shkolla.

Pyetja 39

Kur një studiues është i shqetësuar se fenomeni që po studion në laborator me një kampion të caktuar mund të mos ndodh njëjloj në mjedis natyral, studiues po shqetësohet për cilin lloj vlefshmërie të studimit?

- A) Vlefshmërinë ekologjike;
- B) Vlefshmërinë e brendshme;
- C) Vlefshmërinë e jashtme;
- D) Vlefshmërinë e instrumentit.

Pyetja 40

Shkallët matëse që vlerësojnë përgjigjen me një pikëzim nga 1 deri në 5, apo nga 1 deri 7, 1 deri në 10, përdorin cilin sistem vlerësimi:

- A) Vlerësim kategorik;
- B) Vlerësim numerik;
- C) Vlerësim sipas shkallës Likert;
- D) Vlerësim sistematik.

Pyetja 41

Një psikolog shkollor do të masë nëse mungesa e gjumit ndikon te rezultatet e testit të nxënësit në shkollë. Ai bën një studim pilot me nxënësit e një klase. Përpara se të bëjnë provimin, ato plotësojnë një anketë për orët e gjumit që kanë bërë gjatë javës dhe ditën para provimit. Psikologu nuk merr në konsideratë që ditën e provimit ka pasur një mot me diell dhe me temperatura shumë të larta. Temperatura e lartë konsiderohet si një variabël:

- A) Ndërmjetësues;
- B) Ndërlidhës;
- C) I pavarur;
- D) Ngatërrues.

Pyetja 42

Një psikolog në anketimin e tij grupon pjesëmarrësit sipas besimit fetar. Ky variabël quhet:

- A) Variabël me intervale;
- B) Variabël i pavarur;
- C) Variabël nominal;
- D) Variabël i vazhdueshëm.

Pyetja 43

Kur ne përdorim një variabël që vlerëson përgjigjet nga 1 deri te 5 (1 -aspak dakord dhe 5-shumë dakord), ky variabël quhet:

- A) Nominal;
- B) Ordinal;
- C) Me intervale;
- D) Kategorik.

Pyetja 44

Një psikolog shkollor do të përdor një instrument të ri për të vlerësuar sjelljet përshtatëse të nxënësit. Psikologu po përdor një klas pilot dhe gjatë javës ka bërë tre matje për testin e ri dhe ka krahasuar rezultatet. Cila është arsyeja që psikologu bëri një matje të tillë?

- A) Kërkon të testojë besueshmërinë e instrumentit;
- B) Kërkon të testojë vlefshmërinë e jashtme të testit;
- C) Kërkon të testojë vlefshmërinë e brendshme të testit;
- D) Kërkon të testojë besueshmërinë e thënieve të testit.

Pyetja 45

Një psikolog shkollor kërkon të bëjë disa intervista me prindër të shkollës për të hartuar një ndërhyrje për aftësitë prindërore. Shumë prindër refuzojnë në bëjnë intervista, por psikologu arriti të gjej disa prindër pasi vetë prindërit referonin prindër të tjerë që ato njihnin dhe kishin nxënësit në shkollë. Cilën teknikë ka përdorur psikologu për të zgjedhur kampionin e tij për intervistat?

- A) Përzgjedhja rastësore;
- B) Përzgjedhje e shtresëzuar;
- C) Teknikën e topit të dëborës;
- D) Teknikën e referimit.

Pyetja 46

Në një eksperiment për të testuar një ilaç për gjendjen e humorit depresiv, eksperimentuesi në njërin grup i jep ilaçin pjesëmarrësve që vuajnë nga gjendjet depresive, në grupin tjetër jep një multivitaminë, por i thotë pjesëmarrësve që po pijnë ilaçin dhe se mbas gjysmë ore do ndjehen të gëzuar dhe optimistë. Çfarë do të masë eksperimentuesi?

- A) Efektin placebo për të parë ndikimin e pritshmërive të pjesëmarrësve;
- B) Efektet psikologjike të marrjes së ilaçit dhe të mos marrjes së ilaçit;
- C) Nivelin e sugjestionimit të pjesëmarrësve që nuk marrin ilaçin;
- D) Ndikimin që ka ilaçi te grupi eksperimental në krahasim me grupin e kontrollit.

Pyetja 47

Një nga disavantazhet e vëzhgimit natyror është:

- A) Ka më pak vlefshmëri ekologjike;
- B) Ka më pak mundësi të vëzhgosh pjesëmarrësit;
- C) Është më i vështirë për t'u ndërmarrë;
- D) Është më pak realistë dhe spontan.

Pyetja 48

Një nga avantazhet e metodës së eksperimentit është:

- A) Të gjithë variablat në studim mund të kontrollohen;
- B) Përgjithësohen rezultatet e studimit;
- C) Rezultatet e marrë kanë vlefshmëri të lartë ekologjike;
- D) Vlefshmëria e instrumenteve është e lartë.

Pyetja 49

Statistika përshkruese përdoret:

- A) Për të testuar nëse të dhënat janë të vlefshme apo jo;
- B) Për të testuar nëse të dhënat janë të besueshme apo jo;
- C) Për të parë nëse ka ndonjë gabim në hedhjen e të dhënave apo jo;
- D) Për të përmbledhur të dhënat numerikisht.

Pyetja 50

Statistika analitike përdoret:

- A) Për të nxjerrë konkluzione për marrëdhëniet midis variablave;
- B) Për të analizuar homogjenitetin e kampionit të marrë në studim;
- C) Për të analizuar treguesit e tendencës qendrore;
- D) Për të analizuar mesataren dhe devijimin standart.

Pyetja 51

Një psikolog shkollor ka zbatuar një ndërhyrje kundra bullizmit në një klasë ku ka disa nxënës që shfaqin sjellje bullizuese. Psikologu përpara ndërhyrjes mori të dhëna për shkallën e bullizmit në këtë klasë. Ai ka bërë dy matje të tjera dhe në përfundim të semestrit do të bëjë matjen e fundit pas përfundimit të ndërhyrjes. Si quhet ky studim:

- A) Eksperimental;
- B) Ndërsektorial;
- C) Gjysmë eksperimental;
- D) Studim afatgjatë.

Pyetja 52

Si quhet lloji i studimit ku variablat nuk manipulohen por vëzhgohet lidhja e tyre?

- A) Studim korrelacional;
- B) Studim përshkrues;
- C) Studim ndërsektorial;
- D) Studim gjysmë eksperimental.

Pyetja 53

Një psikolog shkollor vëren se ka një lidhje të moderuar midis nivelit të ankthit dhe uljes së performancës akademike të nxënësit. Kjo lidhje korrelacionale është:

- A) E parashikueshme;
- B) Negative;
- C) Pozitive;

D) Neutrale.

Pyetja 54

Një psikolog shkollor vëren se sa më e madhe të jetë mbështetja prindërore për nxënësit adoleshentë, aq më të larta janë rezultatet shkollore të nxënësve. Kjo lidhje korrelacionale është:

- A) Lidhje e fortë;
- B) Lidhje pozitive;
- C) Lidhje negative;
- D) Lidhje shkak-pasojë.

Pyetja 55

Një psikolog shkollor mbas një muaji që nxënësi po merr ndërhyrje për zhvillimin e aftësive në matematikë dhe lexim, sheh se rezultatet e nxënësit janë jo të qëndrueshme, në disa raste ka ngritje dhe në të tjera ka ulje të rezultateve. Si e vlerësoni këtë luhatje të të dhënave?

- A) Të dhënat janë të besueshme pasi në muajin e parë të një ndërhyrje nxënësit shfaqin luhatje të arritjes akademike;
- B) Të dhënat duhet të interpretohen me kujdes për të kuptuar shkakun e kësaj luhatje;
- C) Të dhënat janë të pavlefshme dhe tregojnë se ndërhyrja nuk është e suksesshme;
- D) Të dhënat duhen rishikuar duke identifikuar variabla ngatërrues që të modifikohet ndërhyrja.

Pyetja 56

Një psikolog shkollor kërkon të bëjë një anketim për të gjithë nxënësit që të masë nivelin e ankthit gjatë provimeve dhe nëse ky nivel ndikon apo jo te nxënësit në arritjet e tyre. Psikologu për arritjet akademike do të përdorë mesataret e notave të nxënësve, ndërsa për nivelin e ankthit gjatë provimit do të përdorë një instrument të standartizuar me 12 pohime që masin këtë ankth. Psikologu në punën e tij kërkimore:

- A) Ka planifikuar natyrën e studimit;
- B) Ka bërë operacionalizimin e variablave kërkimore;
- C) Ka përcaktuar kampionin dhe pyetjet kërkimore;
- D) Ka përcaktuar hipotezat kërkimore.

Pyetja 57

Një psikolog ndërmori një anketim për të hulumtuar rreth qëndrimeve dhe sjelljeve seksuale të adoleshentëve me qëllim që të bëjë një ndërhyrje parandaluese dhe informuese për sjelljet seksuale. Prindërit u shqetësuan shumë për këtë pyetësor dhe u irrituan pasi psikologu nuk i kishte informuar. Ato bënë një ankesë në drejtori për psikologun shkollor. Cili është qëndrimi juaj në këtë rast?

- A) Psikologu duhet të merrte miratimin e informuar nga prindërit dhe adoleshentët, në këtë rast të mos përdoren të dhënat por të ribëj anketimin sipas rregullave etike të punës kërkimore;
- B) Edhe pse miratimi i informuar nuk është marrë, psikologu duhet të mirëkuptohet pasi qëllimi i tij është në mbështetje të adoleshentëve dhe uljes së rrezikut për marrëdhënie seksuale të hershme
- C) Psikologu duhet të kërkojë falje dhe të vazhdojë punën që ka nisur për këtë problem;

D) Psikologu duhet të bëj një takim me prindërit e revoltuar dhe t'i sqarojë qëllimin e studimit të tij.

Pyetja 58

Një psikolog shkollor do të hulumtojë se si ndikon një ndërhyrje për disiplinë pozitive te nxënësit që shfaqin sjellje kundërshtuese. Ai i ndan dy grupe me nxënës që shfaqin sjellje kundërshtuese. Grupi i parë mbas shkollës merr ndërhyrjen, ndërsa grupi i dytë nuk merr ndërhyrje. Përzgjedhja e nxënësve në grupe nuk ka qënë rastësore po sipas klasave. Si quhet ky studim:

- A) Eksperimental;
- B) Gjysmë eksperimental;
- C) Studim afatgjatë;
- D) Studim me matje para dhe pas ndërhyrjes.

Pyetja 59

Një psikolog shkollor do të ekzaminojë se si trajnimi i prindërve mund të ulë shkallën për sjellje rrezikuese tek adoleshentët që shfaqin sjellje të tillë. Psikologu në njërin grup të nxënësve i trajnon prindërit e tyre, te grupi i tjetër nuk i trajnon. Si quhet grupi në të cilin prindërit trajnohen?

- A) Grupi placebo;
- B) Grupi i kontrollit;
- C) Grupi e ndërhyrjes;
- D) Grupi eksperimental.

Pyetja 60

Një psikolog shkollor do të ekzaminojë se si ndikon trajnimi i mësuesve për disiplinën pozitive në klasë në uljen e rasteve që mësuesit referojnë për sjellje kundërshtuese të nxënësve. Ai përzgjedh mësuesit që referojnë më shumë raste nxënësish për thyerje të disiplinës dhe i ndan në dy grupe, grupi që do trajnohet dhe grupi që nuk do marrë trajnimin. Si quhet grupi që nuk do të marrë trajnimin?

- A) Grupi placebo;
- B) Grupi i kontrollit;
- C) Grupi eksperimental;
- D) Grupi krahasues.

Pyetja 61

Një psikolog shkollor ekzaminoi lidhjen midis metakognicionit dhe motivacionit në të nxënë te nxënësit. Fuqia korrelacionale doli .78. Rretho alternativën që përshkruan më mirë këtë lidhje korrelacionale?

- A) Lidhje negative e moderuar korrelacionale;
- B) Lidhje pozitive e moderuar korrelacionale;
- C) Lidhje e fortë pozitive korrelacionale;
- D) Lidhje e fortë negative korrelacionale.

Pyetja 62

Një psikolog shkollor vuri re se lidhja korrelacionale midis mbështetjes prindërore dhe motivacionit në të nxënë tek adoleshentët është .34, dhe $p > 0.05$. Çfarë tregon vlera p në këtë rast?

- A) Lidhja midis variablave ka ndodhur rastësisht, nuk ka rëndësi statistikore;
- B) Lidhja midis variablave ka ndodhur nga fuqia e lidhjes së dy variablave;
- C) Lidhja ka rëndësi statistikore por fuqia e lidhjes është e ulët;
- D) Lidhja korrelacionale ka rëndësi të ulët statistikore por është e vlefshme për ta përdorur si rezultat.

Pyetja 63

Një psikolog shkollor do të testojë nëse statusi socio-ekonomik i familjes lidhet me arritjet akademike të nxënësve në shkolla. Cilin test statistikor do të përdore psikologu?

- A) Analizën e variancës me një drejtim (ANOVA);
- B) Regresionin linear;
- C) Analizën e kovariancës (ANCOVA);
- D) Analizën faktoriale.

Pyetja 64

Një psikolog shkollor do të testojë një instrument të ri funksionet ekzekutive, i cili është i standartizuar në kontekste kulturore të ndryshme nga konteksti i psikologut. Cilin analizë statistikore do të ndërmarrë psikologu për të parë nëse testi ruan vlefshmërinë?

- A) Analizë faktoriale konfirmuese;
- B) Analizë faktoriale eksploruese;
- C) Regresion i shumëfishtë;
- D) Analizë e kovariancës.

Pyetja 65

Një psikolog shkollor duke u bazuar tek intervistat me fokus grup të disa nxënësve, ka hartuar një instrument vetë-raportues që mat stilet e të nxënësve. Cilin analizë statistikore do të përdorë psikologu për të testuar vlefshmërinë e instrumentit?

- A) Regresionin linear;
- B) Alfën e Kronbahut;
- C) Analizën faktoriale konfirmuese;
- D) Analizën faktoriale eksploruese.

Pyetja 66

Një psikolog shkollor do të hulumtojë faktorët e rrezikut për gjendjet depresive gjatë adoleshencës. Ai përcakton disa faktorë që lidhen me vetë-efikasitetin, kënaqësinë nga jeta të adoleshentit, stilin e prindërimit. Cilën analizë statistikore do të përdorë psikologu?

- A) Regresionin e shumëfishtë;
- B) Analizën e variancës me një drejtim;
- C) Analizën e kovariancës me shumë drejtime (MANCOVA);
- D) Metodën korrelacionale.

Pyetja 67

Një psikolog shkollor bëri një anketim me nxënësit e shkollës ku ai punon për të hulumtura mbi dallimet gjinore të nxënësve për sjelljet riskuese. Gjatë analizës përshkruese të të dhënave ai vuri re se 85% e të anketuarëve ishin vajza. Cili është qëndrimi juaj në këtë rast?

- A) Psikologu pavarësisht përqindjes së ulët përfaqësuese për djemtë mund të bëjë analizat përkatëse që i duhen për studimin e tij;
- B) Psikologu duhet të planifikonte me kujdes përfaqësimin e djemve dhe vajzave në studim;
- C) Psikologu duhet të përsërisë studimin pasi kampioni nuk është përfaqësues për popullatën e studimit;
- D) Psikologu duhet të marrë të dhëna shtesë për të rritur përfaqësimin e djemëve në studim.